

**VENDIME
TË PËRZGJEDHURA
TË KOLEGJIT PENAL
TË GJYKATËS SË LARTË
(2022 - 2026)**



**GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDIME
TË PËRZGJEDHURA
TË KOLEGJIT PENAL
TË GJYKATËS SË LARTË
(2022 - 2026)**



© Të drejtat e autorit në lidhje me përmbajtjen e këtij botimi, duke përfshirë
tekstin dhe fotot e përdorura, i takojnë Gjykatës së Lartë.
Tiranë, 2026

Përgatiti Aulona Hazbiu
Faqosja dhe kopertina Maluka print
Shtypur në Shqipëri nga “Maluka”

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe
të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit.
Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se
pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

VOLUMI III:

**VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË KOLEGJIT PENAL TË GJYKATËS
SË LARTË: MASAT E SIGURIMIT, SEANCA PARAPRAKE, GJYKIMI I
SHKURTUAR**

TABELA PËRMBLEDHËSE

FJALË HYRËSE10

I. Masat e sigurimit 15

1. Vendim njësues nr. 00-2021-1120 (55), datë 13.10.2021 (gjykata jo kompetente-moskompetencë prokuror hetime paraprake)..... 15
2. Vendim nr.205(44), datë 10.02.2022 (mbivendosje të masave të sigurimit: efekti i masës së re).....29
3. Vendim nr. 650 (172), datë 21.06.2022 (shuarje e masës së sigurimit personal: rivendosje në afat ankimi)32
4. Vendim nr. 00–2023–1230, datë 13.07.2023 (shuarje mase sigurimi personal: pezullim ekstradimi)36
5. Vendim nr. 00-2023-1329 (222), datë 25.07.2023 (shuarje/zëvendësim mase sigurimi personal: parim kontradiktoriteti)39
6. Vendim nr.00-2023-1602 (272), datë 12.10.2023 (sekuestro preventive: ekzistencë e minimumit të provave për elementet objektive të veprës penale)41
7. Vendim nr.00-2023-1935 (320), datë 21.11.2023 (revokim/zëvendësim mase sigurimi: rrethanat e reja)46
8. Vendim nr. 00–2024–432 (60), datë 07.03.2024 (masë sigurimi personal: humbje fuqie juridike - vendim penal i formës së prerë)52
9. Vendim nr. 00-2024-515 (76), datë 25.03.2024 (sekuestro provuese mjete pune/përmbajtje personale: propocionaliteti i masës)56
10. Vendim nr. 00-2024-1625 (195), datë 24.07.2024 (masë sigurimi personal: individualitet mase)63
11. Vendim nr. 00-2024-1421 (205), datë 13.09.2024 (masë e sigurimit personal: shqyrtim kërkesë për ekstradim)74
12. Vendim nr. 00-2024-1626 (246), datë 10.10.2024 (sekuestro preventive: ekzistenca e dyshimit se ka vepër penale / kërkesë për ndihmë juridike)78
13. Vendim nr. 00-2024-1856 (283), datë 19.11.2024 (sekuestro provuese: vendim prokurori, pezullim hetimi, send i vjedhur) ..84

14. Vendim njësues nr.00-2025-1007 (82), datë 27.03.2025 (verifikimi i nevojave të sigurimit: detyrueshmëria e pjesëmarrjes së prokurorisë).....88
15. Vendim nr. 00-2025-883, datë 29.05.2025 (zëvendësim i masës së sigurimit personal: gjykatë kompetente e fazës ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së kërkesës)..... 100
16. Vendim i Kolegjeve të Bashkuara 00-2026-736 (80), datë 09.04.2026 (arsyetimi i masës së sigurimit “arrest me burg” nga prokuroria dhe gjykata) 105

II. Seanca paraprake 125

17. Vendim njësues nr.00-2021-1134 (62), datë 01.11.2021 (afat paraburgimi që konsumohet gjatë seancës paraprake) 125
18. Vendim nr. 115 (53), datë 18.02.2022 (kufijtë e gjykimit në themel: kontroll/ plotësi e hetimeve paraprake) .. 139
19. Vendim nr. 1151 (183), datë 24.06.2022 (ekzistenca e provave të mjaftueshme për të mbështetur akuzën)..... 144
20. Vendim nr. 763, datë 05.07.2022 (kompetencë lëndore/funksionale: çështje të veçuara të të njëjtit procedim penal) 149
21. Vendim nr. 94 (23), datë 19.01.2023 (Pushim akuze: ndalim vlerësimi i provave/elementeve të figurës së veprës) 152
22. Vendim nr. 00-2024-1995 (298), datë 04.12.2024 (legjitimim për ankim ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake: viktimë e veprës penale - person juridik) 157
23. Vendim nr. 00-2025-1140 (180), datë 10.07.2025 (vlerësim i gjendjes së akteve/kërkesë gjykim i shkurtuar: pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar seancë paraprake/gjykim themel) 161
24. Vendim nr. 00-2025-1887, datë 02.12.2025 (kompetencë funksionale: shqyrtimi i të gjitha kërkesave që burojnë nga i njëjti procedim penal) 166
25. Vendim nr. 00-2025-1867 (293), datë 04.12.2025 (vendim për pushimin e çështjes: kompetencë e kufizuar/ analiza e thelluar tejkalim kompetence)..... 170

III. Gjykimi i shkurtuar 175

26. Vendim nr. 00-2021-739, datë 04.11.2021 (revokim vendimi gjykim i shkurtuar- ndryshim cilësimi juridik) 175

27. Vendim nr. 00-2022-29 (34), datë 27.01.2022 (refuzim i aplikimit të gjykimit të shkurtuar: ndryshim i cilësimit juridik-rrethanë rënduese)	178
28. Vendim nr. 00-2023-1078 (191), datë 30.06.2023 (mosrëndimi i pozitës së të pandehurit nga gjykata rishikuese)	181
29. Vendim njësues nr. 00-2024-2161 (167), 04.07.2024 (vepra penale/dënim me burgim të përjetshëm - mbetja në tentativë/cilësim tjetër juridik).....	193
30. Vendim njësues nr. 00-2025-2162 (275), datë 06.11.2024 (përsëritje shqyrtimi gjyqësor apeli - kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm përfitim ulje 1/3 e dënimit)	211
31. Vendim nr. 00-2025-1032 (163), datë 26.06.2025 (refuzim i aplikimit të gjykimit të shkurtuar: mosnjoftim personal i të pandehurit në seancë paraprake).....	236
32. Vendim nr. 00-2025-1402 (221), data 23.09.2025 (dënim me burgim të përjetshëm: ndalim procedural absolut që lidhet vetëm me natyrën e veprës).....	244
33. Vendim nr. 00-2025-1613 (255), datë 21.10.2025 (akses riti gjykimi: person juridik).....	249

**PARATHËNIE E KRYETARIT TË GJYKATËS SË LARTË
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**FOREWORD BY THE PRESIDENT OF THE SUPREME
COURT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA**

I nderuar lexues,

Është një kënaqësi e veçantë, që vijmë pranë jush sërish me një përzgjedhje të re të vendimeve më domethënëse të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në tre institute me rëndësi themelore për procedimin penal: *masat e sigurimit, seancën paraprake dhe gjykimin e shkurtuar*.

Përzgjedhja nuk është bërë vetëm mbi bazën e rëndësisë së çështjeve konkrete të zgjidhura, por, mbi të gjitha, duke pasur parasysh kontributin që këto vendime kanë dhënë në njësimin e praktikës gjyqësore dhe në zhvillimin e interpretimit të ligjit. Në një numër rastesh, ato kanë zgjidhur çështje juridike që për një kohë të gjatë kishin krijuar praktika divergjente në gjykata, duke ofruar standarde të qarta për zbatimin e Kodit të Procedurës Penale dhe duke harmonizuar jurisprudencën kombëtare me standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Viti 2026 shënon një vit të rëndësishëm, për praktikën e masave të sigurimit. Patjetër që kryefjala e kësaj kolone për nga rëndësia është vendimi për ndryshimin e pjesshëm të praktikës së njësuar të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të vitit 2011 mbi masat e sigurimit personal. Në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara vlerësuan nevojën për verifikimin e formulimeve të pjesës arsyetuese të cilat mund të kishin nevojë për qartësim, saktësim, standardizim, ndryshim ose zhvillim të mëtejshëm, për shkak të hapësirës që mund të kenë krijuar për kuptime jo të njëtrajtshme në praktikë. Në këtë mënyrë, ky mekanizëm procedural shërbeu për të forcuar vijimësinë, koherencën dhe përshtatjen e praktikës gjyqësore me standardet aktuale ligjore të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht të nenit 5 § 3 të Konventës, duke riafirmuar se masa “arrest në burg” përbën masën më të rëndë të sigurimit personal dhe, për rrjedhojë, duhet të zbatohet vetëm si *ultima ratio*, kur çdo masë tjetër më pak kufizuese rezulton e pamjaftueshme për të garantuar zhvillimin normal të procedimit penal. Ky zhvillim i praktikës njësuare vjen në konsolidim dhe të vendimit njësuar të vitit 2025, i cili në zgjidhjen e çështjes së pranisë së prokurorit në vlerësimin e masës në apel, riafirmoi se është detyrë e organit të akuzës që të paraqesë çdo herë arsye të përligjura mbi vijimin e masës së sigurimit.

Një vendim tjetër njësuar që meriton në mënyrë të veçantë, vëmendjen e lexuesit është dhe ai i vitit 2021, i cili zgjidhi një problem që kishte ndarë prej vitesh praktikën gjyqësore të vetë Kolegjit Penal: nëse neni 88 i Kodit të Procedurës Penale, i cili rregullon humbjen e fuqisë së masave të sigurimit të vendosura nga një gjykatë që më pas shpallet jokompetente, zbatohet vetëm për masat e sigurimit personal apo edhe për masat e sigurimit pasuror, siç është sekuestroja preventive. Përgjigjja e Kolegjit ishte e qartë: Dispozita nuk bën asnjë dallim sipas natyrës së masës së sigurimit dhe as *ratio legis* e saj nuk lejon një interpretim të tillë. Karakteri i përkohshëm dhe emergjent i çdo mase siguri të vendosur nga një gjykatë që ka vepruar jashtë kompetencës së saj materiale ose tokësore vlen njësoj si për masat që kufizojnë lirinë personale, ashtu edhe për ato që kufizojnë të drejtat pasurore.

Po aq të rëndësishme janë edhe vendimet mbi seancën paraprake dhe gjykimin e shkurtuar. Përvoja gjyqësore ka dëshmuar se zbatimi i këtij instituti ka ngritur ndër vite një sërë çështjesh interpretative, të cilat kanë bërë të domosdoshëm ndërhyrjen e Gjykatës së Lartë për të njësuar praktikën gjyqësore. Vendimet e përzgjedhura në këtë pjesë trajtojnë pikërisht këto problematika, duke sqaruar kushtet procedurale

për pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, rolin e gjykatës në shqyrtimin e saj, si dhe pasojat juridike që rrjedhin nga pranimi ose refuzimi i kësaj procedure. Këto vendime dëshmojnë një përpjekje të vazhdueshme për të balancuar dy interesa themelore: nga njëra anë, nevojën që procedimi penal të zhvillohet me efikasitet dhe pa vonesa të panevojshme; nga ana tjetër, detyrimin që çdo person të përballet me gjykimin vetëm pasi të jenë respektuar plotësisht garancitë procedurale që përbëjnë thelbin e procesit të rregullt ligjor. Një vlerë e shtuar e këtij botimi është përfshirja, aty ku ato ekzistojnë, e mendimeve në pakicë. Debati juridik është pjesë e natyrshme e zhvillimit të jurisprudence dhe mendimet në pakicë pasqyrojnë qasje alternative interpretimi, të cilat kontribuojnë në pasurimin e diskutimit shkencor dhe në transparencën e vendimmarrjes gjyqësore.

Gjatë viteve të fundit, Gjykata e Lartë ka qenë e angazhuar në një proces të pandërprerë modernizimi, me synimin për t'iu afruar më shumë qytetarëve dhe studiuesve të ligjit, duke përcjellë aktivitetin e saj me transparencë dhe në kohë reale. Për këtë arsye, për të dytin vit radhazi ky botim i veçantë, i realizuar me ndihmën e çmuar të Këshillit të Evropës, do të jetë i disponueshëm edhe në format elektronik duke u bërë lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë. Gjithashtu, nisur nga angazhimi dhe pjesëmarrja e GJL në forume ndërkombëtare ku ajo jep kontributin e saj për trajtimin e temave me rëndësi për gjykimin administrativ, civil e penal, u pa me vend që një informacion i shkurtër i këtyre vendimeve të jetë edhe në gjuhën angleze, duke u ardhur në ndihmë studiuesve të huaj ose atyre shqiptarë që prezantojnë vendimmarrjen e GJL jashtë vendit. Botimi i këtij viti vjen i pasuruar me risi të rëndësishme, jo vetëm në strukturë dhe përmbajtje, por edhe në qasjen ndaj përmbledhjes ligjore, duke synuar një paraqitje më të qartë dhe koncize të thelbit të çdo vendimi të përzgjedhur. E njëjta metodikë zbatohet për hedhjen e vendimeve në platformën JUDIX e cila vetëm brenda një viti është pasuruar me mbi dy mijë vendime të përzgjedhura. Në këtë udhëtim transformimi, në emër të Gjykatës së Lartë, shpreh mirënjohjen time për Këshillin e Evropës, i cili, përmes projektit “Mbrojtja e të drejtës së pronës dhe lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në Shqipëri” (D-REX III), ka qenë dhe mbetet një partner i palëkundur në rrugën tonë drejt botimit cilësor dhe bashkëkohor të vendimmarrjes së kësaj Gjykate. Mbështetja e tij ka qenë vendimtare jo vetëm për harmonizimin e jurisprudence shqiptare me atë të GJEDNJ-së, por edhe për forcimin e kapaciteteve të Gjykatës së Lartë, me qëllimin final të garantimit të drejtave themelore dhe ofrimit të një drejtësie efektive për të gjithë.

Qëllimi i këtij botimi është të ofrojë një instrument praktik pune për të gjithë profesionistët e së drejtës, duke sjellë në mënyrë të sistemuar zhvillimet më të rëndësishme të jurisprudence penale të Gjykatës së Lartë. Njëherazi, ai përfaqëson vijimësinë e nismës për dokumentimin dhe sistematizimin e jurisprudence së Gjykatës, me bindjen se botimet që do të pasojnë do të vijnë të mbështesin zbatimin e njëtrajtshëm të ligjit, zhvillimin e doktrinës dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Ju uroj një lexim të frytshëm!

SOKOL SADUSHI
Kryetar i Gjykatës së Lartë

Dear reader,

It is with great pleasure that we present to you a new compilation of the most significant decisions of the Criminal Chamber of the Supreme Court on three institutes of fundamental importance for criminal proceedings: *security measures, preliminary hearings and summary trial proceedings*. This selection has not been made solely on the basis of the importance of the individual cases decided, but above all, reflecting the contribution these judgments have made to the *harmonisation of judicial practice* and the continued development of the interpretation of criminal procedural law. In a number of instances, these decisions have resolved legal questions that had long given rise to divergent judicial approaches, establishing clear standards for the application of the Criminal Procedure Code while ensuring greater alignment between domestic jurisprudence and the case-law of the European Court of Human Rights.

The year 2026 marks a particularly significant milestone in the jurisprudence concerning personal security measures. Undoubtedly, the most important development in this field is the decision of the Joint Chambers of the Supreme Court partially revising their unified case-law established in 2011 on personal security measures. Through this judgment, the Joint Chambers recognised the need to revisit certain formulations contained in the reasoning of the earlier unifying decision that required clarification, refinement, standardisation or further development, in light of the differing interpretations they had generated in judicial practice. In doing so, the Court reinforced the continuity, coherence and adaptability of its jurisprudence, further developing the legal standards governing personal security measures in the light of the case-law of the European Court of Human Rights, particularly Article 5 §3 of the European Convention on Human Rights. The Court reaffirmed that pre-trial detention constitutes the most severe personal security measure and must therefore remain a measure of last resort (*ultima ratio*), applicable only where every less restrictive alternative proves insufficient to ensure the proper conduct of criminal proceedings.

This development further consolidates the Chamber's 2025 unifying decision, which, in addressing the issue of the prosecutor's participation during appellate review of detention measures, reaffirmed that it is incumbent upon the prosecution authority, in every instance, to demonstrate the existence of justified grounds warranting the continuation of the security measure. Another unifying judgment deserving particular attention is the 2021 decision, which resolved a legal issue that had divided the jurisprudence of the Criminal Chamber for many years: whether Article 88 of the Criminal Procedure Code, governing the lapse of security measures ordered by a court subsequently declared incompetent, applies exclusively to personal security measures or also extends to property security measures, such as preventive seizure. The Chamber's answer was unequivocal. The provision draws no distinction according to the nature of the security measure, nor does its *ratio legis* support such an interpretation. The temporary and urgent nature of any security measure ordered by a court lacking territorial or subject-matter jurisdiction applies equally to measures restricting personal liberty and those limiting proprietary rights.

Equally important are the judgments on the preliminary hearings and summary trial proceedings. Judicial experience has proven that the implementation of this institute has raised a number of interpretative issues over the years, which have necessitated the intervention of the Supreme Court to unify judicial practice. The judgments included in this publication address precisely these issues, clarifying the procedural conditions

governing the admission of requests for summary trial, the role of the court in examining such requests, and the legal consequences arising from their acceptance or refusal. Collectively, these decisions reflect the Court's continuing efforts to strike an appropriate balance between two fundamental objectives: on the one hand, ensuring that criminal proceedings are conducted efficiently and without unnecessary delay; on the other, safeguarding every individual's right to be tried only after full observance of the procedural guarantees that constitute the very essence of due process. An important added value of this publication is the inclusion, where applicable, of dissenting opinions. Legal debate is a natural part of the development of jurisprudence and dissenting opinions reflect alternative approaches to interpretation, which contribute to the enrichment of scientific discussion and the transparency of judicial decision-making. In recent years, the Supreme Court has remained continuously engaged in a process of institutional modernization, with the objective of bringing the Court closer to citizens and legal scholars alike by ensuring greater transparency and providing timely access to its activities. For this reason, and for the second consecutive year, this special publication, prepared with the invaluable support of the Council of Europe, will also be made available in electronic format, thereby ensuring its accessibility to all. Furthermore, in view of the Supreme Court's active participation in international forums, where it contributes to discussions on matters of importance to administrative, civil and criminal adjudication, it was considered appropriate to provide a brief summary of each selected judgment in English, thereby facilitating access for foreign scholars, as well as Albanian practitioners and academics presenting the jurisprudence of the Supreme Court abroad.

This year's edition introduces important innovations, not only in its structure and content, but also in its approach to legal reporting, with the objective of presenting the essence of each selected judgment in a clearer and more concise manner. The same methodology has been adopted for the publication of judgments on the JUDIX platform, which, within the space of a single year, has been enriched by the addition of more than two thousand carefully selected decisions. In the course of this process of transformation, and on behalf of the Supreme Court, I wish to express my sincere appreciation to the Council of Europe, which, through the project "Improving the protection of the right to property and facilitating execution of ECtHR judgments in Albania(D-REX III)," has been, and continues to be, a steadfast partner in our efforts to ensure the high-quality and modern publication of the Court's jurisprudence. Its support has proved instrumental not only in promoting the harmonization of Albanian case-law with that of the European Court of Human Rights, but also in strengthening the institutional capacity of the Supreme Court, with the ultimate objective of safeguarding fundamental rights and ensuring the effective administration of justice for all.

The purpose of this publication is to provide a practical working tool for all legal professionals by systematically presenting the most significant developments in the administrative jurisprudence of the Supreme Court. At the same time, it represents the continuation of the Court's initiative to document and systematize its case-law, in the conviction that future publications will continue to promote the uniform application of the law, the development of legal doctrine and the consolidation of the rule of law.

I wish you a rewarding and enriching reading.

SOKOL SADUSHI
President of the Supreme Court

VOLUMI III:

**VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË KOLEGJIT PENAL TË GJYKATËS
SË LARTË: MASAT E SIGURIMIT, SEANCA PARAPRAKE, GJYKIMI I
SHKURTUAR**

I. Masat e sigurimit



1. Vendim njësuës nr. 00-2021-1120 (55), datë 13.10.2021 (gjykata jo kompetente-moskompetencë prokuror hetime paraprake)

Sentencë njësuëse: Neni 88 i KPP zbatohet si për masat e sigurimit personal, ashtu dhe për masat e sigurimit pasuror. Gjykata që cakton masën e sigurimit, jo domosdoshmërisht është e njëjtë me gjykatën që shpall moskompetencën. Parashikimet e nenit 88 të KPP në lidhje me masën e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente, nuk zbatohen në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente, sipas nenit 84/1 të KPP.

Fjalë kyçe: masat e sigurimit me karakter pasuror, sekuestro preventive, humbjes së fuqisë së masës së sigurimit, moskompetencë prokurori, fazë seance paraprake

Unifying Decision no. 00-2021-1120 (55), dated 13.10.2021 (non-competent court - lack of prosecutorial competence in preliminary investigations)

Unifying sentence: Article 88 of the Criminal Procedure Code applies equally to personal security measures and property security measures. The court that initially orders the security measure is not necessarily the same court that subsequently declares its lack of jurisdiction. The provisions of Article 88 of the Criminal Procedure Code concerning the lapse of security measures ordered by an incompetent court do not apply where the prosecution declares its own lack of jurisdiction and transfers the case file to the competent prosecution office pursuant

to Article 84(1) of the Criminal Procedure Code.

Keywords: *security measures on property, preventive seizure, lapse of the security measure, prosecutorial lack of jurisdiction, preliminary hearing stage.*

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë [...] ka regjistruar procedimin [...] për veprat penale “Mashtrimi”, i kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të kryera në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 143/1, 333/a, 319 - 25, 319/c - 25, të KP, si dhe, në të njëjtën kohë, emrat e personave që ju atribuohen veprat penale të sipërcituara, të identifikuar në shtetasit A.D., D.H., A.D., E.S., me cilësinë (formale) e personave të hetuar.

Në kuadër të këtij procedimi penal, [...] gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj Gjykate, me [...], ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë [...] duke urdhëruar vendosjen e masës së sigurimit pasuror, të sekuestros preventive mbi pasuritë sipas objektivit të kërkesës.

Gjithashtu, me vendimin [...] gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj Gjykate ka vendosur heqjen e sekuestros të vendosur me vendimin nr. 16, datë 10.01.2018, të Gjykatës së [...] dhe vendosjen e sekuestros preventive, mbi 35 % të sipërfaqes së ndërtimit që do të realizohej mbi pasurinë [...] që do të regjistrohej, në ZVRPP Tiranë, pas nënshkrimit të aneks kontratës dhe kontratës së shkëmbimit midis palëve, për pjesën takuese të të hetuarës D.H.

[...] Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore për çështjen penale [...] Kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë si prokuroria kompetente në lëndë dhe territor.”

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të hetimeve paraprake, [...] i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën me objekt gjykimin e çështjes [...] ndër të tjera, në ngarkim të të pandehurës D.H., duke e akuzuar, për kryerjen e veprave penale; “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143/3 i KP, “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i KP, dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287/c i KP. Gjykata [...] ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. 7011, të vitit 2018.

Kërkuesja D.H. në datën 01.02.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë me kërkesën me objekt heqjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të vendosur, [..]

[..] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [..] ka vendosur rrëzimin e kërkesës.”

[..] Gjykata e Apelit Tiranë, [..] ka vendosur pranimin e kërkesës. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit pasuror të sekuestros, të vendosur me vendimin nr [..]Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të vendosur me vendimin [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji Penal [..] në shqyrtim të kushteve të pranueshmërisë së rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në dhomë këshillimi, [..] në respektim të detyrimit të tij për të “shqyrtuar çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs”, sikurse përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 434 të KPP, por pa paragjykuar të drejtën e kësaj Gjykate/këtij Kolegji “për të vendosur, kryesisht, edhe për çështje të ligjit” (pavarësisht shkaqeve të paraqitura në rekurs), sikurse përcaktohet në paragrafin e dytë të kësaj dispozite, vlerësoi se duhet gjykuar mbi bazueshmërinë në ligj të shkaqeve të parashtruara nëpërmjet rekursit, në kushtet e aplikimit të gabuar, prej Gjykatës së Apelit Tiranë, të ligjit procedural, konkretisht, të nenit 88 të KPP që parashikon “humbjen e fuqisë (efekteve) të masës së sigurimit të caktuar prej gjykatës, e cila, në të njëjtën kohë apo më vonë, shpallet jokompetente (për çdo lloj shkak), në qoftë se, brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit”.

Nga ana tjetër, Kolegji, [..]vlerësoi se në rastin konkret verifikohet ekzistenca e kushtit të parashikuar në pjesën e parë të nenit 432/1-a të KPP, të “mosrespektimit apo të zbatimit të gabuar të ligjit procedural”, duke vlerësuar, në të njëjtën kohë, edhe konkurrimin e kushteve për nisjen e procedurës të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 438 të KPP, pikërisht të gjykimit, për të njësuar praktikën gjyqësore.

Kolegji konstaton se ka qëndrime të ndryshme në lidhje me zbatimin e nenit 88 të KPP, kryesisht të kolegjeve të veçantë të Gjykatës së Lartë që, lidhur me aplikimin e përcaktimeve të kësaj dispozite, kanë operuar në mënyrë kontradiktore, duke pranuar, herë – herë, aplikimin e kësaj dispozite, pra nenit 88 të KPP dhe deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit të caktuar nga gjykata (gjyqtari për hetimet paraprake) edhe në rastin e deklarimit të moskompetencës nga ana e prokurorit gjatë hetimeve paraprake, për vazhdimin e këtyre hetimeve dhe të dërgimit, për pasojë, të çështjes tek prokurori kompetent (vendimet nr. 25 dhe

64 datë 29.04.2015, nr. 14, datë 30.03.2015 të këtyre kolegjeve); si dhe herë – herë, kanë disponuar edhe të kundërtën. Por, Kolegji konstaton se edhe gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me zbatimin e nenit 88 të KPP, situatë procedurale e verifikuar edhe në rastin konkret në shqyrtim.

Kolegji ka identifikuar si çështje me rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore, sa më poshtë vijon:

- ***A është i zbatueshëm neni 88 i KPP për masat e sigurimit pasuror apo është një dispozitë që i referohet vetëm masave të sigurimit personal?***
- ***Sipas përcaktimit të nenit 88 të KPP, gjykata që cakton masën e sigurimit a është e njëjtë me gjykatën që, në të njëjtën kohë ose më vonë, shpall moskompetencën?***
- ***A zbatohen parashikimet e nenit 88 të KPP edhe në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokurori dhe të dërgimit të akteve prokurorisë kompetente sipas përcaktimit të nenit 84/1- të KPP.***

Në funksion të zgjidhjes së problematikës kryesore, të vendosur në bazë të këtij gjykimi, Kolegji, në cilësinë e “aktorit” iniciues të procedurës së gjykimit njësues, ka detyrimin për tu prononcuar edhe lidhur me kuptimin, interpretimin e normës referuese, nenit 88 të KPP, aspekteve të veçanta të saj, të identifikuara në dy çështjet e para të renditura në objektin e këtij gjykimi njësues. Konkretisht, Kolegji, së pari, vlerëson të sqarojë nëse neni 88 i KPP zbatohet edhe për masat e sigurimit të karakterit pasuror, të sekuestros preventive, në rastin konkret, si dhe në mundësinë e interpretimit të zgjeruar të përcaktimit preçiz dhe univok të kësaj dispozite, për pjesën që bën fjalë për “identitetin” e gjykatës që cakton masën e sigurimit me gjykatën që, kontekstualisht apo më vonë, shpallet/deklarohet në kushtet e moskompetencës.

Në këtë kuadër, neni 88 i KPP, përmbajtja e tij, konsiderohet si një disiplinë e përgjithshme dhe organike për të gjithë lëndën e masave të sigurimit, të caktuara nga gjyqtari jokompetent dhe që, bashkë me nenin 87 të KPP, që bën fjalë për “provat e marra nga gjykata jokompetente”, janë shprehje e parimit të “konservimit/ruajtjes së akteve”. Neni 88 i KPP, sikurse qartazi (*ictu oculi*) evokon përmbajtja e tij, verifikohet i zbatueshëm, sidomos përsa i përket tipologjisë së ndryshme të masave të sigurimit, si të atyre më karakter personal, ashtu edhe të atyre shtrënguese, të parashikuara në nenin 232 të KPP apo të atyre ndaluese, të parashikuara në nenin 240 të KPP, po kështu edhe të atyre të karakterit real pasuror, të parashikuara në nenet 270 dhe 274 të KPP që bëjnë fjalë për masat e

sigurimit pasuror të sekuestros konservative dhe preventive. Në të njëjtën kohë, neni 88 i KPP, nuk gjen zbatim përsa i përket “sekuestros provuese”, e ashtuquajtura sekuestro penale, e parashikuar në nenin 208 të KPP, përsa kohë që, kjo e fundit, konkretizon njërin nga “mjetet e sigurimit të provës”, [...]

Pra, përsa i përket çështjes së parë të shtruar për njësim, qartazi dispozita, neni 88 i KPP, nuk parashikon asnjë lloj diferencimi midis masave të sigurimit të të gjitha llojeve, sikurse u sipërcitua, përfshirë edhe masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive. Kolegji vlerëson se edhe masat e sigurimit pasuror, do t'i nënshtrohen pasojave, të identifikuara në “humbjen e efekteve të fuqisë” së tyre, në kushtet e deklarimit kontekstual, me momentin e caktimit të masës apo edhe në një moment të mëvonshëm, të moskompetencës së gjykatës (gjyqtarit për hetimet paraprake) që ka caktuar këtë masë dhe të mosripërtëritjes (mosrinovimit) të saj nga gjykata kompetente, brenda një afati dhjetë ditë nga marrja e akteve.

Me verifikimin e kushteve të parashikuara në nenin 88 të KPP, të deklarimit (kontekstual apo të mëvonshëm) të moskompetencës të gjykatës (gjyqtarit për hetimet paraprake) që ka caktuar masën e sigurimit të karakterit pasuror të sekuestros preventive, të parashikuar nga neni 274 i KPP, si dhe të mosripërtëritjes të saj prej gjykatës kompetente, brenda dhjetëditëve nga marrja e akteve, kjo e fundit, pra masa e sigurimit (pasuror) humbet efikasitetin – provizor/të përkohshëm – të “fituar”, me rastin e deklarimit të kësaj moskompetence, (prej këtij momenti), si një masë e caktuar prej gjyqtarit (gjykatës) jokompetent. Masa e sigurimit (pasuror) e caktuar nga gjyqtari jokompetent ka karakter të jashtëzakonshëm dhe emergjencial/si një masë e caktuar në kushte emergjence.

Kolegji, në funksion të interpretimit të dispozitës, objekt i referimit të këtij gjykimi njësoes, nenit 88 të KPP, lidhur me kushtet e aplikimit të saj, konsideron se “shkronja” – përmbajtja e kësaj dispozite – e bazuar në identitetin midis (në kuptimin e të njëjtës gjykatë/gjyqtar) gjyqtarit që cakton masën e sigurimit me atë (gjyqtarin) që deklaron, në të njëjtën kohë apo më pas, moskompetencën e tij, nuk përjashton mundësinë që kjo disiplinë e “humbjes së fuqisë së masës së sigurimit” të interpretohet në mënyrë të zgjeruar dhe të zbatohet edhe në eventualitetin e verifikimit të diversitetit (në kuptimin e gjykatës/gjyqtarit të ndryshëm) midis gjyqtarit që disponon masën e sigurimit dhe gjyqtarit që deklaron moskompetencën. Ky konkluzion, sikurse u sipërcitua, mbështetet në faktin se masa e sigurimit e caktuar nga gjyqtari jokompetent ka vlefshmëri/efikasitet provizor, duke qenë shprehje e një pushteti të jashtëzakonshëm dhe emergjencial, të “akorduar”, këtij të fundit, prej ligjvënësit, dhe si rrjedhojë nuk mund të

kufizohet vetëm në rastet e “identitetit” midis dy gjyqtarëve/gjykatave.

Rast emblematic i aplikimit të këtij interpretimi zgjerues të disiplinës së parashikuar nga dispozita, neni 88 i KPP, do të konsiderohej “deklarimi i moskompetencës, jo vetëm nga gjyqtari (për hetimet paraprake) që ka caktuar masën e sigurimit, por edhe nga gjyqtari (i gjykatës së apelit), që gjykon ankimin ndaj vendimit të këtij gjyqtari që ka caktuar këtë masë me karakter të përkohshëm. Mbi këtë bazë arsyetimi, konkludohet prej këtij Kolegji, në funksion të problematikës së identifikuar, objekt i njësimit nëpërmjet gjykimit të kësaj çështjeje, (pika 2 e çështjeve objekt njësimi), se: provizoriteti (*ad interim*)/përkohshmëria e masës së sigurimit merr jetë ekskluzivisht vetëm në kushtet e deklarimit të moskompetencës, për çdo lloj shkaku pa përjashtim, të moskompetencës lëndore apo tokësore, prej gjykatës/gjyqtarit për hetimet paraprake, gjatë kësaj faze të procedimit, të hetimeve paraprake, në të njëjtën kohë (me caktimin e kësaj mase) ose më vonë, e cila (i cili) presupozohet në kushtet e identitetit, me gjykatën (gjyqtarin) që ka caktuar këtë masë, pra e njëjta gjykatë. “Jetëgjatësia” e këtij provizoriteti (të kësaj mase të caktuar, të deklaruar në këto kushte) merr fund (në kuptimin e humbjes së efekteve, të fuqisë së kësaj mase) në kushtet e mosrinovimit (ripërtëritjes) të saj prej gjykatës kompetente brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, pra, në thelb, kur nuk konfirmohet nëpërmjet deklarimit stabiliteti/qëndrueshmëria e saj. Ky është rregulli bazë i sanksionuar nga dispozita – neni 88 i KPP, që nuk përjashton, sikurse u argumentua më sipër, diversitetin e gjykatës që ka caktuar masën e sigurimit, me gjykatën që më pas, ka deklaruar moskompetencën, lidhur me caktimin e kësaj mase siguri.

Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arrin në konkluzionin njëses si më poshtë vijon: **“Jo domosdoshmërisht, në kushtet e aplikimit të përcaktimeve të dispozitës, nenit 88 të KPP, Gjykata që ka caktuar masën e sigurimit do të (duhet) jetë e njëjtë me Gjykatën, e cila, më vonë, ka deklaruar moskompetencën e saj, për çdo lloj shkaku, për gjykimin e çështjes me këtë objekt.”**

Duke ju referuar konkluzioneve njëses lidhur me dy problematikat e para të trajtuara, konkluzioni mbi problematikën e tretë, të identifikuar në mundësinë e aplikimit të përcaktimeve të nenit 88 të KPP, në thelb, “të humbjes së efikasitetit/shuarjes së masave të sigurimit”, të caktuara nga gjykata/gjyqtari për hetimet paraprake, edhe në rastin e deklarimit të moskompetencës nga prokurori gjatë fazës së hetimeve paraprake, (pas caktimit të tyre prej gjykatës kompetente dhe në kushtet e mungesës së një prononcimi gjyqësor lidhur me (mos)kompetencën) dhe dërgimit të akteve (të çështjes) tek prokurori kompetent, sipas përcaktimit të

nenit 84/1 të KPP, është automatik dhe i pashmangshëm. Përsa kohë që masa e sigurimit e caktuar nga gjykata (gjyqtari për hetimet paraprake) kompetente, verifikohet në kushtet e stabilitetit (të efikasitetit të plotë), pra nuk rezulton që gjykata që ka caktuar këtë masë të ketë deklaruar, kontekstualisht apo më vonë, moskompetencën e saj, për çdo lloj shkak, transferimi i hetimit të çështjes, sipas nenit 84/1 të KPP, nga një prokurori tek tjetra, për vazhdimin e hetimeve, i motivuar ky transferim me verifikimin e moskompetencës së prokurorisë që kishte regjistruar fillimisht/*ab initio* procedimin penal, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi lidhur me efikasitetin e masës së sigurimit të caktuar nga ajo gjykatë, në drejtim të humbjes së efikasitetit të masës së caktuar. Kolegji vlerëson se neni 88 i KPP kushtëzon provizoritetin (përkohshmërinë) e masës së sigurimit të caktuar dhe inefikasitetin e saj (në kushtet e mospërtëritjes së saj brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve prej gjykatës kompetente), vetëm në rastin e deklarimit (kontekstual apo të mëvonshëm) të moskompetencës (për çfarëdo lloj shkak) prej gjykatës (gjyqtarit), në cilësinë e deklarimit të organit juridiksional. Kolegji çmon se nuk sjell asnjë pasojë për masën e sigurimit të caktuar, në rastin kur disponohet për kalimin e akteve, gjatë hetimeve paraprake, nga një prokurori tek tjetra, e motivuar me konstatimin e moskompetencës për të hetuar, duke qenë se bëhet fjalë për akte të nxjerra nga një organ/prokurori, i konsideruar palë (megjithëse palë publike) në proces (procedim), pa pushtet dhe kompetenca të karakterit juridiksional.

Me të drejtë ligjvënësi, sikurse rezulton nga përmbajtja e dispozitës, nuk ka toleruar (duke mos parashikuar) në funksion të qëllimit të ruajtjes së efikasitetit të masës së sigurimit, domosdoshmërinë e nxjerrjes së një vendimi (disponimi) të ri, prej gjyqtarit kompetent, në rastin kur, menjëherë mbas adoptimit, prej gjyqtarit për hetimet paraprake, të një mase sigurimi dhe në mungesë të një vendimi (disponimi) gjyqësor mbi (mos) kompetencën, prokurori, pranë këtij gjyqtari (kësaj gjykate), transmeton aktet e hetimit të (kësaj) çështjes, sipas përcaktimit të paragrafit të parë të nenit 84 të KPP, tek organi i akuzës (prokurori) pranë gjykatës që ai vlerëson kompetente. Ligjvënësi, duke mbajtur parasysh cilësinë e palës të organit të akuzës/prokurorit, megjithëse palë publike në procesin penal, si dhe rrethanën që, gjatë fazës së hetimeve paraprake të zhvilluara në drejtimin e këtij të fundit (prokurorit), për shkak të dinamikës (fluiditetit) së zhvillimit të tyre, hipotezat mbi karakterizimin (rindërtimin) e fakteve janë subjekt i modifikimit me pasojë ndikimi të drejtpërdrejtë mbi kualifikimin (juridik) të tyre, ka privilegjuar nevojën e efikasitetit dhe të menjëhershmerisë së zhvillimit të funksionit investigativ, nëpërmjet

adoptimit të kriterit të elasticitetit në përcaktimin e raporteve (marrëdhënieve) midis prokurorive të ndryshme, duke evituar një ndarje të thellë dhe rigoroze të “pushteteve” respektive, kriter i ndryshëm në raport me ato që përcaktojnë kompetencën midis gjykatave.

Sakaq, mbi bazën e kësaj logjike, gjithnjë prej ligjvënësit, nga njëra anë, është ometuar parashikimi i “mekanizmave” detyruese të prokurorit të “palegjitimuar”, për të transmetuar aktet tek titullari i hetimeve paraprake, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 25 të KPP dhe toleruar prokurorit titullar të hetimeve paraprake të zhvilluara lidhur me çështjen penale të regjistruar ndaj personit që aplikohet masa e sigurimit, të vazhdojë hetimet edhe në kushtet e deklarimit të moskompetencës prej gjyqtarit të hetimeve paraprake që ka caktuar masën. Por, nga ana tjetër, adresohet rregullimi i konflikteve negative të kompetencës midis prokurorive të ndryshme, gjatë kësaj faze të hetimeve paraprake, në brendësi të strukturës organike të kësaj pale/prokurorisë, duke i atribuuar zgjidhjen e tyre “prokurorit më të lartë”, sipas përcaktimit të paragrafit të dytë të nenit 89 të KPP (për mosmarrëveshjet mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm), si dhe “duke i dhënë përparësi” kompetencës së Prokurorisë së Posaçme, në rastet e krijimit të konfliktit të kësaj të fundit, me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Ligjvënësi me këtë zgjidhje ligjore ka evituar, në këtë mënyrë, investimin dhe prononcimin e gjykatës në lidhje me këtë moment.

Në këtë kontekst, të implementimit të kësaj disipline normative, vetëm rrethana që prokurori procedues, në një moment të caktuar të zhvillimit të fazës së hetimeve paraprake, gjatë hetimeve paraprake ose në përfundim të tyre, sipas përcaktimit të paragrafit të parë të nenit 84 të KPP, transmeton aktet tek prokurori pranë gjykatës që ai mendon dhe vlerëson si gjykata kompetente, nuk është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të legjitimuar kompetencën e këtij të fundit/gjyqtarit për tu shprehur mbi masën e sigurimit. Gjyqtari në këtë rast, “paqësisht”, mund ta refuzojë atë (kërkesën) në rastin kur i kërkohet prej palëve, të prononcohet nëpërmjet një disponimi të tij mbi masën, apo për të përjashtuar/shmangur, kompetencën e gjyqtarit pranë të cilit ushtron funksionet, prokurori që ka transmetuar aktet.

Për pasojë, konkludohet se transmetimi i akteve, i verifikuar në këto kushte, të deklarimit të moskompetencës së prokurorit procedues, në favor të kompetencës së prokurorit pranë gjykatës të vlerësuar (prej tij – prokurorit procedues) si gjykata kompetente, gjatë fazës së hetimeve paraprake të procedimit të regjistruar dhe mbas caktimit të masës së sigurimit prej gjykatës kompetente, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të efikasitetit të masës së sigurimit (të caktuar si më sipër). Në të

njëjtën kohë, disponimi i prokurorit për deklarimin e moskompetencës është “i paaftë” për t’i “atribuuar” kësaj mase, efikasitet të përkohshëm/ të limituar, të tillë që të imponojë deklarimin e humbjes së fuqisë së saj në kushtet e mosrinnovimit brenda afatit dhjetë ditor nga marrja e akteve, sikurse parashikohet në dispozitë, nenin 88 të KPP, përsa kohë që mungon deklarimi i moskompetencës prej organit juridiksional – gjykatës.

Ndërkohë ligjvënësi, me ndryshimet e adoptuara me ligjin nr. 35/2017, neni 52 i këtij ligji, ka shtuar një paragraf të ri në nenin 84, paragrafin e dytë, [...] Përpos përmbajtjes së paqartë të kësaj dispozite, përsa kohë që i atribuon prokurorit “akte të hetimit paraprak të kryera para gjykatës” (të cilat gjykata jokompetente duhet t’ja dërgojë gjykatës kompetente), kur cilësinë e një akti të tillë e “gëzon” vetëm prova e marrë prej gjyqtarit për hetimet paraprake me procedurën e jashtëzakonshme të “sigurimit” të saj, të parashikuar nga nenet 317-322 të KPP, mbi kërkesën e palëve, e justifikuar kjo urgjencë me rrezikun e zhdukjes së saj”, dhe përsa kohë që “aktet e hetimit paraprak konsiderohen në diskrecionin ekskluziv të prokurorit dhe të policisë gjyqësore” të realizuara prej tyre, nën drejtimin e prokurorit titullar i kësaj faze, në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale”, Kolegji çmon se duhet theksuar që në këtë fazë ndërhyrja e gjykatës/gjyqtarit për hetimet paraprake është e karakterit incidental, garantues, e “provokuar”/stimuluar prej palëve, në kushtet e mungesës së disponibilitetit mbi to (hetimet paraprake). Në këto rrethana, dispozita e sipërcituar, paragrafi i dytë i nenit 84 të KPP, megjithë “përkujdesjet” për të vënë në gjendje “gatishmërie” gjykatat respektive, të “interesuara” dhe të “shqetësuara” prej kalimit të akteve nga një prokurori tek tjetra gjatë kësaj faze të hetimeve paraprake, për shkak të kompetencës dhe paragjykit, për pasojë, të karakterit definitiv të masave të sigurimit të caktuara, qartazi, për asnjë moment, nuk kontraston dhe nuk mohon arsyen e përcaktimit të nenit 88 të KPP, moskompetencën e deklaruar nga gjykata, si e vetmja mundësi për të “provokuar” provizoritetin/përkohshmërinë e masës së sigurimit personal të caktuar gjatë fazës së hetimeve paraprake. Në konkluzion të këtij parashtrimi, Kolegji thekson se as përcjellja e akteve nga njëra gjykatë tek gjykata pranë të cilës funksionin prokuroria, të cilës i kanë kaluar aktet për kompetencë, nuk nënkupton zbatimin e nenit 88 të KPP, përsa kohë ky kalim i akteve nuk vjen si pasojë e një vendimi gjyqësor për shpalljen e moskompetencës.

Përfundimisht, mbi këtë bazë, Kolegji, lidhur me problematikën e tretë të shtruar për njësim, konkludon se **“Parashikimet (përcaktimet) e nenit 88 të KPP nuk janë të aplikueshme me rastin e shpalljes (deklarimit) së moskompetencës prej prokurorit, gjatë hetimeve**

paraprake apo në përfundim të tyre, dhe të dërgimit të akteve prokurorisë (prokurorit) kompetente, sipas përcaktimit të nenit 84/1 të KPP.”.

[..] 1. Në lidhje me pyetjen e parë të ngritur për njësimin e praktikës gjyqësore: “A zbatohet neni 88 i KPP për masat e sigurimit pasuror, apo është një dispozitë që i referohet vetëm masave të sigurimit personal?”, të mbahet ky qëndrim njëses:

Neni 88 i KPP zbatohet si për masat e sigurimit personal, ashtu dhe për masat e sigurimit pasuror.

Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim: “Sipas nenit 88 të KPP, gjykata që cakton masën e sigurimit a është e njëjtë me gjykatën që, në të njëjtën kohë ose më vonë, shpall moskompetencën?”, të mbahet ky qëndrim njëses:

Gjykata që cakton masën e sigurimit, jo domosdoshmërisht është e njëjtë me gjykatën që shpall moskompetencën.

Në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim: “A zbatohen parashikimet e nenit 88 të KPP edhe në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente sipas nenit 84/1 të KPP?”, të mbahet ky qëndrim njëses:

Parashikimet e nenit 88 të KPP në lidhje me masën e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente, nuk zbatohen në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente, sipas nenit 84/1 të KPP.

Duke u kthyer tek zgjidhja e çështjes konkrete, që nxiti këtë gjykim të karakterit njëses, konkludohet prej këtij Kolegji, duke ju referuar konkluzionit të tretë të këtij vendimi, pamundësia e aplikimit/zbatimit të përcaktimeve të nenit 88 të KPP, me rastin e kalimit të akteve nga njëra prokurori tek tjetra, gjatë fazës së hetimeve paraprake, për shkak moskompetence. [...] Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Tiranë, [...], është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural me rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore, parashikuar në shkronjën “a” të paragrafit të parë të nenit 432 të KPP, e lidhur kjo më zbatimin e gabuar të përcaktimeve të nenit 88 të këtij Kodi. Si rrjedhojë, Kolegji çmon se ky vendimi [...] është i cenueshëm duke sjellë si pasojë prishjen e këtij vendimi, sipas përcaktimit të shkronjës “b” të paragrafit të parë të nenit 441 të KPP. Në të njëjtën kohë, prej këtij Kolegji, konkludohet mbi ligjshmërinë (në thelb) të vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së të hetuarës D.H. me objekt “Deklarimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit me karakter pasuror të sekuestros preventive”, me rastin e kalimit të akteve nga prokuroria pranë Gjykatës

për Krime të Rënda tek Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të deklarimit të moskompetencës prej prokurorit, me pasojë lënien në fuqi të këtij vendimi.

Mendimi i pakicës

Ne gjyqtarët Sandër SIMONI dhe Klodian KURUSHI jemi pjesërisht kundër vendimit njësuës [...] vetëm në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim, që i referohet pyetjes nëse zbatohen parashikimet e nenit 88 të KPP edhe në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente sipas nenit 84/1 të K.Pr.Penale?

Në lidhje me këtë pyetje, jemi të mendimit se fillimisht është i nevojshëm trajtimi i dispozitave të KPP që rregullojnë shpalljen e moskompetencës së prokurorisë dhe gjykatës gjatë fazës së hetimeve paraprake apo gjatë gjykimit në shkallë të parë.

[...] Referuar nenit 84/1 të KPP, prokurori gjatë hetimeve paraprake apo në përfundim të tyre vendos moskompetencën për çdo lloj shkakut dhe i dërgon aktet prokurorisë kompetente. Në këtë rast, aktet i përcillen prokurorisë kompetente e cila vazhdon hetimet në lidhje me çështjen. Kjo situatë verifikohet edhe në ato raste kur gjykata pranë prokurorisë që ka shpallur moskompetencën ka disponuar në lidhje me një masë sigurimi, si rrjedhojë e kërkesës së prokurorit. Diskutimi që shtrohet para Kolegjit lidhet me faktin nëse këtë situatë do të zbatohen parashikimet e nenit 88 të KPP, në lidhje me masën e sigurimit për të cilën ka disponuar gjykata e mëparshme?

Mendojmë se nga interpretimi logjik i bërë kësaj situatë ligjore arrihet në përfundimin se neni 88 i KPP do të zbatohet edhe në këtë rast. Pavarësisht se moskompetenca lëndore është shpallur nga prokuroria pranë gjykatës që ka caktuar masën e sigurimit dhe jo nga kjo gjykatë, në kushtet kur është shpallur moskompetenca dhe aktet i kanë kaluar prokurorisë kompetente, në thelb masa e sigurimit është caktuar nga një gjykatë që nuk është më kompetente në lidhje me çështjen. Ky përfundim nuk duhet të çojë në konkluzionin se është prokuroria ajo që përcakton kompetencën e gjykatës, por lidhet me faktin se kompetenca e prokurorisë dhe gjykata pranë të cilës ajo ushtron funksionet janë të lidhura ngushtësisht dhe nuk mund të shihen veç si gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit të çështjes.

Diskutimi në lidhje me zbatimin e nenit 88 të KPP mendojmë se mund të lindte para ndryshimeve që ka pësuar neni 84/2 i KPP. Me ndryshimet që ka pësuar kjo dispozitë situata është e zgjidhur nga ligjvënësi, pasi në këtë rast prokurori që shpall moskompetencën ka detyrimi të njoftojë të dyja gjykatat. Gjykatës kompetente i përcillen aktet e hetimeve paraprake nga gjykata jokompetente. Në këto kushte, gjykata kompetente do të duhet të

marrë në vlerësim masën e sigurimit në mënyrë që kjo e fundit të vazhdojë të ketë fuqi juridike. Në KPP parashikohen rregullat për përcaktimin se kompetencës lëndore dhe tokësore të cilat lidhen me faktin se kush do jetë gjykata kompetente për gjykimin e themelit të çështjes, rregulla këto që vlejnë edhe për fazën e hetimeve paraprake lidhur me kompetencën e prokurorisë që do të hetojë rastin konkret.

[..] Në këtë logjikë, vjen edhe parashikimi i rasteve të mosmarrëveshjeve që lidhen me moskompetencën, pasi në nenin 89/2 të KPP, thuhet që mosmarrëveshjet e lindura në fazën e hetimit paraprak zgjidhen nga prokurori më i lartë, ndërsa në nenin 91/1 të po këtij Kodi parashikohet rastet e mosmarrëveshjeve të konstatuara gjatë gjykimit zgjidhen nga Gjykata e Lartë.

Me këtë duam të themi se ligjvënësi ka dashur të krijojë fleksibilitet në fazën e hetimeve paraprake për të mos krijuar pengesa e zvarritje fiktive që do të ndikonin në mbarëvajtjen e procesit hetimor dhe nga ana tjetër, nëse do të donte që konfliktet e kompetencës edhe gjatë fazës së hetimeve paraprake t'ia linte gjykatës, nuk kishte përse të bënte ndarje për fazën e hetimeve dhe atë të gjykimit, apo do avanconte parashikimet më tej, duke kërkuar nga prokurori që, kur ai të konstatonte kompetencën gjatë hetimeve paraprake, t'i drejtohej gjykatës pranë së cilës ai ushtronte funksionet për të shpallur moskompetencën dhe në vijim, çdo mosmarrëveshje do zgjidhej nga Gjykata e Lartë.

Ky fleksibilitet i legjislatorit gjen shprehjen e vet edhe në rastet kur në nenin 87/1 të KPP i cili parashikon se mosrespektimi i dispozitave mbi kompetencën nuk sjell pavlefshmërinë e provave të marra. Jo vetëm kaq, por neni 88 të KPP rregullon edhe vlefshmërinë e masave të sigurimit të marra nga gjykata kompetente kur shprehet që: [..]

Po të kryhet interpretimi sistematik i neneve 84 dhe 88 të KPP, vihet re se këto dispozita rregullojnë në mënyrë të qartë veprimtarinë e organit procedues si dhe të gjykatës në rast të shpalljes së moskompetencës në fazën e hetimeve paraprake. Kështu, prokuroria shpall moskompetencën gjatë hetimeve paraprake dhe për këtë ka detyrimin të njoftojë menjëherë të dyja gjykatat. Këtu ligji si afat përdor termin menjëherë. Në vijim gjykata jokompetente brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, i përcjell gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate. Në vijim gjykata kompetente, nëse është caktuar masë sigurimi nga gjykata jokompetente, e merr atë në vlerësim brenda afatit 10 ditor në mënyrë që ajo të vazhdojë të ketë fuqi juridike.

Kolegji Penal në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se: Gjykatat e faktit, gjatë fazës së hetimeve paraprake gjithmonë vihen në

lëvizje me kërkesë të prokurorit që ushtron funksionet pranë asaj që merr vendimet lidhur me masat e sigurimit personal, me sekuestro, kontrollet e banesave e personale, etj, ku vlerëson kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji vendosjen e këtyre masave që i shërbejnë mbarëvajtjes së hetimeve.

[...] Duke u kthyer tek rasti konkret, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk mund të refuzonte asnjë kërkesë të prokurorit pranë kësaj gjykate lidhur me masat të karakterit shtrëngues personal, pasuror etj, vetëm me argumentin se nuk i ka ardhur praktika e akteve mbi të cilat gjykata jo kompetente kishte vendosur për masat e sigurimit. Neni 88 i KPP kërkon vetëm që të marrë aktet e masës së sigurimit të vendosura nga gjykata jo kompetente por nuk thotë shprehimisht që merr këto akte të masës së sigurimit nga gjykata jo kompetente. Siç thamë dhe më lart, gjatë hetimeve paraprake moskompetenca lëndore apo për çdo shkak tjetër shpallet nga prokuroria e cila në vendimin e saj nuk bën gjë tjetër veçse deklaron mos kompetencën e gjykatës ku ajo i ushtron funksionet. *(shih vendimet nr. 64 datë 29.04.2015, nr. 25 datë 29.04.2015, nr. 14 datë 30.03.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*

Përfundimi i mësipërm është mbajtur në mënyrë të konsoliduar nga Kolegji Penal i edhe para ndryshimeve të nenit 84 të KPP, duke interpretuar dispozitat e KPP që rregullojnë kompetencën gjatë hetimeve paraprake dhe gjatë gjyqimit. Megjithatë, mendojmë se jemi në kushtet kur tashmë situata rregullohet nga ligji, pasi zbatimi me korrektësi i nenit 84/2 të KPP nga prokuroria krijon një praktikë të qartë dhe të konsoliduar gjyqësore. Ky përfundim arrihet po të marrim në konsideratë ndryshimet që ka pësuar neni 84 i KP, [...] Qëllimi i një ndryshimi të tillë ka qenë pikërisht që të shmangte praktikën e ndryshme të zbatimit të nenit 88 të KPP në rast të shpalljes së moskompetencës nga prokuroria gjatë hetimeve paraprake. Me këtë ndryshim është përforcuar qëndrimi dhe qëllimi i ligjvënësit që pavarësisht se gjatë hetimeve paraprake moskompetenca shpallet nga gjykata ose nga prokuroria, masat e sigurimit duhet të vlerësohen nga gjykata kompetente brenda 10 ditësh.

[...] Mendojmë se nëse zbatohet siç duhet parashikimi i nenit 84/2 të KPP nuk krijohen dyshime në lidhje me përgjigjen e pyetjes së tretë të shtruar për njësim. Gjithashtu, mendojmë se zbatimi korrekt i kësaj dispozite do të shmangte edhe praktikën jo uniforme në lidhje me zbatimin e nenit 88 të KPP në rastin kur moskompetenca shpallet nga prokuroria. Mendojmë se parashikimi i nenit 88 të KPP do të gjejë zbatim në çdo rast, pavarësisht se cili organ e shpall moskompetencën, gjykata e hetimeve paraprake apo prokuroria. Këtu një rol determinant ka zbatimi me korrektësi i detyrimit të parashikuar nga neni 84/2 i KPP nga ana e prokurorit që vendos

moskompetencën gjatë hetimeve paraprake.

Mendojmë se përfundimi i mësipërm arrihet po të lexohet neni 88 i KPP në raport me neni 84/2 të Kodit. Edhe në rast se moskompetenca shpallet nga prokuroria gjatë apo në përfundim të fazës së hetimeve paraprake, ajo ka detyrimin të njoftojë të dyja gjykatat. Gjykata pranë prokurorisë që ka shpallur moskompetencën njofton gjykatën kompetente brenda 3 ditëve dhe i përcjell asaj aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate. Arsyeja e një parashikimi të tillë ka qenë pikërisht që gjykata kompetente të njihet me aktet e hetimeve paraprake si dhe të përmbushë edhe detyrimin e parashikuar nga neni 88 i KPP.

Mendojmë se nëse nuk do të duhej që gjykata kompetente të merrte në vlerësim masën e sigurimit brenda afatit 10 ditor, atëherë ligjvënësi nuk kishte pse të parashikonte detyrimin e prokurorit që të njoftonte të dyja gjykatat në lidhje me shpalljen e moskompetencës. Gjithashtu, nuk do të parashikohej detyrimi i gjykatës së parë që brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, t'i përcjellë gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate. Parashikimi i nenit 84/2 të KPP dëshmon pikërisht qëllimin e ligjvënësit që edhe në këtë rast, gjykata kompetente të zbatojë parashikimin e nenit 88 të K.Pr. Penale dhe të marrë në vlerësim masën e sigurimit të vendosur nga gjykata jo kompetente.

Hartimi i dispozitave të KPP është uniform me qëllimin e ligjvënësit që jo vetëm kur moskompetenca shpallet nga gjykata e hetimeve paraprake, por edhe kur ajo shpallet nga prokuroria, aktet e hetimeve paraprake t'i kalojnë sa më shpejt gjykatës kompetente e cila njihet me to dhe nëse nga gjykata jokompetente është caktuar masë siguri, ajo merret në vlerësim nga gjykata kompetente brenda 10 ditësh. Edhe afati 3 ditor i përcaktuar nga neni 84/2 i KPP brenda të cilës gjykata jokompetente i përcjell aktet gjykatës kompetente është një afat i shkurtër, i caktuar pikërisht me qëllimin që t'i japë mundësi gjykatës kompetente që brenda afatit 10 ditor të marrë në vlerësim masën e sigurimit, sipas nenit 88 të KPP.

[..] Sa më sipër, jemi të mendimit se në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim, Kolegji duhet të arrinte në këtë përfundim njëses:

Parashikimet e nenit 88 të KPP do të gjejnë zbatim edhe në rastin kur prokuroria gjatë hetimeve paraprake shpall moskompetencën dhe i dërgon aktet prokurorisë kompetente, sipas nenit 84/1 të KPP.

Në këtë rast është e domosdoshme që nga prokuroria që shpall moskompetencën të përmbushet me korrektësi detyrimi i parashikuar nga neni 84/2 i KPP.



**2. Vendim nr.205(44),
datë 10.02.2022 (mbivendosje
të masave të sigurimit:
efekti i masës së re)**

Maksima: Kur ka mbivendosje të masave të sigurimit, momenti i fillimit të efekteve të masës së re të sigurimit është momenti kur mbarojnë efektet e masës së parë ose pasi personi ka kryer të gjithë dënimin me burgim për të cilin ishte vendosur masa e parë e sigurimit.

Fjalë kyçe: mbivendosje mase sigurimi, momenti i fillimit të masës së re

Decision no. 205 (44), dated 10.02.2022 (overlapping of security measures: effect of the new measure)

Legal principle(s): Where security measures overlap, the legal effects of the subsequent security measure commence only upon the expiry of the effects of the earlier security measure, or, where applicable, after the person has fully served the term of imprisonment in respect of which the first security measure had been imposed.

Keywords: overlapping of security measures, moment of commencement of the new measure

Rrethanat e çështjes:

[..] kërkuksi S.K është arrestuar më datë [..] dhe me vendimin nr. [..] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë i është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg”, për procedimin penal me objekt veprën penale të vjedhjes sipas nenit 134, paragrafi 2 të KP. Gjatë kohës së qëndrimit nën masën e sigurimit arrest në burg, ndaj tij ka nisur një tjetër procedim penal, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Rebelimi i të burgosurve”, respektivisht sipas nenit 150 dhe 270 të KP. Për llogari të këtij procedimi ai është arrestuar me [..] dhe me vendimin nr.[..] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ndaj tij për llogari të këtij procedimi është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”. [..] Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 134, paragrafi 2 i KP ai është dënuar përfundimisht me 2 vjet dhe 4 muaj burgim me vendimin nr. [..] të Gjykatës së Apelit Durrës. Me Urdhrin e datës 22.10.2020, të Prokurorisë së Apelit Durrës është urdhëruar lirimi i menjëhershëm i tij, duke u konstatuar se dënimi i dhënë është vuajtur. IEVP Peqin nuk ka kryer lirin e të dënuarit, duke qenë se ndaj tij kishte edhe një masë kufizuese

të lirisë personale për llogari të një procedimi penal tjetër.

Lidhur me procedimin penal të dytë, atë me objekt nenin 150 dhe 270 të KP, rezulton se me vendimin nr. [...] të Gjykatës së Apelit Durrës është vendosur shuarja e masës së sigurimit personal arrest në burg, të caktuar me vendimin [...], më datë [...] datë në të cilën përfundon dënimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë. Me vendimin nr. [...] të Gjykatës së Apelit Durrës është lënë në fuqi vendimi i dënimit me 2 vjet burgim, i gjykatës së shkallës së parë për procedimin penal të dytë ndaj kërkuesit. IEVP nuk e ka liruar të dënuarin, duke konstatuar se ndaj tij ka pasur mbivendosje masash sigurimi dhe se për rrjedhojë në dy aktet e lirimit të menjëhershëm janë përlllogaritur gabim periudhat e vuajtjes së dënimit, duke sjellë në vëmendje se, për pjesën e mbivendosjes së masave ato janë përlllogaritur në kundërshtim me nenin 57 të KP, pasi një ditë paraburgim është përlllogaritur me 3 ditë burgim nën efektin e dy masave të sigurimit arrest në burg. Për këtë qëndrim të organit të ekzekutimit të vendimeve penale është vënë në dijeni prokuroria.

Më datë [...], prokuroria ka përcjellë urdhrin për revokimin e Urdhrit të ekzekutimit, [...] lidhur me ekzekutimin e vendimit nr. [...] të Gjykatës së Apelit Durrës. Përmes këtij akti është urdhëruar mosnjohja e periudhës së vuajtjes për efekt të këtij dënimi të periudhës që kërkuesi ka qenë nën efektet e masës së sigurimit “arrest në burg” për llogari të procedimit të dytë penal dhe më tej është urdhëruar vijimi i vuajtjes së dënimit prej 2 vjet dhe 4 muaj për llogari të procedimit penal për veprën penale, të parashikuar nga neni 134, paragrafi 2 i KP. Prokuroria në urdhrin e ekzekutimit ka saktësuar se kërkuesi ka vuajtur nga data 25.01.2019 deri më datë 07.08.2019 gjithsej 6 muaj dhe 12 ditë paraburgim dhe sipas nenit 57 të KP rezulton që ai të ketë vuajtur 9 muaj dhe 18 ditë burgim. Prokuroria ka konkluduar se nga data 07.12.2020, kur kërkuesi është liruar nga dënimi i marrë në procedimin penal të dytë, do të duhet të vijojë përlllogaritjen dhe vuajtjen e dënimit të parë të mbetur pa vuajtur, gjithsej 1 vit, 6 muaj dhe 12 ditë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. [...] ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës, si të pabazuar në ligj dhe në prova... [...]” [...]

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “1. Ndryshimin e vendimit nr. [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Pranimin e kërkesës së dënuarit S.K Shuarjen e dënimit të mbetur për të dënuarin, të dhënë [...]. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit, nëse liria personale e tij nuk është kufizuar për një shkak tjetër ligjor. [...]”

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...]vlerëson se shkaqet e ngritura në rekurs janë të tilla që e çënojnë vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, si vendime të marra në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal.

Në çështjen objekt shqyrtimi, gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me shuarjen e dënimit të kërkuarit S.K. Kjo, pasi ndaj këtij shtetasi janë aplikuar dy masa sigurimi personal “Arrest në burg” për fakte penale të ndryshme, të cilat kanë krijuar dhe një mbivendosje të pjesshme me njëra-tjetrën, si dhe janë dhënë dy vendime të ndryshme dënimi me burgim. [...]

Lidhur me këto qëndrime që kanë mbajtur gjykatat e faktit, Kolegji e vlerëson të drejtë qëndrimin e mbajtur nga gjykata e apelit, për faktin se ndërprerja e ekzekutimit të masës së dënimit e arsyetuar nga gjykata e shkallës së parë nuk gjen bazë ligjore dhe në lëmin e zbatimit të ligjit penal, në të cilin zbatohet parimi se, nuk mund të bëhet interpretimi me analogji i ligjit, për më tepër kur ka si pasojë privimin e lirisë së individit, e cila është një nga të drejtat themelore të tij, të parashikuara në Kushtetutën dhe në KEDNJ, kufizimi i së cilës mund të bëhet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në ligj.

Nga ana tjetër, Kolegji e vlerëson të gabuar qëndrimin e gjykatës së apelit, sipas të cilit kërkuari S.K e ka shlyer dënimin e tij. Ky qëndrim i gjykatës së apelit bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 57 të KP. [...]

Kolegji vlerëson se, në rastin kur ndaj personit, i cili ndodhet nën një masë sigurimi personal “arrest në burg”, apo kur është duke kryer dënimin me burgim për një vepër të mëparshme penale, vendoset një masë e re sigurimi “arrest në burg”, kjo e fundit duhet ti njoftohet personit ndaj të cilit është vendosur masa e re e sigurimit personal, në momentin kur mbarojnë efektet e masës së parë të sigurimit personal, ose pasi personi ka kryer të gjithë dënimin me burgim për të cilin ishte vendosur masa e parë e sigurimit personal “arrest në burg”. Në rastet kur ndaj personit nuk ka qenë caktuar masë sigurimi “arrest në burg”, por ai ka qenë duke vuajtur një dënim me burgim për një vepër penale tjetër, masa e sigurimit për veprën penale që akuzohet, duhet ti njoftohet, pasi ai ta ketë përfunduar dënimin për veprën e parë penale. Pra, ky është momenti që do të fillojnë efektet e masës së re të sigurimit personal “arrest në burg”. Kjo linjë arsyetimi është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore të nenit 57 të KP dhe nenit 250 të KPP.

Kolegji vlerëson se, rekursi i paraqitur nga organi i prokurorisë plotëson shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP [...]për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të faktit. [...]

Kolegji vlerëson se nuk jemi në rastin e parashikuar nga pika 3 e nenit 434 të KPP . [...] Duhet theksuar se, Kolegji nuk ka vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimet e tyre, pasi në dhomën e këshillimit janë shqyrtuar vetëm çështjet e ngritura në rekursin e paraqitur nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Në zbatim të parashikimeve që bëhen në germën “c”, të pikës 1, të nenit 441 të KPP [...] Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit duhet të priset dhe çështja të dërgohet për tu rishqyrtuar nga një trup tjetër gjykues i Gjykatës së Apelit Durrës. Gjatë rishqyrtimit të çështjes, gjykata e apelit duhet t’i përmbahet arsyetimit të të bërë nga Kolegji Penal në këtë vendim.



**3. Vendim nr. 650 (172),
datë 21.06.2022 (shuarje e masës
së sigurimit personal: rivendosje
në afat ankimi)**

Maksima: Gjykata e faktit nuk mund të shqyrtojë kërkesën për deklarimin e shuarjes e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj kërkuarit, pa shqyrtuar më parë kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit (e regjistruar më herët), pra pa u prononcuar lidhur me “formën e prerë” të vendimit të gjyqimit të themelit të akuzës.

Fjalë kyçe: shuarje mase sigurimi, zëvendësim mase sigurimi, rivendosje në afat ankimi

Decision no. 650 (172), dated 21.06.2022 (termination of personal security measure: reinstatement within the appeal deadline)

Legal principle(s): A court of fact cannot not examine a request for the declaration of termination of the personal security measure imposed on the applicant, without first examining the request for the reinstatement within the appeal deadline of the right to appeal (registered earlier), i.e. without pronouncing on the “final form” of the decision of the trial of the merits of the charge.

Keywords: termination of security measure, replacement of security measure, reinstatement within the appeal deadline

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. [...], në ngarkim të të pandehurve: A.N etj. [...] të akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283 paragrafi i dytë, i KP. [...] Objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor është gjykimi i çështjes penale në ngarkim të të pandehurve H.B dhe K.K. [...]

[...]Me vendimin nr. [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtarit për hetimet paraprake, pranë kësaj Gjykate) është vendosur: Caktimi i masës së sigurimit personal te “arrestit ne burg”, te parashikuar nga neni 238 i KPP, ndaj shtetasit K.K, me cilësinë, ky i fundit, të personit te hetuar (dyshuar) për kryerjen e veprës penale te “Prodhimit dhe te shitjes se narkotikëve”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 2/283 i KPP.

Me vendimin nr. [...], të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, është vendosur: “... Deklarimi fajtor i të pandehurit K.K, për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283, paragrafi i dytë, i KP dhe dënimi i tij me tetë vjet burgim. Vuajtja e dënimit për të pandehurin, të fillojë nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme...”. Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vijuar me procedurën e njoftimit të vendimit penal të pandehurit. Rezulton nga dëftesa e komunikimit nr. [...], se ky vendim nuk është njoftuar për shkak të adresës së pasaktë.

Në datë [...], nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vijuar me “Shpalljen e Vendimit për Efekt Njoftimi”. Me shkresën nr. [...], Bashkia Tiranë ka njoftuar administratoren e Njesisë Bashkiake nr. 4 dhe, me shkresën nr. [...] Bashkia Tiranë ka njoftuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë se data e afishimit të “Shpalljes së Vendimit për Efekt Njoftimi”, për vendimin nr. [...] u realizua në datë 09.11.2018, në adresën [...].

Mbi bazën e ankimit të Prokurorit dhe të bashkëtëpandehurit tjetër, në këtë proces, H.B, çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit me nr. [...]. Nga aktet rezulton se janë zhvilluar disa seanca gjyqësore, në këtë gjykatë, për gjykimin e çështjes nr. 5217, por gjykimi nuk ka përfunduar.

Në datë 26.03.2019, është arrestuar i pandehuri K.K dhe mbi bazën e procesverbalit të kësaj date, me vendimin nr. [...], të Gjykatës së Apelit Tiranë [...] janë verifikuar kushtet e caktimit të masës së sigurimit, duke vendosur vazhdimin e zbatimit të kësaj mase. Në datë 05.04.2019, është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kërkesa e kërkuarit K.K, me objekt rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr. [...], të kësaj gjykate. Po në atë datë, është paraqitur edhe ankimi penal nr. 524 regjistri, lidhur me vendimin për të cilin kërkohej rivendosja në afat.

Me vendimin nr. [...], Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke iu referuar nenit 147 të KPP, ka shpallur mos kompetencën e saj lëndore dhe e ka dërguar kërkesën, për rivendosjen në afat të ankimit, në Gjykatën e Apelit Tiranë (rekursi i paraqitur nga kërkuesi ndaj këtij vendimi, nuk u pranua nga Gjykata e Larte me vendimin nr. 162, datë 09.05.2019). Mbi këtë bazë çështja për rivendosjen në afat të ankimit u regjistrua, në Gjykatën e Apelit Tiranë, me nr. [...]

Më datë 06.08.2021, është regjistruar kërkesa e paraqitur nga kërkuesi K.K, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me objekt: “Zëvendësimin e masës së sigurimit personal të “Arrestit në burg”, me një masë tjetër sigurimi, për shkak të humbjes së fuqisë së masës së sigurimit, të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin e datës [...], lidhur me kërkesën e sipërcituar, ka vendosur: “Deklarimin e mos kompetencës së Gjykatës së Shkallës së Parë, për gjykimin e kërkesës për deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal të “Arrestit në burg”, të caktuar ndaj kërkuesit Kllapi dhe dërgimin e çështjes për kompetence gjykimi-Gjykatës së Apelit Tiranë-në disponim të së cilës rezultoi gjykimi i çështjes (së themelit) [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së ushtruar nga kërkuesi, si e pabazuar në ligj dhe në prova.” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] konsideron vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit-prononcuese të pabazueshmërisë në (thelbësore) ligj të kërkesës së paraqitur prej kërkuesit [...] në kushtet e “zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal me rëndësi për zhvillimin e praktikës gjyqësore”-përcaktimi i shkronjës “a”, të nenit 432/1 të KPP-integruese të shkaqeve të pranueshmërisë së rekursit të paraqitur prej rekursuesit.

Aktivimi i Gjykatës së Apelit për të trajtuar në thelb kërkesën e kërkuesit për deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit “Arrest në burg”, të caktuar ndaj tij, ndërkohë që varet-pranë asaj Gjykate-të Apelit-gjykimi i kërkesës për rivendosje në afat të të drejtës së ankimit (të paraqitur prej kërkuesit) ndaj vendimit të Prokurorit, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal [...] konsiderohet, prej këtij Kolegji, minimalisht, i parakohshëm dhe i papërshtatshëm dhe maksimalisht i papërligjur përsa kohë që kjo “formë e prerë”-res giudicata-presupozon pamundësinë-ndalimin-për të ndërhyrë dhe për t’u prononcuar lidhur me masat e sigurimit personal-vlefshmërinë e tyre-atë kohë të caktuara.

Në terma të tjerë, Gjykata e Apelit-kompetente për të trajtuar ankimin-

apelin e paraqitur nga Prokurori dhe i bashkëpandehuri, ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë që ka deklaruar fajtor dhe dënuar edhe të gjykuarin, në kushtet kur kjo pjesë e vendimit nuk është ankimuar nga ky i fundit dhe përse kohe, paqësisht, prej tij, është kërkuar rivendosja në afat e së drejtës së ankimit ndaj këtij vendimi, nuk ka asnjë mundësi për të trajtuar problematikë të karakterit kautelar-procedimi incidental për verifikimin e vlefshmërisë së masës së sigurimit personal të caktuar ndaj këtij subjekti-përpara (dhe në funksion të) zgjidhjes së këtij problemi të karakterit parësor-të “zhbërjes” së formës së prerë, të vendimit për pjesën që i përket të gjykuarit, që paragjykon dhe prekludon mundësinë e gjykimit të shkaqeve të ankimit potencial të këtij subjekti ndaj vendimit të gjykimit në themel të akuzës në ngarkim të tij dhe aq më tepër (në kompetencë njohje të të njëjtës gjykatë) të kërkesës për deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal të caktuar ndaj këtij të fundit, masë e cila, në kushtet e zbatimit të vendimit të formës së prerë (të dënimit të të gjykuarit me tetë vjet burgim), nuk paraqet më asnjë lloj ndikimi në drejtim të justifikimit të “izolimit” të tij.

Referuar sa më sipër, Kolegji vlerëson se, Gjykata e Apelit ka gabuar duke shqyrtuar kërkesën e kërkuarit, për deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal “arrest ne burg”, të caktuar ndaj tij, pa shqyrtuar më parë kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, pra pa u prononcuar lidhur me “formën e prerë” të vendimit të gjykimit të themelit të akuzës për pjesën që i përket këtij të gjykuarit aq më tepër kur bëhet fjalë, përveç të tjerash, për një kërkesë të depozituar në atë gjykatë që në vitin 2019.

Shqyrtimi i kërkesës së rivendosjes në afat, jo vetëm duhet të ishte shqyrtuar më herët për shkak të momentit të regjistrimit në Gjykatën e Apelit, por do të shërbente si një kusht pa të cilin-condition sine qua non-nuk mund të konceptohej trajtimi i kërkesës së paraqitur në Gjykatën e Apelit, vendimmarrja e të cilës është objekt i rekursit të paraqitur prej kërkuarit.

Përse më sipër, [...] Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit duhet të priset. Në rishqyrtim, kjo gjykatë duhet t'i përmbahet arsytimit të Kolegjit dhe të shqyrtojë kërkesën e kërkuarit K.K, me objekt: “Zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga “Arrest në burg”, me një masë tjetër siguri, për shkak të humbjes së fuqisë së masës së sigurimit, të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë.”, pasi të ketë shqyrtuar kërkesën e paraqitur prej tij, me objekt: “Rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr[...] të kësaj gjykate”, të regjistruar në Gjykatën e Apelit, Tiranë, me nr. [...].



**4. Vendim nr. 00-2023-1230,
datë 13.07.2023 (shuarje mase sigurimi
personal: pezullim ekstradimi)**

Maksima: Në shqyrtimin e një kërkesë që lidhet me procesin e ekstradimit, gjykata duhet të arsyetojë jo vetëm mbi masën e sigurimit personal të caktuar për efekt ekstradimi, por edhe mbi kërkimin për humbjen e fuqisë së vendimit të ekstradimit, duke verifikuar gjendjen e procedimit penal në ngarkim të personit dhe veprimet e ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë pas pezullimit të ekstradimit.

Fjalë kyçe: ekstradim i pezulluar, shuarje mase sigurimi

Decision No. 00-2023-1230, dated 13.07.2023 (termination of personal security measure: suspension of extradition)

Legal principle(s): When examining an application arising in the context of extradition proceedings, the court must provide reasons not only in respect of the personal security measure imposed for the purposes of extradition, but also in relation to the request for the declaration of the lapse of the extradition decision. In doing so, the court must verify the status of the criminal proceedings pending against the person concerned and assess the measures undertaken by the Ministry of Justice, following the suspension of the extradition.

Keywords: suspended extradition, lapse of a security measure

Rrethanat e çështjes:

[..]më datë 07.01.2022 është kryer arrestimi i shtetasit B.D), pasi ai ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma në Itali ku Gjkata e Milanos, me vendimin nr. [..]e ka dënuar me 7 vjet burgim për veprën penale “Organizata kriminale” dhe “Trafikimi i lëndëve narkotike”, të parashikuara nga Kodi Penal Italian. [..] Gjykata e Rrethit Gjyqësor [..]ka vendosur të vlefësojë të ligjshëm arrestimin dhe të caktojë ndaj të arrestuarit B.D masën e sigurimit “Arrest në burg” me afat 40 ditor, [..]

Gjykata e Rrethit [..]ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së [..]Lejimin e ekstradimit nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Italisë të [..] Ky vendim ka marrë formë të prerë me datë 13.04.2022.

Me shkresën nr. [..]Ministria e Drejtësisë miratuar shtyrjen e ekstradimit të shtetasit B.D dhe pezullimin e dorëzimit të tij deri në përfundim të

ndjekjes penale dhe vuajtjes së dënimit të tij në Shqipëri në mbështetje të nenit 500 të KPP. [...]kërkuesi është mbajtur në paraburgim të ndryshëm nga ai i ekstradimit deri në datën 29.07.2022 dhe konkretisht: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë [...]ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve dhe armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i KP.

[...]Me vendimin nr. [...], Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka deklaruar fajtor shtetasin B>D për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve dhe armëve shpërthyesë dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i KP dhe e ka dënuar me 1 muaj burg.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin [...]ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në burg” për shtetasin B.D i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/3 dhe “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i KP. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. [...] ka ndryshuar vendimin [...]dhe ka caktuar masën e sigurisë “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, [...]

Me vendimin nr. [...]Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka deklaruar fajtor shtetasin B.D vetëm për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, [...] gjykata ka vendosur shuarjen e masës së sigurimit: “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore” [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. [...]ka vendosur: Pranimin pjesërisht të kërkesës. Konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit (humbjen e fuqisë) “Arrest në burg”, caktuar shtetasit B.D [...] *për efekt ekstradimi nga [...]*

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. [...]ka vendosur: “Miratimin e vendimit nr. [...]”.[...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...]konstaton se, vendimi i Gjykatës së Apelit të [...]për shuarjen e masës së sigurimit personal “arrest në burg” dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, e caktuar për efekt të ekstradimit të kërkuesit B.D drejt shtetit Italian është marrë në interpretim të gabuar të ligjit procedural penal. [...]

[...] Në rastin konkret ekstradimi është pezulluar dhe siç u parashtruar më sipër ligji nuk ka parashikuar se, çfarë ndodh me masën e sigurimit të caktuar për efekt ekstradimi në rastin konkret të masës së sigurimit “arrest me burg”, kur subjekti qëndron për efekt të kësaj mase jashtë afateve të parashikuara nga ligji i brendshëm për gjykimet në lidhje me ekstradimin.

Vendimmarrja për pranimin pjesërisht të kërkesës nga ana e gjykatave të faktit dhe referimi ligjor për këtë gjykim të posaçëm, konstatohet nga ky Kolegj, i pa arsyetuar. Vendimmarrja e gjykatave nuk është e bazuar në prova të mjaftueshme dhe në ato administruara në gjykim. Nga gjykatat nuk është bërë një hetim i plotë në lidhje me gjendjen e procedimeve, për të cilat subjekti i pranuar për tu ekstraduar ka qenë në ndjekje penale apo është dënuar nga gjykatat shqiptare. Faktin nëse këto vendime kanë marrë formë të prerë dhe a është njoftuar apo çfarë masash janë marrë nga Ministria e Drejtësisë për vazhdimin apo revokimin e vendimit të pezullimit.

Kolegji vlerëson se, nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk u është dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të prokurorisë në ankim. Vendimi është një pasqyrim formal i vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit [...]. Referuar sa më sipër Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk ka arsyetuar se përse është pranuar kërkesa për shuarjen e masës së sigurimit të caktuar për efekt ekstradimi, kur vetë ligji nuk e ka parashikuar një vendimmarrje të tillë në rastet e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të ekstradimit të marrë nga Ministri i Drejtësisë. Gjithashtu në referim të neneve 499-500 të KPP, nuk konstatohet nga aktet nëse nga Ministria e Drejtësisë të jenë marrë masa për njoftimin e shtetit kërkuar Italisë, në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit të ekstradimit. Për këto paqartësi të konstatuara nga ky Kolegj dhe pamundësinë e administrimit të provave në lidhje me ecurinë e procedurave të pezullimit të ekzekutimit, pasi Gjykata e Lartë si gjykatë ligji nuk e ka kompetencën për të marrë prova, orienton Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të kryej një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, në interpretim të drejtë të ligjit procedural dhe material penal dhe të kthejë përgjigje shteruese në lidhje me shkaqet e ankimit të parashtruara nga organi i akuzës.

Kolegji sjell në vëmendje se, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. [...] Në rastin në shqyrtim ndodhemi në fushën e marrëdhënieve juridiksionale ndërmjet shteteve, pjesë e të cilave është edhe instituti i ekstradimit për jashtë shtetit, prandaj ligjet e zbatueshme në këtë rast janë aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, të cilat sipas Kushtetutës kanë epërsi mbi ligjet e brendshme. Rezulton se gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje humbjes së fuqisë së ekstradimit, i cili ka qenë edhe kërkitimi i parë i kërkuar në objektin e kërkesës, por ato janë marrë vetëm me shuarjen e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, duke iu referuar nenit 261 të KPP, i cili nuk e parashikon rastin e shuarjes së masës së sigurimit personal të vendosur nga gjykata për shkak të ekstradimit.

Gjykata e apelit e përmend shkarazi në arsyetim humbjen e fuqisë së ekstradimit si kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë, por ajo nuk arsyeton se, gjykata e shkallës së parë pas marrjes dhe administrimit të provave duhej të shprehej për pranimin ose rrëzimin e kërkesës së kërkuarit për humbjen e fuqisë së ekstradimit dhe jo të mjaftohej në dispozitivin e vendimit vetëm me shprehjen “Pranimin e pjesshëm të kërkesës”. Pas zgjidhjes së kërkesës së parë, gjykata e shkallës së parë duhet të merrte në shqyrtim kërkesën tjetër të kërkuarit, që kishte të bënte me shuarjen e masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”. Gjykata e apelit jo vetëm që nuk e ka ndrequr këtë shkelje procedurale të lejuar nga gjykata e shkallës së parë, por ajo nuk ka arsyetuar në lidhje me këtë çështje.

Për sa u thanë më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi nr. [...]duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Në rishqyrtim, gjykata e apelit duhet të kërkojë informacion nga Ministria e Drejtësisë se çfarë është bërë në lidhje me ekstradimin e kërkuarit dhe duhet të zbatojë ato që u thanë në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.



**5. Vendim nr. 00-2023-1329 (222),
datë 25.07.2023 (shuarje/zëvendësim
mase sigurimi personal: parim
kontradiktoriteti)**

Maksima: Gjykimi i konstatimit të shuarjes dhe zëvendësimit të masës së sigurimit duhet të realizohet duke respektuar kontradiktoritetin e palëve, të cilët, nëse e çmojnë, paraqesin provat përkatëse dhe kundërshtojnë ato të paraqitura nga pala tjetër.

Fjalë kyçe: shuarje mase sigurimi, zëvendësim mase sigurimi, kontradiktoritet.

Decision No. 00-2023-1329 (222), dated 25.07.2023(termination/replacement of personal security measure: principle of adversarial proceedings)

Legal principle(s): The decision of the determination of the termination and replacement of the security measure must be conducted in accordance with the adversarial principle, ensuring that the parties are afforded the opportunity, where they consider it appro-

priate, to produce relevant evidence and to challenge the evidence submitted by the opposing party.

Keywords: *termination of security measure, replacement of security measure, adversarial proceedings.*

Rrethanat e çështjes:

Kërkuesi B.P, ka paraqitur [...]para Gjykatës së Apelit, kërkesën me objekt konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit “*arrest në burg*”, të caktuar në mungesë të tij më vendimin nr. [...]dhe të ekzekutuar në datë 01.04.2021, duke pretenduar se kanë kaluar afatet tërësore të parashikuar në nenin 263/b të KPP; zëvendësimin e kësaj mase me një masë sigurimi më të lehtë, siç është ajo e “*arrest në shtëpi*”, bazuar në nenin 260/2 të KPP.

[...]Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. [...], ka vendosur, ndër të tjera: Deklarimin fajtor të të pandehurit B.P për kryerjen e veprës penale “*Kultivimi i narkotikëve*”, parashikuar nga neni 284/2 i KP dhe në bazë të kësaj dispozite dhe nenit 406 të KPP është dënuar përfundimisht me 4 vjet e 8 muaj burgim. Vuajta e dënimit fillon nga dita e arrestimit 01.04.2021.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. [...] dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.[...] Kolegji Penal me vendimin datë [...] ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. [...] të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Apelit, Tiranë, me vendimin nr. [...]ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës*” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Kolegji konsideron se, paragrafi i katërt i nenit 260 të KPP, që identifikon kompetencën për gjykimin e kërkesave (të Prokurorit dhe të pandehurit) për revokimin, zëvendësimin, bashkimin e të masave të sigurimit personal, gjatë fazës së gjykimit të themelit të çështjes – tek “*gjykata që disponon materialisht aktet*” – në thelb – gjykata që gjykon procedimin kryesor – e cila ka detyrimin – për këtë shkak të – disponimit materialisht të akteve – për të gjykuar – për tu prononcuar – detyrimisht edhe për procedimin incidental të instauruar në kuadrin e këtij procedimi kryesor - gjen zbatim efektiv vetëm për gjykatat e faktit - të shkallës së parë dhe të dytë - për vetë karakterin ngushtësisht faktual të këtij lloji gjykimi, në pamundësi për t’u zbatuar pranë Gjykatës së Lartë, për shkak

të funksionit, sikurse u sipërcitua, ngushtësisht të fokusuar në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë së disponimeve të gjykatave më të ulëta.

Ky gjykim (*konstatimi i shuarjes së masës së sigurimit dhe zëvendësimi i masës së sigurimit*) duhet të realizohet në prezencë të kontradiktoritetit të palëve, të cilët (nëse do ta çmojnë) do të paraqesin provat përkatëse dhe do të kenë mundësinë të kundërshtojnë provat e paraqitura nga pala tjetër. Vetëm pasi të bëhet gjykimi para gjykatave të faktit, palët mund të ushtrojnë rekurs ndaj vendimit të gjykatës së Apelit, në Gjykatën e Lartë, e cila do të shqyrtojë rekursin/et në përputhje me parashikimet e nenit 432 të KPP, si dhe rregullave të përcaktuara në këtë Kod për gjykimin në Gjykatën e Lartë. Në këtë mënyrë, palëve mund t'u sigurohet dhe e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor, të paktën në një shkallë tjetër gjykimi. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se, fakti që gjykata vendos brenda 5 ditëve nga momenti i depozitimit të kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit dhe gjykimi bëhet me prezencën e palëve në kontradiktoritet, tregon se ky gjykim zhvillohet në gjykatat e faktit, pasi ligji jo vetëm që nuk parashikon afat gjykimi pesë ditë për Gjykatën e Lartë, por nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, në bazë të nenit 14/a të KPP, shqyrton rekursin në dhomë këshillimi dhe vetëm në rastet e parashikuara në ligj shqyrton çështje në seancë gjyqësore. Ndërsa në rastin konkret, referuar nenit 263 dhe 260/4 të KPP, shqyrtimi i kërkesës bëhet me prezencën e palëve, çka evidenton faktin se shqyrtimi i kësaj kërkesë bëhet nga gjykatat e faktit dhe jo nga Gjykata e Lartë.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se, në kushtet kur çështja e themelit, është kthyer për rishqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ajo gjykatë duhet të shqyrtojë çdo kërkesë që lidhet me masën e sigurimit të caktuar ndaj të pandehurve në atë gjykim, për rrjedhojë dhe kërkesën e paraqitur nga kërkuesi/ i pandehuri.



**6. Vendim nr.00-2023-1602 (272),
datë 12.10.2023 (sekuestro preventive:
ekzistencë e minimumit të provave për
elementet objektive të veprës penale)**

Maksima: Vërtetimi i veprës penale kundër të cilës kërkohet caktimi i një mase sigurimi pasuror, përcaktohet në gjykimin në themel të çështjes, gjatë të cilës prokurori duhet të provojë akuzën përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Kolegji rithekson se, për caktimin e masës së sekuestros preventive mjafton të krijohet një dyshim se vepra penale ekziston, pra

kërkohet ekzistenca e një minimumi provash që lidhen me elementet objektive të veprës penale.

Fjalë kyçe: sekuestro preventive, minimum provash

Decision no. 00-2023-1602 (272), dated 12.10.2023 (preventive seizure: existence of minimum evidence for the objective elements of the criminal offense)

Legal principle(s): Whether the criminal offence in respect of which a property security measure is sought has in fact been committed is a matter to be determined during the trial on the merits, where the prosecution bears the burden of proving the charge beyond reasonable doubt. The Criminal Chamber reiterates, however, that for the purpose of imposing a preventive seizure, it is sufficient that there exist reasonable grounds to suspect that a criminal offence has been committed, namely the existence of a minimum evidentiary threshold relating to the objective elements of the alleged offence.

Keywords: preventive seizure, minimum evidentiary threshold

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka regjistruar procedimin penal nr. [...], për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287 i KP. [...] Përsa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kërkuar në gjykatë caktimin e masës së sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të mësipërme të regjistruara në emër të këtyre personave, duke argumentuar se, ekziston dyshimi se nga shtetasit A.T, G.T dhe B.T disponohen pasuri të cilat mund të jenë mbi bazën e veprimtarisë së tyre kriminale pasi nuk justifikohen nga të ardhurat e tyre është e nevojshme vendosja e kësaj mase sekuestro dhe pikërisht sekuestrimi i pasurive luajtshme dhe të paluajtshme të sipërpërmendura, pasi këto pasuri mund të fshihen apo tjetërsohen nga shtetasit [...], veprim, i cili mund të rëndojë dhe zgjasë pasojat e veprës penale, si dhe bazuar në faktin se vetë objekti është produkt i veprës penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Pranimin e kërkesës. Vendosjen e masës së sigurimit sekuestro preventive mbi objektet: 1. Pasuria [...] Automjeti me targë automjetin me targë [...] [...]”

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “1. Ndryshimin e vendimit penal [...]. 2. Rrezimin e kërkeses se Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Elbasan. [...]”

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] konstaton se gjykatat e faktit kanë mospërputhje në disponimet e tyre lidhur me caktimin e masës së sekuestros preventive sipas nenit 274 të KPP ndaj pasurive të shtetasve [...], të kërkuara nga organi i akuzës. [...]

Në lidhje me sa më sipër, Kolegji sjell në vëmendje se KPP parashikon tre lloje të ndryshme sekuestrimi: sekuestron “provuese” (neni i 208 KPP), sekuestron “konservative” (neni 270 i KPP) dhe sekuestron “preventive” (neni i 274 KPP). E para është vendosur në kreun “mjetet e kërkimit të provës”; dy të tjerat tek kreu i masave të sigurimit. Element i përbashkët për të tre llojet e sekuestros është se ato passjellin një kufizim të disponimit të një sendi të luajtshëm a të paluajtshëm, nëpërmjet vendosjes së tyre në një “posedim të detyruar”. Por për shkak të qëllimit të ndryshëm që ndjekin, secila prej tyre gjen një rregullim të veçantë në KPP.

Sekuestroja “provuese” (neni 208 i KPP) vendoset për të siguruar një send të luajtshëm a të paluajtshëm, në një procedim, me qëllim vërtetimin e fakteve, nëpërmjet “posedimit të detyrueshëm” të sendit dhe vendosjes së kufizimeve për disponimin e lirë të tij. Vendosja e një kufizimi të tillë shërben për të mbajtur të pandryshuar sendin, me qëllim vërtetimin e fakteve.

Sekuestroja “konservative” (neni 270 i KPP) vendos mbi një send të luajtshëm ose të paluajtshëm një kufizim për disponimin e tij me qëllim garantimin e pagimit të dënimit me gjobë, shpenzimeve të procedimit ose çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit.

Sekuestroja “preventive” parashikohet në nenin 274 të KPP, [...] Sipas kësaj dispozite, sekuestroja “preventive” vendoset nga gjykata me kërkesë të prokurorit në prezencë të nevojave të sigurimit që vijnë:

Rrezikshmëria e sendit objekt sekuestrimi mund të rezultojë nga lidhja që ky send ka me faktin penal. Për këtë arsye, KPP lejon sekuestrimin me qëllimin për të evituar që “*disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj*”;

Rreziku që disponimi i lirë i sendit “*mund të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera*”;

Rrezikshmëria e vetë sendit; në fakt sekuestroja preventive lejohet të vendoset “*për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP*”. Kolegji evidenton faktin që “rrezikshmëria e sendit” është vlerësuar nga vetë ligjvënësi që ka parashikuar konfiskimin e tyre; vendosja e sekuestros preventive në këtë rast bëhet me qëllim që gjatë procesit të garantohet kufizimi nga disponimi i tyre i lirë.

Në vijim të analizës së mësipërme, sekuestroja preventive zbatohet në dy raste: në rastin e parë kur ka rrezik që disponimi i lirë i sendit që lidhet me veprën e penale mund të rëndojë a të zgjasë pasojat e veprës ose të lehtësojë kryejen e veprave të tjera; në rastin e dytë, sekuestroja zbatohet mbi sendet që janë produkt i veprës penale ose mbi çdo pasuri tjetër që mund të konfiskohet sipas nenit 36 të KP.

Kolegji thekson se, sekuestroja preventive e parashikuar në nenin 274 të KPP, vendoset në dy rastet e mësipërme dhe se organi i akuzës ka barrën e provës për të provuar se disponimi i lirë i sendit paraqet rrezik apo që sendi mund të konfiskohet. Lidhur me kriteret e vendosjes së masës së sekuestros preventive, Kolegji vlerëson se kjo masë zbatohet kur vërtetohet rreziku i disponimit të lirë të një sendi që lidhet me veprën penale, pra ekzistenca e indicjeve se personi ka kryer vepër penale dhe se disponimi i sendit ka rrezik që të rëndojë apo të zgjasë pasojat e veprës ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera. Kjo në rastin e parashikuar në paragrafin e parë të nenit 274 të KPP. Ndërsa në rastin e parashikuar në paragrafin e dytë të kësaj dispozite, kërkohet që për sendin të ketë indicje se është produkt i veprës penale apo që mund të konfiskohet sipas nenit 36 të KP. Në ndryshim nga caktimi i masave të sigurimit personal që kanë si kusht *sine qua non* ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, në rastin e sekuestros preventive, mjafton të krijohet një dyshim se vepra penale ekziston.

Duke iu rikthyer çështjes objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë, bazuar në aktet e paraqitura nga organi i akuzës, në analizë të nenit 274 të KPP ka vlerësuar se ka indicje se personi nën hetim A.T mund të ketë kryer veprën penale [...] të parashikuar nga neni 287 i KP.. [...]

Duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes të pranuar nga gjykatat e faktit, vendimmarrjes së tyre, në raport dhe me shkaqet e paraqitura në rekurs nga prokurori, Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit ka pamjaftueshmëri arsyetimi për arsyet që vijnë:

Së pari, ndonëse gjykata e apelit argumenton se për të tre shtetasit mbi të cilët është vendosur masa e sekuestros nuk ka asnjë vepër penale për të cilën ata dyshohet se kanë kryer dhe se prej saj kanë përfituar të ardhura, nuk arsyeton në drejtim të veprës penale të parashikuar nga neni 287 të KP, për të cilën prokuroria ka regjistruar procedim penal dhe ka paraqitur kërkesën objekt shqyrtimi. Ndonëse gjykata e apelit arsyeton se, me vendim të prokurorisë të datës 1.11.2011 është vendosur pushimi i procedimit penal në ngarkim të shtetasit A.T për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe i konsideron të pamjaftueshme të dhënat e përcjella

nga autoritetet italiane të drejtësisë, nuk arsyeton në drejtim të veprës penale të parashikuar nga neni 287 i KP për të cilën ka një procedim penal të regjistruar. Duhet evidentuar se dispozitat e nenit 287 të KPP gjejnë zbatim edhe në rastet kur [...]Kolegji vlerëson se, ndonëse, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ka indicje se personi nën hetim A.T mund të ketë kryer veprën penale [...]të parashikuar nga neni 287 i KP, gjykata e apelit e ka ndryshuar këtë vendim, pa argumentuar në drejtim të ekzistencës së indicjeve për ekzistencën e kësaj vepre penale.

[...]Kolegji vlerëson se, nga gjykata e apelit nuk është arsyetuar ky përfundim në raport me aktin e ekspertimit kontabël të marrë gjatë hetimeve (të mbajtur në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë) sipas të cilit B.T nuk mbulon me të ardhura të ligjshme [...] Në kushtet kur nga personi juridik tregtar Topuzi sh.p.k., nuk është shpërndarë dividend, Kolegji e gjen të paargumentuar vendimin e gjykatës së apelit në drejtim të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive objekt sekuestroje. Arsyetimi është i mangët edhe për arsye se, gjykata e apelit nuk argumenton se cilat aktivitete ekonomike fitimprurëse apo nga shitja e cilave pasuri janë krijuar të ardhurat e ligjshme të subjekteve të treta, të cilat i ka mbajtur në konsideratë për të arritur në përfundimin se këto subjekte kanë patur burime të ligjshme për krijimin e pasurive objekt sekuestro. Gjithashtu, argumentimi i gjykatës së apelit se personat e tretë kanë pasur aktivitet ekonomik fitimprurës në kohë shumë më parë se të ishte i dënuar familjari i tyre, vlerësohet nga Kolegji i paarsyetuar pasi nuk identifikohet se cili familjar apo dënim është mbajtur në konsideratë për arritjen e një përfundimi të tillë, në kushtet kur nga aktet e dosjes të paraqitura nga prokurori kanë rezultuar indicje për aktivitet kriminal nga shtetasi A.T “Favorizimi i prostitucionit”, parashikuar nga neni 114/1 KP në periudhën kohore [...]Kolegji konstaton se shtetasi A.T është hetuar për veprën penale të favorizimit të prostitucionit të parashikuar nga neni 114/1 i KP dhe çështja penale në ngarkim të tij është pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale dhe jo se fakti nuk ekziston, nuk përbën vepër penale apo se nuk provohet se e ka kryer ky shtetas.

Së treti, gjykata e apelit nuk ka arsyetuar mjaftueshëm përmbushjen e kushteve të nenit 274 të KPP, përsa ka konkluduar se për të tre shtetasit mbi të cilët është vendosur masa e sekuestros nuk ka asnjë vepër penale për të cilën ata dyshohet se kanë kryer. [...] Kolegji vë në dukje [...] se subjekti i kryerjes së veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale është çdo person i cili është në dijeni se çdo pasuri që ai mban, përdor, fsheh, zhvendos etj., është produkt i një vepre penale, pavarësisht faktit nëse është apo jo ky subjekt autori i veprës penale kryesore. Vërtetimi i

veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal (neni 287 KP në rastin konkret) dhe në kuadër të të cilit kërkohet caktimi i një mase sigurimi pasuror, nuk përcaktohet në këtë moment, por në gjykimin në themel të çështjes, gjatë të cilit prokurori duhet të provojë akuzën *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*. Kolegji rithekson se, për caktimin e masës së sekuestros preventive mjafton të krijohet një dyshim se vepra penale ekziston. Lidhur me caktimin e masës së sigurimit “sekuestro preventive”, kërkohet ekzistenca e një minimumi provash që lidhen me elementet objektiv të veprës penale.

Sa më sipër, Kolegji konstaton pamjaftueshmëri arsyetimi nga ana e gjykatës së apelit. [...] Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit duhet të priset dhe **çështja të kthehet për rishqyrtim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues**. Kjo çështje duhet kthyer për rishqyrtim në gjykatën e apelit, pasi ky kthim diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve dhe provave/akteve të marra deri në këtë fazë të procedimit penal (*përfshi këtu edhe verifikimin në çfarë faze apo gjendje është aktualisht procedimi penal nr. 1687, i vitit 2018*), analizë që duhet bërë duke pasur në konsideratë nivelin e dyshimit dhe nevojat e sigurimit, pra kriteret për caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” sipas nenit 274 të KPP, të evidentuara më lart në këtë vendim.



**7. Vendim nr.00-2023-1935 (320),
datë 21.11.2023 (revokim/zëvendësim
mase sigurimi: rrethanat e reja)**

Maksima: *Në procedurën e parashikuar nga neni 260 i KPP, revokimi ose zëvendësimi i masës së sigurimit nuk mund të mbështetet në risjelljen e të njëjtave pretendime të shqyrtuara në vendimmarrjen për caktimin e masës. Rrethanat e reja duhet të jenë të tilla që të ndikojnë në nevojat e sigurimit, duke provuar zbutjen e tyre ose mospërputhjen e mëtejshme të masës me rëndësinë e faktit apo dënimin që mund të caktohet.*

Fjalë kyçe: *masë sigurimi, arrest në burg, zëvendësim mase, rrethana të reja*

Decision no. 00-2023-1935 (320), dated 21.11.2023 (revocation/replacement of security measure: new circumstances)

Legal principle(s): *In the procedure provided for by Article 260 of the CPC, the revocation or replacement of the security measure cannot be based on the re-introduction of the same claims examined in the decision-making for the determination of the measure. The new circumstances must be such as to affect the grounds justifying the security measure, proving their mitigation or further inconsistency of the measure with the importance of the fact or the punishment that can be determined.*

Keywords: *security measure, prison detention, replacement of security measure, new circumstances*

Rrethanat e çështjes:

[..] Në kuadër të këtij procedimi, [..] më datë 12.05.2023, [..], është bërë arrestimi në flagrancë i të pandehurit Dh.A.B, ndërsa në orën 08:30, të së njëjtës datë, është bërë arrestimi në flagrancë i të pandehurit tjetër P.K [..] pasi dyshoheshin për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të KP.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. [..], ka vendosur: “1. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë datë [..] 2. Caktimin ndaj personit nën hetim Dh.A.B masën e sigurimit personal shtrëngues “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i KPP. 3. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë datë 12.05.2023, të personit nën hetim P.K [..] Caktimin ndaj personit nën hetim P.K masën e sigurimit personal shtrëngues atë “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i KPP [..] Dërgimin e akteve të çështjes penale nr. 205 regj. them, datë 12.5.2023 regjistrimi të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore. ...”.

[..] Gjykata e Posaçme e [..] ka vendosur: “Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” parashikuar nga neni 238 i KPP caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. [..], ndaj personave nën hetim [..] të dyshuar lidhur me veprën penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje në bashkëpunim parashikuar nga neni 328 dhe 25 i KP. [..]

Gjykata e Posaçme e Apelit [..] ka vendosur: “Miratimin e Vendimit nr. [..] me ndryshimin si vijon: 2. Caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, ndaj personit nën hetim P.K sipas nenit 234 të KPP. [..]

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. [...], të Gjykatës së Posaçme të Apelit [...].”

[...] I pandehuri Dh.A.B, [...] i është drejtuar Gjykatës së [...] me kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg” me një masë sigurimi më të lehtë.

Gjykata e Posaçme e [...] ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës penale nr. [...] si të pabazuar në ligj dhe në prova. [...]

Gjykata e Posaçme e Apelit [...] ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit [...] të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”.

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi nuk është i bazuar, me pasojë mospranimin e tij. Kolegji konstaton se, pretendimet e parashtruara në rekurs lidhen me zbatimin e nenit 260 të KPP dhe kanë për objekt vendimarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, të cilat kanë rrëzuar kërkesën e të pandehurit për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, të caktuar më herët ndaj tij. [...]

Duke qenë se nevojat për caktimin e masës së sigurimit janë dinamike, Kolegji penal ka mbajtur qëndrimin se, kur vlerësohet se ka ndryshim të këtyre nevojave, masat e sigurimit mund të revokohen nga gjykata, apo të zëvendësohen me masë më të lehtë, apo më të rëndë, në përputhje me parashikimet e nenit 260 të KPP. Nuk mjafton vetëm evidentimi i rrethanave të reja, por duhet që këto rrethana të reja të kenë ndikim në nevojat e sigurimit, duke imponuar ndryshim të tyre.

Në rastin konkret objekt shqyrtimi, pikërisht, në përputhje me mjetin procedural të përzgjedhur nga kërkuesi “zëvendësimi i masave të sigurimit”, referuar rrethanave të çështjes të evidentuara nga gjykatat e faktit dhe shkaqeve të rekursit, nuk rezulton që, nga momenti i caktimit të masës së sigurimit “Arrest në burg” ndaj kërkuesit, të jenë verifikuar rrethana të reja me ndikim në nevojat e sigurimit.

[...] Kolegji çmon se ky arsyetim i kërkuesit nuk është i bazuar. *Së pari*, sikundër kanë argumentuar gjykatat e faktit, vendimi i komunikimit të akuzës ndaj kërkuesit tregon për ndryshim të rrethanave, të cilat e rëndojnë situatën e tij procedurale, pasi në përfundim të hetimeve prokuroria ka vijuar me komunikimin e akuzës dhe nuk rezulton që të ketë pushim të procedimit apo lehtësim të akuzës, referuar veprave penale për të cilat kërkuesi ka qenë nën hetim. Megjithatë argumentet e mësipërm janë të mjaftueshëm për rrëzuar këtë pretendim të kërkuesit lidhur me ndikimit e kësaj rrethane në zbutjen e nevojave të sigurimit, sillet gjithashtu në vëmendje se gjykatat, në

ekzistencën e nevojave për caktimin e një mase sigurimi ndaj kërkuesit kanë evidentuar ekzistencën e të tre kushteve të parashikuar në paragrafin 3 të nenit 228 të KPP, ndërsa, sa i përket përzgjedhjes së masës konkrete i janë referuar parashikimeve të neneve 229 dhe 230 të KPP.

Kështu, edhe lidhur me pretendimin vijues se tashmë provat i janë ekspozuar rrezikut të marrjes apo të vërtetësisë së tyre, me caktimin e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” të të dyshuarit në atë kohë P.K, Kolegji vlerëson se, sikundër është arsyetuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimarrjen me objekt caktimin e masave të sigurimit për të Dh.A.B dhe P.K në këtë procedim penal, situata në të cilën ndodhej P.K paraqitej e ndryshme lidhur me nevojat e sigurimit dhe vendimarrja përkatëse ka qenë gjerësisht dhe mjaftueshmërisht e argumentuar. Megjithatë, nëse mbrojtja e kërkuesit është në dijeni të të dhënave që P.K, megjithë gjendjen e tij shëndetësore, ndikon në ndotjen e provave, ka detyrimin që të paraqesë kallëzim pranë organeve ligjzbatuese. Gjithësesi, një eventualitet i tillë, nëse mund të ketë ndikim në situatën ligjore të P.K, nuk ndikon tek nevojat e sigurimit të të bashkëpandehurit Dh.A.B, pasi sikundër ka arsyetuar Kolegji në vendimarrjen me objekt caktimin e masave të sigurimit, nevojat e sigurimit paraqiten të ndryshme nga subjekti në subjekt, në përputhje me parashikimet e neneve 228 – 230 të KPP. Në rrethanat e deritanishme, referuar argumentimeve të vendimarrjes së Kolegjit në caktimin e masave të sigurimit për këtë procedim, nuk ka baza të arsyeshme dhe as të bazuara në ligj, që fakti se të bashkëdyshuarit Kokaveshi i është caktuar masë sigurimi “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, zbeh apo shuan rrezikun e marrjes apo vërtetësisë së provave nga kërkuesi.

Referuar argumentimit të rekursit të paraqitur, Kolegji vëren se nuk është në të njëjtën linjë me mjetin procedural “Revokimi, zëvendësimi dhe bashkimi i masave të sigurimit”, parashikuar nga neni 260 i KPP dhe të përzgjedhur nga ajo për t’iu drejtuar gjykatave. Sjellja si argumentim nga ana e mbrojtjes e të njëjtave rrethana të shqyrtuara në momentin e caktimit të masës nuk është në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligjvënësi kur ka parashikuar këtë mjet procedural në KPP. Sikundër është evidentuar më lart në këtë arsyetim, nevojat për caktimin e masës së sigurimit janë dinamike. Kolegji Penal ka mbajtur qëndrimin se, kur vlerësohet se ka ndryshim të këtyre nevojave, masat e sigurimit mund të revokohen nga gjykata, apo të zëvendësohen me masë më të lehtë, apo më të rëndë, në përputhje me parashikimet e nenit 260 të KPP. Nuk mjafton vetëm evidentimi i rrethanave të reja, por duhet që këto rrethana të reja të kenë ndikim në nevojat e sigurimit, duke imponuar ndryshim të tyre.

Risjellja nga ana e mbrojtjes e të të njëjtave argumente të cilat kanë qenë objekt shqyrtimi në vendimmarrjen për caktimin e masës dhe që janë arsyetuar gjerësisht edhe nga Kolegji Penal në atë shqyrtim, nuk është në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë mjetin procedural të përzgjedhur nga mbrojtja në këtë kërkim. Konkretisht, pretendimet mbi faktin se *dëshmitari ka qenë i dënuar për mashtrim, apo përgjimet e paligjshme* janë avancuar dhe më parë nga mbrojtja dhe ligjshmëria e përgjimeve ka qenë objekt edhe i një shqyrtimi të posaçëm gjyqësor lidhur me vlefshmërinë e tyre. Gjithashtu, Kolegji ka arsyetuar lidhur me pretendimet për trajtimet e ndryshme në raste të tjera me subjekte të proceduar të zgjedhurit vendorë.

Sa i përket çështjes së rehabilitimit të personit, Kolegji është shprehur edhe më herët me vendimin nr. 00-2023-1313 (224), datë 25.07.2023, të Kolegjit Penal, lidhur me këtë pretendim. Pa përsëritur të njëjtin arsyetim të bërë më herët nga Kolegji, sillet në vëmendje se Kolegji ka arritur në atë përfundim, jo sepse nuk ka pasur dijeni apo se nuk e ka marrë në konsideratë dëshminë e penalitetit si “I padënuar”, të paraqitur nga mbrojtja, por, ka arsyetuar se referuar ligjit të brendshëm, rehabilitimi i referohet një dënimi të vuajtur. Edhe fakti që tashmë është administruar dëshmia e re e penalitetit për kërkuesin, nga ku rezulton se ai është “i rehabilituar”, nuk ndryshon qëndrimin në këtë drejtim. Sërish ekziston rreziku i ikjes së të pandehurit, i lidhur me rrethanën se ai i është shmangur ekzekutimit të vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Vlorë, me të cilin është deklaruar fajtor për veprat penale “Thirrja për urrejtje nacionale” dhe “Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj”, të parashikuara nga nenet 266 – 25 dhe 268 – 25 të KP, lënë në fuqi nga [...] dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 09, datë 04.02.2009. Ky është një fakt i pakontestuar nga palët dhe i pranuar nga gjykatat në vendimin e tyre përfundimtar për caktimin e masës së sigurimit për të pandehurin Dhionisios Alfred Beleri.

Lidhur me këtë rrethanë të ngritur si shkak rekursi, Kolegji mban qëndrimin se rehabilitimi shuan dënimet plotësuese dhe çdo efekt penal të dënimit, por nuk përjashton vlerësimin e precedentëve penalë dhe gjyqësore të të rehabilituarit, duke qenë se bëhet fjalë për fakte të cilat gjyqtari duhet t'i mbajë në konsideratë, në vlerësimin e sjelljes në të kaluarën të të pandehurit, në funksion të caktimit të dënimit. Ky dënim i paekzekutuar në rast rehabilitimi nuk mund të mos merret në konsideratë nga ana e gjykatës në vlerësimin e personalitetit të të pandehurit dhe sjelljes së tij të mëparshme në raport me ligjin.

Përsa i përket rrezikut të marrjes ose vërtetësisë së provës, ky rrezik, sikurse është theksuar në vendimin përfundimtar dhe të formës së prerë

për caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit, vazhdon të ekzistojë. Paralelizmat që kërkuesi, tashmë me cilësinë e të pandehurit, heq me të pandehurin tjetër në të njëjtin procedim, P.K, nuk ekzistojnë. Jo vetëm që gjykatat në vendimmarrjet e sipërcituara kanë argumentuar nevojën e zbatimit të masës së sigurimit “Arrest në burg”, e parashikuar nga neni 238 i KPP, për kërkuesin, por roli dhe pozicioni i tij në raport me atë të të bashkëpandehurit tjetër nuk është i njëjtë. Kërkuesi rezulton të jetë kandidat fitues në zgjedhjet vendore të zhvilluara në Bashkinë Himarë dhe, si i tillë, me marrjen e detyrës ai do të vishet me pushtet dhe autoritet shtetëror. Kjo do t'i mundësonte kërkuesit, në dallim nga i pandehuri tjetër P.K, i cili nuk rezulton të ketë një post të rëndësishëm zyrtar, të ndikonte mbi provat. Faktet që e mbështesin këtë përfundim si dhe mënyra se si ai mund të helmojë provat janë shpjeguar në mënyrë eksplicite në vendimmarrjet e mëparshme që kanë disponuar për caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit.

[..] Sa i përket kërkesës për aplikimin e parashikimeve të nenit 236 të KPP, që ka të bëjë me zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” me masën “Garancia pasurore”, rezulton se nuk përmbushen kushtet për këtë zëvendësim. Referuar parashikimeve të nenit 236 të KPP, [..] garancia pasurore jepet kur, në caktimin e masës së sigurimi, gjykatat kanë evidentuar vetëm rrezikun e ikjes. Ndërkohë, në rastin në shqyrtim, referuar vendimmarrjeve të gjykatave në caktimin e masës së sigurimit, prej këtyre gjykatave është evidentuar jo vetëm rreziku i ikjes, por edhe ai i kryerjes së krimeve të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet, apo rreziku i marrjes apo vërtetësisë së provës. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se nuk janë kushtet për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” me masën “Garancia pasurore”.

Lidhur me llojin e masës së sigurimit që është caktuar ndaj kërkuesit, në respektim të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të parashikuara në nenet 229 dhe 230 të KPP, kjo është argumentuar në vendimmarrjet e sipërpërmendura që e kanë caktuar këtë masë, që tashmë konsiderohen përfundimtare me vendimin nr. [..], të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për rrethanat që ato kanë analizuar. Në këtë kontekst Kolegji konsideron të drejtë qëndrimin e Gjykatës së Apelit të Posaqëm se, nuk rezulton që kërkuesi të ketë prezantuar rrethana të reja, të cilat të kenë zbutur nevojat e sigurimit ose të kenë bërë që masa e sigurimit të mos i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet.

Shkaqet e parashtruara në ankim lidhur me nevojën e kërkuesit për të kryer betimin dhe marrë detyrën e Kryetarit të Bashkisë Himarë, si një e drejtë e komunitetit që e ka zgjedhur dhe si një standard i shtetit të së drejtës, e theksuar edhe nga rezoluta e Parlamentit Evropian, gjykata

i konsideron si shkaqe jo të karakterit ligjor. Instituti i zëvendësimit të masës së sigurimit nuk mund të vihet në lëvizje nga ana e të paraburgosurit me argumentin se ai duhet të kryejë betimin si i zgjedhur në pushtetin vendor dhe të marrë detyrën, por ka të bëjë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhet të garantohen në çdo rast konkret. [...]

Në përfundim, referuar arsyetimit të mësipërm, Kolegji vlerëson se kërkesa e kërkuarit Dh.A.B për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, nuk është e bazuar në ligj dhe për rrjedhojë, vendimmarrja e gjykatave për rrëzimin e kësaj kërkeje, duhet të mbetet në fuqi.



**8. Vendim nr. 00–2024–432 (60),
datë 07.03.2024 (masë siguri
personal: humbje fuqie juridike -
vendim penal i formës së prerë)**

Maksima: *Largimi nga banesa i personit ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, gjatë kohës që kjo masë është ende në fuqi, përbën veprën penale të “Largimit të të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, sipas nenit 323/1 të Kodit Penal. Pas marrjes formë të prerë të vendimit penal të dënimit, masa e sigurimit humbet fuqinë dhe mosparaqitja vullnetare për vuajtjen e dënimit nuk përbën këtë veprë penale, por i përket fazës së ekzekutimit të vendimit.*

Fjalë kyçe: *largim i burgosuri nga vendi i qëndrimit, masë siguri, arrest në shtëpi, ekzekutim vendimi penal*

Decision no. 00–2024–432 (60), dated 07.03.2024 (personal security measure: loss of legal force-final criminal decision)

Legal principle(s): *A person subject to the security measure of house arrest who leaves the designated place of residence while the measure remains in force commits the criminal offence of “Escape of a detainee from the place of detention”, as provided for in Article 323/1 of the Criminal Code. Once the criminal conviction has become final, the security measure ceases to have legal effect. Consequently, the convicted person’s voluntary failure to surrender for the execution of the custodial sentence does not constitute this criminal offence, but falls within the scope of the execution of criminal judgments.*

Keywords: *escape of a detainee from the place of detention, security measure, house arrest, execution of a criminal judgment*

Rrethanat e çështjes:

[..]në Komisarriatin e Policisë nr. 3 Tiranë, është dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë urdhri për ekzekutimin e vendimit penal datë [..], pasi me vendimin e formës së prerë nr. [..]të Gjykatës [..] është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit R.F për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, të parashikuar nga neni 139 e 25 i KP dhe dënimi i tij me shtatë vjet burgim. Shtetasi R.F ka qenë me masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi” dhe [..] i kishin mbetur për të vuajtur edhe katër vjet, dy muaj e njëzet ditë burgim.

[..]i gjykuari nuk është gjendur në banesën e tij, fakt që është dokumentuar në procesverbal. [..] rezulton se ai është larguar nga Shqipëria me datë 09.02.2017 dhe nuk është kthyer më. [..]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. [..]ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit Redi Ferizaj për veprën penale të “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” dhe në bazë të nenit 323/1 të KP, dënimin e tij me 1 vit burgim. Vuajtja e dënimit të pandehurit Redi Ferizaj i fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi.(...)”. [..]

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. [..]ka vendosur: “Prishjen e vendimit penal nr. [..]dhe pushimin e çështjes”. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se në çështjen objekt gjykimi, duhet të analizohen elementet e figurës së veprës penale “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, parashikuar nga neni 323/1 i KP, në raport me faktin e provuar gjatë gjykimit në fakt. [..] Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të institucioneve ku vuhet dënimi ose mbahen të ndaluarit, të arrestuarit ku përfshihen edhe organet e ngarkuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore apo ruajtjen e burgjeve apo vendeve të qëndrimit të të ndaluarve apo arrestuarve, të mbrojtur posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive, ky krim realizohet me veprime aktive të kundërligjshme që shfaqen në forma të ndryshme: (i) në largimin e të ndaluarve nga vendi i posaçëm ku është vendosur nga organet e rendit publik; (ii) në largimin e të arrestuarit nga qelitë ose vendet e izolimit ose gjatë transportimit; (iii) në largimin e të burgosurit nga vendi i vuajtjes së dënimit, pasi vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë; (iv) me largimin ose moskthimin në institucionin mjekësor ku është vendosur me vendim të gjykatës për mjekim të detyruar; (v) me moskthimin në vendin e vuajtjes së dënimit sipas vendimit të copëzimit të dënimit ose nga leja e

dhënë nga organet kompetente; (vi) me largimin e personit që i atribuohet vepra penale, personit nën hetim apo të pandehurit nga banesa kur është me masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”. [...]. Dispozita penale e nenit 323/1 të KP është një dispozitë e vetme dhe duhet lexuar si e tillë dhe jo në mënyrë të ndarë dhe të pavarur nga titulli apo e fragmentuar në vetë përmbajtjen e saj, sipas të cilës subjekt i largimit nga vendi i qëndrimit do të quhet vetëm ai i dyshuar të cilit i është kufizuar liria dhe ndodhet nën mbikëqyrjen e policisë apo të forcës së sigurisë të institucionit të ekzekutimit të vendimit penal, në ambiente të posaçme që ruhen dhe garantohen nga shteti. Subjekt i kësaj dispozite penale është çdo i ndaluar, apo i arrestuar në ngarkim të të cilit gjykata ka vendosur masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, thyerja apo mosrespektimi i së cilës është e njëjtë me atë të largimit nga çdo vend qëndrim i detyrueshëm i caktuar nga gjykata, përfshirë këtu edhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”. (vendimi nr.208, datë 03.07.2013 të Kolegjit Penal).

[...]Kolegji vlerëson se konkluzioni i gjykatës së shkallës së parë, lidhur me fajësinë e të gjykuarit R.F për veprën penale, të parashikuar nga neni 323/1 i KP është në interpretim të drejtë të ligjit penal material mbi faktin e provuar, ndonëse në vlerësimin e Kolegjit me arsyetim tjetër. [...]

Në këtë këndvështrim, ndryshe nga sa argumentojnë gjykatat e faktit, Kolegji vlerëson se i gjykuari është fajtor, pasi është larguar nga banesa gjatë kohës që masa e sigurimit “arrest në shtëpi” ka qenë në fuqi dhe jo në kohën, pasi që vendimi i dënimit ka marrë formë të prerë (27.03.2017). Pas kësaj date sikurse me të drejtë ka arsyetuar gjykata e apelit, nuk formësohen elementet e veprës penale, të parashikuar nga neni 323/1 të KP, pasi fakti që një i dënuar nuk ekzekuton vullnetarisht një vendim penal me burgim, nuk passjell përgjegjësi penale. Ekzekutimi i vendimeve penale të formës së prerë bëhet nga ana e policisë, e cila kryen të gjitha veprimet e mundshme për ekzekutimin me forcë të vendimit. Kolegji vlerëson se, me marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor penal të dënimit nuk mund të flitet për ekzistencë të fuqisë juridike të masave të sigurimit. Masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” humbet fuqinë me marrjen formë të prerë të vendimi të dënimit penal. Pas këtij momenti, e gjithë procedura e ekzekutimit është përgjegjësi e koordinimit midis gjykatës së apelit e cila ia përcjell vendimin gjykatës së shkallës së parë, kjo e fundit prokurorit të ekzekutimeve në prokurorinë pranë saj dhe më tej prokurori nxjerr urdhërin e ekzekutimit. E gjithë hapësira kohore e nevojshme e koordinimit të këtyre institucioneve nuk mund të interpretohet se i dënuari vijon të jetë me masë siguri, pasi masat e sigurimit i shërbejnë garantimit të hetimeve e gjykimit dhe nuk mund të përdoren për të

garantuar fazën e ekzekutimit të një vendimi penal. Faza e ekzekutimit garantohet nga vetë strukturat, procedurat dhe veprimtaria konkrete e përcaktuar shprehimisht në ligjin e posaçëm, ku parashikohet ekzekutimi vullnetar dhe më tej ai i detyrueshëm. Mund të ndodhë që organet kompetente të mos koordinohen për një periudhë relativisht të gjatë midis tyre për të ekzekutuar vendimin penal, pra prokurori të vonojë në nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit. Kjo nuk do të thotë që shtetasi i dënuar të vijoje të jetë me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”. Nuk ka kuptim dhe logjikë juridike që i njëjti person të jetë paralelisht i dënuar me vendim penal të formës së prerë me burgim dhe njëkohësisht të jetë nën masën e sigurimit “Arrest në shtëpi” për të njëjtin fakt penal/procedim penal. Një interpretim i ndryshëm do të çonte në interpretimin e gabuar juridik se vendimi gjyqësor penal merr formë të prerë në momentin që nxjerr urdhërin e ekzekutimit prokurori.

Në vijim të kësaj analize, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit ka zbatuar gabim ligjin penal material mbi faktin penal të provuar në gjykim, pasi nuk ka marrë në konsideratë faktin që në kohën e largimit nga vendi i qëndrimit (sipas të dhënave nga sistemi TIMS) masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi” ka qenë në fuqi, pasi vendimi i dënimit nuk kishte marrë ende formë të prerë. Prandaj, edhe referimi i gjykatës së apelit në vendimin nr. 46, datë 01.04.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk është i saktë. Kjo pasi rrethanat ligjore dhe faktike të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 46, datë 01.04.2015 nuk janë të njëjta me situatën që paraqitet në rastin objekt shqyrtimi, pasi në rastin e të gjykuarit sipas atij vendimi, i gjykuari është larguar nga shtëpia gjatë kohës që është dhënë ndaj tij një masë tjetër më të ashpër nga gjykata e apelit, e cila është vlerësuar nga Kolegji Penal se nuk formëson elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 323/1 të KP, pasi nuk ekziston detyrimi ligjor për të pandehurin për respektimin e masës së mëparshme. Ndërkohë që në rastin konkret ka rezultuar e provuar se i pandehuri R.F është larguar gjatë zbatimit dhe ekzekutimit të masës së arrestit në shtëpi (ende pa marrë formë të prerë vendimi i dënimit).

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Tiranë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit penal material mbi faktin që është provuar në këtë gjykim, si dhe në ometim të arsytimit të kësaj vendimmarrje sipas neneve 152 dhe 383 të KPP. [...]

Në përfundim të analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson se, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit penal material mbi faktin e provuar në gjykim dhe arsytimi përmban vijë logjike me faktet dhe rrethanat të pranuar si të provuara

nga të dyja gjykatat e faktit. Zbatimi i ligjit penal material është kryer drejtë prej Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, prandaj Kolegji vlerëson se kjo vendimmarrje duhet lënë në fuqi, ndërsa duhet prishur vendimi i Gjykatës së Apelit për të gjitha shkaqet e arsyeuara më sipër.



**9. Vendim nr. 00-2024-515 (76),
datë 25.03.2024 (sekuestro provuese
mjete pune/përmbajtje personale:
proporcionaliteti i masës)**

Maksima: Në ankimet mbi ekzekutimin e sekuestrimit në fazën e hetimeve paraprake, edhe kur sekuestrimi si mjet kërkimi prove është në parim i ligjshëm dhe i justifikuar, gjykata e apelit ka detyrimin të kryejë shqyrtim efektiv të pretendimeve mbi proporcionalitetin (sasior, cilësor dhe kohor) të masës, veçanërisht kur sekuestrimi prek mjete pune të gazetarit dhe materiale me përmbajtje personale/familjare e të fëmijëve.

Fjalë kyçe: sekuestro provuese, të dhëna kompjuterike, privatësi personale, proporcionalitet.

Decision no. 00-2024-515 (76), dated 25.03.2024 (evidentiary seizure of work equipment/personal content: proportionality of the measure)

Legal principle(s): In appeals on the execution of seizure in the preliminary investigation phase, even when seizure as a means of searching for evidence is in principle lawful and justified, the appellate court has the obligation to conduct an effective review of the claims on the proportionality (quantitative, qualitative and temporal) of the measure, especially when the seizure affects the journalist's work equipments and materials with personal/family content and children.

Keywords: evidentiary seizure, computer data, personal privacy, proportionality

Rrethanat e çështjes:

Në datë [...], Prokuroria e Posaçme [...] ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, kërkesën për lejim kontrolli personal, në banesë dhe vendin e punës së ankuesit. [...] Prokurori i Posaçëm në kërkesën e parashtruar në gjykatë ka pretenduar se konstatohet dukshëm që teksti në

këto publikime (të sipërmendura) përmban disa pjesë të komunikimeve që bashkëpunëtori i drejtësisë N.D (aktualisht i pandehur) ka bërë me disa persona (të paidentifikuar deri aktualisht nga hetimet) në platformën e kriptuar SkyECC. [..]

Nga veprimet verifikuese [..] përsa i përket publikimeve të artikujve të sipërcituar, si dhe konsultimit me aktet hetimore të komunikimeve SkyECC [..] rezulton se bisedat e bëra publike në media, nuk janë dokumentuar ende në akte procedurale nga ana e Prokurorisë së Posaçme në kuadër të procedimit penal nr.75/2022. Nga ana tjetër, disa nga shkrimet e evidentuara në artikujt mediatik, përputhen me përmbajtjen e komunikimeve që ka kryer N.D, me përdorues të tjerë në platformën SkyECC (të paidentifikuar deri aktualisht), komunikime të cilat Prokuroria e Posaçme i disponon (i ka pjesë të akteve të hetimit paraparak).

[..]Me vendimin nr. [..], Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme [..]duke vendosur lejimin e kontrollit në vendin e punës ku gazetari E.Q ushtron detyrën e tij me adresë: “ [..]dhe në banesën e tij të ndodhur [..]me qëllim për të kërkuar, gjetur, marrë e sekuestruar sende dhe prova materiale që lidhen me veprën penale. Me vendimin nr. [..]ka vendosur pranimin e kërkesës [..] duke vendosur lejimin e kontrollit personal të shtetasit E.Q me qëllim gjetjen e sendeve apo provave materiale që lidhen me veprën penale. [..]

Gjykata e Posaçme e [..], me vendimin nr. [..], ka vendosur:

“Kthimin e një USB-je [..]marrë gjatë kontrollit të automjetit, pronarit të ligjshëm shtetasit Elton Qyno. Për pjesën e sendeve për të cilat ka disponuar Prokuroria e Posaçme me urdhrin “Për kthimin e sendit” datë 25.12.2023, zbatohet ky urdhërim. Rrëzimin e kërkeve të tjera si të pambshtetura në ligj”.

[..]

Gjykata e Posaçme e Apelit [..], me vendimin nr. [..] ka vendosur: *“Miratimin e vendimit nr. [..] Ndalimin e publikimit të këtij vendimi në referim të nenit 103 të KPP”. [..]*

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] pranon analizën që ka bërë Gjykata e [..]në lidhje me veprimet e domosdoshme të Prokurorisë së Posaçme për kryerjen e këtyrë veprimeve procedurale në kushtet e regjistrimit të një procedimi në lidhje me veprën penale të [..]parashikuar nga nenet 295/a paragrafi 3 dhe 313/b, pika 1 të KP.

Ne rekursin e paraqitur ndaj këtij vendimi ngrihen të njëjtat pretendime të cilat janë paraqitur para Gjykatës së Apelit të Posaçëm, duke kërkuar nga

Gjykata e Lartë heqjen e sekuestros mbi këto sende të sekuestruara dhe pavlefshmërinë e veprimeve procedurale të kryera. [...] Ndërsa në rekursin ndaj Vendimit nr. [...] të Gjykatës së Posaçme e Apelit [...], vlerëson se, objekt rekursi janë procedura ekzekutimit të sekuestrimit dhe kërkesa për heqjen e sendeve të sekuestruara.

[...] Ashtu siç argumenton dhe Gjykata e Apelit, Kolegji vlerëson së bisedat e publikuara të bashkëpunëtorit të drejtësisë N. D me persona të tjerë, jo vetëm që nuk kanë interes publik por ato janë të dhëna që nuk duheshin nxjerrë nga ata që i kanë patur në posedim. [...] Kriterin e domosdoshmërisë në këtë rast të sekuestros e justifikon pikërisht vepra penale që parashikon penalizim të veçantë mbi personat, subjekte të veçanta, punonjës policie, oficerët e policisë, nëpunës të administratës, e të sistemit të drejtësisë që nxjerrin të dhënat në lidhje me bashkëpunëtorët e drejtësisë.

Kolegji vlerëson se në bazë të akteve deri në këtë fazë të hetimit në lidhje me hetimet [...] për kryerjen e veprës penale [...] parashikuar nga nenit 295/a paragrafi 3 dhe 313/b, pika 1 të KP, dyshohet se janë kryer veprime që vijnë në kundërshtim me ligjin, me përmbushjen e rregullt të detyrës të cilat shfaqen në zbulimin ndaj të tretëve të akteve sekrete, akte hetimore që përbëjnë sekret hetimor (lidhur me komunikimet SkyECC).

Sendet e sekuestruara kanë vlerën e provës materiale, pasi janë objekt i verifikimeve që po kryen prokuroria në funksion të hetimit të procedimit penal nr.75 të vitit 2022, hetuar dhe për veprat penale [...] të parashikuara nga nenit 295/a paragrafi 3 dhe 313/b, pika 1 të KP. [...]

Kolegji vlerëson se kjo mënyrë interpretimi i nenit 218 pika 3 e KPP, nuk e çliron gjykatën gjatë fazës së hetimeve paraprake nga detyrimi për të kontrolluar respektimin e garancive të moscenimit të jetës private, familjare, të drejtave të fëmijëve gjatë përdorimit të ekzekutimit të mjeteve të tilla si kontrolli dhe sekuestroja si dhe nga zbatimi i parimit të proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë gjatë zbatimit të masës së sekuestros. [...] Kolegji pranon argumentet e Vendimit të Gjykatës së Apelit se telefonat celular nuk janë sisteme kompjuterike por sende. Kolegji pranon arsyetimin e Gjykatës [...], në lidhje me interpretimin që i ka bërë pretendimit në ankim se janë shkelur rregullimet e parashikuara në nenin 208/a të KPP. Në rastin e sekuestrimit të telefonave nuk kemi të bëjmë me sekuestrim të dhënash apo sistemesh kompjuterike, por me sekuestrimin si send.

Kolegji në këtë rast rithekson qëndrimin në Vendimin Njësues nr. 00-2021-1135 i Vendimit (147) të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë mbi interpretimin e nenit 208/a, Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike [...]

Në lidhje me sekuestron provuese, [...] është shtuar në KPP neni 208/a, i titulluar "Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike". Sikundër konstatohet,

kjo dispozitë është vendosur pas nenit 208 të KPP, që normon rregullat e përgjithshme mbi sekuestron provuese. Kolegji vlerëson se rregullat e përgjithshme të parashikuara në nenin 208 të KPP, përveçse kur në nenin 208/a ka parashikim të posaçëm, do të zbatohen edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Garancitë e analizuara në pjesën e parë arsyetuese të këtij vendimi njësues, lidhur me nevojën e arsyetimit të vendimit në drejtim të domosdoshmërisë së sekuestrimit të të dhënave, duhet të zbatohen edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike.

Në rastin kur sekuestrimi i të dhënave ose sistemeve kompjuterike bëhet ndaj gazetarëve profesionistë veprime të tilla hetimore kur është e nevojshme të procedohet me sekuestrimin e të dhënave kompjuterike duhet të vlerësohen në raport me lirinë e shprehjes, liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, të cilat mbrohen në të gjitha sistemet demokratike, duke qenë më evidente dhe më të ndjeshme në rastin e gazetarëve profesionistë. [..]

Nën frymën e jurisprudencës së GJEDNJ dhe të Vendimit Njësues, në kushte kur gjykatat kanë lejuar sekuestrimin në vendet e punës dhe banesë të gazetarit, në kërkim të të dhënave të autorëve të nxjerrjes së sekretit hetimor dhe të dhënave të bashkëpunëtorit të drejtësisë, është e rëndësishme kontrolli i procedurës së sekuestrimit.

Gjykatat e faktit gjatë shqyrtimit të ankimeve të procedurave të sekuestrimit duhet që të verifikojnë nëse, gjatë sekuestrimit e kontrollit janë zbatuar nevojat për ndërhyrje më anë të këtyre mjeteve të kërkimit të provës në raport me proporcionalitetin në planin sasior, cilësor e kohor. Në rastin e profesionit të gazetarit, referuar standardit ndërkombëtar në rast të ndërhyrjes, duhet të respektohet e drejta për ushtrim të profesionit në përputhje me standardet e jurisprudencës së GJEDNJ dhe Vendimin Njësues nr. 00-2021-1135, i Vendimit (147) të Kolegjit Penal në mënyrë që mbajtja për një kohë të gjatë e mjeteve të punës së gazetarit të mos dëmtojë ushtrimin e profesionit të tij.

Kolegji vlerëson se Gjykatat e faktit u kanë dhënë përgjigje pretendimeve në ankim duke vlerësuar se sekuestrimet janë kryer duke respektuar rregullat e parashikuara në nenin 202-208 të KPP, dhe nenet 300-303 të KPP, për këtë arsye, kërkimin për papërdorshmërinë e të dhënave e vlerëson të pabazuar. Masa e vendosur në rastin objekt gjykimi, sekuestron mbi disponimin e gjykatës për lejimin e kontrollit personal, të banesës, vendin e punës, si dhe ata të vendosura në respektim të nenit 300 e vijues të KPP, kanë si qëllim të identifikojnë personat përgjegjës lidhur me nxjerrjen e akteve sekrete ose të dhënave të përmbajtura në aktet

sekrete, ruajtjen e fshehtësisë së hetimeve lidhur me procedimin penal nr. 75/2022 (i cili gjendet në fazën e hetimeve paraprake), mbrojtjen e jetës, integritetit fizik, lirinë e dëshmitarëve të pyetur në kuadër të procedimin penal nr.75/2022, dhe atë të bashkëpunëtorit të drejtësisë N.D.

Vendosjet e sekuestros objekt ankimi janë konsideruar të justifikuara, referuar dhe nenit 17 të Kushtetutës, si dhe kufizimet janë kryer për një interes publik. Bërja publike e akteve sekrete apo e të dhënave të përmbajtura në akte sekrete, lidhur me procedimin penal nr. 75/2022, në vlerësim të kësaj gjykate, dëmton interesat dhe suksesin e hetimit. Gjykatat kanë konstatuar se komunikimet SkyECC të përdoruesit, janë të dhëna me karakter të klasifikuar. [..]. Kolegji vlerëson këtë argumentim të Gjykatës së Apelit me vërejtjen se është detyrë e gjykatave të faktit që të verifikojnë nëse gjatë procedurës së sekuestrimit veprimet e sekuestrimit në tërësinë e sendeve të sekuestruara cenojnë të drejtat e privatësisë familjare, personale apo profesionale. [..]

Referuar përmbajtjes së shkrimeve të bëra nga gazetari në lidhje me procedimin penal nr. 75/2022, mbajtja në sekuestro e materialeve, apeli nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, ndërkohë që duhet të kishte verifikuar këtë pretendim në mënyrë që të mos lejohej cenimi i të drejtës së fëmijëve, dhe të dispononte me kthimin e materialeve të tilla që janë pjesë të jetës së fëmijëve apo të familjes. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se është në kompetencën e prokurorit kthimi i sendeve të sekuestruara, por pa shqyrtuar pretendimin nëse këto sende të sekuestruara kanë apo jo përmbajtje familjare apo të materialeve që kanë të bëjnë me jetën fëmijërore. [..] Apeli është mjaftuar me një arsyetim të përgjithshëm se nuk ka shkelje, meqenëse seksuestroja është urdhëruar nga gjykata, duke mos shqyrtuar pretendimin që në zbatim të vendimit të gjykatës, janë sekuestruar sende që nuk kanë lidhje me procedimin por kanë të dhëna që lidhen me momente të jetës së fëmijëve. [..]Gjykata e Apelit duhet të kishte verifikuar këtë pretendim në mënyrë që, të mos lejohet cenimi i të drejtës së fëmijëve, e nëse rezultonte që këto materiale kishin këtë përmbajtje, të disponojë më kthimin e atyre që kanë pjesë nga jeta e fëmijëve e familjes.

Gjykata e Apelit, nuk ka verifikuar nëse në sendet që kërkohet të kthehen nga ana e ankuesit, ka CD me përmbajtje të jetës personale e familjare, apo nëse kompjuterat e sekuestruar në banesë kanë qenë në funksion të lojërave të fëmijëve. [..] **Për këtë pjesë të vendimit ky vendim është i cënueshëm dhe sipas nenit 443 paragrafi 1 i KPP, çështja duhet kthyer për rigjykim në Gjykatën e Apelit, pranë të njëjtit gjyqtar që ka dhënë [..], me qëllim shqyrtimin e kësaj pjese të ankimit.**

Kolegji konstaton se Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar pretendimin që

mbajtja nën sekuestro e sendeve, mjeteve të punës që lidhem me ushtrimin e profesionit të gazetarit, cenon e pengon ushtrimin e profesionit të gazetarit dhe i sjell dëm pozitës së tij, në raport me mbrojtjen e burimeve, dhe nuk i është dhënë një përgjigje kërkesës së ankuesit/gazetarit E.Q dhe të shoqërisë Ora Neës, për kthimin e sendeve të sekuestruara, të mjeteve të punës së gazetarit, sipas parimit të proporcionalitetit e përshtatshmërisë në kohë, të mbajtjes së këtyre sendeve nën sekuestro, e nëse është e nevojshme mbajtja më tej e këtyre sendeve, apo prokuroria mund të nxirrte kopje të të dhënave, të mbarte të dhënat, e të kryente verifikimet duke i kthyer këto sende gazetarit dhe shoqërisë. [..]

Siç theksohet në këtë sentencë njësuere, sekuestroja vendoset për aq sa është e nevojshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme, dhe se për nxjerrjen e të dhënave, pajisjet mund të sekuestrohen për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e të dhënave apo kopjimin e tyre. Nëse gjatë sekuestrimit janë plotësuar kriteret e proporcionalitetit, përshtatshmërisë e sa është koha e nevojshme për ti mbajtur nën sekuestro këto sende të sekuestruara, këtë e verifikon gjykata, në këtë rast gjyqtari i hetimeve paraprake, në rast të ankimit ndaj zbatimit të procedurës së sekuestrimit siç është vepruar në këtë rast. [..]

Kolegji rithekson se parimet e domosdoshmërisë, përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit duhet të udhëheqin vendimmarrjen e gjykatës, qoftë në marrjen e vendimit për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, ashtu edhe në lidhje me parashikimin e modaliteteve konkrete për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike. Gjithashtu, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë, **sekuestrimi i të dhënave dhe në mënyrë të veçantë i sistemeve kompjuterike do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme në vërtetimin e fakteve, duke u parashikuar në këtë mënyrë se proporcionaliteti nuk mund të mos raportohet edhe me kohëzgjatjen e kufizimit, e cila do të vlerësohet sipas një kriteri kohor të arsyeshëm** (*GJEDNJ Smirnov v. Russia, Draghici v. Portugal*).

[..] Gjykata e Apelit, në zbatim të parimit të proporcionalitetit e përshtatshmërisë në kuptimin kohor të sekuestros, duhet të verifikonte e të shqyrtonte nëse mbajtja nën sekuestro e sendeve (mjete të punës) të gazetarit është e nevojshme, dhe nëse prokuroria mund të zbatonte nenin 208/a paragrafi 3 shkronja b), duke nxjerrë dhe marrë kopje të të dhënave kompjuterike, dhe paragrafit të parë të nenit 213 të K.Pr.P, duke marrë kopje të akteve dhe dokumenteve. [..]

Meqënëse shkaku i prishjes së këtij vendimi është mosshqyrtimi nga ana e Gjykatës së Apelit, të dy pretendimeve të ankuesit, dhe meqënëse

ankimi ka të bëjë më fazën e hetimeve paraprake, Kolegji vlerëson se është rasti i zbatimit të nenit 443 të KPP [..]

Në këtë rast çështja duhet kthyer për rigjykim tek e njëjta gjykatë (*gjyqtari i vetëm i hetimeve paraprake*) i Gjykatës së Apelit [..] që shqyrton kërkesat në kuadër të procedimit penal ndaj të cilit është ushtruar ankesa më këtë objekt.

Mendim pakice

[..]rezulton që të mos ketë shkaqe për cenimin e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit. [..]

Duke analizuar nenin 149 KPP, kuptohet se “përfaqësimi” është pikërisht prova apo njoftimi/dija mbi faktin që kërkohet të provohet, ndërsa “*mjeti mbajtës i quajtur dokument*”, është burimi i provës, nga ku përfaqësimi i ruajtur, memorizuar, del dhe bëhet i njohur. Si mjete mbajtëse, pra si dokument mund të jenë letra, faks, në të cilët është materializuar, dokumentuar, memorizuar, depozituar përfaqësimi i faktit, personit apo sendit.

Një nga mjetet e mundshme të komunikimit është edhe aparati celular, në “*flash memory*” e të cilit janë shënuar këto komunikime. Ky send me cilësinë e dokumentit provues, është çmuar i nevojshëm në rastin objekt gjykimi lidhur me hetimet që po kryhen në kuadër të procedimit penal nr.75/2022. Mbi bazën e këtij arsytimi që shpreh lidhjen ndërmjet sendit aparat telefoni i lëvizshëm (celular) që mban “*flash memory*” e kështu dokument në të cilin janë memorizuar komunikimet, me veprat penale për të cilat janë shtrirë hetimet në kuadër të procedimit penal nr.75/2022, edhe për këtë kolegji është i ligjshëm dhe i arsyeshëm vendimi i Prokurorit të Posaçëm datë 14.12.2023, që ka vendosur sekuestrimin e aparateve të lëvizshëm “*Samsung*”, në përdorim të ankuesit.

Vlerësoj se Gjykatat e Posaçme kanë bërë një analizë të plotë dhe të qartë duke argumentuar në lidhje me rastin konkret.

Sendet e sekuestruara kanë vlerën e provës materiale, pasi janë objekt i verifikimeve që po kryen prokuroria në funksion të hetimit të procedimit penal nr.75 të vitit 2022, hetuar dhe për veprat penale [..] të parashikuar nga nenet 295/a paragrafi 3 dhe 313/b, pika 1 të KP.

Gjykatat vlerësuan drejt duke çmuar të bazuar në të drejtën e parashikuar nga neni 300/2, kombinuar me nenin 187 të KPP, aktin e ngutshëm të sekuestrimit të sendeve të luajtshme telefona celularë, nga Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, dhe vendimmarrjen e datës 14.12.2023 të Prokurorit të Posaçëm për vleftësimin si të ligjshëm të tyre, në bazë të nenit 301/2 të Kodit të Procedurës Penale, me argumentimin se: “*lidhen*

dhe ofrojnë të dhëna për faktet objekt hetimi,” përputhur ky këndvështrim me kuptimin që ligji procedural penal i jep provës materiale.

Sikurse komunikimet SkyECC të përdoruesit N.D, janë të dhëna me karakter të klasifikuar dhe komunikimet e publikuara, përmbanin të dhëna që lidhen me individë të përfshirë në bisedë dhe për rrjedhojë ndaj tyre në këtë rast zbatohen të gjitha garancitë Kushtetuese për të dhënat personale të parashikuara nga neni 35 i Kushtetutës, duke përfshirë dhe ndalimin pa pëlqim të publikimit të tyre, duke arritur në përfundimin se kufizimi i vendosur në këtë rast nuk ka cenuar kriterin e proporcionalitetit, referuar qëllimeve legjitime që ndiqen në këtë rast.

Sa më sipër vlerësoj se Gjykatat kanë interpretuar drejtë lidhur me kriteret që duhet të përmbushen për të lejuar sekuestrimin e sendeve të luajshmë të rekursuesit E.Q.



**10.Vendim nr. 00-2024-1625 (195),
datë 24.07.2024 (masë sigurimi
personal: individualitet mase)**

Maksima: Masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, ndonëse përbën privim të lirisë në kuptim të nenit 5 të KEDNJ, nuk barazohet me paraburgimin si masë “arrest në burg”. Për kohëzgjatjen maksimale të saj zbatohet neni 267/1 i KPP, sipas të cilit masat shtrënguese të ndryshme nga paraburgimi humbasin fuqinë kur ka kaluar një kohë e barabartë me dyfishin e afateve të parashikuara nga neni 263 i KPP. Çdo masë sigurimi ruan individualitetin e saj, ndaj afatet e masave të ndryshme nuk bashkohen për efekt të shuarjes së tyre.

Fjalë kyçe: masë sigurimi, arrest në burg, arrest në shtëpi, individualiteti i masave të sigurimit

Decision no. 00-2024-1625 (195), dated 24.07.2024 (personal security measure: individuality of the measure)

Legal principle(s): Although the security measure of house arrest constitutes a deprivation of liberty within the meaning of Article 5 of the European Convention on Human Rights, it is not equivalent to pre-trial detention as the security measure of detention in prison. Its maximum duration is governed by Article 267(1) of the Criminal Procedure Code, pursuant to which coercive measures

other than pre-trial detention lapse upon the expiry of a period equal to twice the time limits prescribed by Article 263 of the Criminal Procedure Code. Each security measure retains its autonomous legal character, and therefore the time limits applicable to different security measures may not be aggregated for the purpose of determining their lapse.

Keywords: security measure, pre - trial detention, house arrest, autonomy of security measures

Rrethanat e çështjes:

[..]Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë [..] ka vendosur caktimin [..] masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, për të hetuarit M.M, dhe S.D, [..] të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të KP. [..]

Gjykata Posaçme [..] me vendimin [..]ka vendosur: “Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” caktuar ndaj të hetuarve ...M.M me vendimin [..]”. [..]Gjykata e Posaçme të [..] me vendimin nr. [..]ka vendosur: “Miratimin e vendimit nr. [..]”.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së [..]ka vendosur: “...Zëvendësimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për të hetuarën M.M me atë të ‘detyrim për t`u paraqitur në Policinë Gjyqësore’, [..]

Gjykata e Posaçme e Apelit [..]ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. [..]për personin nën hetim M.M, duke vijuar si masë sigurimi ajo e “Arrest në shtëpi” [..]

Kërkuesja [..]ka paraqitur para Gjykatës së Posaçme të Shkallës së [..]kërkesën penale me objekt: “Shuarjen e masës së sigurimit personal ‘arrest në shtëpi’, [..]” për shkak të kalimit të afatit maksimal 9 muaj nga data e dorëzimit të akteve në gjykatës (dt. 26.02.2021) pa u dhënë vendimi i gjykatës në lidhje me këtë çështje. [..]

Gjykata e Posaçme Shkallës [..] ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së [..]”. [..] **Gjykata e Apelit për [..]**ka vendosur: “Miratimin e vendimit nr. [..].

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..]thekson se kjo çështje penale po (ri)-shqyrtohet në Gjykatë të Lartë, si rrjedhojë e vendimit nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese, që ka disponuar për pranimin e kërkesës së kërkuës, shfuqizimin e vendimit nr. [..]dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke theksuar se: “Gjykata e Lartë [..] ajo

nuk ka bërë vlerësim në substancë të shkaqeve të tij, duke u mjaftuar me faktin se masa për të cilën kishte nisur procesi ishte shuar tashmë nga vendimi gjyqësor i dënimit. Pra, Gjykata e Lartë nuk ka bërë vlerësim nëse gjykatat më të ulëta për shkak të interpretimit të ligjit procedural penal i kanë cenuar ose jo lirinë personale të kërkuarës për periudhën që ajo pretendonte se ka qëndruar përtej afatit të parashikuar nga ligji. [..]

Kolegji mban qëndrim në lidhje me çështjet juridike dhe interpretimin që kanë bërë gjykatat e posaçme neneve 263/2, gërma b), 263/6 gërma b) dhe 267/1 të KPP, në lidhje me llogaritjen e kohëzgjatjes maksimale të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, dhe a duhet konsideruar kjo masë sigurimi si masë paraburgimi apo masë e ndryshme nga paraburgimi sipas parashikimit të nenit 267 paragrafi 1 i KPP. [..]

Afatet e parashikuara në nenin 263 të KPP, lidhen me rastin e paraburgimit, pra të masës së sigurimit “arrest në burg”, që nënkupton ndalimin dhe vendosjen në regjimin tradicional të burgjeve (*shih vendimet e GJEDNJ-së Solmaz k.Turqisë, §§ 23-24; Kalashnikov k. Rusisë*). Për të gjitha masat e tjerat sigurimit personal me karakter shtrëngues, përfshirë edhe masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”, vlen afati i kohëzgjatjes së tyre sipas parashikimit të nenit 267, pika, 1 të KPP. Vendosja në masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, përbën privim të lirisë, por nuk përbën as paraburgim në pritje të vendimit, por një regjim më pak të ashpër ndalimi se regjimi tradicional i burgjeve. [..] Në këtë rast ndaj kërkuarës rezulton të jetë caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” dhe jo ajo e “Arrestit në burg” sikurse parashikon neni 263 i KPP-së.

[..]

Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarës, se paraburgimi e ka humbur fuqinë pasi kanë kaluar afatet procedurale të parashikuara sipas nenit 263 të KPP-së, është i pabazuar ligjërisht. Në interpretim të nenit 263 të KPP-së paraburgimi i një shtetasi dhe afatet e kohëzgjatjes së tij, kalojnë në tre shkallë procedimi që janë: 1. Nga fillimi i zbatimit të paraburgimit deri në ditën e dorëzimit të akteve në gjykatën e shkallës së parë (neni 263/1 i KPP), 2. Nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë deri në ditën e dhënies së dënimit (neni 263/2 i KPP), 3. Nga dita e dhënies së dënimit në shkallë të parë deri në ditën e dhënies së vendimit të dënimit nga gjykata e apelit (neni 263/3 i KPP), duke përcaktuar njëherësh edhe afatet përkatëse të kohëzgjatjes së paraburgimit për secilën shkallë procedimi, në varësi të llojit apo sanksionit të veprës penale për të cilën akuzohen të gjykuarit. Në kuptim të kësaj dispozite ligjore, vlerësohet se neni 263 pika 2, e lidh humbjen e fuqisë së paraburgimit në gjykim me kalimin e afateve të parashikuara “nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë deri

në ditën e dhënies së dënimit”, sikurse përbën çështja objekt gjykimi. Ndërkaq rezulton se, vepra penale për të cilën është regjistruar procedimi penal ndaj kërkueses Margjeka, është ajo e “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë*” kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319/ç dhe 25 i Kodit Penal, **që parashikon në maksimum dënimin deri** në dhjetë vjet burgim. [...]

Në arritjen e këtij përfundimi – konkluzioni, Kolegji mbështetet tek metodat e interpretimit të dispozitave dhe ligjit, si dhe në prezumimin se kohëzgjatja e zbatimit të masave të sigurimit përcaktohen në proporcion me shkallën e rëndësisë dhe kufizimit të lirisë së individëve. Konkretisht, referuar metodës së interpretimit qëllimor (teleologjik) dhe atij literal (gjuhësor), deduktohet konkluzioni se ligjvënësi ka synuar të diferencojë rëndësinë dhe peshën e masës së sigurimit shtrëngues “arrest në burg” në raport me masat e tjera shtrënguese, duke përcaktuar shprehimisht kohëzgjatjen maksimale në një dispozitë të veçantë, të posaçme (neni 263 i KPP). Qëllimi i dispozitës del qartësisht si në titullin e saj, ashtu edhe në përmbajtje ku përmendet vetëm fjala “*paraburgim*”. Me interpretim *a’contrario*, rezulton se nëse ligjvënësi do të kishte synuar që në këto afate të kishte përfshirë edhe llojin e masës së sigurimit personal shtrëngues “*arrest në shtëpi*”, neni 263 i këtij Kodi, minimalisht do të duhej të citonte atë në tekstin e kësaj norme. Përkundrazi, shprehimisht neni 267 i KPP, dikton se çdo masë sigurimi shtrënguese personale, e ndryshme nga paraburgimi, ka kohëzgjatje maksimale me dyfishin e afateve të paraburgimit.

Qëllimi i ligjvënësit në lidhje me afatet e kohëzgjatjes së çdo mase tjetër të ndryshëm nga paraburgimi (*arrest në burg*) del që në titullin e dispozitës të nenit 267 të KPP “*Afatet e kohëzgjatjes maksimale të masave të tjera të sigurimit*”. Referuar kësaj analize, arrihet në konkluzionin se neni 267 i KPP, është i posaçëm sa i përket kohëzgjatjes maksimale të masave të sigurimit të ndryshme nga paraburgimi, në raport me nenin 237 të këtij Kodi, që parashikon në tërësi modalitetet përmbajtësore dhe procedurale të caktimit të masës “*arrest në shtëpi*” duke përfshirë edhe mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së saj.

Gjithashtu, duke e konsideruar korpusin ligjor, e veçanërisht të sistemuar organikisht në KPP, si një tërësi normash logjike e të ndërlidhura racionalisht dhe logjikisht me njëra-tjetrën, konkludohet se nëse do të pranohej që afatet maksimale të “*arrestit në burg*” (paraburgimi) do të ishin të njëjta me atë “*arrest në shtëpi*”, do të rezultonte se rëndësia dhe shkalla e kufizimit të lirisë në një institucion paraburgimi dhe në shtëpi për personat nën hetim do të ishin të njëjta. Kjo hipotezë do të reflektonte paqartësi mbi nevojën për të parashikuar dy masa të ndryshme në ligj,

por me të njëjtën rëndësi dhe shkallë kufizimi të lirisë. Kolegji thekson se masa e sigurimit “arrest në burg” nuk konsiderohet e njëjtë me “arrest në shtëpi”, duke analizuar dhe interpretuar në frymën e pikës 1 të nenit 266 të KPP, përderisa kjo dispozitë parashikon mundësinë e caktimit të masave të tjera të sigurimit, pa asnjë përjashtim, kur kanë mbaruar afatet e paraburgimit, çfarë nënkupton se masat e sigurimit janë të ndryshme ndërmjet njëra-tjetrës dhe nuk mund të përjashtojnë njëra-tjetrën për shkak të kalimit të afatit maksimal në zbatimin e tyre.

Sipas nenit 7 të ligjit nr. 7942, datë 31.5.1995 [..]Pra, në kuptim të këtij ligji koncepti i “paraburgimit” përfshinë vetëm “ndalimin” dhe “arrestin në burg” dhe jo “arrestin në shtëpi”. Por, edhe nga interpretimi gjuhësor, logjik dhe sistematik i dispozitave të KPP, vlerësohet se qëndrimi nën masën e sigurimit “Arrest në shtëpi”, nuk konsiderohet si “paraburgim”, në kuptim të nenit 263 të KPP.

Formulimi i nenit 267, paragrafit të parë të KPP, [...] krijon paqartësi dhe lë vend për keqinterpretim. Por, interpretimi i drejtë gjuhësor, logjik dhe teleologjik (qëllimi që ndjek), është ai i bërë nga gjykata më të ulëta (në rastin konkret), që rregulli vlen në mënyrë të njëjtë për çdo lloj mase tjetër, të ndryshme nga paraburgimi.

Argument tjetër mbështetës i kësaj logjike interpretimi janë edhe përcaktimet e bëra në ligjin Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (i ndryshuar), i cilin në nenin 3, pika 7 të tij “Përkufizime”, përcakton se: [..]

In secundis; Masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” “e parashikuar nga neni 238 i KPP, fillon të llogaritet duke filluar nga momenti i njoftimit të vendimit personit nën hetim / të pandehurit dhe një ditë arrest në shtëpi do të llogaritet e barabartë me një ditë burgim. Nëse zbatimi i kësaj mase, është ndërprerë për shkaqe si ato që janë verifikuar, afati përkatës do të pezullohet dhe eventualisht do të bashkohet me pjesën tjetër nëse në një moment të mëtejshëm vijohet me rifillimin e zbatimit të saj, siç dhe ka ndodhur në rastin konkret. Afatet e pezulluar të paraburgimit nuk duhet të llogariten në tërësinë e afatit për efekt të kalimit të afatit të qëndrimit në një masë të caktuar, në këtë rast të masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, pasi pezullimi ka qëllim vetëm disiplinimin e sjelljes së të akuzuarit gjatë gjykimit të shtyrë për shkak të sjelljeve të tij. Pezullimi është ndërprerje e afateve për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj dhe këto afate rifillojnë pasi të ketë mbaruar, ose të jetë hequr shkaku i pezullimit.

Për secilën masë siguri afatet llogariten të ndara e për rrjedhojë afatet e kohëzgjatjes së masës së sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” nuk llogariten së bashku me afatet e kohëzgjatjes së

zbatimit të masës “Arrest në shtëpi”, dhe nuk futen në kohëzgjatjen e kësaj mase. Masat e sigurimit personal ruajnë individualitetin e tyre, në lidhje me kushtet dhe kriteret që janë parashikuar për zbatimin tyre por edhe në lidhje me kohëzgjatjen që ato mund të zbatohen sipas nenit 267 të KPP. Në përlllogaritjen e kohëzgjatjes së “masave të tjera të sigurimit”, neni 267 i KPP i referohet secilës masë së caktuar, e cila individualisht e konsideruar, nuk mund të kalojë afatin maksimal të parashikuar në këtë dispozitë referuese.

Zbatimi suksesiv (njëra pas tjetrës) i disa “masave të tjera të sigurimit”, të parashikuara në nenin 267 të KPP, nuk passjell bashkimin e periudhave të nënshtimit ndaj çdo mase, me qëllim përcaktimin e kohëzgjatjes maksimale, pasi ato (secila prej tyre), duhet të llogariten në mënyrë të pavarur/autonome, në përputhje edhe me paragrafin e 3 të nenit 250 të KPP, (nga momenti në të cilin njoftohen vendimet përkatëse). Sipas kësaj dispozitë efektet e masave të tjera fillojnë nga çasti në të cilin është njoftuar vendimi. Pra, efektet e secilës masë janë të lidhura vetëm me njoftimit përkatës të vendimit që e ka caktuar atë. Rrjedhojë logjike, por dhe juridike, është se nuk mund të interpretohet ndryshe, duke e iniciuar afatin nga momenti i ekzekutimit të masës së parë të aplikuar. Zgjatja e afatit të hetimeve ka si qëllim zgjatjen e afateve për kryerjen e veprimeve hetimore dhe jo për vijimin e masës së sigurimit personal.

Ky interpretim i dispozitave të përshkruara deri më tani, nuk bie ndesh me normat kushtetuese, duke u pretenduar eventualisht, se në këtë mënyrë do të vazhdohej për një kohë të pacaktuar kohëzgjatja e masave të sigurimit. Rezulton se, i gjithë sistemi i masave të sigurimit personal, bazohet në një discrimen (dallim) të qartë midis masave që përfshijnë një kufizim më të rreptë të lirisë personale (paraburgimi) dhe ato më të buta (masat e tjera të sigurimit të parashikuara nga neni 267 i KPP). Kjo, si për sa i përket kushteve në bazë të të cilave mund të zbatohet secila prej tyre, si dhe për nga kohëzgjatja (*e parashikuar përkatësisht nga nenet 263 dhe 267 të KPP, ku për masat e ndryshme nga “arresti në burg”, afatet maksimale janë madje sa dyfishi në krahasim me ato të parashikuara për masat e paraburgimit*). Regjim i diferencuar ky, që përbën rezultatin e një kompromisi të drejtë dhe të arsyeshëm ndërmjet nevojave për mbrojtje të komunitetit dhe mbrojtjen e të drejtës së lirisë së të akuzuarit, duke justifikuar kështu një kohëzgjatje më të gjatë të intervalit të nënshtimit të kufizimit në forma gradualisht më të lehta, në prezencë gjithmonë të nevojave të sigurimit.

Një konfirmim logjik i këtij interpretimi, konstatohet dhe në parashikimin e paragrafit të parë të nenit 266 të KPP, ku shprehimisht para-

shikohet [...] Në një lexim sistematik, parashikimi i një rregulli të tillë, në fakt, përjashton për tabulas (literalisht) bazueshmërinë e pretendimit të kërkuësës për bashkimin e kohëzgjatjes së zbatimit të masave të ndryshme, të parashikuara nga neni 267 i KPP. Për më tepër, nëse ndalimi i bashkimit të kohëzgjatjes së zbatimit të masave, vlen ndërmjet masës me burgim dhe një mase tjetër jo me burgim (neni 266.1 i KPP), *a fortiori* **që ndalimi i bashkimit të kohëzgjatjes duhet të zbatohet në rastin, siç dhe është ky objekt shqyrtimi, ku zëvendësimi ndërmjet masave i referohet atyre të parashikuara në neni 267 i KPP. Kjo për arsyen, lehtësisht të kuptueshme, të cenimit krahasimisht më të vogël të lirisë personale.**

Kolegji vlerëson se masat e sigurimit personal ruajnë individualitetin e tyre, në lidhje me kushtet dhe kriteret që janë parashikuar për zbatimin tyre por edhe në lidhje me kohëzgjatjen që ato mund të zbatohen sipas nenit 267 të KPP. Në këtë kuptim, kohëzgjatja maksimale e parashikuar nga neni 267 të KPP, i referohet secilës masë, që eventualisht mund të caktohet dhe zbatohet. Për rrjedhojë logjike, masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi”, do t’i nënshtrohet respektimit të afatit tërësor. Nëse zbatimi i kësaj mase, është ndërprerë për shkaqe si ato që janë verifikuar në rastin konkret, afati përkatës do të pezullohet dhe eventualisht do të bashkohet me pjesën tjetër nëse në një moment të mëtejshëm vijohet me rifillimin e zbatimit të saj, siç dhe ka ndodhur në rastin konkret. Zgjatja e afatit të hetimeve ka si qëllim zgjatjen e afateve për kryerjen e veprimeve hetimore dhe jo për vijimin e masës së sigurimit personal.

[...]Kolegji, pasi verifikoi, pretendimet e palës kërkuëse në lidhje me llogaritjen e afateve të zbatimit të masës së sigurimit; [...] Në këtë gjendje fakti të vlerësuar nga gjykatat e faktit, me të drejtë këto Gjykata kanë vendosur rrëzimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi” e caktuar ndaj të pandehurës, për shkak të kalimit të afatit të gjykimit, në procedimin penal nr. 186/2020, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319/ç dhe 25 i KP. [...]

Në këto kushte Kolegji, duke vlerësuar se vendimi nr. [...] *që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. [...]të Gjykatës së Shkallës [...], për rrëzimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, e caktuar ndaj të pandehurës, për shkak të kalimit të afatit të gjykimit, në procedimin penal [...]është një vendim i dhënë në interpretim të drejtë të ligjit procedural penal, ndaj nuk ka vend për cenimin e tij, e si i tillë, bazuar në nenin 441, pika 1 shkronja “e” të KPP, ky vendim duhet lënë në fuqi.*

Mendim pakice

[..] **Si gjyqtare në pakicë**, kam votuar kundër këtij vendimi, pasi për mendimin tim qëndrimi i gjykatave të faktit dhe i shumicës së kolegjit penal bie ndesh me ligjin dhe kuptimin e kohëzgjatjes së masës së sigurimit arrest në shtëpi të rregulluar posacërisht nga ligji. Interpretimi i bërë nga shumica nuk i përshtatet kuptimit teksual ligjor. [..]

1-Masa e sigurimit arrest në shtëpi sigurisht, që është një masë e ndryshme nga ajo e arrestit në burg, pasi janë të parashikuar si lloje të ndryshme të masave të sigurimit. [..]Pra, nisur nga marzhet e konvertimit të tyre në dënim del se diferenca e masës së sigurimit arrest në shtëpi nuk është aq e madhe me atë të arrestit në burg, sikurse argumenton shumica. Kjo diferencë është vetëm gjysmë dite ose 12 orë, ndërkohë që në mënyrën se si e ka interpretuar shumica kohëzgjatjen e masës së arrestit në shtëpi sa dyfishin e masës së sigurimit “arrest në burg” del që qëndrimi i personit në kushtet e masës së sigurimit arrest në shtëpi për efekt të llogaritjes së dënimit në fakt tejkalon atë të masës arrest në burg. [..]Duke mbajtur në konsideratë marzhet, që ligji përcakton për konvertimin e këtyre masave në dënimin me burg del se mënyra e interpretimit nga shumica i jep masës së sigurimit arrest në shtëpi një rëndesë më të madhe në kufizimin e lirisë së personit se ajo e arrestit në burg, kur në fakt duhet të jetë e kundërta. Rëndësia e një mase nuk duket vetëm me efektet ekonomike e sociale që sjell në jetën e personit, por edhe në mënyrën se si ligjvënësi e llogarit atë në vuajtjen e dënimit, që jepet ndaj një personi. Duke qënë se masa e sigurimit arrest në burg është masa më e rëndë e njohur nga KPP atëherë edhe llogaritja e kohëzgjatjes totale të saj në masën e dënimit duhet të ketë një peshë më të madhe se ajo e kohëzgjatjes së masës arrest në shtëpi, gjë që nuk gjen mbështetje në mënyrën e arsytimit të shumicës pasi sikurse u sipërcitua rezulton e kundërta.

2-Shumica arsyeton në mënyrë të detajuar dallimin midis masës së arrestit në burg me atë të arrestit në shtëpi duke konkluduar se vetëm masa e sigurimit arrest në burg konsiderohet paraburgim. Ky arsyetim i shumicës nuk prek dhe as ndryshon parashikimin ligjor të kohëzgjatjes së masës së sigurimit arrest në shtëpi. [..]. Sipas fjalorit shqip kohëzgjatje është një fjalë e përbërë nga dy rrënjë ‘koha + zgjatje’. Sipas kuptimit gramatikor dhe llogjik kjo fjalë identifikon “kohën që zgjat”. Për këtë kohëzgjatje ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë se zbatohen rregullat e paraburgimit, parashikim që nuk krijon asnjë dyshim se cilat janë rregullat, që zbatohen për të llogaritur kohën e zgjatjes së kësaj mase dhe që janë ato të paraburgimit. [..] Përderisa ligji procedural penal referon për kohëzgjatjen e masës arrest në shtëpi te rregullat e paraburgimit del e

qartë se masa e sigurimit arrest në shtëpi nuk konsiderohet e barabartë me arrestin në burg si masë, por për efekt të kohëzgjatjes së tyre rregullat që zbatohen janë të njëjta duke u zbatuar ato të paraburgimit, kohëzgjatje që në mënyrë të shprehur parashikohet nga neni 263 i KPP. Një parashikim i tillë i bërë në nenin 4/237 të KPP nga ligjvënësi përjashton çdo keqkuptim ose interpretim të ndryshëm, pasi teksti i ligjit është i qartë. Analiza interpretative bëhet kur ligji nuk e ka një rregullim të shprehur sikurse ndodh në rastin konkret.

3- Kolegji (shumica) konkludon se kohëzgjatja e masës së sigurimit arrest në shtëpi rregullohet nga neni 267 i KPP. [..]Përderisa ligjvënësi ka rregulluar në mënyrë të shprehur kohëzgjatjen e masës së arrestit në shtëpi sipas kohëzgjatjes së paraburgimit në bazë të nenit 237/4 të KPP, atëherë kohëzgjatja e arrestit në shtëpi nuk mund të rregullohet sipas nenit 267 të këtij kodi. Parashikimi i nenit 237/4 të KPP ka karakter specifik për normimin e kohëzgjatjes vetëm për masën e sigurimit arrest në shtëpi dhe si dispozitë e posacme ajo përjashton zbatimin e cdo dispozite tjetër me karakter të përgjithshëm sic është ajo e masave të tjera të sigurimit në përputhje me parimin se *lex specialis derogate generalis*.

Një gjë e tillë do të ndodhte nëse neni 237/4 i KPP nuk do të kishte një rregullim të shprehur për kohëzgjatjen e masës arrest në shtëpi. Në kushtet, kur kohëzgjatja e arrestit në shtëpi referon te rregullat e paraburgimi atëherë për këtë masë janë të zbatueshme afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit të parashikuara nga neni 263 i KPP. Përdorimi i fjalës ‘paraburgim’ në rastet e kohëzgjatjes si në nenin 263 të KPP ose në dispozita të tjera të Kodit identifikon për efekte zbatimi jo vetëm paraburgimin si masë e arrestit në burg, por edhe masën e arrestit në shtëpi.

Mënyra e interpretimit të nenit 267 të KPP nga shumica, duke i shtrirë efektet e saj edhe për masën e arrestit në shtëpi e barazon këtë të fundit me cdo masë tjetër të ndryshme nga ajo e arrestit në burg, gjë që bie ndesh me qëllimin e e nenit 237/4 të KPP, i cili në mënyrë të shprehur kohëzgjatjen e saj ka zgjedhur ta rregullojë sipas dispozitave të paraburgimit. [..]

4-Shumica nuk ka dhënë argumenta juridike se në cilin rast sipas saj gjen zbatim parashikimi i nenit 237/4 i KPP. Mënyra e caktimit dhe e mbikqyrjes së kësaj mase kanë rregullime të posacme dhe nuk është e nevojshme të rregullohen nga neni 237/4 i KPP, i cili specifikisht ka të bëjë me kohëzgjatjen e masës së sigurimit. Nga ana tjetër llogaritja e kësaj të fundit në dënimin e një personi është e parashikuar në mënyrë të shprehur në nenin 237/5 të KPP dhe për rrjedhojë kohëzgjatja e nenit 237/4 të Kodit ka të bëjë vetëm me kohëzgjatjen e masës arrest në shtëpi, si masë sigurimi.

5-Neni 267 i KPP rregullon kohëzgjatjen e masave të tjera të sigurimit

të ndryshme nga paraburgimi dhe nga arresti në shtëpi, që rregullohet po nga dispozitat e paraburgimit. [...]Këto masa në fakt nuk kufizojnë me izolim lirinë e personit, por vetëm pengojnë lëvizjen e tij në kohë të caktuar ose në terriore të caktuara. Për rrjedhojë këto masa konsiderohet shumë më të lehta se ajo e arrestit në shtëpi apo në burg. Ato nuk llogariten në vuajtjen e dënimit, që mund të jepet ndaj një personi. Nisur nga këto karakteristika dhe ndikime më të pakta në lirinë e personit se dy masat arrest në burg e në shtëpi, ligjvënësi ka zgjedhur të zgjasë kohëzgjatjen e masave të tjera në dyfishin e kohës së masave të sigurimit të rregulluara sipas nenit 263 të KPP.

6-Masa e “arrestit në shtëpi” për vetë efektet izoluese, që sjell në lirinë e personit ka më shumë afërsi e ngjashmëri si për as i përket izolimit ashtu edhe llogaritjes së saj në dënim, me atë të arrestit në burg dhe jo me masat e tjera më të lehta si ndalim i daljes jashtë shtetit, qëndrim në një vend të caktuar, detyrim për paraqitje etj. [...] Nisur nga natyra dhe efektet e saj kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të barazohet me ato të masave të lehta sikurse arsyeton shumica, por ligjvënësi në mënyrë të shprehur në nenin 237/4 të KPP ka zgjedhur ta barazojë atë për shkak të kohëzgjatjes me atë të paraburgim, pra të arrestit në burg. [...] Interpretimi i bërë nga shumica për barazimin e kohëzgjatjes së saj me masat që nuk konsiderohet heqje lirie bie ndesh me natyrën e kësaj mase dhe çënon të drejtat e të pandehurve në kundërshtim me mbrojtjen e dhënë nga Kushtetuta dhe Konventa.

7- [...]Në përputhje me nenin 261/c të KPP togfjalëshi kohëzgjatja e paraburgimit ka të bëjë si me kohëzgjatjes e masës së arrestit në burg, por edhe asaj të arrestit në shtëpi, që është barazuar me të sipas nenit 237/4 të KPP. Për rrjedhojë, masa deklarohet e shuar pavarësisht se personi ka qënë nën masën e sigurimit arrest në shtëpi ose në burg mjafton që kohëzgjatja e këtyre masave të ketë tejkaluar atë të dënimit, që gjykata e shkallës së parë ka dhënë ndaj të pandehurit. Pra, në këtë dispozitë togfjalëshi kohëzgjatja e paraburgimit nuk ka për qëllim dhe as identifikon vetëm personat, që kanë qëndruar nën masën arrest në burg, por edhe ata nën masën e arrestit në shtëpi.

8- [...] Në rezume të dispozitave të sipërcituara përderisa rregullat e kohëzgjatjes së masës arrest në burg si paraburgim zbatohen edhe për masën e arrestit në shtëpi si për sa i përket pyetjes së të arrestuarit, pezullimit të afateve, shuarjes së masave në bazë të nenit 261 pika c e KPP atëherë edhe për kohëzgjatjen totale të masës së sigurimit arrest në shtëpi do të zbatohen rregullat e kohëzgjatjes së paraburgimit në bazë të nenit 263 të KPP. në kushtet kur neni 4/237 i Kodit të Procedurës penale referon kohëzgjatjen e kësaj mase te rregullat e paraburgimit atëherë ligjvënësi e

ka barazuar mënyrën e trajtimit të kohëzgjatjes së saj me atë të arrestit në burg duke përjashtuar cdo interpretim të kundërt.

9-Ligjvënësi nuk e ka parë të njëvojëshme të përmend në cdo dispozitë të mësipërme secilën nga llojet e masave arrest në shtëpi e arrest në burg, për aq kohë sa ka vendosur një dispozitë të vecantë ligjore, ku kohëzgjatjen e masës së arrestit në shtëpi e referon te rregullat e paraburgimit. Në këto kushte është e mjaftueshme të përdoret vetëm termi paraburgim për të kuptuar se këto rregulla janë të zbatueshme edhe për masën e sigurimit arrest në shtëpi për sa i përket kohëzgjatjes nisur nga referenca e bërë nga neni 237/4 i KPP. Nën këtë llogjikë edhe përdorimi i fjalës paraburgim në nenit 267 të KKP nënkupton të dyja masat.

10-Në rastet, kur ligjvënësi ka vlerësuar të bëjë një trajtim të diferencuar të masave arrest në burg nga ajo arrest në shtëpi e ka parashikuar shprehimisht. [...] Vetëm në këtë rast termi paraburgim i referohet masës së arrestit në burg, kjo për faktin se mbarimi i afateve i paraparë në këtë dispozitë ka të bëjë me personin e liruar nga burg, situatë që ndodh në rastet kur personi ka qënë nën masën e sigurimit arrest në burg. Nisur nga ky parashikim gjykata nuk ka pengesë që kur e konstaton të përfunduar masën e sigurimit arrest në burg, të caktojë masën e sigurimit arrest në shtëpi kur ekzistojnë të njëjtën kushte për të cilën ishte vendosur masa e sigurimit arrest në burg. Megjithatë kohëzgjatja e masës arrest në shtëpi, e cila vendoset pas përfundimit të asaj arrest në burg, është e barabartë me atë të masës arrest në burg sipas nenit 263 të PP. Fakti se neni 267 i KPP është i zbatueshëm ndaj masave të tjera të sigurimit të ndryshme nga ato të arrestit në shtëpi dhe burg del dhe nga interpretimi gramatikor i nenit 262 të KPP. [...]

Nga sa mësipër si gjyqtare në pakicë vlerësoj se gjykatat e faktit kanë bërë një interpretim të gabuar të ligjit në kundërshtim me kuptimin tekstual të nenit 237/4 e nenit 263 të KPP. Nga llogaritjet e bëra rezulton se afati i qëndrimit nën masën e sigurimit arrest në shtëpi prej 9 muaj për periudhën e gjykimit ishte plotësuar dhe gjykatat duhet të kishin urdhëruar shuarjen e masës e lirim të menjëherëshëm të të gjykuarës nga kjo masë.



**11. Vendim nr. 00-2024-1421 (205),
datë 13.09.2024 (masë e sigurimit
personal: shqyrtim kërkesë për ekstradim)**

Maksima: Masa e sigurimit personal nuk kushtëzon vlefshmërinë e procedurës së ekstradimit dhe gjykata duhet të vazhdojë shqyrtimin e kërkesës për ekstradim edhe pas mbarimit ose ndryshimit të saj, duke garantuar respektimin e të drejtave themelore të personit dhe kushteve të përcaktuara nga konventat ndërkombëtare dhe legjislacioni i brendshëm.

Fjalë kyçe: masë e sigurimi personal, kërkesë për ekstradim

Decision no. 00-2024-1421 (205), dated 13.09.2024 (personal security measure: extradition request review)

Legal principle(s): The personal security measure does not condition the validity of the extradition procedure and the court must continue the review of the extradition request even after its completion or amendment, guaranteeing respect for the fundamental rights of the person and the conditions set out in international conventions and domestic legislation.

Keywords: personal security measure, extradition request

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë [...] ka paraqitur kërkesën me objekt: Lejimin e ekstradimit nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Italisë të shtetasit B.U.[...]Gjykata e Milanos Itali ,me vendimin nr. [...]ka vendosur : *Deklarimin fajtor të shtetasit B.U për kryerjen e veprës penale “Importim, posedim dhe trafikim të lëndëve narkotike” e kryer ne bashkëpunim të parashikuar [...] ky vendim është bërë përfundimtar dhe i parevokueshëm me vendimi [...]të Gjykatës së Kasacionit Itali.*

Prokuroria pranë Gjykatës së Zakonshme në Milano Itali ka nxjerrë urdhrin SIEP nr. [...]për ekzekutimin e vendimit [...].

Ministria e Drejtësisë se [...]me shkresën me referencë nr. [...]ia ka përcjellë aktet për ekstradim Drejtorisë së Marrëdhënieve me jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. [...]ia ka përcjellë aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit [...]

Gjykata e Shkallës së Parë [...]me vendimin me nr. [...]ka vendosur: “Të vleftësojë si të ligjshëm arrestimin e shtetasit shqiptar B.U si dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit “Arrest në burg” për efekt të ekstradimit [...]

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin [...]ka vendosur: “Të lejojë ekstradimin e shtetasit shqiptar B.U [...]për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të [...]Gjykatës së Milanos Itali, [...]

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. [...]ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit [...] Mospranimin e kërkesës për ekstradimin e shtetasit shqiptar [...].

Urdhërohet lirimi nga paraburgimi i të arrestuarit [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se rekursi i prokurorisë përmban element nga ato të parashikuar nga neni 432 të KPP dhe se vendimi i gjykatës së apelit është marr në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe, për rrjedhojë, vendimi duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me tjetër trup gjykues.

[...]Nisur nga kjo rëndësi e shqyrtimit të kësaj çështjeje, Kolegji vlerësoi të trajtojë fillimisht disa koncepte juridike të institutit të ekstradimit dhe garancive ligjore që ofron legjislacioni ndërkombëtar dhe i brendshëm në raport me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe garancive të shtetasve vendas apo të huaj ndaj të cilëve zbatohen procedurat e ekstradimit për jashtë vendit.

Instituti i ekstradimit përbën një nga format kryesore të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar me autoritetet e huaja në fushën e marrëdhënieve juridiksionale, duke qenë e vetmja formë e dorëzimit të një shtetasi, nga shteti në territorin e të cilit ai gjendet, në shtetin që ka kërkuar dorëzimin për qëllime të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor apo të gjykimit penal. Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Ekziston mundësia e ekstradimit të të huajit, të ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë, përsa kohë që ndalimi kushtetues i sipërcituar lidhet qartazi me kushtin e domosdoshëm për të zbatuar këtë procedurë ndaj shtetasit shqiptar dhe se ky parashikim nuk përjashton mundësinë e bashkëpunimit dypalësh të ekstradimit reciprok të personave të huaj, edhe në mungesë të marrëveshjes dypalëshe, por bazuar në parime të së drejtës ndërkombëtare. [...]

Kolegji konsideron se gjykimi i garancisë juridiksionale, i parashikuar në normat konvencionale dhe të brendshme të sipërcituara, referuar rastit

konkret të ekstradimit pasiv, i nisur mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë, ka për objekt, jo vetëm verifikimin e zbatimit të dispozitave të të drejtës objektive që rregullojnë këtë raport të marrëdhënieve juridiksionale mes shteteve në kuadër të angazhimeve të marra nga shteti ynë si vend anëtar i Këshillit të Evropës, por mbi të gjitha garantimin e të drejtës themelore të lirisë dhe të sigurisë së personit që i nënshtrohet këtij lloji të gjykimi. Përsa kohë që ekstradimi përbën një nga rastet kur ligjërisht mund të ushtrohet ndikim mbi këtë të drejtë, është e domosdoshme të verifikohet që procedimi kryesor jashtë shtetit në vendin kërkues të ekstradimit ndaj shtetasit që kërkohet ekstradimi e që motivon kërkesën e përbën kushtin e ekstradimit, të respektojë këtë parashikim. Në të kundërt ekstradimi nuk do të siguronte garancitë për lirinë e sigurinë e individit si një nënsistem juridik më vete për këtë qëllim.

[..]Në vijim Kolegji në lidhje me problematikën e ngritur në rekurs prej prokurorisë sesa duhet të afektohet procesi i shqyrtimi të kërkesës së autoriteteve të huaja për ekstradimin e një shtetasi, duke disponuar për themelin e kërkimit, nga humbja e fuqisë së masës së sigurimit personal e identifikuar ajo me arrestin në burg, të caktuar në dobi të shqyrtimit të kërkesës për ekstradim me efekt ekzekutimin e dënimit penal në zbatim të nenit 493 të KPP, prej Kolegjit vlerësohet si një pretendim i cili duhet pranuar dhe zgjidhur si më poshtë vijon.

Kërkesa për ekstradim është parashikuar nga ligjvënësi në seksion më vetë duke identifikuar rregulla të caktuara për mënyrën sesi duhet shqyrtohen kërkesa të kësaj natyre. Për efektivitetin e shqyrtimit të kërkesës dhe që ky vendim të mos ngelet vetëm i shkruar por edhe i ekzekutueshëm, KPP, ka parashikuar në nenin 493 të saj masat shtrënguese që mund të merren në mbështetje të kërkesës për ekstradim. Kjo dispozitë në pikën 1 të saj ka parashikuar parimin e përgjithshëm se mund të caktohet një masë sigurimi shtrëngues ndaj personit të cilit është kërkuar ekstradimi, ndërsa për llojet e tyre në pikën 2 të nenit 493 të KPP bënë referim në Titullin V, të KPP, “Masat e Sigurimit” duke referuar kështu që për modalitetet llojet dhe kushtet e kriteret që do të përdoren për identifikimin dhe caktimin e masës së përshtatshme kjo në raport me rrezikshmërinë e autorit dhe veprës penale për të cilën është dënuar apo kërkohet të gjykohet subjekti i kërkesës për ekstradim. Pra jo domosdoshmërisht masa e sigurimit mund të jetë ajo e “arrestit në burg”, por mund të jetë një ose disa nga ato të parashikuara nga neni 232 të KPP.

Ndërkohë pika 4 e nenit 493 të KPP, afateve të paraburgimit nuk ja ka lënë rregullimit të nenit 263 të KPP, për mbarimin e tyre por e ka rregulluar vetë duke vënë afate fikse për çdo shkallë të gjykimit të kërkesës

për ekstradim. Ndërkohë nëse e shikojmë këtë dispozitë me parashikimin e nenit 498 të KPP, e cila rregullon vendimin e gjykatës që shqyrton kërkesën për ekstradim, rezulton se nga përmbajtja e pikës 1 të kësaj dispozite vendimmarrja e gjykatës nuk kushtëzohet nga masa e sigurimit e se procesi i vlerësimit të kërkesës është i pavarur nga natyra e masës së sigurimit ose edhe i mosekzistencës së saj, kjo në kuptim të nenit 493/3 të KPP, duke pranuar që qëllimi i masës së sigurimit është në funksion të ekstradimit

Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji arrin në përfundimin se masa e sigurimit nuk mund të kushtëzojë kërkesën për ekstradim, e cila qëndron e pavarur si e tillë dhe gjykata duhet të vijojë shqyrtimin e saj dhe disponuar në lidhje me pranimin ose rrëzimin e saj pavarësisht nëse masa e sigurimit personal është në zbatim apo është revokuar/ndryshuar/zëvendësuar në lehtësim apo rëndim të natyrës së saj.

Kolegji vlerëson se gjykata e apelit gabimisht ka arsyetuar se ishte e detyruar që, brenda afatit të kohëzgjatjes së masës së sigurimit, duhej të jepte një vendim përfundimtar për pranimin ose jo të kërkesës për ekstradimit. Nga përmbajtja e dispozitave ligjore që rregullojnë institutin e ekstradimit, të parashikuara nga nenet 488 e vijues të KPP, në to nuk ka asnjë detyrim që gjykata ta lidhë vendimmarrjen e saj me kohëzgjatjen e masës së sigurimit. Në nenin 493 të KPP është parashikuar kohëzgjatja e masave shtrënguese të sigurimit, si edhe pasoja në rastet kur gjykimi nuk përfundon në kohë, që është ai i revokimit të masës shtrënguese, por jo detyrimi që me mbarimin e këtij afati gjykata është e detyruar të japë vendim përfundimtar. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit mund të konstatonte humbjen e fuqisë së masës së arrestit në burg, duke caktuar ndaj personit të kërkuar një masë tjetër më të butë, bazuar në të drejtën që i jepte neni 266 i KPP, siç mund të ishte edhe ajo e “Arrestit në shtëpi”, e më pas të vijonte gjykimin. Ka qenë pikërisht ky interpretim i gabuar i Gjykatës së Apelit, i cili ka bërë që gjykata të ngutet dhe të mos marrë kohë për të pritur përgjigjen dhe dokumentacionin shtesë nga Autoritetet Gjyqësore Italiane, përgjigje e cila në fakt ka mbërritur 18 ditë më pas, përcjellë me shkresën [...] të Ministrit tonë të Drejtësisë.

Në vijim Kolegji vlerëson se edhe pretendimi në lidhje me gjykimin në mungesë apo jo në shtetin Italian, si shkak i ngritur nga prokurori në rekurs, dhe si një nga motivet e pranuar nga gjykata e apelit, konstatohet se nga aktet shoqëruese të kërkesës për ekstradim dhe të përkthimit zyrtar të tyre rezulton se: [...] pra nuk kemi të bëjmë me një mbrojtës të caktuar kryesisht për shkak të padijenisë së tij për procesin që po zhvillohet, por edhe nëse do të kemi një gabim material në materialin e përkthyer, atëherë

Gjykata e Apelit si një gjykatë fakti mund të thërras përkthyesin zyrtar për të sqaruar përkthimin e saktë të vendimit, por nuk mund kurrësi të pranojë në apriori pretendimin e ankuesit se ai është gjykuar në mungesë në shtetin Italian. Pavarësisht kësaj edhe sikur të rezultojë i drejtë pretendimi i subjektit duke qenë se prokurori referon në rekurs se edhe letër garancia për rishqyrtimin gjyqësor të çështjes ka ardhur nga shteti kërkues, gjykata e apelit në rigjykim duhet të marrë në shqyrtim të dyja alternativat se cila është ajo më e zbatueshmja. [..]

Bazuar në sa më sipër, del e qartë se në rast të pranimit të kërkesës për ekstradim, personi i kërkuar ka gjithë të drejtën e garantuar në ligjin procedural penal të shtetit kërkues (Republikës së Italisë) të rivendoset në afat për të ushtruar ankim dhe kundërshtuar vendimin e dënimit, afat i cili i fillon nga dorëzimi i të dënuarit (pika 2-bis e nenit) përderisa kemi të bëjmë me një ekstradim nga jashtë shtetit. [..]

Kështu, Kolegji konstaton se gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të prokurorisë të ngritura në rekurs dhe për rrjedhojë, Gjykata e Apelit, në rigjykim duhet të marrë në shqyrtim të gjitha konstatimet e shpjeguara më sipër brenda shkaqeve të ngritura në ankim referuar nenit 425/1 të KPP.

Në konkluzion të të gjitha rrethanave të parashtruara më lart, Kolegji, në referim të nenit 441, paragrafi i parë, shkronja “c”, të KPP, vlerëson se duhet disponuar për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.



**12.Vendim nr. 00-2024-1626 (246),
datë 10.10.2024 (sekuestro preventive:
ekzistenca e dyshimit se ka veprë penale)**

Maksima: *Në ndryshim nga caktimi i masave të sigurimit personal që kanë si kusht sine qua non ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, në rastin e sekuestros preventive, mjafton të krijohet një dyshim se vepra penale ekziston (fumus delicti).*

Fjalë kyçe: *kërkesë për ndihmë juridike, sekuestro preventive, dyshim se vepra penale ekziston*

Decision no. 00-2024-1626 (246), dated 10.10.2024 (preventive seizure: existence of suspicion of the commission of a criminal offence / request for legal aid)

Legal principle(s): *Unlike the imposition of personal security measures, which has as its sine qua non the existence of a reasonable suspicion based on evidence, the imposition of a preventive seizure requires only the existence of reasonable grounds to suspect that a criminal offence has been committed (fumus delicti).*

Keywords: *mutual legal assistance, preventive seizure, suspicion of the commission of a criminal offence*

Rrethanat e çështjes:

Nga ana e Prokurorisë së Posaçme [...] është kërkuar vënia në ekzekutim e kërkesës për ndihmë juridike të ardhur nga autoritetet italiane të drejtësisë, [...] në kuadër të veprave penale “Zhvatje”, e kryer në bashkëpunim, “Përvetësim i paligjshëm i parave publike”, “Pastrim i produkteve të veprës penale”, “Organizatë kriminale”, parashikuar nga legjislacioni penal italian në ngarkim të shtetasve: M.M, Sh.M dhe M.M. [...]

Nga përmbajtja e kërkesës për ndihmë [...] ezulton, ndër të tjera, se është kërkuar: “...Për sqarim të së vërtetës objektive, [...] është e nevojshme të kryhen disa veprime përkatëse hetimore në territorin e Republikës së Shqipërisë. Së pari, në lidhje me faktet e parashtruara më sipër, kërkohet sekuestrimi, me vlerësimin paraprak të vlerës së tyre të tregut, pasuritë e mëposhtme, deri në arritjen e vlerës prej 1.882.049,14 Euro, [...]. Pasuria me nr. [...] Autoveturë [...] Së dyti, vënia në dispozicion e lëvizjeve bankare nga [...] duke treguar shumat e zhvendosura, përfituesit e operacioneve, duke bashkëngjitur dokumentacionin përkatës, që ka ë bënë edhe me çdo riinvestim në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të shumave të zhvendosura. Së treti, vënia në dispozicion e informacionit mbi ekzistencën e mundshme dhe detajet relative të pozicioneve bankare dhe/ose financiare të hapura dhe të regjistruara në Shqipëri, ose në çdo rast që i atribuohet subjekteve të mëposhtme: [...]

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për [...], me vendimin nr. [...] ka vendosur:

“Pranimin e kërkesës. Vënien në ekzekutim të kërkesës për ndihmë juridike të Autoriteteve të Drejtësisë të Italisë, konkretisht të Prokurorisë së Republikës pranë Gjykatës së Maçerata, [...] Për ekzekutimin e letërporosisë ngarkohet Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe

Krimit të Organizuar. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme Kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar që ti dërgojë menjëherë rezultatet e ekzekutimit të letërporosisë pranë të Prokurorisë së Republikës pranë Gjykatës së Maçerata, Itali.” [..]

Gjykata e Posaçme e Apelit [..] me vendimin nr. [..] ka vendosur: “Miratimin e vendimit nr. [..] me këtë ndryshim: Sekuestrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shtetases Sh.M, si më poshtë: Pasuria me nr[.] Autoveturë e markës [..].”[..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vëren se të dyja gjykatat e posaçme kanë pranuar kërkesën e prokurorisë së posaçme për lejjimin e ekzekutimit të letërporosisë, por kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me të drejtën e ankimit ndaj kësaj vendimmarrje të gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji konstaton se kërkesja ka parashtruar si shkak rekursi faktin që Gjykata [..] ka pranuar ekzekutimin e letërporosisë në dhomë këshillimi, duke mos i dhënë mundësi që të paraqiste prova dhe argumentet e saj. [..] Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson se Gjykata e Posaçme e [...]ka gabuar kur ka arsyetuar se palës së interesuar (subjekti të cilit i sekuestrohen pasuritë) nuk i njihet e drejta e ankimit, pasi për një formë të tillë të marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja një e drejtë e tillë nuk ekziston, bazuar në parimin e taksativitetit të, ankimit i sanksionuar në nenin 407, pika 1 të KPP. Sikurse ka argumentuar gjykata e posaçme e apelit, në këtë rast, përveç dispozitave që trajtojnë institutin e letërporosisë, si formë e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, zbatohen edhe dispozitat që kanë të bëjnë me sekuestron preventive.

Në nenin 276 të KPP parashikohet se kundër vendimit për vënien e sekuestros mund të bëjë ankim çdo i interesuar brenda dhjetë ditëve nga marrja dijeni efektivisht për sekuestron e vënë dhe çështja në këtë rast gjykohet nga gjykata e apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve. Një e drejtë e tillë ankimi parashikohet në mënyrë specifike edhe në fjalinë e dytë, të nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 10193, datë 03.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, ku përcaktohet se, [..]Në këtë kontekst, në raste si ky objekt shqyrtimi, Kolegji vlerëson se gjykatat e faktit, me qëllim që të mos rrezikohet cenimi i të drejtës së pronës për shtetasit që zotërojnë pasuri në territorin e Republikës së Shqipërisë, si një e drejtë e garantuar në nenin 41, pika 1, të Kushtetutës, dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, të KEDNJ duhet të kenë në vëmendje që të mos kufizojnë aksesin e personave në gjykim.

Në lidhje me pretendimin se gjykata e shkallës së parë e ka zhvilluar gjykimin në dhomë këshillimi pa i dhënë mundësi ankueses të paraqesë prova dhe argumente, Kolegji vlerëson se neni 274 i KPP, nuk parashikon shprehimisht thirrjen e personave që mund të cenohen nga sekuestrimi i pasurisë gjatë gjykimit në shkallën e parë. Por nëpërmjet të drejtës së ankimit kundër kësaj vendimmarrje, sipas përcaktimit në nenin 276 të KPP, ligjvënësi i ka dhënë mundësi personit që preket nga kjo vendimmarrje që të rivendosë të drejtën. Në këtë vështrim Kolegji vlerëson se pretendimi për cenim të së drejtës për t'ju drejtuar gjykatës i ngritur në rekurs nuk qëndron për shkak të shqyrtimit të pretendimeve në gjykatën e shkallës së dytë.

Në lidhje me pretendimin se gjykatat kanë mospërputhje në disponimet e tyre lidhur me caktimin e masës së sekuestros konservative apo preventive sipas neneve 270 dhe 274 të KPP, ndonëse është një pretendim që formalisht qëndron, Kolegji vlerëson se në thelb nuk e cenon vendimmarrjen objekt rekursi. Ndonëse neni 274 i KPP parashikon se, sekuestroja preventive vendoset nga gjykata me kërkesën e prokurorit, në rastin konkret kjo kërkesë duke qenë se është paraqitur për llogari të një procedimi penal që zhvillohet në një shtet të huaj (nëpërmjet letërporosisë) kushtëzohet jo vetëm nga vullneti i prokurorit që ka paraqitur kërkesën por nga kërkesa për ndihmë juridike e autoriteteve të huaja të drejtësisë (përmbajtja e saj), kërkesë kjo e cila në vlerësimin e Kolegjit është identifikuar drejtë nga gjykata e posaçme e apelit. Jo vetëm kaq por Gjykata e Posaçme e Apelit, ndryshe nga gjykata e posaçme e shkallës së parë ka identifikuar në pjesën urdhëruese edhe pasuritë konkrete, të cilat do t'i nënshtrohen sekuestros preventive.

Në lidhje me sa më sipër, Kolegji sjell në vëmendje se KPP parashikon tre lloje të ndryshme sekuestrimi: sekuestron “provuese” (neni 208 KPP), sekuestron “konservative” (neni 270 KPP) dhe sekuestron “preventive” (neni 274 KPP). E para është vendosur në Kreun “mjetet e kërimit të provës”; dy të tjerat tek Kreu i masave të sigurimit. Element i përbashkët për të tre llojet e sekuestros është se ato passjellin një kufizim të disponimit të një sendi të luajtshëm a të paluajtshëm, nëpërmjet vendosjes së tyre në një “posedim të detyruar”. Por për shkak të qëllimit të ndryshëm të secilit prej tyre, secili “institut-instrument” gjen një rregullim të veçantë në KPP. Sekuestroja “konservative” vendoset mbi një send të luajtshëm ose të paluajtshëm një kufizim për disponimin e tij me qëllim garantimin e pagimit të dënimit me gjobë, shpenzimeve të procedimit ose çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit. Ndërsa sekuestroja “preventive” parashikohet në nenin 274 të KPP, sipas të cilit: [..] Bazuar në këtë dispozitë sekuestroja

“preventive” vendoset nga gjykata me kërkesë të prokurorit në prezencë të njëres prej nevojave të sigurimit që vijnë: (i) Rrezikshmëria e sendit që duhet t’i nënshtrohet “kufizimit të disponimit” mund të burojë nga lidhja që ky send ka me veprën penale. Për rrjedhojë KPP lejon vendosjen e sekuestros me qëllim që të evitohet *“disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj”* (neni 274, pika 1). (ii) Një nevojë tjetër sigurimi lidhet edhe me rrezikshmërinë që sendi *“mund të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera”* (neni 274/1). Në këtë rast gjykata vlerëson nevojat e sigurimit me qëllim vendosjen e “sekuestros preventive” duke kryer një vlerësim tashmë përtej veprës penale, pra një vlerësim parashikues me qëllim “parandalues” ante delictum, ose parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale që nuk lidhen me veprën penale tashmë të kryer. (iii) Rrezikshmëria e vetë sendit (neni 2/274 i KP); në fakt sekuestroja preventive lejohet të vendoset *“për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP”*. Duhet theksuar që “rrezikshmëria e sendit” është vlerësuar nga vetë ligjvënësi që ka parashikuar konfiskimin e tyre të detyrueshëm; vendosja e sekuestros preventive në këtë rast bëhet me qëllim sigurimin e procesit nëpërmjet “kufizimit të disponimit të lirë” të këtyre sendeve.

Në sintezë të sa më sipër, theksohet se sekuestroja konservative, referuar nenit 270, pika 1 të KPP, është një masë që vendoset mbi pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, me qëllim për të garantuar pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit. Nga ana tjetër, sekuestroja preventive është një masë sigurimi me natyrë pasurore, e cila referuar nenit 274, pika 2 të KPP, vendoset mbi produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP. Nga ana e tij, neni 36 i KP, ndërsa rendit sendet të cilat mund të konfiskohen si mjete për kryerjen e veprës penale ose produkte të saj, në shkronjën “ç” të tij shprehet se objekt konfiskimi është edhe çdo pasuri tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale. Në këtë vështrim si dhe referuar akteve të letërporosisë, Kolegji vlerëson se Gjykata e Posaçme e Apelit, në dallim nga gjykata e posaçme e shkallës së parë, me të drejtë ka arritur në përfundimin se në këtë rast nuk ndodhemi përpara sekuestros konservative, por përpara sekuestros preventive. [...] Pra, këto pasuri, nuk përbëjnë domosdoshmërisht produkt të drejtpërdrejtë të veprës penale, pasi një gjë e tillë nuk është specifikuar në kërkesën për ndihmë juridike nga autoritetet italiane, por përbëjnë një pjesë të vlerës që i korrespondon asaj të produkteve të veprave penale të

hetuara në shtetin italian. Për rrjedhojë për shqyrtimin e dhënies udhë të letërporosisë në fjalë me të drejtë Gjykata e Posaçme e Apelit ka zbatuar regjimin juridik të sekuestros preventive.

Nga ana tjetër, referuar pretendimeve të ngritura në rekurs, lidhur me identifikimin e pasurive objekt sekuestrimi, vlerën e tyre, verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të tyre, Kolegji vlerëson se në rastin konkret elementet e sekuestros preventive që është caktuar mbi pasuritë e ankueses Sh.M janë analizuar nga gjykata e posaçme e apelit, në përputhje me natyrën e kërkesës që ka patur për shqyrtim (letërporosi nga jashtë për sekuestrimin e pasurive të identifikuar nga autoriteti i huaj) dhe këto shkaqe nuk e cenojnë vendimmarrjen objekt rekursi.

Kolegji Penal ka një qëndrim të konsoliduar se, në ndryshim nga caktimi i masave të sigurimit personal që kanë si kusht *sine qua non* ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, në rastin e sekuestros preventive, mjafton të krijohet një dyshim se vepra penale ekziston/fumus delicti. (vendimin nr. 123, datë 7.12.2021 të Kolegjit Penal). [...]

Kolegji evidenton edhe faktin se në rastin konkret, Gjykata e Posaçme e Apelit ka administruar aktet e pronësisë të pasurive të paluajtshme të ankueses Sh.M që janë kërkuar të sekuestrohen, si dhe i ka kërkuar prokurorisë sjelljen e akteve të pronësisë që kanë të bëjnë me automjetin, për të cilin sërish është kërkuar sekuestroja. [...]

Ndërsa në lidhje me pretendimet e ringritura në rekurs sa i përket verifikimit të origjinës së ligjshme të burimit të krijimit të pasurive të cilat i janë nënshtruar sekuestros, [...] Kolegji vlerëson se nëse ankuesja ka pretendime të këtij lloji ajo duhet t'i parashtrojë ato përpara autoriteteve italiane të drejtësisë, të cilat janë kompetente për zhvillimin e hetimeve penale në ngarkim të saj. Këtu ajo mund të kërkojë të provohet se shtetasit M.M dhe M.M nuk kanë asnjë të drejtë pronësie mbi këto pasuri dhe se ato nuk janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

Edhe lidhur me vlerën paraprake të pasurive, Kolegji vëren se kërkesja lidhur me pretendimet e ringritura në rekurs ka marrë përgjigje të argumentuar nga gjykata e posaçme e apelit, e cila ka arsyetuar se: [...] Ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, Kolegji vlerëson se ndonëse gjykata e posaçme e apelit nuk ka vlerësuar të nevojshme kryerjen e një ekspertimi vlerësues nga ana tjetër ka bërë një vlerësim paraprak të pasurive objekt sekuestrimi, duke ekzekutuar letërporosinë sipas kërkesës së autoriteteve të drejtësisë së Italisë.

Përpos sa më sipër, Kolegji vlerëson se pjesa e pretendimeve të ngritura në rekurs në lidhje me vlerësimin e gabuar të fakteve dhe provave, nuk merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, pasi kjo është

një çështje që del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj. Kolegji vlerëson se Gjykata e Posaçme e Apelit, ka identifikuar drejtë kërkesën për ndihmë juridike të autoriteteve italiane të drejtësisë, ka individualizuar në vendim pasuritë objekt sekuestrimi, si dhe ka arsyetuar mjaftueshëm, referuar edhe llojit të çështjes që ka patur për shqyrtim, në lidhje me të gjitha pretendimet e parashtruara në ankim (ringritur në rekurs) nga pala e interesuar Sh.M.

Në përfundim, Kolegji duke vlerësuar në tërësi vendimmarrjen objekt rekursi, procesin e zhvilluar nga gjykatat e faktit, verifikimin e zbatimit të garancive kushtetuese e procedurale për rekursuesen, të cilës i është garantuar e drejta e aksesit dhe mbrojtja efektive, çmon se vendimi nr. [...] i Gjykatës së Posaçme të Apelit [...] duhet lënë në fuqi. Së fundi, lidhur me pretendimet e parashtruara në shtesën e rekursit, duke qenë se i referohen vlerësimit të provave (që është atribut i gjykatave të faktit) aq më tepër që shpjegohet se kanë dalë pas vendimit objekt rekursi (që do të thotë nuk i janë nënshtruar shqyrtimit nga gjykatat e faktit), Kolegji vlerëson se janë pretendime që dalin jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë, por mund të përbëjnë shkak që nëpërmjet mjetit të duhur juridik, pala ankuese t'i drejtohet organit kompetent për shqyrtimin e tyre.



**13. Vendim nr. 00-2024-1856 (283),
datë 19.11.2024 (sekuestro provuese:
vendim prokurori, pezullim hetimi, send i
vjedhur)**

Maksima: 1. Nuk mund të paraqitet ankim kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake që ka disponuar në lidhje me ankimin e palës kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e hetimeve dhe as rekurs në Gjykatën e Lartë kur ligji shprehimisht nuk e parashikon. 2. Sendi i vjedhur që është objekt i veprës penale nuk mund t'i kthehet kërkuarit kur shërben për qëllim prove. 3. Fituesi, qoftë edhe me mirëbesim, nuk bëhet pronar i sendit kur ky është i vjedhur.

Fjalë kyçe: sekuestro provuese, send i vjedhur, ankim vendimi ndaj prokurorit për pezullim hetimi

Decision No. 00-2024-1856 (283), dated 19.11.2024 (evidentiary seizure: prosecutor's decision to suspend investigation/stolen item)

Legal principle(s): 1. No appeal may be filed against the decision of the judge of the preliminary hearing who has ruled on the party's appeal against the prosecutor's decision to suspend the investigation, nor may recourse be filed with the Supreme Court when the law does not expressly provide for it. 2. A stolen item that is the object of a criminal offense may not be returned to the applicant when it serves as evidence. 3. The transferee, even in good faith, does not become the owner of the item when it is stolen.

Keywords: evidentiary seizure, stolen item, appeal against the prosecutor's decision to suspend investigation

Rrethanat e çështjes:

[..]rezulton se në datën [..]në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë, oficerët e Frontex kanë ndaluar mjetin me targa [..], në pronësi të E.G, me drejtues mjeti T.G, [..]. [..] për shkak të ndryshimit të numrave të shasisë midis kompjuterit të bordit të makinës dhe numrit aktual në mjet, si dhe dokumentacionit përkatës, ka lindur dyshimi i arsyeshëm se mund të ketë ndërhyrje në numrin e shasisë së automjetit me targa [..].

Në bazë të aktit nr. 992, të ekspertimit teknik të numrave të shasisë së mjetit në fjalë, me qëllim verifikimin nëse kishte ndërhyrje falsifikuese në numrat e shasisë së stampuar në bordin e mjetit, ka rezultuar se: *“Në mjetin e markës [..]është i stampuar në dy rreshta numri i shasisë [..]Në numrin e shasisë [..] objekt ekspertimi evidentohen ndërhyrje, ku poshtë karaktereve të numrit aktual të shasisë janë shfaqur konture të numrave të mëparshëm.”* Në vijim me qëllim zbardhjen e rrethanave të veprës penale i është kërkuar ndihmë autoriteteve gjermane dhe serbe të drejtësisë. [..]Mjeti në fjalë referuar komunikimit të autoriteteve gjermane të drejtësisë ishte dhënë me qera nga kompania [..]e më pas nuk është kthyer më te pronari i mjetit/kompania. Në këtë mjet janë kryer ndërhyrje falsifikuese, duke ndryshuar numrat e shasisë, e më pas mjeti është pajisur me dokumentacionin përkatës, referuar numrit të falsifikuar të shasisë, në mënyrë që mjeti të mos rezultojë me status pozitiv gjatë kontrolleve përkatëse. [..]Në këto kushte rezulton se nga ana e organit procedues janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, por pavarësisht këtij fakti ende nuk është arritur të sigurohet asnjë e dhënë apo provë lidhur me autorin e veprës penale. Në këto kushte bazuar në nenin 326, pika 1, 2 dhe 3 të KPP është vendosur pezullimi i hetimeve të procedimit penal nr.716, të vitit 2020.

E.G [...] është drejtuar gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi dhe kthimin e mjetit të sekuestruar në pronësi të saj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. [...] ka vendosur: “1. Rrëzimin e kërkesës. 2. Lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë [...] Për pezullimin e hetimeve të procedimit penal [...]” [...]

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. [...]” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se pretendimet e ngritura nga kallëzuesja nuk e cenojnë vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Shkodër. Ky vendim është në interpretim të drejtë të ligjit procedural penal dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Së pari, lidhur me pezullimin e hetimeve paraprake, Kolegji vlerëson se kërkesja nuk legjitimohet të paraqesë ankim, pasi ligji nuk e lejon. Neni 326, me titull “Pezullimi i hetimeve” parashikon se, [...] Nga përmbajtja e kësaj dispozite, rezulton se ligjvënësi ka parashikuar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pezullimin e hetimeve para gjyqtarit të seancës paraprake. Ky ankim i lejohet viktimës dhe personit që ka bërë kallëzimin dhe shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake brenda afatit 30 ditë. Shprehimisht, ligjvënësi ka parashikuar se “Kundër vendimit nuk lejohet ankim.” [...]

Në këto kushte, përsa kohë qartazi neni 326, pika 3 i KPP nuk lejon ankim (apel) kundër vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake që ka disponuar në lidhje me ankimin e palës kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e hetimeve, referuar këtij rregulli (që ka kufizuar këtë gjykim deri te gjyqtari i seancës paraprake), nuk lejohet ankim as nëpërmjet rekursit në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, kërkesja nuk legjitimohen të paraqesin ankim, e për rrjedhojë as rekurs kundër disponimit të vendimmarrjes së mësipërme të gjyqtarit të seancës paraprake. Përpos kësaj, për këtë disponim ligji ka bërë dallim ndërmjet palëve që mund të paraqesin ankim, duke e lejuar vetëm për viktimën e veprës penale dhe personin që ka bërë kallëzim, kategori subjektsh të cilëve nuk i përket kërkesja. Viktimë e veprës penale në rastin konkret është personi të cilit i është shkaktuar dëm ekonomik nga pakësimi i pasurisë si rezultat i vjedhjes/personi juridik që ka dhënë mjetin e vjedhur me qera dhe jo kërkesja që në eventualitet mund të legjitimohet në një proces civil me lëndë shqyrtimi shpërblim dëmi pasuror.

Së dyti, Kolegji sjell në vëmendje se KPP parashikon tre lloje të ndryshme sekuestroje: sekuestron “provuese” (neni 208 KPP), sekuestron “konservative” (neni 270 KPP) dhe sekuestron “preventive” (neni 274 KPP). E para është

vendosur në kreun “mjetet e kërkimit të provës”; dy të tjerat tek kreu i masave të sigurimit. Element i përbashkët për të tre llojet e sekuestros është se ato passjellin një kufizim të disponimit të një sendi të luajtshëm a të paluajtshëm, nëpërmjet vendosjes së tyre në një “posedim të detyruar”. Por për shkak të qëllimit të ndryshëm të secilit prej tyre, secili “institut-instrument” gjen një rregullim të veçantë në KPP. Sekuestroja “provuese” (neni 208 i KPP) vendoset për të siguruar një send të luajtshëm a të paluajtshëm, në një procedim, me qëllim vërtetimin e fakteve, nëpërmjet “posedimit të detyrueshëm” të sendit dhe vendosjes së kufizimeve për disponimin e tij. Vendosja e një kufizimi të tillë shërben për të mbajtur të pandryshuar sendin, me qëllim vërtetimin e fakteve. Për të vendosur këtë sekuestro duhet të përmbushen dy kriterë: (i) kriteri i “natyralitetit” dhe (ii) kriteri “juridik”. Kriteri i parë lidhet me faktin që sendi objekt sekuestroje duhet të jetë një e mirë “materiale” ndërsa për kufizimin e disponimit të të drejtave subjektive juridike ose të mirave “jomateriale” përdoren mjete të tjera juridike (*p.sh. sekuestroja preventive për kuotat e pjesëmarrjes në shoqëri; sekuestroja konservative në një bilanc llogarie*). Kriteri i dytë lidhet me faktin që objekt sekuestroje mund të jenë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes ose sende që lidhen me veprën penale (*sende që shërbejnë në mënyrë të tërthortë për vërtetimin e faktit, autorin dhe rrethanat e faktit, të individualizuara rast pas rasti*) dhe mbi të gjitha, që sendi të jetë “i domosdoshëm” për vërtetimin e fakteve.

Referuar parashikimeve ligjore të evidentuar më lart dhe kriterëve të sipërpërmendura, Kolegji vlerëson se drejt ka konkluduar gjykata e apelit në zgjidhjen e çështjes, [...]Me të drejtë sendi nuk mund të kthehet pasi mjete rezultojnë i vjedhur dhe kështu përbën objekt të veprës penale, duke qenë kështu objekt i sekuestros provuese.

Kërkuesja pretendon se, sipas nenit 190/2 të KPP që parashikon se, [...]ky send, pavarësisht se është objekt i veprës penale, duhet t'i kthehet asaj si person që i përket pasi ka qenë në mirëbesim. Kolegji vlerëson se ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, ky send nuk evidentohet se i përket kërkueses por duhet t'i kthehet pronarit të saj/ kompanisë ku është marrë me qira në shtetin gjerman. Arrihet në këtë përfundim pasi nuk mund të fitohet kundrejt shpërblimit në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë një sendi të luajtshëm kur ky është i vjedhur, qoftë kur blerësi është në mirëbesim. Për këtë arsye, Kolegji e vlerëson të drejtë, arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë (lënë në fuqi nga gjykata e apelit) [...]

Përsa më lart u arsyetuar Kolegji, vlerëson se, në rekursin e paraqitur nuk janë sjellë argumente se përse gjykata e apelit ka gabuar në vendimmarrjen e saj, në lidhje me shkeljen e ligjit material apo procedural penal. Për këtë arsye ky vendim në konformitet me nenin 441, pika 1, shkronja “e” të KPP [..]duhet të lihet në fuqi.



**14. Vendim njësues nr.00-2025-1007 (82),
datë 27.03.2025 (verifikimi i nevojave të
sigurimit: detyrueshmëria e pjesëmarrjes
së prokurorisë)**

Sentenca njësuese: Pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të Kodit të Procedurës Penale, gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore në shkallën e parë, është e detyrueshme. Mungesa e prokurorit gjatë shqyrtimit të ankimit në apel, kur është njoftuar dhe nuk ka paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen, nuk e pengon gjykatën e apelit që të vijojë me shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar mbi verifikimin e nevojave të sigurimit dhe kërkesën për zëvendësim apo revokim të masës së sigurimit. **Fjalë kyçe:** verifikim i nevojave të sigurimit, pjesëmarrje e prokurorit, shqyrtim apel, njoftim i prokurorit, mosparaqitje pa shkak

**Unifying Decision no. 00-2025-1007 (82), dated 27.03.2025
(verification of security measure needs: mandatory participation of the prosecution)**

Unifying sentence: The participation of the prosecutor in proceedings concerning the review of the necessity of a security measure, pursuant to Article 246, point 6, of the Code of Criminal Procedure, during the hearing in the first instance court session, is mandatory. The absence of the prosecutor during the hearing of the appeal, where he or she has been duly notified and has failed to appear without presenting a valid reason, does not prevent the Court of Appeal from proceeding with the examination of the appeal against the decision reviewing the necessity of the security measure, including any request for its substitution or revocation. .

Keywords: review of the necessity of a security measure needs, participation of the prosecutor, appeal hearing, notification of the prosecutor, failure to appear without reason

Rrethanat e çështjes:

[..] i hetuari Xh.K dyshohet se në koordinim me bashkëpunëtorët e tjerë ka kryer veprimet e pritjes së të shtetasve nga Bangladeshi, duke plotësuar dokumentacionin për “punësimin” e tyre në aktivitetin e tij si person fizik. Në kuadër të këtij procedimi penal, me vendimin nr. [...] ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “arrest në burg”, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale të cituara më lart. Ky vendim është miratuar nga gjykata e apelit.

Më datë 11.10.2024, kërkuesi ka paraqitur kërkesë në gjykatë për verifikimin e nevojave të sigurimit dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga arrest në burg në një masë më të lehtë. [...] (gjyqtari i hetimit paraprak) ka vendosur shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me gjendjen e procedimit penal nr. 188 të vitit 2023, hetimet e kryera pas momentit të caktimit të masës së sigurimit dhe nevojat e sigurimit. [...]

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. [...] ka vendosur:

“Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Xh.K dhe mbrojtësit të tij, për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të caktuar me vendimin nr. [...] me masën sigurimit “garanci pasurore” apo “arrest në shtëpi” sipas neneve 236, 237 të KPP si të pabazuar në ligj dhe në prova.” [...]

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. [...], ka vendosur:

“Miratimin e vendimit nr. [...]” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

i. Nevoja për njësim të praktikës gjyqësore dhe qëndrimet e palëve

[...] Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore Kolegji konstatoi se ka qëndrime të ndryshme të gjykatave në zbatimin e ligjit procedural penal, lidhur me pjesëmarrjen e palëve, konkretisht organit të prokurorisë, gjatë shqyrtimit periodik të nevojave të sigurimit personal, konkretisht nenin 246/6 të KPP. Konstatohet se gjykatat e faktit kanë mungesë uniformiteti në lidhje me zhvillimin e seancës me praninë e prokurorit, në procesin që zhvillohet për shqyrtimin e informacionit periodik 2 mujor dhe verifikimin e nevojave të sigurimit, në fazën e hetimeve paraprake. Konstatohet se në shumicën e rasteve, seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e prokurorisë, të arrestuarit dhe mbrojtësit të zgjedhur ose caktuar kryesisht. Megjithatë, dhe në raste të tjera konstatohen se, sikurse edhe ky objekt shqyrtimi, në të cilën seanca në gjykatën e shkallës së parë është zhvilluar me pjesëmarrjen

e prokurorit, të arrestuarit dhe mbrojtësit, ndërsa seanca në gjykatën e apelit është zhvilluar pa praninë e prokurorit.

Duke patur parasysh mënyrën e procedimit nga gjykatat e faktit në drejtim të palëve pjesëmarrëse në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP, si dhe nevojën për të garantuar qëndrueshmëri në gjykatat më të ulëta lidhur me zbatimin e këtij parashikimi ligjor, Kolegji evidentoi nevojën për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Nëpërmjet njësimit dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore Kolegji ka për qëllim njëtrajtësimin e praktikës gjyqësore në mënyrën e zbatimit të ligjit me qëllim që të vendoset i njëjti standard për mënyrën e procedimit dhe palët pjesëmarrëse në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP. [..]

ii. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

Kolegji [..] Nisur nga procedura e ndjekur në rastin konkret (por jo vetëm), ku shqyrtimi i ankimit në apel ndaj vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë për vijimin e qëndrimit në fuqi të masës së sigurimit “arrest në burg”, sipas neneve 246/6 dhe 249 të KPP është bërë pa praninë e organit të akuzës, si dhe detyrimet dhe standardet e përcaktuar në KEDNJ dhe jurisprudencën e GJEDNJ, Kolegji shtroi për njësim çështjen: *“A është e detyruar pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP, në zbatim të masës së sigurimit personal të caktuar ndaj personit nën hetim?”*

[..] Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat me vendimin nr. 1, datë 08.01.2009 kanë unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me kuptimin e drejtë të këtij parashikimi ligjor, detyrat e subjekteve të procedurës penale gjatë shqyrtimit periodik të masës së sigurimit, si dhe natyrën e këtij gjykimi. [..] Nisur edhe nga përmbajtja e vendimit unifikues nxirret konkluzioni se shqyrtimi periodik i masave të sigurimit përbën kontroll efektiv, ezaurues dhe jo formal të gjendjes së procedimit në tërësi dhe ky verifikim kryhet në seancë gjyqësore, duke garantuar zhvillimin e debatit gjyqësor mes palëve mbi materialin e paraqitur. Vendimi unifikues nuk ka trajtuar çështjen e pjesëmarrjes së prokurorit në seancën gjyqësore të shqyrtimit të ankimit në apel, gjë që ka sjellë mënyra të ndryshme të zbatimit të procedurës së shqyrtimit të këtyre kërkesave e që në praktikën aktuale gjyqësore janë interpretuar si raste të pavlefshmërive të gjykimit për shkak të mospjesëmarrjes së prokurorit.

[..] Fjalja e parë e pikës 6 të nenit 246 të KPP vendos detyrimin e prokurorit për të informuar me shkrim gjykatën që ka caktuar masën. Teknika e ndërtimit të fjalisë “*prokurori informon me shkrim gjykatën*” në

krahasim me atë para ndryshimeve “*gjykata që ka dhënë vendimin duhet të informohet*” synon që të theksojë pikë së pari detyrimin e prokurorit të paraqesë informacionin me shkrim para gjykatës. Qëllimi i ligjvënësit me këtë parashikim ligjor është që të evidentojë detyrimin e prokurorit për të informuar me shkrim periodikisht (çdo dy muaj) gjykatën për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit (gjendjen e procedimit) në mënyrë që kjo e fundit të garantojë që kjo gjendje të bëhet objekt i shqyrtimit gjyqësor. Ky detyrim rrjedh nga fakti se organi i prokurorisë funksionin e tij në ushtrimin e ndjekjes penale duhet ta ushtrojë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe ligjshmëria e vijueshmërisë së zbatimit të masës së sigurimit të arrestit të kërkuar prej vetë atij (prokurorisë) duhet t’i nënshtrohet kontrollit periodik gjyqësor.

Fjalja e dytë e pikës 6 të nenit 246 të KPP parashikon përmbajtjen e informacionit dhe ky parashikim ka mbetur i pandryshuar. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Ky parashikim është në funksion të përcaktimit në fjalinë e parë të nenit 246/6 të KPP, [...] Nisur nga këto formulime është e qartë se ky informacion me shkrim nuk duhet të jetë formal në kuptimin që prokurori thjesht të listojë veprimet hetimore që ka kryer nga momenti që masa e arrestit është kërkuar *ab initio* në gjykatë. Përkundrazi, ky informacion jo vetëm që duhet të përmbajë të dhëna mbi gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra, pra në tërësi lidhur me hetimet e kryera, por duhet të informojë gjykatën edhe lidhur me nevojat e sigurimit. Nevojat e sigurimit parashikohen në pikën 3 të nenit 228 të KPP dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendimin njësesues nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara.

Ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova në ngarkim të të hetuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të gjykuarit. Mirëpo, rrethanat e çështjes penale mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Sipas nenit 246/6 të KPP, gjykata duhet të shqyrtojë të gjitha rrethanat e lidhura me ekzistencën ose jo të interesit publik real që justifikon vazhdimin e zbatimit të masës së arrestit. Në këtë gjykim ajo mban parasysh edhe respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, si dhe natyrën e masës së arrestit si përjashtim nga rregulli kushtetues i respektimit të lirisë individuale. [...]

Në këtë vështrim, paraqitja e informacionit me shkrim duke bërë thjesht një listim/përshkrim të veprimeve hetimore që janë kryer apo ato që do të kryhen, por pa u dhënë motivet konkrete për justifikimin e vazhdimit të kufizimit të lirisë së individit (nevojat e sigurimit), nuk përmbush kërkesat që neni 246/6 i KPP i vendos prokurorit dhe detyrimin e këtij të fundit për ushtrimin e ndjekjes penale në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Megjithatë, në këtë gjykim me objekt rivlerësimin e masës së arrestit është gjykata ajo që duhet të çmojë e vendosë edhe në varësi të vërtetimit ose jo të motiveve të tjera të parashtruara me shkrim apo në gjykim nga organi i akuzës për justifikimin e vazhdimit të kufizimit të lirisë së individit. [..]

Më tej, kjo dispozitë (neni 246/6 i KPP) sipas formulimit në fuqi përcakton rregullin se nëse prokurori nuk përmbush detyrimin për vënien në lëvizje të gjykatës nëpërmjet paraqitjes së informacionit për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit, është gjykata që kryesisht ose me kërkesë të të pandehurit vihet në lëvizje për të verifikuar nevojat e sigurimit për personin ndaj të cilit është zbatuar masa e arrestit. Ky detyrim rrjedh nga fakti se rrethanat e çështjes mund të ndryshojnë me kalimin e kohës gjë që bën të domosdoshëm zbatimin e një mekanizmi të rishqyrtimit periodik, të detyrueshëm të masës së sigurimit nga ana e gjykatës me qëllim që të çmohet nëse masa e arrestit vijon të jetë e justifikuar ligjërisht dhe nuk cenohen të drejtat e njeriut. Para ndryshimit të kësaj dispozite nuk parashikohej detyrimi i verifikimit kryesisht nga ana e gjykatës të nevojave të sigurimit kur prokurori nuk përmbushte detyrimin e informimit dy mujor, por ajo mund të vihej në lëvizje nga vetë personi i arrestuar. Për të garantuar kontradiktoritetin dhe mbrojtjen efektive, norma e ndryshuar ka përcaktuar detyrimin e gjykatës për të dëgjuar palët, përpara se të vendosë për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. [..]

Norma e parashikuar në pikën 6 të nenit 246 të KPP nuk rregullon shprehimisht procedurën që kryen gjykata, në rastet kur ajo shqyrton ligjshmërinë e vijimit të zbatimit të masës së arrestit, gjatë verifikimit të detyrueshëm periodik. Para ndryshimit të normës në fjalë, Kolegjet e Bashkuara¹ kanë përcaktuar se gjykata e shqyrton çështjen në seancë gjyqësore dhe duhet të vendosë me shpejtësi për marrjen e vendimit, qëndrim ky që është reflektuar edhe në ndryshimet që ka pësuar neni

1 Shih vendimin unifikues nr. 1 datë 8.1.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

246/6 i KPP. Nga ana tjetër, megjithëse kjo dispozitë nuk përcakton në përmbajtjen e saj procedurën që ndjek gjykata gjatë shqyrtimit periodik të masës së arrestit, ajo përcakton se gjykata merr vendim për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit, pasi ka dëgjuar palët. [...] Prandaj, nisur nga këto detyrime konventore, duke patur parasysh se veprimi i parimit të kontrollit gjyqësor mbi masën e arrestit mishërohet mes të tjerave edhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të KPP, gjykata kompetente duhet të shqyrtojë me shpejtësi çështjen në seancë gjyqësore, duke dëgjuar palët. Lidhur me përmbushjen e këtij detyrimi (dëgjimin e palëve) përpara marrjes së vendimit, kjo dispozitë (neni 246/6 i KPP) përcakton se zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të KPP.

Objekti i normës së parashikuar nga neni 248 i KPP është rregullimi i procedurës që kryen gjykata, në rastet kur ajo vendos një masë sigurimi personal, shtrënguese ose ndaluese, pa e dëgjuar paraprakisht personin e dyshuar. Dispozita normon detyrueshmërinë e marrjes në pyetje të personit nga gjykata, kohën e marrjes në pyetje, garantimin e mbrojtjes dhe mundësitë e ndryshimit të vendimmarrjes pas marrjes së provave të parashtruara nga personi që i është kufizuar liria. Me marrjen në pyetje të personit dhe dëgjimit të argumenteve të tij dhe të mbrojtësit, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi. Verifikimin e kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës, si dhe nevojat e sigurimit, gjykata e kryen nëpërmjet marrjes në pyetje të personit ndaj të cilit është zbatuar masa, duke proceduar personalisht me pyetjen e tij. Natyrisht, personi ka të drejtë të mos përgjigjet, si dhe të bëjë deklaratimet që i çmon të nevojshme për mbrojtjen e tij. [...]Gjatë debatit gjyqësor palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshmitarë. Kësisoj, qartazi kuptohet se marrja në pyetje bëhet në seancë gjyqësore, në të cilën marrin pjesë përveç të arrestuarit, prokurori dhe mbrojtësi, kundrejt njoftimit paraprak nga sekretaria e gjykatës.

Ndërkohë, megjithëse norma e zbatueshme në çështjen e shtruar për njësim, pika 6 e nenit 246 të KPP nuk rregullon shprehimisht procedurën që kryen gjykata, në rastet kur ajo shqyrton ligjshmërinë e vijimit të zbatimit të masës së arrestit gjatë verifikimit të detyrueshëm periodik, ajo përcakton se gjykata merr vendim për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit, pasi ka dëgjuar palët. Dëgjimi i palëve nënkupton detyrimin e gjykatës që tu sigurojë palëve në proces të drejtën për tu paraqitur në seancë gjyqësore kundrejt njoftimit paraprak, njohjen me provat, të drejtën për të paraqitur argumentet/provat dhe për të

kundërshtuar ato të palës tjetër. Në referim të nenit 246/6 të KPP gjykata duhet të dëgjojë si prokurorin (arsyet e vazhdimit të paraburgimit), ashtu edhe argumentet e mbrojtjes, dhe tu japë mundësi të dyja palëve të paraqesin prova apo të kundërshtojnë të dhënat e paraqitura. Dëgjimi i palëve është një parim thelbësor për të garantuar një proces të drejtë dhe kontradiktor dhe çdo shkelje e tij e cenon ligjshmërinë e vendimmarrjes së dhënë. Nisur nga ky detyrim, por edhe sepse fjalia e fundit e pikës 6, të nenit 246/6 referon në rregullat e parashikuara në nenin 248 të KPP, gjykimi i verifikimit të detyrueshëm periodik për ligjshmërinë e vijimit të zbatimit të masës së arrestit në shkallë të parë, do të bëhet në seancë gjyqësore, në të cilën marrin pjesë përveç të arrestuarit, prokurori dhe mbrojtësi, kundërshtojnë njoftimit paraprak nga sekretaria e gjykatës.

Ndërkohë, objekti i normës së parashikuar nga neni 249 është rregullimi i mjeteve të ankimit kundër vendimit të gjykatës për masat e sigurimit sipas neneve 244 dhe 248 të KPP, kohëzgjatjen e afatit të paraburgimit (mbi 6 muaj), afatet brenda të cilit duhet të paraqitet dhe shqyrtohet ankimi, rregullat që duhet të ndiqen për njoftimin e palëve, si dhe alternativat e vendimmarrjes. [...]

Në sintezë të arsytimit deri në këtë pikë të vendimit, Kolegji thekson se në zbatim të parashikimeve të mësipërme ligjore dhe vendimit njësuës nr. 1/2009, shqyrtimi periodik i ligjshmërisë së zbatimit të masës së sigurimit të arrestit me kërkesë të palëve ose kryesisht nga gjykata, do të kryhet në seancë gjyqësore, me pjesëmarrjen e palëve (prokurorit dhe mbrojtësit), duke u dhënë mundësinë për tu dëgjuar në një procedurë me ballafaqim dhe me barazi të armëve, në përfundim të të cilës gjykata do të vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Nga ana tjetër, nisur nga çështja konkrete objekt njësimi, sillet në vëmendje se as neni 246/6 i KPP dhe as nenet 248 dhe 249 në të cilat referon kjo dispozitë, nuk parashikojnë pasojën ligjore të mosparaqitjes së palëve në seancën gjyqësore që zhvillohet sipas këtyre dispozitave. Megjithatë, neni 246/6 lidhur me rregullat për zbatim referon në nenet 248 dhe 249 të KPP. Nga përmbajtja e nenit 248 të KPP vërehet se ligjvënësi parashikon pjesëmarrjen e mbrojtësit dhe prokurorit, por nuk përcakton nëse kjo pjesëmarrje është e domosdoshme/detyrueshme, sikundër parashikon për shembull në rastin e zhvillimit të seancës së vleftësimit të arrestit/ndalimit (neni 259/1), seancën paraprake (neni 332/b, pika 1), gjykimin në themel, gjykimin me marrëveshje, gjykimet në fazën e ekzekutimit. Këtu duhet evidentuar një dallim: KPP sanksionon me pavlefshmëri absolute kur nuk respektohen dispozitat për pjesëmarrjen e mbrojtësit, vetëm kur prania e tij është e detyrueshme, ndërsa lidhur me prokurorin kur cënohet

pjesëmarrja e tij në procedim. [..]

Prokurori është subjekti i vetëm që Kushtetuta dhe ligji procedural penal i njeh pushtetin për të ushtruar ndjekjen penale. [..]Në këtë vështrim nocioni “ushtrim i ndjekjes penale” materializohet në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq të paraqitur nga prokurori në përfundim të hetimeve paraprake. Praktika gjyqësore shqiptare lidhur me rastet kur është cënuar e drejta e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale, ka cilësuar si të tilla për shembull kur gjykata nuk ka ndryshuar cilësimin ligjor, por ka ngritur akuzë të re², kur gjykata prish vendimin për shkak të mosmarrjes nën hetim të një personi tjetër³, kur hetimet në ngarkim të njërit prej të pandehurve kanë vijuar pa u shfuqizuar paraprakisht vendimi i pushimit të çështjes në ngarkim të tij dhe personi deklarohet fajtor⁴ etj. [..]

Në arritjen e këtij përfundimi mbahet në konsideratë nga ana tjetër edhe fakti i rëndësishëm që ky gjykim (në apel) vihet në lëvizje jo kryesisht (sikurse ndodh në gjykimin në shkallë të parë - neni 246/6), por vetëm me iniciativën e palëve (nëpërmjet paraqitjes së ankimit), duke i mbetur kësisoj zgjedhja atyre (palëve) nëse duan apo jo të marrin pjesë në gjykim. Përmbushja e detyrimit për thirrjen dhe dëgjimin e palëve gjatë gjyimit në shkallë të parë, si dhe njoftimi i palëve për datën e seancës në gjykimin në apel, duke u dhënë mundësinë për tu paraqitur dhe për tu dëgjuar, garanton standardet e vendosura nga KEDNJ, në kuadër të respektimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Fakti që palët zgjedhin të mos paraqiten në procedurën e apelit, gjykim që inicohet dhe kufizohet nga ankimi (brenda shkaqeve të tij), nuk justifikon zvarritjen e gjyimit dhe për pasojë mosparaqitja e palëve nuk e pengon shqyrtimin e ankimit për vendimin e masës së sigurimit personal nga ana e gjykatës së apelit, brenda afateve të arsyeshme. Kusht *sine qua non*, në këtë rast është që ato (palët) të njoftohen rregullisht për seancën (neni 249/4), si dhe në eventualitet për çdo memorie/akt/apel kundërshtues apo qëndrim që sjell elemente të reja në proces, me qëllim respektimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në gjykim. Nga ana tjetër, fakti që zhvillimi i seancës në apel pa pjesëmarrjen e prokurorit nuk sanksionohet me pavlefshmëri absolute, nuk do të thotë që prokurori duhet të jetë indiferent.

2 Shih vendimin nr.00-2011-1106, datë 27.12.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

3 Shih vendimin nr. 00-2012-1333 (251), datë 03.10.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Kolegji ritheksoi jurisprudencën e mëparshme, se është e drejtë e prokurorit të formulojë akuzë dhe të ushtrojë ndjekjen, ndaj mosveprimi i tij nuk përbën shkak për pavlefshmëri absolute.

4 Shih vendimin nr.282, datë 15.03.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Mundësia që gjykata e apelit, sipas pikës 6 të nenit 249 të KPP të vendosë sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, sigurisht që evidenton rëndësinë që ka pjesëmarrja e prokurorit edhe në gjykimin në apel, sepse vendimi mund të bazohet mbi argumente shtesë ose të tjera nga ato që palët kanë dhënë fillimisht. Prandaj mungesa e një sanksioni procedural lidhur me mosparaqitjen e prokurorit në apel, duhet të kuptohet në sensin logjik se akuzuesi, duke mbajtur detyrimin e barrës së provës, është i lirë të bëjë zgjedhjet e tij të përgjegjshme në lidhje me pjesëmarrjen në procedim, duke qenë i detyruar që të përmbushë jo vetëm të drejtën që lidhet me ushtrimin e ndjekjes penale por edhe detyrimin që funksionin e tij në ushtrimin e ndjekjes penale ta ushtrojë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke dhënë motive konkrete që justifikojnë vazhdimin e kufizimit të lirisë së individit (nevojat e sigurimit) si pasojë e masës së arrestit të kërkuar prej vetë atij (prokurorisë).

Përsa më lart, duke qenë se zgjedhja e ligjvënësit ka qenë që rregullat e parashikuara në nenin 249 të KPP të zbatohen edhe në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP, gjykata e apelit ka detyrimin të garantojë pjesëmarrjen e prokurorit edhe në këtë gjykim nëpërmjet njoftimit të tij të rregullt paraprak për datën e seancës. Mandej, pjesëmarrja e prokurorit në seancën gjyqësore që zhvillohet në apel, si organ që ka barrën e akuzës dhe motivimit për rastin konkret të nevojave të sigurimit për vijueshmërinë e zbatimit të arrestit (të kërkuar prej tij), është zgjedhja e tij e lirë, përkundrajt të cilës nuk mund të veprojë sanksioni procedural i pavlefshmërisë absolute të aktit (vendimit të gjykatës). Nocioni i pjesëmarrjes së prokurorit në seancën në apel dhe pavlefshmëria që buron prej saj lidhet drejtpërsëdrejti me detyrimin e njoftimit të tij (shih nenin 249/4 të KPP), në mënyrë që të ketë mundësinë reale të ushtrojë funksionet, por jo edhe me rastet kur ai nuk dëshiron të përfitojë nga kjo mundësi. Parashikimi në nenin 246/6 të KPP se gjykata merr vendim pasi dëgjon palët, në raport me gjykimin që zhvillohet në shkallë të dytë, lidhet posaçërisht me detyrimin e saj (gjykatës së apelit) për t'i njoftuar palët rregullisht, me qëllim që procedura të jetë me ballafaqim dhe të garantojë në të gjitha rastet “barazinë e armëve” midis palëve edhe në këtë shkallë të gjykimit, por jo me “paralizimin” e procesit të rishikimit, kur palët me vullnetin e tyre të lirë zgjedhin të mos paraqiten në seancë. [...]

Pavarësisht logjikës së argumentit të Prokurorisë së Posaçme dhe Prokurorisë së Përgjithshme se për rastet kur zgjedhja ka qenë për të zhvilluar seancën pa pjesëmarrjen e palëve ligjvënësi e ka parashikuar

shprehimisht sikurse në nenin 261/3 të KPP, duhet thënë nga ana tjetër se qëllimi i ligjvënësit në vendosjen e detyrimit për të dëgjuar palët sipas nenit 246/6 të KPP merr vlerë në gjykimin në shkallë të parë (referuar specifikës së gjykimit në shkallë të parë), por nuk mund të shërbejë si shkak që të legjitimojë situatat “absurde” të ndodhura në praktikë, ku palët nuk paraqiten në gjykimin në apel të iniciuar mbi vullnetin e tyre, duke shkaktuar kështu zvarritje të gjykimit. Qëllimi i kësaj dispozite ka qenë garantimi i mundësisë së palëve për tu dëgjuar para se gjykata të marrë vendim për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit dhe jo zvarritja e gjykimit në apel, në rastet kur palët nuk dëshirojnë të përfitojnë nga e drejta për t’u dëgjuar në gjykimin rishikues. [..]

Gjykimi (në apel) vihet në lëvizje jo kryesisht, por vetëm me iniciativën e palëve (nëpërmjet paraqitjes së mjetit të ankimit), duke i mbetur kështu zgjedhja atyre nëse duan apo jo të marrin pjesë në gjykim. Fakti që palët zgjedhin të mos paraqiten në gjykimin e apelit, gjykim që inicohet dhe kufizohet nga ankimi (brenda shkaqeve të tij), nuk justifikon zvarritjen e gjykimit dhe për pasojë mosparaqitja e palëve nuk pengon shqyrtimin e ankimit nga ana e gjykatës së apelit brenda afateve të arsyeshme. Kusht *sine qua non*, sikurse u theksua edhe më lart, është që ato (palët) të njoftohen rregullisht për seancën në apel (neni 249/4), si dhe në eventualitet për çdo memorie/akt/apel kundërshtues apo qëndrim që sjell elemente të reja në proces, me qëllim respektimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në gjykim.

Mbi natyrën e gjykimit në apel, Kolegji Penal në vendimin njësuës 00-2024-2162(275) ka mbajtur këtë qëndrim: [..]Në përfundim të arsyetimit më lart, në lidhje me çështjen e shtruar për njësim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mban këtë qëndrim njësuës:

Pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të Kodit të Procedurës Penale, gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore në shkallën e parë, është e detyrueshme.

Mungesa e prokurorit gjatë shqyrtimit të ankimit në apel, kur është njoftuar dhe nuk ka paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen, nuk e pengon gjykatën e apelit që të vijojë me shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar mbi verifikimin e nevojave të sigurimit dhe kërkesën për zëvendësim apo revokim të masës së sigurimit.

iii. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete:

Për zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegji bazohet në qëndrimin njëses të konkluduar më lart se pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP, gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore në shkallën e parë është e detyrueshme dhe mungesa e prokurorit gjatë shqyrtimit të ankimit në apel, kur është njoftuar dhe nuk ka paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen, nuk e pengon gjykatën e apelit që të vijojë me shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar mbi verifikimin e nevojave të sigurimit, dhe kërkesën për zëvendësim apo revokim të masës së sigurimit.

[..]Nga ana tjetër, rekursuesi nuk argumenton se prania e prokurorit ka qenë e domosdoshme në këtë proces, pasi pretendimet në thelb mbështeten tek mungesa e arsytimit nga ana e gjykatave dhe jo në mungesë të paraqitjes së informacionit me shkrim apo akteve të fashikullit nga ana e prokurorit. [..] Ndërkohë, vlerësimi i nevojave të sigurimit është i arsytuar nga të dyja gjykatat dhe pretendimet e parashtruara në rekurs janë të njëjtat shkaqe të parashtruar në ankim, të cilat kanë marrë përgjigje të argumentuar në vendimmarrjen objekt rekursi. [..]Përsa më lart, duke qenë se pretendimet e ngritura nga mbrojtja e personit nën hetim rezultuan të pabazuara, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “e” të KPP, Kolegji vlerëson se vendimmarrja objekt rekursi duhet të lihet në fuqi.

Mendim pakice

Unë gjyqtari në pakicë **Medi BICI** jam kundër vendimit njesues nr. [..] të Kolegjit Penal [..] Në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, pakica është e mendimit se pjesëmarrja e prokurorit në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit është e detyrueshme, prandaj Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të pranonte rekursin e prokurorit dhe të vendoste prishjen e vendimit nr [..] dhe t’a dërgonte çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues në mënyrë që gjykimi të zhvillohej me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit.

Gjykata e apelit, ashtu si dhe gjykata e shkallës së parë është një gjykatë fakti. Kontrolli që u bën ajo vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, që vijnë me ankim përpara saj, e bëjnë atë një gjykatë ligji. Por në gjykatën e apelit, mund të lindi nevoja e debatimit të çështjes dhe provave, ose të përsëritet pjesërisht ose tërësisht shqyrtimi gjyqësor i çështjes, gjë e cila e bën gjykatën e apelit një gjykatë fakti. Në rastin në shqyrtim pjesëmarrës në gjykimin në apel ka qenë vetëm përfaqësuesi ligjor i kërkuarit dhe kjo gjykatë është mjaftuar me njoftimin e prokurorit, në një kohë që ajo ka

qenë e detyruar të shtynte seancën gjyqësore dhe të siguronte pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit në gjykimin e çështjes në apel. [..]

KPP me ndryshimet që ka pësuar në vitin 2017 ka parashikuar në mënyrë të shprehur parimin e dëgjimit të palëve nga gjykata nëpërmjet zhvillimit të seancës gjyqësore, pra, përpara se gjykata të marrë një vendim në lidhje me këtë çështje. Ky detyrim, para ndryshimeve të bëra në KPP, rregullohej me anë të vendimit unifikues nr. 1, datë 08.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, [..]. Parashikimi në nenin 246/6 të KPP i zbatimit në këto gjykime i rregullave të përcaktuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi ka shtuar garancitë për personin e arrestuar për një proces të rregullt ligjor, që lidhet me të drejtën për t'u njohur me aktet, me të drejtën për t'u dëgjuar dhe në veçanti me gjykimin brenda një afatit të arsyeshëm, si dhe me të drejtën e ankimit.

Në të tilla raste, gjykata kompetente duhet të shqyrtojë me shpejtësi çështjen në seancë gjyqësore, duke dëgjuar prokurorin dhe pretendimet përkatëse të personit ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit personal ose mbrojtësin e tij. [..] Respektimi i garancive në lidhje me parimin e dëgjimit të palëve lidhet jo vetëm me të drejtën e pjesëmarrjes së mbrojtësit dhe të drejtën për tu njohur me aktet, por edhe me të drejtën e një procesi të rregullt ligjor, garanci që parashikohen në nenin 28/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 5/4 dhe 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu ky parim lidhet ngushtë edhe me të drejtën e prokurorit për të ushtruar ndjekjen penale dhe për të marrë pjesë në procedimin penal. Ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i personit të akuzuar për kryerjen e një veprë penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Elementë të këtij procesi janë: caktimi i masave të sigurimit, njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit, këqyrja dhe kontrolli i personit ose i banesës, sekuestrime, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe mbledhja e provave të tjera.

Edhe përsa i përket ligjshmërisë së caktimit dhe vijimit të zbatimit të masës së sigurimit personal dhe në veçanti arrestit në burg, kujdesi dhe përpjekjet e duhura nga ana e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale në një çështje konkrete, është një element dhe aspekt thelbësor i vlerësimit të ekzistencës ose jo të procesit të rregullt ligjor. [..]

Përderisa ligjvënësi ka parashikuar detyrimin e gjykatës për të vendosur pasi të dëgjojë palët, e bën pjesëmarrjen e prokurorit në gjyq të detyrueshme. Gjykata detyrohet të dëgjojë prokurorin jo vetëm mbi mënyrën se si ai e ka

ushtruar ndjekjen penale, në drejtim të përgjegjshmërisë që ai ka treguar në kohëzgjatjen e hetimit, të veprimeve hetimore të kryera, të saktësisë të tyre, të marrë parasysh edhe kompleksitetin dhe karakteristikat e veçanta të çështjes dhe në verifikim të pretendimeve të individit, por edhe në drejtim të qëndrimit të tij mbi rrethanat që lidhen me ekzistencën ose jo të interesit publik real që justifikon vazhdimin e zbatimit të kësaj mase sigurimi. [...]

Pakica vë në dukje se, i vetmi rast kur ligji ynë procedural penal njeh gjykimin e një çështje penale pa praninë e prokurorit në gjykatën e apelit është rasti i nenit 427/a i KPP, i cili rregullon gjykimin në dhomë këshillimi, [...] Në këtë rast, ligjvënësi ka shprehur vullnetin e tij që asnjëra prej palëve të mos dëgjohet nga gjykata e apelit, përpara se ajo të marrë vendimin, i cili bazohet vetëm në aktet që ndodhen në dosje. [...]



**15.Vendim nr. 00-2025-883,
datë 29.05.2025 (zëvendësim i masës
së sigurimit personal: gjykatë
kompetente e fazës ku ndodhen aktet
në momentin e paraqitjes së kërkesës)**

Maksima: *Një kërkesë që në përmbajtje apo natyrë i përket fazës së hetimeve paraprake, siç mund të jetë edhe zëvendësimi i masës së sigurimit personal, do të shqyrtohet nga gjyqtari i hetimeve paraprake vetëm nëse procesi penal në atë shkallë gjykimi ndodhet ende në këtë fazë. Nëse një kërkesë e tillë paraqitet ndërkohë që çështja në atë shkallë gjykimi ka kaluar në një fazë tjetër, siç është seanca paraprake apo gjykimi në themel, atëherë ajo do të shqyrtohet nga gjykata kompetente e asaj faze ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së kërkesës.*

Fjalë kyçe: *moskompetencë lëndore/funksionale, zëvendësim mase sigurimi, faza e hetimeve paraprake*

Decision No. 00-2025-883, dated 29.05.2025 (replacement of personal security measure: the court competent to deal with the proceedings at the stage at which the case file is pending at the time the request is submitted)

Legal principle(s): *An application which, by its substance or legal nature, pertains to the preliminary investigation stage, including an application for the substitution of a personal security measure, shall*

be examined by the Judge of the Preliminary Investigations only where the criminal proceedings before that level of jurisdiction remain at that procedural stage. Where such an application is submitted after the proceedings have progressed to a subsequent procedural stage—such as the preliminary hearing or the trial on the merits—it shall be examined by the court having jurisdiction over the procedural stage in which the case file is pending at the time the application is lodged.

Keywords: *subject matter/functional jurisdiction, replacement of security measure, preliminary investigation stage*

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat me urdhrin datë [...], ka regjistruar procedimin penal nr[...] për veprën penale “Keqtrajtimi i të miturit”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 124/b/2 dhe 25 i KP [...] regjistruar mbi bazën e materialit kallëzues nr. [...] nga Komisariati i Policisë Kuçovë.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, me vendimin nr. [...] ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë [...]. Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit për personat nën hetim A.K dhe N.R. Caktimin si masë sigurimi ndaj personave nën hetim atë të “Arrest në burg” [...].”. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr[...] ka vendosur: “Miratimin e vendimit [...]”. I njëjti trup gjykues në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (me gjyqtar F. I) ka shqyrtuar dhe disa ankime të tjera gjatë fazës së hetimeve paraprake për këtë çështje dhe konkretisht;

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari F. I, me vendimin nr. [...] ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. [...], lidhur me konfirmimin e ligjshmërisë së masës së sigurimit me titull “Arrest në burg” ndaj kërkuesve A.K dhe N.R”.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari F. I, me vendimin nr. [...] ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. [...] lidhur me disponimin për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest me burg” të të pandehurës N.R [...] duke urdhëruar qëndrimin në shtëpi [...]

Në fazën përfundimtare të gjykimit të kësaj çështje në themel, i pandehuri A.K ka paraqitur [...] kërkesën penale: “Zëvendësimi i masës së sigurimit personal “arrest në burg”, [...] Gjykata e Shkallës [...] ka vendosur: “1. Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova. [...]”.

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (gjyqtari F. I), me vendimin nr. [...] ka vendosur: “Moskompetencën lëndore/funksionale

për shqyrtimin e kësaj çështje dhe dërgimin e akteve për shqyrtim trupës gjykuese kompetente të caktuar me short elektronik në përputhje me [...] të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Apelit [...]”.[...]

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (gjyqtare A.K), me vendimin nr. [...] ka vendosur: “1. Parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore/funksionale, të gjykatës me trupë gjykuese me relatore gjyqtare A. K, për shqyrtimin e çështjes penale me nr[...] pranë Gjykatës së Lartë [...]”.[..]

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] konstatohet ekzistenca e konfliktit për kompetencë, pasi dy gjyqtarë të të njëjtës gjykatë (në apel) nuk pranojnë të gjykojnë kërkesën penale të kërkuarit A.K, me objekt: “Zëvendësimin e masës së sigurimit”. [...]

Lidhur me rastin objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se në mënyrë të përsëritur, gjyqtarë të të njëjtës gjykatë, në shkallë të parë apo në apel, parashtrojnë mosmarrëveshje për kompetencë lëndore/funksionale, kryesisht në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të palëve gjatë hetimit paraprak apo seancës paraprake. Në rastin konkret, gjyqtari F.I, pretendon se nuk është kompetent për shqyrtimin e kërkesës si gjyqtar i hetimit paraprak të çështjes, pasi kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit është shqyrtuar nga gjykata që po shqyrton çështjen në themel në shkallë të parë. Nga ana tjetër, gjyqtarja A.K, pretendon se kompetent për shqyrtimin e kërkesës është gjyqtari i hetimit paraprak, duke argumentuar se çështja e themelit nuk është regjistruar akoma pranë gjykatës së apelit.

Sipas gjyqtarit F. I, çështja e regjistruar në këtë gjykatë, nuk rezulton të jetë shortuar në zbatim të vendimit nr. [...] të Zëvendëskryetares së Gjykatës, por kjo çështje rezulton se i ka kaluar për shqyrtim, pasi Zëvendëskryetarja e gjykatës në vijim të vendimit nr. [...] (me te cilën ka pranuar kërkesën për heqje dorë të gjyqtares I. K në çështjen me bashkëtepandehur N.R), ka urdhëruar të kalojë çështja tek gjyqtari F. I për shkak se ka gjykuar masën e sigurimit, si gjyqtar i hetimeve paraprake.

Në parim, Kolegji vlerëson se disponimi i Zëvendëskryetares për pranimin e kërkesës së gjyqtares I.K. për heqje dorë (në raport me rastin e të bashkëpandehurës), nuk është e bazuar në ligjin procedural penal (referuar neneve 15, 16 e 17 të KPP), pasi nuk verifikohet asnjë shkak papajftueshmërie e kësaj gjyqtareje për pjesëmarrjen në procedim. Kolegji vlerëson të theksojë se faza e seancës paraprake synon verifikimin e plotësisë së hetimeve dhe mjaftueshmërisë së provave në mbështetje të akuzës, që do të thotë se disponimet që lidhen me këtë fazë të procedimit penal janë të parashikuara shprehimisht në ligj (nenet 329, 329/b dhe 332/

dh të KPP), ndërkohë që kërkesat e palëve në lidhje me masat e sigurimit nuk janë disponime tipike të seancës paraprake. Kolegji tërheq vëmendjen e gjyqtarëve të apelit që në rastet e ushtrimit të ankimit në lidhje me kërkesat që nuk janë tipike të seancës paraprake (kërkesë për pushim çështje, kërkesë për dërgim në gjyq etj), siç është rasti konkret, gjyqtari i hetimit paraprak apo çdo gjyqtar që i kalon çështja sipas procedurës së shortit, nuk ka pengesë ligjore për vijimin e shqyrtimit të këtij ankimi. Por, pavarësisht këtij vlerësimi, Kolegji konstaton se ligjvënësi nuk ka parashikuar të drejtë ankimi ndaj këtij disponimi të zëvendëskryetares (ankimi është parashikuar shprehimisht vetëm në rastin e vendimit që shprehet mbi kërkesën e përjashtimit).

Për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, Kolegji vlerëson me rëndësi të theksojë edhe faktin se objekt shqyrtimi është kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, e lidhur me lirinë personale të individit. Ky konstatim nënkupton që kërkitime të tilla duhen verifikuar e shqyrtuar brenda afatit të përcaktuar në ligj, pa vonesa të pajustificuara ligjërisht. Nga të dhënat/rrethanat e parashtruara nga gjyqtarët pranë gjykatës së apelit, që kanë nxitur këtë mosmarrëveshje funksionale, rezulton se procedimi penal në kuadër të të cilit është paraqitur kjo kërkesë për zëvendësimin masës së sigurimit personal, ndodhet aktualisht në fazën e gjykimit në themel, në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë ka disponuar për rrëzimin e kërkesës së të pandehurit për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, e pikërisht ndaj këtij disponimi të gjykatës së shkallës së parë, i pandehuri ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit, në referim të nenit 249 të KPP.

Në rrethanat faktike dhe procedurale si më sipër, Kolegji vlerëson se për sa kohë që çështja, si gjykim “themeli”, nuk është regjistruar akoma në gjykatën e shkallës së dytë - (gjykatën e apelit), që do të thotë se nuk është konstituuar ende gjykata e apelit/trupi gjykues për shqyrtimin e kësaj çështje në themel, trupi gjykues monokratik (F.I.) që ka gjykuar në shkallë të dytë të gjykimit kërkesat e palëve të paraqitura si gjatë fazës së hetimit paraprak ashtu edhe gjatë seancës paraprake, nuk ka asnjë pengesë për të gjykuar edhe ankimin/kërkesën objekt shqyrtimi, të paraqitur nga i pandehuri. Kolegji vlerëson se fazat (iter procesual) e procesit penal nuk fillojnë apo përfundojnë në të njëjtën kohë në të gjitha shkallët e gjykimit. Ndaj, në rastin konkret, faza e procesit që i takon gjykimit/themelit të çështjes, ndonëse ka filluar në gjykatën e shkallës së parë, nuk konsiderohet si e tillë në gjykatën e apelit, përderisa pranë kësaj të fundit akoma nuk është regjistruar çështja për gjykimin e themelit të saj. Konstituimi i gjykatës së apelit për gjykimin e themelit të çështjes

(gjykata e caktuar me ligj), pasohet/ndodh pas regjistrimit të çështjes për gjykim në themel pranë kësaj gjykate, si rezultat i paraqitjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

Shqyrtimi i kërkesave ose ankesave që lidhen me masat e sigurimit, siç është në rastin në shqyrtim, nuk cenon paanësinë e gjykatës ku ndodhen aktet, për të verifikuar pretendimet e palëve mbi caktimin, zëvendësimin, revokimin apo heqjen e këtyre masave. Kufizimi ligjor që i ndalon gjyqtarët të shqyrtojnë kërkesat e palëve në faza të ndryshme nga ajo në të cilën ndodhet procesi penal (neni 15 i KPP), lidhet drejtpërdrejt me fazën procedurale në të cilën ndodhet procesi në atë shkallë gjykimi, në të cilën paraqitet kërkesa, si dhe me kompetencën funksionale të gjyqtarit. Thënë ndryshe, një kërkesë që në përmbajtje apo natyrë i përket fazës së hetimeve paraprake siç mund të jetë edhe zëvendësimi i masës së sigurimit personal, do të shqyrtohet nga gjyqtari i hetimeve paraprake vetëm nëse procesi penal në atë shkallë gjykimi ndodhet ende në këtë fazë. Nëse një kërkesë e tillë paraqitet ndërkohë që çështja në atë shkallë gjykimi ka kaluar në një fazë tjetër, siç është seanca paraprake apo gjykim në themel, atëherë ajo do të shqyrtohet nga gjykata kompetente e asaj faze ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së kërkesës (shih vendimin unifikues 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që në vlerësim të Kolegjit gjen zbatim edhe aktualisht, pasi dispozitat në lidhje me masat e sigurimit, nuk kanë pësuar ndryshimet thelbësore me me ligjet nr. 35/2017 dhe nr. 41/2021).

Në kushtet kur nuk ka filluar faza e gjykimit të çështjes në themel në Gjykatën e Apelit, gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve, të cilat i përkasin hetimeve paraprake, nuk ka asnjë pengesë apo papajtueshmëri, të vijoje gjykimin e kërkesave të kësaj natyre të paraqitura pranë kësaj gjykate, derisa të konstituohet gjykata e apelit (trupi gjykues) që do të shqyrtojë çështjen në themel nga e cila derivojnë këto kërkesa të kësaj natyre. Gjithsesi, Kolegji vlerëson të theksojë se në momentin kur faza e hetimit paraprak ka kaluar në shkallë të parë, pra çështja është në seancë paraprake ose në themel, nuk do të thotë që kërkesa të kësaj natyre (si rasti konkret) të kalojnë drejtpërdrejtë tek gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e fazës së hetimit në apel (sipas nenit 249 të KPP), por mund të jetë edhe një gjyqtar tjetër i përcaktuar sipas procedurave të ndarjes së çështjeve të kësaj natyre, referuar shkronjës “b”, të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016 [...] (pra sipas urdhrit të zëvendëskryetares në rastin konkret, për përcaktimin e listës së gatishmërisë së gjyqtarëve).



**16.Vendim i Kolegjeve të Bashkuara
00-2026-736 (80), datë 09.04.2026
(arsyetimi i masës së sigurimit “arrest
me burg” nga prokuroria dhe gjykata)**

Sentenca unifikuese: Qëndrimi i mbajtur në vendimin nr.7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa e sigurimit “arrest në burg”, gjykata nuk ka detyrimin të analizojë realisht masat alternative dhe mjafton të arsyetojë se masa e zgjedhur është e përshtatshme për rastin konkret, nuk është në përputhje me nenet 228-230 dhe 245/1, shkronja “ç”, të KPP, si dhe me nenin 5 § 3 të KEDNJ-së. Në zbatim të neneve 228, 229, 230 dhe 245/1, shkronja “ç”, të KPP, gjykata ka detyrimin të shqyrtojë realisht masat e tjera më pak kufizuese të lirisë personale dhe të arsyetojë shprehimisht përse ato nuk janë të mjaftueshme në rastin konkret. Ky arsyetim duhet të jetë i shprehur, i individualizuar dhe i mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes, duke pasqyruar qartë rrezikun konkret, sipas nenit 228, pika 3, të KPP, si dhe domosdoshmërinë, përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e kufizimit të lirisë, në përputhje me standardet kushtetuese dhe konventore.

Caktimi i masës arrest në burg ka natyrë përjashtimore dhe mund të vendoset vetëm kur masat e tjera janë të papërshtatshme, në raport me kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 228 e 229 të KPP. Në caktimin e masës arrest në burg, prokurori fillimisht dhe gjykatat në vijim kanë detyrimin të japin një arsyetim të individualizuar, të mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes që lidh nevojën e kësaj mase me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit në rastin konkret. Ky vlerësim duhet të mbështetet në rrethanat specifike të faktit, në mënyrën e kryerjes së veprës dhe në të dhënat që lidhen me personin ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit, përfshirë personalitetin, sjelljen, rrethanat individuale e familjare, si dhe çdo tregues tjetër të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut real procedural ose shoqëror që ai paraqet në çështjen konkrete. Kur verifikohet rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e autorit, në kuptim të nenit 230, pika 1 të KPP, masa e sigurimit “arrest në burg” përlligjet si masa më e përshtatshme, që garanton nevojat e sigurimit. Rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e autorit nuk nxirret vetëm ose kryesisht nga natyra e krimit ose nga marzhi i dënimit, por nga vlerësimi i ndërthurur i rrezikshmërisë së veçantë të faktit penal, i mënyrës së

kryerjes, pasojave të ardhura, i personalitetit të të pandehurit, i sjelljes së tij, si dhe i rrethanave të tjera të rëndësishme dhe të lidhura ndërmjet tyre për rastin konkret.

Në interpretim të neneve 228, 229 dhe 230 të KPP, në lidhje me nenin 5 § 3 të KEDNJ, barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg” i takon prokurorisë, ndërsa gjykata ka detyrimin ta verifikojë dhe ta arsyetojë atë në çdo fazë të procedimit. Prokuroria ka detyrimin të paraqesë dhe të argumentojë në mënyrë konkrete faktet dhe rrethanat që mbështesin nevojën e kësaj mase, përfshirë rrezikun konkret dhe papërshtatshmërinë e masave më pak kufizuese. Në vendimmarrjen e saj gjykata nuk mund të kushtëzohet nga paraqitja ose jo e “provave pozitive” nga i pandehuri. I pandehuri mban vetëm barrën e paraqitjes së rrethanave faktike personale, familjare, shëndetësore ose rrethanave të tjera, kur i ngre ato si argumente në favor të masave më pak kufizuese.

Fjalë kyçe: proporcionaliteti i kufizimit të lirisë, masat alternative, rrezikshmëria e veçantë e veprës, barra e justifikimit të nevojës, rrethana faktike personale, familjare, shëndetësore ose rrethana të tjera

Decision of the Joint Chambers 00-2026-736 (80), dated 09.04.2026 (reasoning of the security measure “prison detention” by the prosecution and the court)

Unifying sentence: The position adopted in unifying decision no. 7/2011 of the Joint Chamber’s of the Supreme Court, according to which, where the imposition of the security measure of “pre-trial detention” is sought or ordered, the court is under no obligation to conduct a genuine assessment of alternative security measures and it is sufficient merely to state that the chosen measure is appropriate in the circumstances of the case, is incompatible with Articles 228–230 and 245(1)(ç) of the Criminal Procedure Code, as well as with Article 5 § 3 of the European Convention on Human Rights. Pursuant to Articles 228, 229, 230 and 245(1)(ç) of the Criminal Procedure Code, the court is under a duty to genuinely examine less restrictive alternatives to deprivation of liberty and to provide express reasons explaining why such measures would be insufficient in the particular case. Such reasoning must be explicit, individualised and supported by the specific facts and circumstances of the case, clearly demonstrating the existence of the concrete risk referred to in Article 228(3) of the Criminal Procedure Code, as well as the necessity, appropriateness and proportionality of the restriction of lib-

erty, in accordance with constitutional and Convention standards. The imposition of pre-trial detention is an exceptional measure and may be ordered only where all other security measures are inadequate, having regard to the conditions and criteria laid down in Articles 228 and 229 of the Criminal Procedure Code. In seeking and subsequently ordering pre-trial detention, the prosecution, in the first instance, and the courts thereafter, are required to provide individualised reasoning, based on the specific facts and circumstances of the case, establishing the necessity of the measure by reference to the seriousness of both the offence and the offender in the particular circumstances. This assessment must be grounded in the specific circumstances of the offence, the manner in which it was committed, and information relating to the person against whom the security measure is sought, including his or her personality, conduct, personal and family circumstances, together with any other relevant indicators necessary for assessing the existence of a genuine procedural or societal risk in the particular case.

Where the particular dangerousness of the offence and of the offender, within the meaning of Article 230(1) of the Criminal Procedure Code, has been established, pre-trial detention is justified as the most appropriate measure capable of securing the purposes of the proceedings. Such particular dangerousness cannot be inferred solely, or predominantly, from the nature of the offence or the applicable sentencing range, but must result from an integrated assessment of the particular seriousness of the criminal conduct, the manner in which the offence was committed, the consequences caused, the personality and conduct of the defendant, together with all other relevant and interconnected circumstances of the particular case.

In interpreting Articles 228, 229 and 230 of the Criminal Procedure Code in conjunction with Article 5 § 3 of the European Convention on Human Rights, the burden of justifying both the imposition and the continued application of pre-trial detention rests with the prosecution, while the court is under a duty to verify and provide reasons for that justification at every stage of the proceedings. The prosecution must present and substantiate, with concrete arguments, the facts and circumstances supporting the necessity of the measure, including the existence of a specific risk and the inadequacy of less restrictive alternatives. In reaching its decision, the court may not make its assessment contingent upon the defendant producing “positive evidence”. The defendant bears only the burden of presenting

personal, family, health-related or other factual circumstances where these are relied upon as arguments in favour of the application of less restrictive security measures.

Keywords: *proportionality of the restriction of liberty, alternative security measures, particular dangerousness of the offence, burden of justifying the necessity of the measure, personal, family and health-related factual circumstances; other relevant circumstances.*

Rrethanat e çështjes:

[..] Gjatë kontrollit, në banesën dhe ambientet përreth [..] të shtetasit B.Z është gjetur dhe sekuestruar në total 7 (shtatë) kilogram e 350 (treqind e pesëdhjetë) gram lëndë e dyshuar e llojit *cannabis sativa*. Në këto rrethana [..] ai u arrestua në flagrancë [..] kryejën e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i KP.

Gjykata e Shkallës [..] Lezhë, me vendimin nr. [..], ka vendosur: “1. Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën [..]. Caktimin ndaj personit nën hetim të masës së sigurimit personal “arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i KPP”. [..]

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. [..] ka vendosur: “Miratimin e vendimit nr. [..] me këtë ndryshim: Caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit B.Z “arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i KPP [..]. [..]

Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara:

Kryetari i Gjykatës së Lartë, me vendimin e ndërmjetëm [..], në kuadër të rolit institucional të Gjykatës së Lartë për garantimin e një praktike gjyqësore të standardizuar, të konsoliduar dhe të qëndrueshme, si dhe në mbështetje të [..] nisi procedurën për ndryshimin e pjesshëm të praktikës gjyqësore të unifikuar me vendimin nr. 7, datë 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. [..] Në vendimin e ndërmjetëm të Kryetarit të Gjykatës së Lartë është evidentuar se “çështja konkrete nuk paraqet interes vetëm për zgjidhjen e rastit individual, por ngre edhe nevojën për të vlerësuar nëse praktika e konsoliduar nga vendimi unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, duhet të vijojë të mbahet në të njëjtin kuptim apo kërkon rishqyrtim të pjesshëm, si dhe nëse, krahas këtij rishqyrtimi, paraqitet nevoja për njësim ose zhvillim të mëtejshëm të praktikës gjyqësore në zbatimin e neneve 228-230 të KPP”. [..] rezulton se zgjidhja e rastit konkret lidhej drejtpërdrejt me disa formulime të praktikës së mëparshme unifikuese për masat e sigurimit personal, çka e bënte të nevojshëm vlerësimin nga Kolegjet e Bashkuara nëse këto formulime kërkonin

qartësim, saktësim ose zhvillim të mëtejshëm. [...] zbatimi i tij ka ngritur nevojën për të rivlerësuar disa formulime në raport me ndryshimet e mëvonshme ligjore dhe standardet e konsoliduara të GJEDNJ, veçanërisht lidhur me shqyrtimin real të masave alternative, vlerësimin konkret e të individualizuar të rrezikshmërisë së veprës dhe të personit, si dhe barrën e justifikimit të nevojës për caktimin ose vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

[...] Kryetari i Gjykatës së Lartë ka shtruar për zgjidhje këto çështje:

1. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a është në përputhje me këto dispozita dhe me nenin 5 § 3 të KEDNJ qëndrimi sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa “arrest në burg”, gjykata nuk ka detyrim të analizojë realisht masat alternative dhe mjafton të arsyetojë se masa e zgjedhur prej saj është e përshtatshme për rastin konkret?

2. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a mund të nxirret “rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e të pandehurit”, si kriter për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” vetëm ose kryesisht nga natyra e veprës penale, nga rëndësia e saj e përgjithshme ose nga marzhi i dënimit, pa një vlerësim konkret dhe të individualizuar të rrethanave të rastit dhe të personit?

3. Kujt i takon barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së “arrestit në burg” dhe a është në përputhje me nenin 5 § 3 të KEDNJ dhe me nenet 228-230 të KPP qëndrimi sipas të cilit papërshtatshmëria e kësaj mase mund të pranohet vetëm nëse i pandehuri paraqet prova pozitive?

Qëndrimi i palëve në proces në lidhje me fillimin e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqësore

[...]

i. Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Kolegjet e Bashkuara çmojnë të nevojshme të sqarojnë se [...], forca orientuese dhe detyruese e vendimit njësoj nuk buron nga mënyra e paraqitjes formale të disa paragrafëve, por nga përmbajtja e arsytimit që është e domosdoshme për të kuptuar rregullin e së drejtës të formuluar nga Kolegjet, kufijtë e zbatimit të tij dhe metodologjinë që gjykatat duhet të ndjekin.

Kjo mënyrë e leximit të vendimit gjyqësor si një i tërë gjen mbështetje edhe në jurisprudencën kushtetuese dhe konventore. [...] Kjo tregon se arsytimi nuk është element dytësor apo thjesht shpjegues, por pjesë përbërëse e vetë standardit të rregullsisë dhe kontrollueshmërisë së vendimit gjyqësor.

[..] Në rastin konkret, ky shqyrtim nuk drejtohet ndaj sentencave unifikuese të vendimit nr. 7/2011, të cilat mbeten të paprekura, por ndaj nevojës për qartësimin dhe saktësimin e atyre pjesëve të arsytimit që kanë evidentuar pasiguri në interpretim ose zbatime jo të njëtrajtshme në praktikë. Ky qartësim është i nevojshëm për të shmangur një lexim të pjesshëm të vendimit unifikues dhe për të garantuar zbatimin e tij në përputhje me kuadrin aktual ligjor dhe konventor.

[..]Në këtë fazë, Kolegjet theksojnë se rishqyrtimi i vendimit unifikues nr. 7/2011 nuk synon mohimin e vlerës së tij orientuese dhe as ndryshimin e sentencave unifikuese, por verifikimin nëse disa formulime të pjesës arsyetuese kërkojnë qartësim, saktësim, standardizim, ndryshim ose zhvillim të mëtejshëm, për shkak të hapësirës që mund të kenë krijuar për kuptime jo të njëtrajtshme në praktikë. Në këtë mënyrë, ky mekanizëm procedural shërben për të forcuar vijimësinë, koherencën dhe përshtatjen e praktikës gjyqësore me standardet aktuale ligjore e konventore.

Këto formulime lidhen, në thelb, me tre aspekte të caktimit dhe vijimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, shqyrtimin real të masave alternative, vlerësimin konkret e të individualizuar të rrezikshmërisë së veprës dhe të personit, si dhe barrën e justifikimit të nevojës për caktimin ose vijimin e kësaj mase. [...] Prandaj, nevoja për ndërhyrje në arsytimin e vendimit unifikues nr. 7/2011 buron nga detyrimi për ta harmonizuar zbatimin e neneve 228-230 të KPP me standardin aktual ligjor dhe konventor, i cili kërkon nga gjykatat një arsytim më konkret, më të individualizuar dhe më të verifikueshëm në çdo rast.

Në këtë kuptim, rishqyrtimi i pjesshëm i praktikës duhet kuptuar jo si shkëputje nga standardi i mëparshëm, por si mundësi për zhvillimin dhe përshtatjen e tij, për aq sa ai standard duhet të lexohet dhe të zbatohet në përputhje me kuadrin aktual ligjor dhe konventor. [...] Ky zhvillim mbetet i kufizuar vetëm në formulimet e pjesës arsyetuese të evidentuara më sipër dhe duhet lexuar në harmoni me sentencat njësuere ekzistuese. Ai nuk prek pjesën tjetër të arsytimit apo sentencat njësuere të vendimit unifikues nr. 7/2011, të cilat mbeten të pandikuara nga ky saktësim.

[..]

Në analizë të **çështjes së parë**, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se nga interpretimi sistematik dhe teleologjik i neneve 228, 229, 230, 244, pika 1 dhe 245, pika 1, shkronja “ç”, të KPP, rezulton se masa e sigurimit arrest në burg nuk përbën masë të zakonshme të sigurimit personal, por masën më të rëndë, e cila mund të vendoset vetëm kur, mbi bazën e një vlerësimi të shprehur, të individualizuar dhe të mbështetur në fakte dhe rrethana të

posaçme të çështjes, provohet se çdo masë tjetër është e papërshtatshme për përmbushjen e nevojave të sigurimit. Në këtë kuptim, kuadri ligjor për caktimin e masës së sigurimit personal kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të këtyre kushteve dhe kritereve: [...] Në vijim, formulimi i nenit 230 të KPP, sipas të cilit arresti në burg mund të caktohet vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme, nuk mund të kuptohet si një dispozitë thjesht deklarative, por si një detyrim konkret për gjykatën që të kryejë një vlerësim real, krahasues dhe të individualizuar të masave alternative, më pak kufizuese ndaj lirisë personale. Në mënyrë të veçantë, masa e sigurimit personal e “arrestit në burg”, konsiderohet, sipas përcaktimit të paragrafit të parë, të nenit 230 të KPP, si masa e fundit/ extrema/ultima ratio, e cila mund të vendoset vetëm kur, çdo lloj mase tjetër rezulton e papërshtatshme për të garantuar nevojat e sigurimit të procedimit penal. Këto nevoja siguri identifikohen në përcaktimet e pikës së tretë (të paktën njërit prej tyre) të nenit 228 të KPP, të cilat nuk mund të garantohen/plotësohen nga asnjë lloj mase tjetër e ndryshme nga kjo masë kufizuese e lirisë, “arresti në burg”.

Ky përfundim përforcohet edhe nga zhvillimet e mëvonshme ligjore. [...] Kjo zgjedhje ligjore nuk ka karakter formal, por pasqyron një orientim të qartë të ligjvënësit për të forcuar kontrollin gjyqësor mbi domosdoshmërinë e kufizimit të lirisë dhe për të shmangur arsyetimet stereotipe ose të përgjithshme.

Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky detyrim nuk duhet kuptuar si kërkesë për një trajtim nominal, të veçuar dhe mekanik të secilës masë alternative, në kuptimin që vlefshmëria e vendimit të varet nga ndarja formale e paragrafëve për “arrestin në shtëpi”, “detyrimin për paraqitje në policinë gjyqësore”, “garancinë pasurore” ose masa të tjera të sigurimit. Kuptimi i drejtë i nenit 245, pika 1, shkronja “ç” të KPP është se ai kërkon arsyetimin e papërshtatshmërisë së masave të tjera në substancë. Ky arsyetim duhet të bëjë të kontrollueshëm faktin se gjykata i ka marrë realisht në shqyrtim alternativat dhe i ka përjashtuar ato mbi bazën e rrethanave konkrete të çështjes. Në këtë kuptim, neni 245, pika 1, shkronja “ç” i KPP kërkon përmbajtje reale të arsyetimit dhe jo ndërtimin mekanik të paragrafëve të veçantë për secilën masë alternative. [...]

I njëjti përfundim del edhe nga jurisprudenca e konsoliduar e GJEDNJ e cila ka vendosur një standard të qartë dhe të konsoliduar mbi detyrimin e gjykatave vendase për të shqyrtuar realisht masat alternative ndaj paraburgimit. [...]

Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se formulimi i vendimit unifikues nr. 7/2011, sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa e

sigurimit arrest në burg, “... gjykata nuk ka detyrim që të analizojë përse llojet e tjera të masave të sigurimit nuk janë të përshtatshme, mjafton që të argumentojë se masa e caktuar prej saj në rastin konkret ndaj të gjykuarit është masa e përshtatshme ...”, ka nevojë për qartësim, saktësim, standardizim, ndryshim dhe zhvillim të mëtejshëm, pasi ky arsyetim lë të kuptohet se shqyrtimi i masave alternative ndaj arrestit në burg nuk përbën një element të detyrueshëm dhe thelbësor të arsytimit të vendimit, por një mundësi me karakter fakultativ për gjykatën. Për rrjedhojë, kur gjykata arsyeton në mënyrë të shprehur, konkrete dhe të individualizuar kushtet dhe kriteret e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg sipas neneve 228 e 229 të KPP; “rrezikshmërinë e veçantë të veprës dhe të pandehurit”, sipas nenit 230 të KPP, duke e lidhur atë me faktet dhe rrethanat e posaçme të rastit, ky arsyetim mund të përfshijë në vetvete, në mënyrë të integruar dhe funksionale, edhe përfundimin se masat e tjera më të lehta nuk janë të përshtatshme. Në këtë kuptim, neni 245, pika 1, shkronja “ç” i KPP kërkon përmbajtje reale të arsytimit dhe jo ndërtimin mekanik të paragrafëve të veçantë për secilën masë alternative. Vetëm kur “rrezikshmëria e veçantë” konstatohet në mënyrë të përgjithshme, përmes formulimeve standarde dhe pa një lidhje të qartë e të kuptueshme me papërshtatshmërinë e masave të tjera të sigurimit, arsytimi konsiderohet në kundërshtim me këtë dispozitë, duke sjellë si pasojë pavlefshmërinë e vendimit, si sanksion të drejtpërdrejtë të mosrespektimit të këtij detyrimi arsytimi (neni 245, pika 1 KPP).

Ndryshimet e bëra në KPP me ligjin nr. 35/2017 e kanë përforcuar këtë detyrim duke e shndërruar arsytimin e papërshtatshmërisë së masave alternative (referuar pretendimeve të të hetuarit në raport me masën e sigurimit të kërkuar nga prokurori), nga një element dytësor në një kusht vlefshmërie të vetë vendimit, duke parashikuar pavlefshmërinë si pasojë të mosrespektimit të tij (neni 245, pika 1 e KPP). [..]

Nga ana tjetër, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se ky qartësim dhe saktësim i arsytimit të vendimit unifikues nr.7/2011 nuk duhet kuptuar si orientim drejt një praktike të re me arsytime skematike ose formulime standarde pa përmbajtje reale për secilën masë alternative sigurimi. Kërkesa e ligjit është që, nga përmbajtja e vendimit të arsyetuar, të rezultojë qartë dhe mbi bazën e elementeve konkrete të çështjes pse masa e arrestit në burg paraqitet si masa e vetme e përshtatshme dhe pse masat e tjera më pak kufizuese të lirisë nuk garantojnë në mënyrë efektive nevojat e sigurimit. [...] Për këtë arsye, arsytimi për masat alternative të sigurimit, (të masave paraburgosëse të sigurimit), në raport me nevojat e sigurimit duhet të jetë i shprehur, i individualizuar dhe i mbështetur në fakte e

rrethana të posaçme të çështjes, duke pasqyruar qartë rrezikun konkret, sipas nenit 228, pika 3, të KPP, si dhe domosdoshmërinë, përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e kufizimit të lirisë nëpërmjet aplikimit të masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”. Vetëm një argumentim i tillë në zbatim të kërkesave të neneve 228, 229, 230/1, 245, pika 1, shkronja “ç” të KPP dhe të paragrafit të parë, shkronja “c” dhe paragrafit të tretë të KEDNJ-së, përmbush detyrimin e vlerësimit dhe arsyetimit në substancë, si në lidhje me caktimin e masës së sigurimit ashtu edhe në raport me kohëzgjatjen e paraburgimit. Në këtë kuptim, detyrimi i gjykatës për të shqyrtuar masat alternative nuk kërkon katalogim ose renditje formale të secilës prej tyre, por përmbushet kur nga arsyetimi i vendimit rezulton në mënyrë të qartë dhe të kontrollueshme se, në rrethanat konkrete të çështjes, asnjë masë më pak kufizuese nuk është e aftë të garantojë nevojat e sigurimit. Për rrjedhojë, shqyrtimi dhe analiza e masave alternative nuk përbëjnë një element fakultativ të arsyetimit, por pjesë të domosdoshme të vlerësimit që gjykata duhet të kryejë përpara caktimit ose vijimit të masës së sigurimit “arrest në burg”.

[..]

Në analizë të **çështjes së dytë**, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se shprehja “rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e të pandehurit”, e parashikuar në nenin 230 të KPP, nuk synon të anashkalojë dhe/apo përjashtojë në të njëjtën kohë, kushtet e caktimit dhe kriteret e përzgjedhjes së masave të sigurimit personal të përcaktuara në nenet 228 dhe 229 të KPP, përfshirë pa dallim dhe masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues të “arrestit në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP. Ky formulim ligjor, përmes lidhëzës “dhe” vendos detyrimin për një analizë të dyfishtë kumulative, i cili nuk mund të kufizohet në elementet abstrakte të figurës së veprës, por kërkon domosdoshmërisht ndërthurjen e elementeve të faktit penal (veprës penale) me rrethanat personale që karakterizojnë personin ndaj të cilit caktohet masa e sigurimit. Në këtë kuptim, neni 228 i KPP vendos standardin e ekzistencës së një rreziku real dhe të individualizuar, ndërsa neni 229 përcakton kriteret e proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë së masës, duke kërkuar që kufizimi i lirisë të jetë i domosdoshëm në raport me nevojat e procedimit penal. [..]

Këto kushte dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, përfshirë dhe masën e “arrestit në burg” imponojnë, në cilësinë e kushtit të përgjithshëm të aplikueshëm/të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 228 të KPP, verifikimin në radhë të parë të ekzistencës së “dysimit të arsyeshëm të bazuar në prova” në ngarkim të personit ndaj të cilit kërkohet

të aplikohet masa, për kryerjen e një vepre penale”. Ky kusht, kur konkurron edhe me elemente të tjerë të identifikuar në: inekzistencën e shkaqeve të padënueshmërisë, shuarjes së veprës penale ose dënimit, përcaktimi i paragrafit të dytë, të nenit 228 të KPP; prezencën e njëres prej nevojave të sigurimit të procedimit, të parashikuara në paragrafin e tretë, të nenit 228 të KPP; kriteret e përshtatshmërisë dhe të proporcionalitetit të parashikuara në paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 229 të KPP; legjitimon gjykatën/gjyqtarin e hetimeve paraprake për caktimin, mbi kërkesën e prokurorit të masës së sigurimit personal të karakterit shtrëngues. Pra, duke i'u referuar përmbajtjes së dispozitave të sipërcituara, qartazi evidentohet se, ndërsa përmbajtja e paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 228 të KPP tolerojnë një vlerësim paraprak të eventualitetit të prezencës së kushteve ligjore që mundësojnë caktimin e një mase sigurimi personal, paragrafi i tretë i kësaj dispozite, që përbën edhe elementin qendror të sistemit të caktimit të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues të parashikuara në KPP lidhet me nevojat e sigurimit të parashikuara në atë paragraf, të cilat lejojnë verifikimin nëse kjo e fundit (masa e sigurimit) duhet të aplikohet. [..]

Konkretisht, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP, që identifikon nevojën e sigurimit të procedimit prej “shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës”, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se në funksion të verifikimit të kësaj nevoje sigurimi në cilësinë e kushtit të domosdoshëm për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues, kumulativisht me kushtet e parashikuara në dy paragrafët e parë, të nenit 228 të KPP, gjykatat duhet të argumentojnë shkaqet e rëndësishme konkrete që i hetuari/personi ndaj të cilit kërkohet të caktohet masa, pengon marrjen ose vërtetësinë/gjenuinitetin e provës dhe në të njëjtën kohë, domosdoshmërinë dhe përshtatshmërinë e masës së caktuar në funksion të eliminimit të këtij rreziku.

Sakaq, sipas përcaktimit të shkronjës “b”, të paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP në cilësinë e nevojës së sigurimit të procedimit, evidentohet edhe eventualiteti i “largimit të të pandehurit/të hetuarit apo ekzistenca e rrezikut që ai mund të largohet”. Përsa i përket elementeve mbi të cilët duhet të bazohet gjykata/gjyqtari për hetimet paraprake në funksion të caktimit të masës së sigurimit personal për të identifikuar “rrezikun e largimit”, Kolegjet e Bashkuara konsiderojnë se duhet të nxirren nga elementë objektivë dhe konkret, të tilla si: mënyra e jetesës së subjektit, precedentët penale, procedime të tjera në ndjekje të regjistruara ndaj tij. Në këtë aspekt mund të konsiderohen të vlefshme në funksion të evidentimit

të rrezikut të largimit edhe nga ekzaminimi i disa elementeve të faktit të lidhura midis tyre të tilla si: disponibiliteti prej të hetuarit i mjeteve për organizimin e arratisjes, burimeve ekonomike lehtësisht të sigurueshme, si dhe mundësinë e marrëdhënieve me persona dhe organizata të cilat mund të bashkëpunojnë me të për realizimin e arratisjes.

Shkronja “c”, e paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP, që parashikon të ashtuquajturën “nevojë sigurimi” justifikuese/garantuese të “mbrojtjes së interesit të kolektivitetit/komunitetit” prej “rrezikut që i pandehuri/i hetuari për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të kryejë krime të rënda apo të të njëjtit lloj me atë me të cilin procedohet”, ndryshe nga nevojat e sigurimit të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të paragrafit të tretë, të nenit 228 të KPP, nuk përgjigjet për nevojat e sigurimit të procesit penal, por sikurse u sipërcitua justifikohet nga motive të parandalimit social. Përmbajtja e këtij rreziku dhe e konkretësisë së tij, që i hetuari/personi ndaj të cilit kërkohet të caktohet masa e sigurimit personal të mund të kryejë “krime të rënda apo të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”, duhet të vlerësohet bazuar në rrethanat e faktit dhe në raport me personalitetin e të hetuarit.

Kolegjet e Bashkuara ritheksojnë se gjykata/gjyqtari për hetimet paraprake, në eventualitetin e verifikimit të pranisë së kushteve të parashikuara në dy paragrafët e parë të nenit 228 të KPP dhe të njëres prej nevojave të sigurimit të parashikuara në paragrafin e tretë të kësaj dispozite, ka detyrimin e caktimit të një mase sigurimi personal me karakter shtrëngues të parashikuar në nenin 232 të KPP. [...] Në terma të tjerë, me verifikimin e kushteve të sipërcituara gjykata/gjyqtari për hetimet paraprake, në individualizimin e masës së sigurimit personal të përshtatshme në funksion të garantimit të nevojave të sigurimit të evidentuara dhe proporcionale në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete që i atribuohet të hetuarit, duke respektuar parimin e gradualitetit në caktimin/përzgjedhjen e llojit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues dhe në mënyrë të veçantë, atë të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 230 të KPP, që parashikon aplikimin e masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”, të parashikuar në nenin 238 të KPP, si *extrema/ultima ratio*, disponon një hapësirë vlerësimi për të zbatuar çdo lloj mase të sigurimit personal të parashikuar në nenin 232 të KPP.

Nga ana tjetër, analiza e nenit 230 të KPP tregon se “rrezikshmëria e veçantë e veprës” presupozon një rrezik të shtuar, duke kërkuar që vepra penale, për shkak të rrethanave konkrete të kryerjes së saj, të paraqesë një intensitet të tillë rreziku, saqë masat e tjera më pak kufizuese të mos

rezultojnë të mjaftueshme për garantimin e nevojave të sigurimit. Por, ky kriter nuk mund të nxirret *a priori* nga natyra e veprës ose nga marzhi i dënimit të parashikuar, por duhet të rezultojë nga një analizë konkrete e faktit penal. Megjithatë, ligji përjashton çdo arsyetim automatik të bazuar vetëm në natyrën e veprës, rëndësinë e saj të përgjithshme ose marzhin e dënimit. Për këtë arsye, natyra e veprës, mënyra e kryerjes së saj, pasojat e ardhura prej saj mund të shërbejnë si tregues të rëndësishëm, por nuk mund të konsiderohen të vetme, si të mjaftueshme për të nxjerrë përfundimin mbi ekzistencën e rrezikshmërisë së veçantë të veprës penale.

Edhe në lidhje me rrezikshmërinë e veçantë të pandehurit, përfundimet mund të arrihen vetëm nëse të dhënat e faktit penal lidhen dhe analizohen në raport me rrethana konkrete që karakterizojnë autorin, si sjellja e tij para dhe pas kryerjes së veprës, qëndrueshmëria e lidhjeve familjare dhe shoqërore, historiku personal, qëndrimi ndaj procesit penal, si dhe çdo element tjetër që mund të japë të dhëna mbi ekzistencën e një rreziku real procedural ose shoqëror që ai paraqet në çështjen konkrete.

Në këtë kuptim, rrezikshmëria e veçantë e veprës penale nuk mund të analizohet e shpëputur nga rrezikshmëria e të pandehurit, por në ndërveprim të ngushtë me të. Ajo nuk identifikohet as me rrezikshmërinë abstrakte të veprës të përcaktuar nga ligjvënësi, as me ekzistencën e thjeshtë të dyshimit për kryerjen e saj. Ky vlerësim nuk mund të mbështetet në prezumime të përgjithshme ose në formula standarde të lidhura vetëm me natyrën e veprës, por duhet të bazohet në elemente faktike të verifikueshme që lidhen me personalitetin, historikun dhe sjelljen konkrete të autorit. Megjithatë, edhe në prani të këtyre elementëve, gjykata është e detyruar të verifikojë në mënyrë konkrete nëse rreziku i konstatuar mund të garantohet përmes masave më pak kufizuese të lirisë, pasi vetëm papërshtatshmëria e tyre, e arsyetuar në mënyrë të shprehur, mund të justifikojë përfundimin se rrezikshmëria e autorit arrin atë nivel që kërkon caktimin e masës së arrestit në burg.

Ky qëndrim mbështetet edhe në jurisprudencën e GJEDNJ, e cila ka konsoliduar standardin sipas të cilit rëndësia abstrakte e veprës penale ose ashpërsia e dënimit të parashikuar nuk përbëjnë, në vetvete, arsye të mjaftueshme për të justifikuar paraburgimin. [...]

Nga kjo jurisprudencë del se gjykata nuk mund të kufizohet te natyra dhe rëndësia e përgjithshme e veprës penale, por duhet të argumentojë në mënyrë të individualizuar rrezikun që paraqet personi konkret në raport me nevojat e procedimit penal. Ajo përjashton gjithashtu çdo qasje që do të trajtonte marzhin e dënimit si element të mjaftueshëm për të provuar “rrezikshmërinë e veçantë”, pasi një arsyetim i tillë do ta zhvendoste vendim-

marrjen nga kontrolli konkret gjyqësor drejt prezumimeve abstrakte.

Sa më i individualizuar dhe i mbështetur në fakte të jetë ky vlerësim, aq më qartë del lidhja ndërmjet rrezikshmërisë së veçantë dhe nevojës për caktimin e masës më të rëndë (arresti në burg). Për këtë arsye, analiza e kërkuar nga neni 230 nuk është e shkëputur nga analiza e kërkuar nga neni 245, pika 1, shkronja “ç” (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017), por e ndërthurur me të. Në këtë kuptim, nëse rrezikshmëria e veçantë arsyetohet mbi elemente konkrete të faktit penal dhe të personit, atëherë, në të njëjtën kohë, gjykata jep edhe arsyet pse masat e tjera më pak kufizuese nuk mjaftojnë. Vetëm një arsyetim i tillë shmang si automatizmin në caktimin e masës së arrestit në burg, ashtu edhe vendimmarrjen në dukje të arsyetuar, por të mbështetur në formulime të përgjithshme dhe pa përmbajtje konkrete.

Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se formulimi i vendimit unifikues nr. 7/2011, sipas të cilit, në rastin e procedimeve penale për krime të rënda apo që kanë sjellë pasoja të rënda, “... për vetë natyrën e këtyre veprave penale, të mënyrës së kryerjes e të pasojës së ardhur, është i pranishëm elementi i shkallës së lartë apo të rëndësishme të rrezikshmërisë së autorit të tyre sipas nenit 228 të KPP ...”, ka nevojë për qartësim, saktësim, standardizim, ndryshim dhe zhvillim të mëtejshëm. Kolegjet e Bashkuara theksojnë se, në caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’, prokurori fillimisht dhe gjykatat në vijim, kanë detyrimin të japin një arsyetim të individualizuar, të mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes konkrete. Në këtë drejtim, Kolegjet theksojnë se edhe vlerësimi i rrezikshmërisë së veçantë duhet të jetë domosdoshmërisht i individualizuar (i mbështetur në fakte e rrethana të posaçme të çështjes) dhe të përfshijë jo vetëm elementet konkrete të faktit penal si natyra e veprës, mënyra e kryerjes, pasojat, por edhe elementet konkrete që lidhen me personin si sjellja para dhe pas veprës, precedentët penalë, lidhjet familjare dhe shoqërore, stabiliteti social, rreziku i cenimit ose ndikimit mbi provën, rreziku i largimit, i përsëritjes së veprës, si dhe çdo faktor tjetër i rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut procedural ose shoqëror të autorit. Vetëm kur verifikohen dhe vërtetohen këto elemente në mënyrë të plotë dhe të individualizuar, duke provuar rrezikshmërinë e veçantë të veprës dhe të autorit në kuptim të nenit 230, pika 1 të KPP, masa e sigurimit “arrest në burg” përligjet si masa më e përshtatshme që garanton nevojat e sigurimit. Prandaj, paraburgimi mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ekzistojnë tregues specifikë të një kërkese të vërtetë të interesit publik. Në këtë kuptim, analiza e kërkuar nga neni 230 i KPP është ngushtësisht e lidhur me atë të nenit 245, pika 1, shkronja “ç” të KPP, pasi

vetëm një arsyetim që evidenton në mënyrë konkrete papërshtatshmërinë e masave alternative mund të legjitimojë kufizimin më të rëndë të lirisë. Ky standard përputhet plotësisht edhe me jurisprudencën e GJEDNJ, e cila kërkon që gjykatat të analizojnë realisht alternativat ndaj paraburgimit dhe të shmangin arsyetimet stereotipe ose abstrakte.

Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, nëse mbajtja e një personi në paraburgim është e arsyeshme dhe e domosdoshme, kjo duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të çdo rasti dhe sipas veçorive të tij specifike. Vetëm një vlerësim i tillë i plotë dhe i individualizuar i përgjigjet kërkesave të ligjit procedural penal dhe standardeve konventore, nga i cili rrjedh edhe rregulli i së drejtës i formuluar më poshtë.

[..]

Në analizë të **çështjes së tretë**, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, nga interpretimi sistematik dhe teleologjik i neneve 228, 229, 230 dhe 244 të KPP, në lidhje me nenin 5, paragrafi 3 të KEDNJ, rezulton se barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg” i takon organit të akuzës, i cili kërkon ose mbron këtë kufizim të lirisë personale, ndërsa gjykata ka detyrimin ta verifikojë këtë nevojë në mënyrë efektive, të pavarur dhe të arsyetuar. Ky përfundim buron nga vetë natyra e masës së arrestit në burg, e cila mund të caktohet vetëm kur rezulton absolutisht e domosdoshme për mbrojtjen e interesit publik, si dhe nga parimi sipas të cilit liria personale përbën rregull, ndërsa kufizimi i saj përbën përjashtim.

Nga interpretimi sistematik i dispozitave të KPP rezulton se barra për justifikimin e caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg” i takon organit të akuzës. Kjo rrjedh drejtpërdrejt nga neni 244 i KPP, sipas të cilit masa vendoset mbi kërkesën e prokurorit, i cili ka detyrimin të paraqesë arsyet ku bazohet kërkesa e tij. Në këtë kuptim, prokuroria nuk kufizohet në paraqitjen formale të kërkesës, por duhet të provojë ekzistencën e të gjitha kushteve dhe kritereve ligjore, nëpërmjet provave të marra sipas nenit 149 e vijues të KPP, të cilat duhet të jenë marrë në përputhje me ligjin dhe të jenë të afta për të vërtetuar faktet relevante për vendimmarrjen. Nenet 228 dhe 229 parashikojnë kushtet dhe kriteret që duhet të provohen nga prokuroria, përkatësisht ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova dhe praninë e njërit prej rreziqeve procedurale. Duke qenë se këto elemente përbëjnë premisat ligjore për kufizimin e lirisë personale, barra për t'i provuar ato nuk mund të zhvendoset tek i pandehuri (autori). Përkundrazi, prokuroria duhet të paraqesë fakte konkrete dhe të verifikueshme që tregojnë rrezikun real të cenimit të provave, të largimit

ose të përsëritjes së veprës penale, sipas nenit 228, pika 3 të KPP. Kjo do të thotë se organi i akuzës nuk mjaftohet me provimin e dyshimit të arsyeshëm dhe të një rreziku procedural, por duhet të argumentojë në mënyrë të veçantë dhe konkrete pse masat e tjera më pak kufizuese nuk janë të mjaftueshme për rastin konkret. Në mungesë të një analize të tillë krahasuese, kërkesa për arrest në burg mbetet e paplotë nga pikëpamja ligjore. Detyrimi i prokurorisë për të mbledhur dhe paraqitur prova nuk është i njëanshëm. Neni 8/a i KPP i imponon organit procedues detyrimin për të shqyrtuar si provat fajësuese, ashtu edhe ato në favor të të pandehurit. Ky standard forcon më tej barrën e prokurorisë, pasi ajo duhet të paraqesë një tablo të plotë dhe objektive të rrethanave të çështjes, duke përfshirë edhe elementet që mund të mbështesin aplikimin e një mase më të butë sigurimi.

Në kuptim të kuadrit ligjor në fuqi, mënyra e marrjes dhe shqyrtimit të provave në procesin penal është qartësisht e rregulluar dhe e formalizuar nga KPP. [...] Si rrjedhojë, edhe në këtë këndvështrim mundësia e të pandehurit (autorit) për të paraqitur prova është e kufizuar nga këto rregulla dhe nuk është e lirë në çdo formë, pasi prova të përdorshme janë vetëm ato që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij.

Megjithatë, fakti që në fazën e hetimeve paraprake provat merren nga organi procedues, pra prokuroria, sipas rregullave të përcaktuara në KPP, ndërsa në gjykim ato merren me kërkesë të palëve dhe brenda kufijve të ligjit procedural penal (neni 151 KPP), nuk kufizon të drejtën e të pandehurit (autorit) për të paraqitur prova që ai i vlerëson të rëndësishme për vendimmarrjen. Në kuadër të procedurës së marrjes në pyetje të personit të arrestuar, neni 248, pika 4 i KPP parashikon të drejtën e palëve për të paraqitur prova gjatë debatit gjyqësor (me përjashtim të provave me dëshmitarë), duke konfirmuar karakterin kontradiktor të këtij shqyrtimi dhe mundësinë efektive të mbrojtjes për të sjellë elemente provuese në mbështetje të qëndrimit të saj.

Në këtë kuptim, personi ndaj të cilit kërkohet caktimi ose vazhdimi i masës së sigurimit “arrest në burg” mund të paraqesë prova kryesisht në lidhje me rrethanat e tij personale, familjare, shëndetësore ose rrethana të tjera të ngjashme që lidhen me gjendjen e tij individuale, për shkak se këto janë të dhëna që njihen dhe disponohen prej tij, por ky rol mbetet thjesht argumentues dhe ndihmues në vlerësimin e gjykatës. Në asnjë rast ai nuk zëvendëson detyrimin e prokurorisë për të provuar, mbi bazën e provave të marra sipas rregullave të përcaktuara në KPP, ekzistencën e kushteve dhe kriterëve për caktimin dhe vijimin e masës së arrestit

në burg. Sikurse u tha më lart, kjo nuk do të thotë se i pandehuri nuk ka rol në debatin gjyqësor mbi shqyrtimin e masës së sigurimit. Në respektim të parimit të kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, ai ka të drejtë të paraqesë rrethana faktike personale, familjare, shëndetësore, profesionale, shoqërore ose rrethana të tjera të ngjashme që lidhen me gjendjen e tij individuale që mund të flasin në favor të një mase më pak kufizuese. Megjithatë, ky rol ka natyrë argumentuese dhe lidhet me faktet që ai vetë pretendon. Ai nuk shndërrohet në barrë për të justifikuar lirinë si të tillë. Elemente të tilla si vendbanimi i qëndrueshëm, lidhjet familjare, gjendja shëndetësore, marrëdhëniet e punës, mungesa e precedentëve penalë, sjellja pas ngjarjes, vetëparaqitja ose bashkëpunimi me organet proceduese e të tjera, mund të merren në konsideratë nga gjykata në kuadër të vlerësimit të proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë së masave alternative ndaj arrestit në burg. Por ato nuk e çlirojnë prokurorinë nga detyrimi i saj për të provuar dhe argumentuar nevojën konkrete për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

Lidhur me gjykatën, Kolegjet e Bashkuara vënë në dukje se, roli i saj nuk është pasiv. Nenet 151 dhe 248 të KPP kërkojnë që gjykata të verifikojë në mënyrë aktive ekzistencën e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi, duke kontrolluar në mënyrë të pavarur provat dhe argumentet e paraqitura nga prokuroria. Megjithatë, ky detyrim verifikimi nuk e përmbys barrën e provës. Kjo për arsye se gjykata kontrollon dhe vlerëson, por nuk e zëvendëson prokurorinë në detyrimin e saj për të provuar nevojën e caktimit dhe vijimit të masës së sigurimit të arrestit në burg. Kërkesa për një arsyetim të individualizuar dhe të plotë konfirmohet edhe nga neni 245 i KPP, i cili e lidh vlefshmërinë e vendimit me paraqitjen e shkaqeve konkrete që justifikojnë masën dhe me arsyetimin pse nuk merren parasysh pretendimet e mbrojtjes dhe pse masat e tjera janë të papërshtatshme. Ky standard tregon se barra e provës mbi prokurorinë reflektohet drejtpërdrejt në detyrimin e gjykatës për të dhënë një arsyetim të bazuar mbi faktet e paraqitura prej saj. Edhe në fazat e mëtejshme të procedimit penal, barra e justifikimit vijon të mbetet mbi prokurorinë. Nga përmbajtja e nenit 246, pika 6 të KPP rezulton se në mënyrë periodike dhe në çdo rivlerësim të masës, prokuroria duhet të informojë dhe të provojë se nevojat e sigurimit vazhdojnë të ekzistojnë. Kjo natyrë dinamike e masave të sigurimit përjashton çdo mundësi për vijim automatik të arrestit në burg mbi bazën e vendimit fillestar.

Ky interpretim është në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ. [...] Kërkesa ndaj të pandehurit për të sjellë të dhëna në favor

të një mase më të butë mund të ketë vlerë vetëm në raport me rrethanat faktike personale që ai vetë i pretendon, por jo si barrë për të rrëzuar domosdoshmërinë e masës së arrestit në burg. Po të pranohej e kundërta, kontrolli gjyqësor do të reduktohej në një verifikim pasiv të mungesës së kundërprovës, duke humbur funksionin e tij si garanci kundër kufizimit arbitrar të lirisë.

Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se qëndrimi i mbajtur në vendimin unifikues nr.7/2011 sipas të cilit, masa e sigurimit arrest në burg mund të çmohet e papërshtatshme “... *vetëm nëse ai ose mbrojtësi i tij i paraqesin gjykatës prova pozitive që tregojnë se kjo gjendje rreziku nuk është e pranishme, apo që nuk është e pranishme në atë shkallë e rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit arrest në burg ...*”, ka nevojë për qartësim, saktësim, standardizim, ndryshim dhe zhvillim të mëtejshëm, pasi ky arsyetim lë të kuptohet se barra e kundërshtimit të rrezikut procedural zhvendoset mbi të pandehurin dhe mbrojtjen e tij, në kundërshtim me parimin e barrës së provës që i takon organit të akuzës. Një kuptim i tillë krijon rrezikun e vendosjes së një prezumimi në favor të paraburgimit, dobëson prezumimin e pafajësisë dhe zhvendos barrën e justifikimit të caktimit dhe vijimit të masës së arrestit në burg nga organi që kërkon kufizimin e lirisë tek personi që gëzon këtë të drejtë themelore. Ky formulim, në efektin e tij praktik, krijon keqinterpretime dhe një prezumim në favor të masës së sigurimit “arrest në burg”, duke zhvendosur barrën e kundërshtimit tek i pandehuri dhe duke përmbysur logjikën kushtetuese të kontrollit gjyqësor mbi lirinë personale. Në këtë mënyrë, kërkesa për “prova pozitive” nga ana e të pandehurit (autorit) rrezikon të kthejë standardin e vlerësimit nga një detyrim i organit të akuzës për të provuar domosdoshmërinë e privimit të lirisë, në një barrë të individit për të rrëzuar një gjendje rreziku të prezumuar, çka paraqet kontradiktë edhe në raport me pabarazinë e palëve në procesin penal dhe vështirësinë objektive të provës së fakteve negative në këtë kontekst. Në këtë kuptim, fokusi i kontrollit gjyqësor zhvendoset nga verifikimi aktiv i domosdoshmërisë së paraburgimit tek vlerësimi i mjaftueshmërisë së kundërshtimeve të mbrojtjes, duke cenuar funksionin garantues të gjykatës në mbrojtje të lirisë personale.

Kuptimi i drejtë i ligjit dhe i standardit konventor është se prokuroria mbart barrën për të justifikuar nevojën e caktimit ose vijimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, gjykata ka detyrimin për kontroll efektiv dhe arsyetim të bazuar në elemente konkrete të mjaftueshme dhe relevante, ndërsa i pandehuri ka vetëm barrën për të paraqitur ato rrethana faktike personale që ai i pretendon në favor të një mase më pak kufizuese. Ligji

procedural penal nuk parashikon asnjë rregull sipas të cilit i dyshuari ka barrën për të provuar se pse ndaj tij nuk duhet të caktohet një masë sigurimi. Rrjedhojë logjike e kësaj strukture normative është se papërshtatshmëria e arrestit në burg nuk mund të kushtëzohet nga paraqitja e “provave pozitive” nga i pandehuri. Një qasje e tillë do të përmbyste logjikën themelore të procesit penal ku është organi procedues ai i cili duhet të paraqesë arsyet dhe provat me qëllim justifikimin e kufizimit të lirisë. [...] I pandehuri ka të drejtë të paraqesë rrethana personale në favor të tij, por kjo nuk e çliron prokurorinë nga detyrimi themelor për të provuar domosdoshmërinë konkrete të masës së arrestit në burg. Prokuroria justifikon nevojën për privimin e lirisë, ndërsa i dyshuari paraqet rrethanat që flasin në favor të masave alternative. Pasi këto rrethana janë paraqitur, gjykata ka detyrimin pozitiv t’i shqyrtojë, t’i peshojë dhe t’i integrojë në arsyetimin e saj duke treguar pse, edhe në prani të tyre, masa e arrestit në burg mbetet e vetmja e përshtatshme. Vetëm ky ekuilibër siguron që kontrolli gjyqësor mbi lirinë personale të mbetet substancial dhe joformal, në përputhje me nenin 5, paragrafi 3 të KEDNJ dhe nenet 228 - 230 të KPP, duke respektuar si të drejtën e individit për të ndikuar në vendimmarrje, ashtu edhe detyrimin e organit procedues për të justifikuar çdo kufizim të lirisë dhe duke çuar te rregulli i së drejtës që formulohet më poshtë.

[..]

Në këtë kuadër, praktika e mëparshme, në pjesën që lidhet me masën e sigurimit “arrest në burg”, duhet të lexohet në përputhje me detyrimin e gjykatës për shqyrtimin real të masave më pak kufizuese, me kërkesën për arsyetim konkret, të individualizuar dhe të kontrollueshëm, mbi rrezikshmërinë e veprës dhe të personit, si dhe me barrën e organit të akuzës për të justifikuar nevojën e kufizimit më të rëndë të lirisë personale.

ii) **Për zgjidhjen e çështjes konkrete**

Kolegjet e Bashkuara në lidhje me [...] çështjen konkrete, vlerësojnë se pretendimet e rekursit nuk gjejnë mbështetje në ligj dhe në kufijtë e kontrollit kasacional që ushtron Gjykata e Lartë. Argumentet e rekursit, të mbështetura kryesisht në natyrën e veprës penale, sasinë e lëndës narkotike, marzhin e dënimit dhe rrezikun e përgjithshëm të largimit ose përsëritjes së veprës, nuk mjaftojnë për të justifikuar automatikisht caktimin e masës “arrest në burg”, në mungesë të një analize konkrete që të tregojë papërshtatshmërinë e masave më pak kufizuese. Edhe pretendimi se vendimi i gjykatës së apelit është i mangët për shkak se nuk ka arsyetuar hollësisht mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së masës “arrest në shtëpi” nuk përbën shkak për prishjen e vendimit, pasi përmbajtja, zbatimi dhe kontrolli i kësaj mase parashikohen nga neni 237 i KPP dhe nga kuadri

ligjor për ekzekutimin e vendimeve penale.

[..] Ajo ka kryer një analizë të individualizuar të rrethanave të rastit dhe të elementeve personale të të hetuarit B.Z, duke marrë në konsideratë moshën e tij 63-vjeçare, statusin si kryefamiljar, gjendjen shëndetësore të bashkëshortes, si dhe faktin se rezulton i rehabilituar nga dënimi i mëparshëm. Ky vlerësim pasqyron kalimin analitik nga rëndësia abstrakte e veprës penale tek personi konkret, në përputhje me parimin se rrezikshmëria nuk mund të nxirret automatikisht vetëm nga natyra e veprës, marzhi i dënimit ose rëndësia e saj e përgjithshme shoqërore, por kërkon një analizë të plotë dhe të individualizuar të rrethanave konkrete të faktit dhe të autorit. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka arsyetuar se, ndonëse vepra penale e prodhimit dhe shitjes së narkotikëve paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe përbën prioritet për drejtësinë penale, këto elemente nuk mjaftojnë në vetvete për të justifikuar aplikimin e masës më të rëndë të sigurimit personal. Ajo ka vlerësuar se nuk rezultojnë rrethana të veçanta që të tregojnë rrezikshmëri të shtuar, as të veprës dhe as të autorit, në atë shkallë që ta bëjnë “arrestin në burg” të domosdoshëm si masën e vetme të përshtatshme, ndërsa masa e “arrestit në shtëpi”, e parashikuar nga neni 237 i KPP, përmbush në mënyrë proporcionale nevojat e sigurimit në rastin konkret. Ky arsyetim reflekton standardin e individualizimit të masës së sigurimit dhe natyrën “ultima ratio” të arrestit në burg.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se edhe pretendimi i ngritur në rekurs lidhur me ekzistencën e rrezikut të largimit, nuk mbështetet dhe argumentohet në elemente konkrete dhe të individualizuara, por kryesisht në konsiderata abstrakte si rëndësia e veprës penale, marzhi i dënimit, precedentët penalë të mëparshëm dhe pretendimi se anëtarë të familjes së të dyshuarit janë të përfshirë në aktivitete të kundërligjshme. [...] Në këtë drejtim, gjykata e apelit ka vlerësuar drejt faktin e rehabilitimit të të dyshuarit dhe mungesën e elementeve konkrete që të tregojnë rrezik real për shmangie nga drejtësia, pengim të hetimit ose përsëritje të veprës penale në kushtet e zbatimit të masës së “arrestit në shtëpi”. Sa i përket precedentëve penalë, gjykata e apelit ka konstatuar se personi rezulton i rehabilituar, element ky që duhet të vlerësohet si rrethanë individuale në favor të tij. [...]

Sa i përket pretendimit të ngritur në rekurs se gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 7/2011, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky pretendim duhet parë nën dritën e saktësisimit, qartësisimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të praktikës gjyqësore të njësuar. Formulime të caktuara të atij vendimi, që lidhen me nxjerrjen e rrezikshmërisë kryesisht

nga natyra abstrakte e veprës penale dhe me mungesën e një detyrimi për analizimin efektiv të masave alternative, rezultuan se nuk janë më plotësisht në përputhje me kuadrin aktual ligjor dhe me standardet kushtetuese e konventore të mbrojtjes së lirisë personale. Në këtë kontekst, arsyetimi i gjykatës së apelit rezulton në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë vendim për qartësimin, saktësimin, standardizimin, ndryshimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të disa formulimeve të pjesës arsyetuese të vendimit unifikues nr. 7 të vitit 2011.

[..] Mungesa e një arsyetimi të detajuar nga gjykata e apelit mbi mënyrën konkrete të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së masës “Arrest në shtëpi” nuk përbën, në rastin konkret, shkak për prishjen e vendimit, për sa kohë gjykata ka përcaktuar vendin e qëndrimit dhe ndalimin e largimit, ndërsa zbatimi dhe kontrolli i mëtejshëm i masës garantohen nga kuadri ligjor përkatës. Konkretisht, neni 237 i KPP parashikon se: [..] Kjo dispozitë përcakton elementet thelbësore të masës së arrestit në shtëpi, mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së saj, si dhe rolin e prokurorit dhe të policisë gjyqësore në kontrollin e respektimit të urdhrave të vendosur nga gjykata. Po kështu, ligji nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” ngarkon prokurorin me detyrimin për të marrë masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit penal dhe për të kontrolluar rregullsinë e zbatimit të tij, duke parashikuar edhe mekanizmat për ndërhyrje në rast parregullsish. Për rrjedhojë, edhe në mungesë të një detajimi të hollësishëm në arsyetimin e vendimit, kuadri ligjor ekzistues garanton mekanizmat e nevojshëm për ekzekutimin dhe mbikëqyrjen efektive të masës së “arrestit në shtëpi”. [..] Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara, në zbatim të nenit 441, pika 1, shkronja “e” të KPP, vlerësojnë se vendimi nr. [..], i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm duhet të lihet në fuqi.

II. Seanca paraprake



17.Vendim njësuës nr.00-2021-1134 (62), datë 01.11.2021 (afat paraburgimi që konsumohet gjatë seancës paraprake)

Sentencë njësuëse: 1. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të hetimit paraprak kur, gjyqtari i seancës paraprake disponon “Për plotësimin e hetimeve”, sipas nenit 332/c dhe/ose “Për kthimin e akteve prokurorit për korrigjimin ose saktësimin e akuzës”, sipas nenit 332/d, pika 3 e KPP.

2. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjyqimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për:

- a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq;
- b) vijimin e gjyqimit nga e njëjta gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e fajësisë dhe caktimit të dënimit;
- c) vijimin e gjyqimit nga e njëjta gjykatë, kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar;
- e) për pushimin e akuzës ose të çështjes, apo deklarin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligj, sipas nenit 332/dh shkronjat «ç» e «d» të KPP.

Fjalë kyçe: dërgim çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprake, afat paraburgimi, pezullim afati paraburgimi

Unifying decision no. 00-2021-1134 (62), dated 01.11.2021 (detention period served during the preliminary hearing)

Unifying sentence: 1. The period of pre-trial detention served during the preliminary hearing shall be attributed to the preliminary investigation stage where the judge of the preliminary hearing or-

ders the completion of the investigation, pursuant to Article 332/c of the Criminal Procedure Code; and/or the remittal of the case file to the prosecutor for the correction or clarification of the charges, pursuant to Article 332/d(3) of the Criminal Procedure Code.

2. The period of pre-trial detention served during the preliminary hearing shall be attributed to the trial stage where the judge of the preliminary hearing orders:

a. the acceptance of the prosecutor's request and the committal of the case for trial;

b. the continuation of the proceedings before the same court following the parties' submission of a plea agreement on the admission of guilt and sentencing;

c. the continuation of the proceedings before the same court where the defendant has requested a summary trial; or

ç. the dismissal of the charge or termination of the proceedings, or a declaration of lack of jurisdiction and the transfer of the case to the competent court in the cases provided by law, pursuant to Article 332/dh, letters (ç) and (d) of the Criminal Procedure Code.

Keywords: *referral of the case to court, preliminary hearing judge, pre-trial detention period, suspension of pre-trial detention period*

Rrethanat e çështjes:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. (467) 25, datë 18.05.2020, ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP, midis të tjerëve edhe për shtetasin D.V., me cilësinë e personit të dyshuar (hetuar) për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i K.Penal.

[..]. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj gjykate, me vendimin nr. (471) 242, datë 21.05.2020, ndër të tjera, ka verifikuar pozitivisht, në përputhje me përcaktimet e nenit 248/2 të KPP, kushtet dhe kriteret e caktimit dhe të zbatimit të masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”, ndaj të hetuarit, (si dhe nevojat e sigurimit, sipas përcaktimit të neneve 228, 229, 230 të KPP).

Më datë 30.07.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka paraqitur kërkesë për dërgimin për gjykim të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 420, të vitit 2018, ku, ndër të tjerë, është marrë i pandehur edhe kërkuesi D.V. [...] Me vendimin nr. (1107) 355, datë 06.11.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtari i seancës paraprake pranë asaj gjykate, ka vendosur pranimin e kërkesës

së prokurorit dhe dërgimin për gjykim të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 420, viti 2018, me të pandehur, ndër të tjerë, edhe kërkuesin.

Më datë 10.06.2021, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për shuarje të masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”, caktuar ndaj tij me vendimin nr. (467) 25, datë 18.05.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Kjo kërkesë është marrë në shqyrtim nga kolegji gjykues në disponim të të cilit rezulton, ndërkohë, gjykimi në themel i akuzës së kontestuar nga prokurori, të pandehurit, si gjykata kompetente, që disponon aktet në zbatim të nenit 261/3 të KPP. Kërkuesi pretendon se është në kushtet e verifikimit të tejkallimit të afateve të paraburgimit të vuajtura prej tij, për efekt të aplikimit të asaj mase, të përcaktuara në nëntë muaj - pa u dhënë vendimi i dënimit - sipas përmbajtjes së nenit 263/2/- të KPP, pasi sanksioni i parashikuar në dispozitën që i atribuohet këtij të fundit, sipas akuzës neni 283/2 të KP, parashikon një dënim, në maksimum deri në 10 vjet.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, [...] ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit D.V. [...]

Gjykata Apelit Shkodër, [...] ka vendosur **lënien në fuqi të vendimit** [...] [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji Penal [...] vlerësoi se rekursi objekt shqyrtimi plotëson kërkesat e ligjit për tu pranuar, konkretisht të kushtit të karakterit substancial, të përcaktuar në germen “a”, të paragrafit të parë të nenit 432 të KPP, të identifikuar në “mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural”, prej gjykatave të të dy shkallëve (të Rrethit Gjyqësor Kukës dhe të Apelit Shkodër), lidhur me kërkesën e paraqitur nga kërkuesi/i pandehuri, gjatë gjykimit në themel të çështjes penale në ngarkim të tij, me objekt deklarin e humbjes së fuqisë (shuarjes) së masës së sigurimit personal të “arrestit në burg” caktuar ndaj tij. Gjykatat e faktit, në shqyrtimin e kësaj kërkeje, kanë disponuar për rrëzimin e saj, duke vlerësuar qëndrimin e mbrojtësit se afatet e paraburgimit janë konsumuar, pasi kanë kaluar nëntë muaj pa u shprehur gjykata me vendim përfundimtar, si të pabazuar në ligj. Në interpretimin e ligjit procedural penal, gjykatat e faktit kanë arritur në konkluzionin se afati i paraburgimit i “konsumuar”/që ka kaluar gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari i seancës paraprake deri në momentin që ky i fundit ka disponuar “për dërgimin e çështjes në gjyq”, duhet përfshirë si afat i fazës së hetimit paraprak. Sipas gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, afati i parashikuar në nenin 263/2 të KPP për fazën e gjykimit, fillon nga momenti i depozitimit dhe i regjistrimit të

fashikullit të gjykimit tek gjyqtari i gjykimit të çështjes në themel, duke vlerësuar këtë moment si “dorëzimi i akteve në gjykatë”.

Në verifikim të praktikës gjyqësore në drejtimin e sipërcituar, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin e rëndësishëm të ndryshimeve që ka pësuar KPP [...] ku është parashikuar seanca paraprake si një fazë e procedimit penal, por, nga ana tjetër, edhe faktin që ky ndryshim nuk është shoqëruar edhe me ndryshimin e nenit 263 të KPP, Kolegji çmoirë ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 438 të KPP për iniciimin e procedurës së gjykimit për njësimin e praktikës gjyqësore. Seanca paraprake është parashikuar si një fazë e rëndësishme dhe e pashmangshme e procedimit penal, që synon të garantojë të drejtat e mbrojtjes, duke verifikuar dhe kontrolluar plotësinë e hetimeve të kryera, veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit gjatë fazës së hetimit paraprak.

Kolegji konstaton se, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar seancën paraprake në procesin penal, nuk e ka shoqëruar këtë ndryshim të rëndësishëm edhe me ndryshimin e nenit 263 që parashikon afatet e paraburgimit për çdo fazë të procedimit. Ndërkohë, në funksion të ushtrimit të kontrollit të hetimeve paraprake, gjyqtari i seancës paraprake mund të disponojë edhe për plotësimin e hetimeve, sipas nenit 332/ç të KPP dhe/ose për korrigjimin ose saktësimin e akuzës, sipas nenit 332/d të KPP, fakt ky që ndikon edhe në afatin e paraburgimit, për të pandehurin ndaj të cilit është caktuar masa e arrestit.

Përballur me problematikën e sipërcituar, Kolegji konstaton se nga gjykatat e faktit ka pasur qëndrime të ndryshme, në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit dhe ndikimin e kësaj faze të re të procedimit (seanca paraprake) në afatet e posaçme (të secilës fazë përkatëse) dhe/ose në ato të përgjithshme (tërësore) të paraburgimit, të parashikuara në nenin 263 të KPP. Në rastin konkret, gjykatat e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe e Apelit Shkodër, kanë përcaktuar se seanca paraprake, parashikuar në nenet 332 - 332/gj të KPP, është pjesë e fazës së hetimeve paraprake, për efekt të llogaritjes së afateve të paraburgimit (të kohëzgjatjes së tyre). Ndërkohë, në raste të tjera të ngjashme, gjykatat kanë mbajtur qëndrimin se seanca paraprake dhe afati i zgjatjes së saj është pjesë e fazës së gjykimit, për efekt të llogaritjes së afateve të paraburgimit (për më tepër, shih vendimet nr. 77, datë 30.07.2018 dhe nr. 219, datë 27.11.2019 të (ish) Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda). Në ndryshim nga ligji procedural penal shqiptar, KPP italiane që është marrë si model referimi nga ligjvënësi shqiptar, parashikon afate të qarta paraburgimi për secilën fazë, përfshi këtu edhe seancën paraprake. Kolegji vlerëson me rëndësi të theksojë faktin se edhe pas ndryshimeve të fundit të KPP, me ligjin nr. 41/2021, ku faza e seancës

paraprake ka pësuar ndryshime thelbësore, ligjvënësi nuk ka reflektuar në përmbajtjen e nenit 263 të KPP.

Në terma të tjera, kjo problematikë se “Cilës fazë procedurale i përket (i atashohet) afati i (kohëzgjatjes) paraburgimit të konsumuar, prej të pandehurit, gjatë fazës së procedimit të gjykimit (trajtim) të çështjes prej gjyqtarit të seancës paraprake”, objekt i këtij gjykimi njësues, do të gjejë zgjidhje në varësi të interpretimit nëse kjo fazë e re e procedimit penal do të cilësohet si një fazë ndërmjetëse midis fazës së hetimeve paraprake dhe fazës së gjykimit të çështjes (në shkallë të parë dhe të dytë) apo do të renditet/përfshihet - *tout court/thjesht* - në përbërje të njërës apo tjetrës fazë (hetim apo gjykim). Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson me rëndësi të evidentojë qëllimin e përfshirjes së kësaj faze procedurale në procesin penal, rolin dhe kompetencat që ka gjyqtari i seancës paraprake.

Kolegji sjell edhe një herë në vëmendje se, me ligjin nr. 35/2017, [...] është parashikuar faza e seancës paraprake, si një fazë “filtri dhe kontrolli” mbi veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit. Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë të verifikojë provat e mbledhura në ngarkim të të pandehurit gjatë fazës së hetimeve paraprake, si dhe bazueshmërinë/qëndrueshmërinë e akuzës në gjykimin e themelit. Me fjalë të tjera, detyra kryesore e gjyqtarit të seancës paraprake është të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq është e bazuar, si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë dhe vlefshmërisë së akteve, por nuk ka si qëllim të arrijë në konkluzione mbi fajësinë e të pandehurit. Kontrolli i ushtruar nga gjyqtari i seancës paraprake mbi hetimet e kryera, përfshi këtu edhe saktësimin apo korrigjimin e akuzës, nuk do të thotë se ai merr funksionet e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale.

Përfshirja e seancës paraprake si një nga fazat e procedimit penal, paraqet rëndësi në funksion të forcimit të institutit të mbrojtjes, nëpërmjet kontrollit (filtrimit) të akuzave të nxituara dhe të pambështetura, të paraqitura prej prokurorit, fryt i një veprimtarie hetimore të pakompletuar/të paplotë, përfshirë sidomos rastet kur prokurori anashkalon apo nuk tregon vëmendjen e duhur në lidhje me integrimin e kontributit të mbrojtjes në funksion të kësaj kompletueshmërie. Ligjvënësi, gjithsesi ndryshe nga fazat e tjera klasike të procedimit penal, të hetimeve paraprake dhe të gjykimit të çështjes në themel (në shkallë të parë dhe të dytë), nuk parashikoi (*ometoï*) afate të veçanta kohëzgjatje të paraburgimit për këtë fazë dhe as një pasqyrim të ndikimit të kësaj faze të re, të shtuar, të procedimit, në afatin tërësor të kohëzgjatjes së paraburgimit, të parashikuar në nenin 263/6 të KPP. Kjo fazë e procedimit penal ka ndikim në ecurinë e

gjithë procesit, përfshi këtu edhe në kohëzgjatjen e paraburgimit për të pandehurin.

Verifikimi i kësaj situate ligjore nga njëra anë, dhe “modelimi” i seancës paraprake, nga ana tjetër, përsa i përket aspektit procedural të zhvillimit të saj, sipas tipologjisë së zhvillimit të seancës gjyqësore të gjykimit të çështjes në themel, me elemente tipike karakterizues të këtij gjykimi, (*in primis* “kompetenca” e gjyqtarit të seancës paraprake, për të pezulluar afatet e paraburgimit të të pandehurit, në përputhje me përcaktimet e nenit 265 të KPP), sipas konsideratës së këtij Kolegji imponon pashmangshmërisht, një linjë interpretimi të problematikës së identifikuar në këtë gjykim njësoje, në favor të konsiderimit të periudhës së kohëzgjatjes së paraburgimit, të vuajtur prej të pandehurit gjatë seancës paraprake, si periudhë që i përket (integrohet) në fazën e gjykimit të çështjes, të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 263 të KPP. Ky afat fillon prej momentit (ditës) të “dorëzimit të akteve në gjykatë”, nga prokurori dhe zgjat deri në momentin e “dhënies së vendimit të dënimit në gjykatën e shkallës së parë”, gjithnjë duke respektuar kjo kohëzgjatje afatet e parashikuara, me pasojë humbjen e fuqisë së masës (shuarjen e saj), në shkronjat “a”, “b”, “c”, të paragrafit të dytë të kësaj dispozite, sipas llojit të akuzës për të cilën procedohet.

Por, nga ana tjetër, Kolegji konstaton se gjyqtari i seancës paraprake në ushtrim të funksioneve që i ka njohur ligji, mund të disponojë edhe për plotësimin e hetimeve, kur ato nuk janë të plota, si dhe mund të urdhërojë prokurorin të korrigjojë apo të saktësojë akuzën e atribuuar të pandehurit. Vendimmarrja e gjyqtarit të seancës paraprake në këto raste, nuk i jep fund seancës paraprake, pra nuk përmbyll këtë fazë të procedimit penal. Diskutimi që lind në këtë rast është nëse kemi një regres në fazën e hetimit paraprak apo kjo vendimmarrje është pjesë e seancës paraprake dhe rolit të saj si një fazë që synon kontrollin e plotësisë së hetimeve dhe garantimin e të drejtave procedurale të të pandehurit.

Për arritjen në një përfundim në lidhje me sa më lart parashtroi, Kolegji vlerëson se duhet bërë një interpretim i normave procedurale që rregullojnë institutin e ri të seancës paraprake, por duke e lidhur me mungesën e reflektimit të kësaj fazë të re të procedimit përsa i përket afateve të paraburgimit. Kolegji çmon se parashikimi i figurës së gjyqtarit të seancës paraprake synon jo thjesht ushtrimin e një “kontrolli” mbi veprimtarinë procedurale të prokurorit gjatë hetimit paraprak, por, mbi të gjitha, garantimin e të drejtave të mbrojtjes, duke synuar edhe efektivitetin e gjykimit të çështjes penale në themel.

Në mungesë të parashikimit ligjor në lidhje me afatin e paraburgimit të konsumuar gjatë seancës paraprake, Kolegji vlerëson se duhet analizuar

edhe përmbajtja e nenit 263 të KPP. Neni 263/2 i KPP në gjendjen aktuale edhe pas ndryshimeve të vitit 2017, parashikon [...] Ndërsa, neni 263/6 i KPP përcakton [...]

Kjo dispozitë, në pikën “1” të saj, e lidh humbjen e fuqisë së paraburgimit të hetimit, me kalimin e afateve të parashikuara “*pa u dorëzuar aktet në gjykatë*”. Interpretimi ligjor që duhet bërë nga Gjykata e Lartë në këtë rast është nëse “dorëzimi i akteve në gjykatë” lidhet me momentin e parashikuar në nenin 327 pika 6, kur prokurori në përfundim të hetimeve kërkon dërgimin e çështjes në gjyq apo në momentin kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për pranimin e kësaj kërkesë, sipas nenit 332/dh të KPP. Në këto dy dispozita ligjvënësi ka parashikuar: (i) detyrimin për prokurorin që, së bashku me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, të depozitojë edhe aktet e provat që përmban fashikulli i hetimeve, sipas nenit 331, pika “4” të KPP; (ii) detyrimin e gjyqtarit të seancës paraprake, që kur vendos dërgimin e çështjes në gjyq, të përcaktojë aktet që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit (neni 332/ë) dhe më pas ta depozitojë këtë fashikull së bashku me aktet e masave të sigurimit, në sekretarinë e gjykatës kompetente (neni 332/f).

Në interpretim të neneve që kanë rregulluar institutin e seancës paraprake, Kolegji Penal nisët nga kriteri teleologjik i normës dhe nga kriteri funksional i organit procedues, në rastin konkret të gjykatës. Pra, vlerësimi se në cilin moment gjykata ushtron funksionet kontrolluese vlerësuese të hetimeve paraprake dhe në cilin moment gjykata ushtron funksionet kushtetuese të bërjes së drejtësisë. Nga vendi që zë në renditjen e normave procedurale, i vendosur në Kreun IX të KPP, “seanca paraprake”, si dhe nga qëllimi i krijimit të kësaj figure të gjyqtarit të seancës paraprake, Kolegji vlerëson se ajo është një fazë e ndërmjetme procedurale, të cilën ligjvënësi nuk e ka përcaktuar as si pjesë e hetimit, por as si pjesë e fazës së gjykimit. Në rrethanat e parashtruara, në lidhje me llogaritjen e afateve të paraburgimit për këtë fazë, në mungesë të një parashikimi të saktë ligjor, Kolegji vlerësoi se duhet t’i referohemi natyrës së vendimmarrjes së gjyqtarit të seancës paraprake, nëse ky vendim i jep fund kësaj faze apo nëse aktet i kthehen prokurorit.

Kolegji vë në dukje se, në zbatim të nenit 327, pika “6” të KPP, prokurori me depozitim të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, depoziton njëkohësisht edhe të gjitha aktet në gjykatë/gjyqtari i seancës paraprake. Ky moment procedural, sipas ligjit (shprehimisht në këtë nen parashikohet: “*në përfundim të hetimeve ...*”), shënon përfundimin e hetimeve paraprake. Në favor të këtij interpretimi të karakterit teleologjik, në përshtatje me qëllimin e ligjvënësit në parashikimin e këtij

instituti procedural, është edhe përcaktimi i nenit 331 të KPP (kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq) që nënkupton përfundimin e fazës së hetimeve paraprake me kontestimin/atribuimin e akuzës të pandehurit dhe dërgimin e çështjes për gjykim. Është pikërisht kjo kërkesë (për dërgimin e çështjes në gjyq) e paraqitur nga prokurori në përfundim të hetimeve paraprake, (përmbajtja e të cilës pasqyron në thelb akuzën e kontestuar prej këtij të fundit të hetuarit, i cili prej këtij momenti “fiton” statusin e të pandehurit, duke u akuzuar për një akuzë të caktuar), që “provokon” konstituimin e seancës paraprake si një moment kyç në funksion, sikurse u sipërcitua, të verifikimit të akuzës të atribuuar të pandehurit, si përsa i përket aspektit të kompletueshmërisë së hetimeve të zhvilluara, ashtu edhe në drejtim të kualifikimit të saktë juridik të faktit penal të atribuuar nëpërmjet akuzës, të pandehurit.

Neni 327 i KPP parashikon[.] Me kryerjen e këtyre veprimeve procedurale, nga ana e prokurorit merret vendimi për dërgimin e çështjes në gjykim, duke kërkuar diçka të tillë para gjyqtarit të seancës paraprake. Në këtë mënyrë prokurori ka mbyllur fazën e tij të hetimeve duke vlerësuar se i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore. Zakonisht në praktikë ky moment procedural korrespondon me përmbushjen e afatit të përcaktuar nga neni 263/1 përfshi dhe atë të nenit 327 të KPP. Kontrolli i hetimeve nga gjyqtari i seancë paraprake është konfirmim e kryerjes së hetimeve paraprake në funksion të një gjykimi efektiv e që garanton më mirë të drejtat e garancitë procedurale. Por duke qenë tipar i një kontrolli gjyqësor që realizohet në debat e kontradiktoritet në mes të palëve të thirrur në seancë gjyqësore nënkuptohet që kur gjyqtari i seancës paraprake vendos sipas nenit 332/dh të KPP ai sillet si gjyqtari i gjykimit, në një gjykim të kufizuar por pa marrë atributet e gjyqtarit të themelit për çështje të vlerësimit të fakteve, provave e fajësisë.

Sipas interpretimit sistematik të normës, seanca paraprake është shtuar si kre më vete (kreu IX, Seanca paraprake), me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017. Më përpara ne nuk kemi pasur një figurë të gjyqtarit të seancës paraprake, kemi pasur vetëm gjyqtarin e hetimit. Që në fillim të parashikimit të rregullave të dhëna nga neni 332 i KPP (i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, ndryshuar pika 1, shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 41/2021, datë 23.03.2021) parashikohet se [..] Nga interpretimi i këtij rregullimi ligjor del se tashmë kemi një figurë të veçantë gjyqtari i cili ka kompetenca për të shqyrtuar në këtë fazë kërkesën e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjykim, shqyrtim i cili duhet të kryhet brenda 30 ditëve. Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë për shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga palët e procesit penal, gjatë kohës që ky

gjyqtar disponon me vendim për plotësimin e hetimeve, sipas nenit 332/ç të KPP shqiptare.

Disa nga llojet e kërkesave që mund të paraqiten nga palët e procedimit penal, gjatë kësaj kohe janë: zgjatja e afateve të paraburgimit, kërkesa që lidhen me masat e sigurimit (revokimi dhe zëvendësimi); kërkesa që lidhen me marrjen e provave të reja; kërkesa që lidhen me pavlefshmërinë e akteve procedurale dhe papërdorshmërinë e provave, të kryera këto gjatë kohës që gjyqtari i seancës paraprake ka disponuar me vendim sipas nenit 332/ç të KPP shqiptare; kërkesa që paraqet i pandehuri për gjykimin e shkurtuar, pasi gjyqtari i seancës paraprake ka disponuar me vendim sipas nenit 332/ç të KPP shqiptare apo kërkesa për përgjimin e komunikimeve etj.

Kontrolli i hetimeve nga gjyqtari i seancës paraprake është në funksion të një gjykimi efektiv e që garanton më mirë të drejtat e garancitë procedurale të të pandehurit. Por, duke qenë tipar i një kontrolli gjyqësor që realizohet nëpërmjet debatit dhe në zbatim të kontradiktoritetit mes të palëve të thirrura në seancë gjyqësore, nënkuptohet që kur gjyqtari i seancës paraprake vendos sipas nenit 332/dh të KPP, ai ushtron funksione juridiksionale (si gjyqtar i gjykimit), në një gjykim të kufizuar, por pa marrë atributet e gjyqarit që shqyrton themelin e çështjes, në lidhje me vlerësimin e fakteve, provave dhe fajësisë së pandehurit.

Gjyqtari i seancës paraprake kontrollon hetimet paraprake dhe, nëse konstaton se akuza nuk është e plotë, urdhëron plotësimin e tyre sipas nenit 332/ç të KPP, duke përcaktuar drejtimet e hetimeve, afatin brenda të cilit ato duhet të kryhen, provat që duhet të ribëhen, si dhe cakton datën e seancës së re. Nenet 332/ç të KPP dhe 332/dh, parashikojnë dy situata të ndryshme rrethanash e kushtesh procedurale.

Kolegji vlerëson se, kur gjyqtari i seancës paraprake vepron sipas nenit 332/ç të KPP, duke urdhëruar plotësimin e hetimeve nuk disponon me vendim që i jep fund seancës paraprake. Në këtë rast, gjyqtari urdhëron kryerjen e veprimeve të mirëfillta procedurale hetimore e për rrjedhojë, afatet e paraburgimit në këtë rast duhen llogaritur si afate të paraburgimit të fazës së hetimit. Kur gjyqtari i seancës paraprake urdhëron *plotësimin e hetimeve* sipas nenit 332/ç të KPP, palët e procesit penal mund të paraqesin kërkesë për zgjatjen e afateve të paraburgimit. Afati i caktuar nga gjykata për plotësimin e hetimeve është në funksion të hetimeve, ndërsa afati i paraburgimit është autonom nga ai i hetimeve. Afati i caktuar nga gjyqtari i seancës paraprake gjithnjë duhet të jetë brenda afatit tërësor të hetimeve. Në momentin e kthimit të akteve prokurorit, lidhur me afatin e paraburgimit, nëse afati i paraburgimit përfundon gjatë periudhës kur aktet janë kthyer sipas kësaj dispozite, prokurori mund të kërkojë zgjatjen

e afateve të paraburgimit, nëse më parë nuk i ka zgjatur ato, sipas nenit 2/264 të KPP.

Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë të vendosë mbi kërkesat e paraqitura nga palët e procesit penal gjatë kohës që ai ka disponuar me vendim për plotësimin e hetimeve, sipas nenit 332/ç të KPP. Kërkesat e paraqitura nga palët për zgjatjen e afatit të paraburgimit, revokimin/zëvendësimin e masave të sigurimit, marrjen e provave të reja, konstatimin e pavlefshmërisë së akteve procedurale dhe papërdorshmërisë së provave, pranimin e gjykimit të shkurtuar, apo për përgjimin e komunikimeve, etj. shqyrtohen nga gjyqtari i seancës paraprake, gjatë kohës që ai ka urdhëruar plotësimin e hetimeve sipas nenit 332/ç të KPP. Një konkluzion i tillë bazohet në faktin se ligjvënësi ka parashikuar që bashkë me urdhërimin për plotësimin e hetimeve, gjyqtari i seancës paraprake cakton edhe datën kur duhet të përfundojnë hetimet si dhe seancën e re.

Ndërkohë, me ndryshimet në KPP me ligjin nr. 41/2021, datë 23.03.2021, gjyqtari i seancës paraprake është kompetent për vijimin e gjykimit dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit, si dhe kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar. Në shkronjat b) dhe c) të nenit 332/dh të KPP, parashikohet tashmë [...] Edhe në këtë rast, për këtë disponim të gjyqtarit të seancës paraprake sipas pikave “b” e “c” të nenit 332/dh të KPP, i cili zgjidh çështjen përfundimisht, nuk është parashikuar nëse afatet e paraburgimit i përkasin gjykimit apo nëse janë afate autonome. Kompetenca e gjyqtarit të seancës paraprake për të vlerësuar nëse ka prova të mjaftueshme për ta dërguar çështjen në gjykim ose ajo për pushimin e akuzës ose të çështjes të përcaktuara nga shkronjat “a” dhe “ç” të nenit 332/dh të KPP, janë kompetenca të natyrës gjykimore, pasi në këtë rast gjyqtari i seancës paraprake bën një vlerësim tjetër nga ai i hetimeve paraprake. Një element tjetër që tregon se kjo fazë e procedimit ka një karakter juridiksional është edhe parashikimi i pezullimit të afateve të paraburgimit bazuar në nenin 265 të KPP nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake. Pezullimi është ndërprerje e afateve të paraburgimit për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj, afate që rifillojnë pasi të ketë rënë shkaku i pezullimit, dhe vazhdojnë për pjesën e pa konsumuar të tyre. Parashikimi i referimit nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake i mundësisë së pezullimit të afateve të paraburgimit, sipas nenit 332/b, paragrafi 7, nënkupton një mundësi procedurale për të frenuar ecjen e pajustificuar të këtyre afateve.

Pezullimi i afateve të paraburgimit nga ana tjetër si një mundësi procedurale me nenin 265 të KPP, nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake

nënkupton që legjislatori është mjaftuar në këtë mundësi procedurale për të frenuar kalimin e afateve të paraburgimit, kur shqyrtimi në seancë paraprake nuk ecën për shkak të mungesës nga ana e të pandehurve. Pezullimi është ndërprerje e afateve për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj dhe këto afate rifillojnë pasi të ketë mbaruar, ose të jete hequr shkaku i pezullimit, dhe vazhdojnë për pjesën e pa konsumuar të tyre.

Kur gjykata disponon për një nga shkaqet që ligji parashikon për pezullim të afateve të paraburgimit, këto afate nuk ecin, por rifillojnë pas heqjes së pezullimit. Kjo do të thotë, se vetë afati maksimal i paraburgimit nuk tejkalohet proceduralisht, por koha fizike e paraburgimit mund të jete me e gjatë se afati tërësor. Po t'i referohemi shkaqeve të pezullimit të afateve të paraburgimit, ato lidhen me veprime dhe kërkesa të padrejta të mbrojtësit apo të pandehurit, apo me mosparaqitjen apo largimin e mbrojtësit nga gjykimi. Pra, pezullimi i afateve të paraburgimit vendoset për shkaqe që kanë të bëjnë me sjelljen e të pandehurve e mbrojtësve të tyre dhe jo me ato të organit të akuzës apo të gjykatës. Parashikimi i referimit nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake i mundësisë së pezullimit të afateve të paraburgimit, sipas nenit 332/b paragrafi 7, nënkupton një mundësi procedurale për të frenuar ecjen e pajustificuar të këtyre afateve.

Kolegji konstaton se në fakt, nga analiza e dispozitave që rregullojnë seancën paraprake, evidentohen elemente që të shtyjnë drejt konsiderimit të kësaj faze në përbërje të fazës së hetimeve paraprake, referuar përcaktimit të nenit 332/ç të KPP (vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për plotësimin e hetimeve, duke përcaktuar drejtimin e tyre), si dhe nenit 332/d, pika “3” e KPP (vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për kthimin e akteve prokurorit, kur ky i fundit nuk vepron për të bërë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme të akuzës). Gjithsesi, konstatimi i këtyre diferencave në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të seancës paraprake, sipas Kolegjit, konsiderohet i pamjaftueshëm për të “eklipsuar” karakterin tendencialisht juridiksional të kësaj faze të procedimit penal (seancës paraprake), dhe përfshirjen e saj (për efekt të llogaritjes së afateve të paraburgimit të të pandehurit, sipas përcaktimit të nenit 263 të KPP) në një fazë tjetër, të ndryshme nga faza e gjykimit të çështjes (në shkallë të parë), të asaj të hetimeve paraprake. Kolegji çmon se qëllimi i dy dispozitave të cituara më lart është në funksion të kompetencës funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake, në lidhje me kontrollin dhe verifikimin e akuzës së paraqitur prej prokurorit, në aspektet e përmendura më lart, përse i përket nivelit (standardit) provues të “provave” (burimeve të provave në fakt) të mjaftueshme, për të “toleruar” (standardi minimal) gjykimin e çështjes (akuzës). Kjo kompetencë e gjyqtarit të seancës paraprake, që në

thelb lidhet me verifikimin e kushteve të gjykueshmërisë së çështjes, ka diferenca edhe me funksionin e gjyqtarit të gjykimit të çështjes (akuzës) në themel, i cili duhet të verifikojë bazueshmërinë e akuzës në funksion të fajësisë së të pandehurit.

Diferencat e evidentuara më lart, në vlerësimin e Kolegjit, mbështesin konkluzionin se seanca paraprake sipas ligjit procedural penal shqiptar, është një fazë e ndërmjetme, por që ka tipare juridiksionale.

Në interpretimin teleologjik të normave, për aq sa ka parashikuar legjislacioni ynë i ri procedural, kompetencën funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake dhe duke iu përmbajtur karakterit funksional të organit procedues në këtë rast, arrihet në përfundimin se afati 30 ditor i paraburgimit që konsumohet gjatë gjykimit të çështjes para gjyqtarit të seancës paraprake, i takon fazës së gjykimit të çështjes në themel (në shkallë të parë) kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për:

- pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq.
- vijimin e gjykimit nga e njëjta Gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e fajësisë dhe caktimit të dënimit.
- vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar.

- pushimin e akuzës ose të çështjes apo deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, në rastet e parashikuara në ligj, sipas nenit 332/dh, shkronjat “c” dhe “d” të KPP.

Ndërsa, për sa i përket situatës procedurale të parashikuar në nenet 332/ç dhe 332/d paragrafi i tretë i KPP, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon *“kthimin e akteve prokurorit” për “plotësimin e hetimeve”* dhe për *“korrigjimin dhe saktësimin e akuzës”*, pra me verifikimin e pamundësisë së konkludimit të seancës paraprake, në dy rastet e sipërcituara, Kolegji, konsideron periudhën e konsumimit të afateve të paraburgimit për llogari të fazës së procedimi penal, të hetimeve paraprake.

Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson që në lidhje me pyetjen e shtruar për njësim, duhet të arrihet në këtë përfundim njësuës:

1. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të hetimit paraprak kur, gjyqtari i seancës paraprake disponon “Për plotësimin e hetimeve”, sipas nenit 332/c dhe/ose “Për kthimin e akteve prokurorit për korrigjimin ose saktësimin e akuzës”, sipas nenit 332/d, pika 3 e KPP.

2. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjykimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për:

- a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq;
- d) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e fajësisë dhe caktimit të dënimit;
- e) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë, kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar;
- ë) për pushimin e akuzës ose të çështjes, apo deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligj, sipas nenit 332/dh shkronjat «ç» e «d» të KPP.

Duke u kthyer tek rasti konkret, çështja objekt gjykimi, që i përket rekursit të paraqitur prej kërkuar, ndaj vendimmarrjes së Gjykatës [...], të cilat lidhur me kërkesën për deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal “arrest në burg” të caktuar ndaj tij, [...] gjyqtari për hetimet paraprake, Kolegji Penal, duke ju referuar konkluzionit njësuës sipas të cilit (shkronja “a” e pikës 1 të tij) “periudha e afatit të paraburgimit të konsumuar gjatë fazës të trajtimit të çështjes para gjyqtarit të seancës paraprake, kur prej këtij të fundit, është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq, sipas përcaktimit të germës “a”, të paragrafit të parë, të nenit 332/dh të KPP, konsiderohet/përfshihet, në cilësinë e afatit të paraburgimit të fazës së gjykimit (në themel, në shkallë të parë) të çështjes, të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 263 të KPP”, konkludon mbi aplikimin e gabuar të ligjit procedural - përcaktimi i germës “a”, të paragrafit të parë të nenit 332 të KPP - prej gjykatave të faktit (të shkallës së parë dhe të dytë). Si pasojë, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatave të faktit, përse i përket përllogaritjes të afatit të paraburgimit të konsumuar prej të pandehurit Vata, për periudhën prej datës 30.07.2020 deri më datë 06.11.2020, si afat të konsumuar gjatë fazës së hetimit paraprak, është i gabuar, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në vlefshmërinë e masës së sigurimit personal të “arrestit në burg”, të caktuar ndaj tij.

Kolegji së pari vlerëson se, në lidhje me masat e sigurimit, e drejta për të ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, është parashikuar shprehimisht në pikën 8 të nenit 249, të KPP, ku theksohet[...] Në këtë vështrim, rekursi në lëndë të masave të sigurimit duhet të evidentojë shprehimisht shkeljen e ligjit, e lidhur kjo edhe me sa parashikon neni 432 i KPP, ku janë parashikuar shkaqet për të cilat lejohet rekursi në Gjykatën e Lartë. Kolegji thekson se juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë, nënkupton shqyrtimin e rekurseve për shkelje të ligjit material dhe procedural, duke siguruar zbatimin uniform të ligjit apo zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ligji nuk i jep Gjykatës së Lartë asnjë kompetencë për të shqyrtuar elementet materiale dhe faktike të ngjarjeve të hetuara, përfshirë nivelin e provave që

mbështesin dyshimin e arsyeshëm apo elementet që lidhen me vlerësimin e nevojave të sigurimit në rastin konkret.

Kolegji vlerëson se, edhe në rastin e rekurseve në lëndë të masave të sigurimit, shqyrtimi i tyre lidhet ngushtësisht me pretendimet për shkelje të ligjit. Në këtë vështrim, shqyrtimi i fakteve dhe i provave/akteve edhe në këtë rast, del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Kolegji arriti në këtë konkluzion pasi shtroi për diskutim nëse kushtet e kërkuara nga neni 266 i KPP mund të verifikohen në Gjykatën e Lartë, si gjykatë ligji apo duhen verifikuar në gjykatat e faktit. Ky diskutim lind pasi shqyrtimi i kushteve për caktimin e masave të sigurimit, siç mund të jetë ekzistenca në vijim e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova ose/dhe shqyrtimi i kriterëve si përshtatshmëria e masës së sigurimit apo analiza e proporcionalitetit, kërkon domosdoshmërisht edhe çmuarjen e provave/akteve të përfshira në fashikull, vlerësim të rrethanave të faktit dhe të nevojave të sigurimit, vlerësim të personalitetit të të hetuarit/dyshuarit, vlerësim të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit të dyshuar të saj. Kolegji vlerëson se, kufizimi në këtë rast është i lidhur me pamundësinë e Gjykatës së Lartë për të caktuar masën më të përshtatshme të sigurimit, qoftë në favor apo kundër të dyshuarit.

Kolegji Penal, duke vlerësuar ligjshmërinë (emunguar) të vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Shkodër por në të njëjtën kohë edhe pamundësinë faktike të tij për të disponuar korrigjimin e kësaj paligjshmërie, në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke zëvendësuar dhe “uzurpuar” diskrecionin e gjykatave të faktit, çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër [...] që ka vendosur “lënien në fuqi” të vendimit [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, duhet të priset duke u kthyer çështja për rigjykim, pranë asaj gjykate si gjykata kompetente.

Mendim pakice mbi motivet e kundërshtimit (të pjesshëm) të vendimit të Kolegjit Penal

[...] Junë gjyqtar Sokol Binaj, me cilësinë e anëtarit të Kolegjit Penal [...] paraqes motivet e kundërshtimit (të pjesshëm) të vendimit (njehsues) të këtij Kolegji, në justifikim të votës time (pjesërisht) kundër këtij vendimi.

[...] Lidhur me konkluzionet njehsuese të Kolegjit Penal, të sipërcituara, ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, me përjashtim të momentit, të përfundimit – konkluzionit – njehsues, të përcaktuar në piken 1, sipas te cilit, konsiderohen me cilësinë e “afateve të paraburgimit të konsumuara gjatë fazës së hetimeve paraprake” afatet e konsumuara si rrjedhojë e vendimmarrjes së këtij gjyqtari – të seancës paraprake – për të “degraduar” – kthyer – çështjen në disponim të prokurorit, pra, në fazën e hetimeve

paraprake, nën justifikimin e “plotësimit të hetimeve” apo të “korrigjimit dhe të saktësimit të akuzës prej Prokurorit”, për të cilin kam mendimin, në saktësim të konceptit, së vërtet, afatet e konsumuara në plotësim të rekomandim/urdhërimeve të gjyqtarit të seances paraprake, duhet të konsiderohen me cilësinë e afateve të fazës së hetimeve paraprake por të afateve të rifilluara, të rillogaritura, nga e para, në të njëjtat kushte sikurse, në rastet e parashikuara në paragrafin e katërt, të nenit 263 të KPP, për afatet e paraburgimit, të fazave të gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe të dytë, me rastin e prishjes së çështjes nga Gjykatat superiore, të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, të cilat fillojnë të llogariten rishtazi, nga e para, gjithnjë, të toleruara, prej afatit të kohëzgjatjes tërësore të paraburgimit, eventualisht të paezauruar.



18.Vendim nr. 115 (53), datë 18.02.2022
(kufijtë e gjykimit në themel: kontroll/
plotësi e hetimeve paraprake)

Maksima: Pavarësisht se në kohën e gjykimit në shkallë të parë nuk ishin miratuar dhe as kishin hyrë në fuqi ndryshimet e KPP, edhe në dispozitat e mëparshme të KPP nuk përmbanin asnjë dispozitë që të parashikonte që gjykata e themelit kontrollonte veprimtarinë hetimore të prokurorit dhe kishte të drejtë të kthente çështjen për hetime kur vlerësonte se ato nuk ishin të plota. Gjykata e themelit gjykon çështjen mbi provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe nga mbrojtja dhe në fund të shqyrtimit gjyqësor, si krijon bindjen, shpall vendimin, që mund të jetë vendim dënimi, pafajësie ose vendim pushimi.

Fjalë kyçe: kontroll veprimtari hetimore prokuror, gjyqtar i seancës paraprake, gjykatë themeli

Decision no. 115 (53), dated 18.02.2022 (boundaries of trial on the merits: judicial review of the completeness of preliminary investigations)

Legal principle(s): Irrespective of the fact that, at the time of the first-instance proceedings, the amendments to the Criminal Procedure Code had neither been enacted nor entered into force, the earlier provisions of the Code likewise contained no provision empowering the trial court to review the prosecutor's investigative activity or to remit

the case for further investigation on the ground that the investigation was incomplete. The trial court adjudicates the case on the basis of the evidence presented by the prosecution and the defence and, upon completion of the trial and after forming its judicial conviction, renders a judgment, which may be one of conviction, acquittal, or dismissal of the proceedings, as the case may be.

Keywords: *review of prosecutor's investigative activity, preliminary hearing judge, court of fact*

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. 697, të vitit 2004, për veprën penale “Vrasja me dashje”, e ngelur në tentativë, parashikuar nga neni 76 dhe 22 i K.Penal. Ky procedim penal është pezulluar me vendimin e datës 19.04.2005, për shkak se nuk është bërë i mundur identifikimi i autorit. Në datën 10.11.2014 është vendosur rifillimi i hetimeve nga ana e Prokurorisë së [...] në lidhje me këtë procedim penal.

Nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar se për ngjarjen e datës 16.01.2004, [...] shtetasi A.F. ka deklaruar se rreth orës 19:30, në lokalin e tij ka hyrë një shtetas të cilin e njohte si fytyrë, i cili është vëllai i G.B. Personi i kërkoj të dëlnin jashtë për t'u sqaruar dhe të dy kanë dalë jashtë lokalit. Personi i ka thënë se kishte një sqarim me të vëllain Arjanin dhe në këtë kohë ka nxjerrë një armë tip pistoletë të cilën i'a ka drejtuar Arbenit. Ndërkohë që e ka fyer me fjalë fyese, Arbeni i ka kërkuar që të qetësohej dhe të vinte ditën tjetër për t'u sqaruar me vëllain e tij Arjanin. Duke i folur i ka ulur pistoletën dhe personi është larguar dhe është futur në një automjet tip Honda me targa Tiranë.

Personi u largua me mjetin tip Honda, duke u kthyer pas disa minutash, dhe pasi ka ndaluar mjetin pranë lokalit, ka qëlluar tre herë me pistoletë tip TT në drejtim të lokalit, ku shtetasi A.F. ka qenë jashtë tij, [...] duke biseduar me dajën e tij Festim. Shtetasi A.F. ka sqaruar se vëllai i G.B. e kishte bërë këtë veprim pasi kishte dëgjuar nga të tjerë që vëllai i tij Arjani kishte pirë kafe me motrën e Gentjanit, shkak për të cilin është ndjerë i fyer. Shtetasi A.F. ka sqaruar se nuk e ka parë vëllain e G.B. gjatë këtyre viteve, por Genti ka vetëm një vëlla i cili është personi që qëllloi me armë në lokalin e tij.

Në lidhje me këtë procedim penal janë kryer veprimet hetimore, këqyrje e vendit të ngjarjes, akt ekspertimi vlerësim prove, janë marrë deklaratimet e personave të pranishëm në vendin e ngjarjes, A.F., E.K., T.S., F.M., A.F. Shtetasi G.B., i pyetur në lidhje me ngjarjen, ka deklaruar se në muajin

nëntor 2004 ai ka qenë jashtë shtetit. Me vëllain nuk ka pasur komunikim, pasi nuk kanë marrëdhënie të mira, [..]

Gjatë hetimeve paraprake, nga prokuroria është kërkuar në gjykatë caktimi i masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj personit nën hetim B.B., kërkesë që është refuzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, vendim ky që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë. Të dyja gjykatat kanë arsyetuar se nga të dhënat rezulton se personi nën hetim B.B. mund të jetë autor i veprave penale të parashikuara nga nenet 84, 278/2 dhe 274 të K.Penal që ka qenë në fuqi në kohën e ndodhjes së ngjarjes, por që për këto vepra penale ndjekja penale në bazë të nenit 66 të K.Penal është parashkruar.

Pas kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore, nga prokuroria është dërguar në gjykatë kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr.697 të vitit 2004 për veprën penale “Vrasja me dashje”, e ngelur në tentativë, parashikuar nga neni 76 dhe 22 i K.Penal në ngarkim të të pandehurit B.B..

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, [..] ndër të tjera, ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin B.B. për veprën penale të vrasjes me dashje të mbetur në tentativë [..] ta dënojë atë me 10 (dhjetë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të KPP duke i zbritur 1/3 e masës së dënimit, i pandehuri dënohet me 6 vjet e 8 muaj burgim. [..]

Gjykata e Apelit Vlorë, [..] ka vendosur prishjen e vendimit [..] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

[..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se pretendimet e ngritura në rekursin e prokurorisë janë të bazuara dhe përbëjnë shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, pasi prej kësaj gjykate është zbatuar gabim ligji procedural penal, konkretisht neni 428/1/ç të KPP që i jep të drejtë Gjykatës së Apelit të prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të kthejë çështjen për rigjykim. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton dhe mungesë arsyetimi nga Gjykata e Apelit në lidhje me shkakun e prishjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, Gjykata e Apelit nuk ka interpretuar si duhet dispozitat në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me themelin e çështjes dhe të drejtën e disponimit të saj në fund të shqyrtimit gjyqësor.

Kolegji vlerëson se nuk është i saktë interpretimi i Gjykatës së Apelit kur është shprehur se nuk rezulton që nga gjykata e shkallës së parë të jenë kryer verifikimet e duhura nëse nga organi i prokurorisë është kryer një

hetim i plotë dhe i gjithanshëm në lidhje me faktin penal objekt procedimi dhe nëse janë kryer veprimet hetimore të propozuara nga oficeri i policisë gjyqësore. Gjykata e shkallës së parë që gjykon themelin e çështjes, referuar nenit 333 e vijues të KPP, ka të drejtë të shqyrtojë çështjen penale, duke zhvilluar shqyrtimin gjyqësor e duke marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga secila palë (akuza dhe mbrojtja) në respektim të parimit të kontraditoritetit dhe barazisë së armëve. Në fund të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e themelit merr vendim referuar bindjes së brendshme të krijuar nga debati gjyqësor dhe provat e administruara në seancë gjyqësore. Ky vendim mund të jetë vendim pafajësie ose pushimi (sipas nenit 387 të KPP) ose vendim dënimi kur gjykata bindet për fajësinë e të pandehurit (sipas nenit 390 të KPP).

Kolegji vlerëson se ligji procedural penal nuk parashikon në asnjë dispozitë ligjore të drejtën e gjykatës së themelit për të kontrolluar kryerjen e veprimeve hetimore nga prokuroria dhe aq më pak kthimi i çështjes për hetime të mëtejshme. Një kompetencë e tillë me ndryshimet e KPP i përket gjyqtarit të seancës paraprake që ka të drejtë të urdhërojë prokurorin për plotësimin e hetimeve duke përcaktuar dhe drejtimin e tyre, referuar nenit 332/ç të Kodit. Gjatë gjykimit në shkallë të parë nuk kishin hyrë në fuqi ndryshimet e miratura me ligjin nr. 35/2017 të KPP, ndërsa këto ndryshime kishin hyrë në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes në Apel.

Në çështjen objekt gjykimi, gjykimi ka qenë në fazën e themelit, në të cilën gjykata e shkallës së parë po gjykonte kërkesën e prokurorisë për gjykimin e të pandehurit. Kolegji vlerëson se, pavarësisht se në kohën e gjykimit në shkallë të parë nuk ishin miratuar dhe as kishin hyrë në fuqi ndryshimet e KPP, edhe në dispozitat e mëparshme të KPP nuk kishte asnjë dispozitë që të parashikonte që gjykata e themelit kontrollonte veprimtarinë hetimore të prokurorit dhe kishte të drejtë të kthente çështjen për hetime kur vlerësonte se ato nuk ishin të plota. Gjykata e themelit gjykon çështjen mbi provat e paraqitura nga organi i akuzës dhe nga mbrojtja dhe në fund të shqyrtimit gjyqësor, si krijon bindjen, shpall vendimin, që mund të jetë vendim dënimi, pafajësie ose vendim pushimi. Në rast se nuk ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës, siç argumenton Gjykata e Apelit në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë vendos ta deklarojë të pafajshëm të pandehurin.

Kolegji thekson se gjykata e shkallës së parë ka detyrimin të vendosë mbi provat që i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, ndërsa nuk ka kompetencë të kontrollojë veprimtarinë hetimore të prokurorit në këtë fazë të gjykimit. Për më tepër, Gjykata e Apelit ka prishur vendimin e shkallës së parë, për shkak se ka konstatuar moskryerje të veprimeve procedurale të propozuara nga oficeri i policisë gjyqësore, arsyetim që gjendet i pabazuar nga Kolegji.

Oficeri i policisë gjyqësore nuk është organi që ushtron ndjekjen penale dhe as që përfaqëson akuzën, prandaj arsyetimi i Gjykatës së Apelit për prishje të vendimit sepse nuk janë kryer veprimet hetimore të kryera prej tij nuk është i bazuar në asnjë dispozitë procedurale. Nëse veprimtaria e prokurorit nuk ka qenë e plotë në kuadër të hetimit paraparak dhe provat janë të pamjaftueshme për të mbështetur akuzën e ngritur, gjykata e themelit do të marrë vendim pafajësie.

Arsyetimi i Gjykatës së Apelit se nga gjykata e shkallës së parë nuk është kontrolluar nëse janë kryer veprimet hetimore të propozuara nga oficeri i policisë gjyqësore nuk është i bazuar në ligjin procedural penal. Gjykata e themelit nuk verifikon veprime të tilla, por nëse ajo vlerëson se nuk ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës merr vendim pafajësie.

Gjykata e Apelit, nëse do të krijonte bindje të ndryshme në lidhje me çështjen objekt gjykimi, mund të dispononte duke ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të deklaronte të pafajshëm të pandehurin. Në rastin konkret nuk mund të vendosej prishja e vendimit të shkallës së parë dhe dërgimi i çështjes për rigjykim pasi nuk ka pasur shkaqe për një vendimmarrje të tillë referuar nenit 428/1/ç të KPP ose të paktën një shkak i tillë nuk është i arsyetuar.

Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit nuk e ka arsyetuar vendimmarrjen e saj kur ka disponuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është dhënë në shkelje të normave procedurale penale dhe për pasojë çështja duhet të priset dhe të kthehet për rigjykim me tjetër trup gjykues. Gjykata e Apelit nuk ka përcaktuar se cilat norma procedurale ka shkelur konkretisht gjykata e shkallës së parë dhe në cilën pikë të nenit 428/1/ç të KPP e bazon vendimmarrjen e saj. Në këtë drejtim, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është i paarsyetuar, pasi nuk përcakton shkakun e prishjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke u bërë shkak që Kolegji të vendosë prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim.

Në rishqyrtim, Gjykata e Apelit duhet të marrë në konsideratë konkluzionet e mësipërme të Kolegjit në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës së themelit dhe disponimin në fund prej saj. Gjithashtu, Gjykata e Apelit duhet të arsyetojë se cilat dispozita procedurale nuk ka zbatuar gjykata e shkallës së parë, që janë bërë shkak për prishjen e vendimit të saj, sipas nenit 428 të KKP. Gjykata e Apelit duhet të shqyrtojë çështjen në themel, në drejtim të shkaqeve të ankimit me të cilat është investuar dhe duke gjykuar në ushtrim të rolit të saj, si gjykatë fakti dhe ligji.

Sa më sipër, Kolegji vendos prishjen e vendimit [...] të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.



**19.Vendim nr. 1151 (183),
datë 24.06.2022 (ekzistenca e provave
të mjaftueshme për të mbështetur
akuzën)**

Maksima: Në fazën e seancës paraprake, gjyqtari nuk mund të vlerësojë fajësinë e të pandehurit sipas standardit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por vetëm ekzistencën e provave të mjaftueshme për të mbështetur akuzën dhe për të justifikuar dërgimin e çështjes në gjykim. Pushimi i çështjes lejohet vetëm kur mungesa e faktit penal është e qartë dhe e dukshme.

Fjalë kyçe: gjyqtar i seancës paraprake, pushim i çështjes

Decision no. 1151 (183), dated 24.06.2022 (existence of sufficient evidence to support the charge)

Legal principle(s): At the preliminary hearing stage, the judge is not called upon to determine the defendant’s guilt according to the standard of proof beyond a reasonable doubt. Rather, the judge’s task is limited to assessing whether sufficient evidence exists to support the charge and justify the committal of the case for trial. The dismissal of the case is permissible only where the absence of a criminal offence is clear and manifest.

Keywords: preliminary hearing judge, dismissal of the case

Rrethanat e çështjes:

[..] Prokuroria pranë Gjykatës [..] ka regjistruar çështjen penale në ngarkim të shtetasve, M.P dhe (në një moment të dytë) dhe Gj.L, për veprat penale [..] të parashikuar nga neni 143/1 i KP dhe [..] nga neni 186/1 i KP.

[..] Sipas kallëzuesve shtetasi M.P, ka fallsifikuar një deklaratë të cilën e ka përdorur në gjykatë dhe, sipas të cilës, kallëzuesi dhe disa fermerë të tjerë, i kanë njohur, shtetasit Pëllumbi, një shpenzim prej 52.000.000 (pesëdhjetë dy milion) lekë të vjetra, të përvetësuar prej tij. [..]

Nga ana e Prokurorisë është sekuestruar fashikulli i çështjes civile me palë; [..]. Në këto dosje gjenden të administruara kopjet origjinale të deklaratave, për të cilat kallëzuesit pretendojnë se janë të falsifikuara. Sipas, aktit të ekspertimit [..], është arritur në konkluzionin se “emër, mbiemër” Q.S, N.L, M.M dhe F.B, duhet të jenë shkruar prej tyre, kurse dorëshkrimi i plotësuar në rubrikat e tjera të këtyre deklaratave, nuk rezulton të jenë (nën) shkruar prej tyre. [..]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. [...] ka vendosur: *“Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë [...] për dërgimin e çështjes për gjykim - të procedimit penal [...], me të pandehur M.P i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mashttrimit”, të parashikuar nga neni 143/1 i KP dhe të pandehurit Gj.L, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumentave”, të parashikuar nga neni 186/1 i KP. Pushimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit M.P [...] pasi fakti nuk përbën veprë penale. Pushimin e akuzës në ngarkim të pandehurit Gj.L [...] pasi nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. [...]”.* [...]

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin e saj [...], ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. [...]”.* [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

[...] Kolegji penal, vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit, Shkodër, nr. [...] është marrë në zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit material dhe procedural. [...]

Kolegji konsideron pretendimin e viktimave nga vepra penale, të materializuar në shkaqet e rekursit, në kushtet e bazueshmërisë. Për të vlerësuar pretendimin e viktimave nga vepra penale, Kolegji vlerëson të ndalet në lidhje me natyrën e gjykimit të seancës paraprake dhe qëllimin që ka patur ligjvënësi në parashikimin e kësaj fazë procedurale me ndryshimet që janë bërë në vitin 2017.

[...] në Kreun IX është shtuar “Seanca paraprake” në cilësinë e një faze të karakterit interlokutor midis përfundimit të hetimeve paraprake dhe gjykimit të çështjes – akuzës – në themel, rregullat e zhvillimit të të cilës parashikohen në nenet 332- 332/gj, ndërsa “Gjykimi” i çështjes penale parashikohet në Kreun I, nenet 333 e vijues të këtij kodi. [...] pra, në thelb, me vendimmarrjet lidhur me ushtrimin (ose jo) të ndjekjes penale, domethënë të kërkesës për “pushimin e çështjes” – përcaktimi i germës “a” të paragrafit të gjashtë të nenit 327 të KPP apo të “dërgimit të çështjes në gjyq” – përcaktimi i germës “b”, të paragrafit të gjashtë, të nenit 327 të KPP. Hetimet paraprake “synojnë” verifikimin e elementëve të përshtatshëm në funksion të konsolidimit të dyshimit që një subjekt i caktuar mund të ketë kryer një krim duke ia nënshtruar, këtë fakt, vlerësimit të një organi juridiksional.

Dispozita e sipërcituar – neni 327 i KPP – mbasi “shpalos” qëllimin e “hetimeve paraprake” – kryerja e hetimeve të nevojshme në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale, evokon, në të njëjtën kohë, edhe “mjedin” që mundëson realizimin e qëllimit të këtyre “hetimeve”, të identifikuar në parimin e “gjithanshmërisë” së realizimit të tyre, që presupozon një

funksion të dyfishtë, nga njëra anë, “gjithanshmëria” bëhet e domosdoshme për t’i toleruar prokurorit mundësinë për të ushtruar (në përfundim të hetimeve) opsionet e mundshme në raport me parimin e “ushtrimit të detyrueshëm të ndjekjes penale” si dhe të qëllimit për t’i (lejuar) dhënë, të hetuarit, mundësinë për të patur akses në ritet (e gjykimit) procedurale alternative (nga gjykimi i zakonshëm) që presupozon ekzistencën e një kuadri provues, ezaurues, dhe, nga ana tjetër, shërben si garanci përballë ushtrimit të ndjekjes penale në mënyrë sipërfaqësore.

Qëllimi i hetimeve të realizuara prej prokurorit dhe policisë gjyqësore në kuadrin e kompetencave të përcaktuara nga KPP është t’i lejojë të parit – prokurorit – “hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale” (neni 277/1 i KPP) domethënë, t’i tolerojë këtij të fundit zgjedhjen, midis “ushtrimit të ndjekjes penale” (nëpërmjet formulimit të akuzës, dhe kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, në përfundim të hetimeve paraprake, neni 327/6/1 i KPP) dhe kërkesës për “pushimin e çështjes”, neni 327/6/a i KPP, kjo e fundit, për tu paraqitur para gjyqtarit (të hetimeve paraprake) kur “njoftimi për veprën penale – *notitia criminis*”, mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal, në konformitet me përcaktimet e nenit 287/1 të KPP dhe legjitimuar këto hetime, konsiderohet i pathemeltë, “sepse elementët e provës, të mbledhur, gjatë hetimeve paraprake nuk rezultojnë të përshtatshëm (të mjaftueshëm) për të mbështetur akuzën në gjykim”.

Lidhur me përcaktimin (formulimin) e nenit 328 të KPP, që bën fjalë për “*pushimin e akuzës ose të çështjes*”, lidhur me të gjithë përcaktimet e dispozitave që disponojnë lidhur me këtë fazë të rëndësishme të procedimit, të hetimeve paraprake, duke filluar që nga momenti i regjistrimit të njoftimit për veprën penale, *notitia criminis*, sipas përcaktimit të nenit 287/1 të KPP, që koïncidon me momentin e “fillimit të çështjes penale”, dhe deri në momentin e përfundimit të hetimeve (paraprake) që “daton”, koïncidon me, përcaktimet e nenit 327 të KPP, veprimet, përmbyllëse të hetimeve, të prokurorit dhe policisë gjyqësore, për asnjë moment nuk bëhet fjalë për “akuzë” të komunikuar “personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet” ose “personit të cilit i atribuohet vepra (fakti) penale” e regjistruar me cilësinë e “notitia criminis”, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, e cila, sikurse përcaktohet në paragrafin e dytë të nenit 287 të KPP, është objekt i pasqyrimin dhe i azhornimit në vazhdimësi, prej prokurorit, përgjatë kohëzgjatjes së hetimeve paraprake, në kushtet e verifikimit të ndryshimit “të cilësimit juridik të faktit penal” apo të ndonjë rrethane të veprës penale, dhe, në mënyrë të veçantë, i verifikimit të themelësisë së saj, në funksion të vendimmarrjes (disponimit) përfundimtare të

prokurorit, sikurse përcaktohet në paragrafin e gjashtë të nenit 327 të KPP, të zgjidhjes së “dilemës”, për pushimin e procedimit penal të regjistruar (apo kërkesa drejtuar gjykatës për pushimin e çështjes, procedimit, për krimet), në kushtet e verifikimit të “pathemelësisë së *notitia criminis*” për të mbështetur dhe kontestuar një akuzë ndaj personit të hetuar, pra, në thelb, të pandehjes së tij, apo, të paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq – në kushtet e verifikimit të “provave” – burimeve të provave (sipas përcaktimeve të neneve 294, 331/3/c, 332/6/1/ç të KPP) të mjaftueshme në mbështetje të akuzës (sikurse “pretendon” përmbajtja e paragrafit të parë, gërma “a”, e nenit 332/dh të KPP).

Prokurori, mbi rezultatet e hetimeve paraprake, përpilon “*kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq*”, sipas përcaktimit të nenit 331 të KPP, të cilën, i’a komunikon, paraprakisht, të hetuarit, ndaj të cilit janë zhvilluar hetimet (paraprake). Ky është edhe momenti procedural i komunikimit të akuzës, këtij të fundit, pra i kontestimit të akuzës dhe i paraqitjes së saj para një organi juridiksional (gjyqtarit të seancës paraprake), në funksion të verifikimit të themelësisë së saj, pra, në thelb, i promovimit, ushtrimit, të ndjekjes penale. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori do të prononcohet, mbi bazën e rezultateve korrente të këtyre hetimeve, në kushtet e përcaktimit të paragrafit të parë të nenit 331 të KPP, kur nuk procedon sipas neneve 328, 329/a të KPP, me pushimin (apo kërkesën) e çështjes (jo të akuzës) kërkon dërgimin e çështjes në gjyq.

[...] paragrafi i parë i nenit 304 të KPP, - nuk është më e orientuar (finalizuar) vetëm në drejtim të disponimeve që kanë të bëjnë me ushtrimin e ndjekjes penale, pra në mbështetje (provues) të **“standartit provues” minimal**, të kërkuar për “kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq – prova (burime) të mjaftueshme në mbështetje të akuzës (sikurse përcaktohet në gërmën “a” të paragrafit të parë të nenit 332/dh të KPP), por edhe në drejtim të krijimit të materialit (provues) të përdorshëm menjëherë në gjykim, pra të gatshëm për tu përdorur në gjykim.

Kontrolli juridiksional mbi “ushtrimin e detyrueshëm të ndjekjes penale”, prej prokurorit (të pavarur), shërben për të përcaktuar nëse në hetimet paraprake janë mbledhur të gjithë elementët e domosdoshëm, me fjalë të tjera, nëse hetimet paraprake janë të plota (të kompletuara përsa i përket anës sasiore dhe cilësore). [...]sepse rregulli (standardi) i gjykimit, që prokurori, por edhe policia gjyqësore, duhet të ndjekin, është i njëjtë me atë që i imponohet gjyqtarit të hetimeve paraprake, në vlerësimin, sipas nenit 329/3 të KPP, e kërkesës për “pushimin e çështjes”.

Ngaanatjetër, dukejureferuarpërmbajtjessëdiskrecionitvendimmarrës të gjyqtarit të seancës paraprake, do të konkludohej se, duhet të kufizohet

në vlerësimin nga pikëpamja procedurale e elementëve të provës së mbledhur gjatë hetimeve paraprake, por pa bërë një shqyrtim në themel të fajësisë së të pandehurit, në kuptimin e suportit (mjaftueshmërisë) të këtyre elementeve në funksion të dërgimit në gjykim të akuzës të cilat, jo domosdoshmërisht duhet të karakterizohen prej “uniformitetit”, përsa kohë që, edhe në kushtet e prezencës, në kuadrin provues, mbështetës, të kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq, të provave të kundërta, standarti provues i mjaftueshmërisë – suficencës - së këtyre elementëve, toleron orientimin drejt dërgimit të kësaj kërkesë – akuzë – në, mënyrë të pashmangshme, në gjykim.

Në mbështetje të argumenteve të sipërcituara, vjen edhe përcaktimi i gërmës “a”, të paragrafit të parë, të nenit 328 të KPP, [...] Pra standardi i të provuarit që duhet të arrihet nga hetimet paraprake me qëllim pranimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, referuar natyrës së gjykimit në seancë paraprake, është ai i provave të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjykimin e themelit.

Natyra e gjykimit të seancës paraprake, nuk toleron mundësinë e gjyqtarit të kësaj seance që të shprehet – prononcohet – lidhur me provueshmërinë e akuzës në standartin provues “përtej tej çdo dyshimi të arsyeshëm”, të parashikuar në nenin 390/1 të KPP, për shkak se një konkluzion i tillë i përket fazës së gjykimit të çështjes në themel dhe formësohet mbi bazën e provave të marra në gjykim në prezencë të kontradiktoritetit të palëve para një gjykate natyrale dhe neutrale, ndërkohë që, sikurse u sipërcitua, funksioni i gjyqtarit të seancës paraprake presupozon kontrollin paraprak të kërkesës së paraqitur prej Prokurorit, për dërgimin e çështjes në gjykim, përsa i përket përshtatshmërisë së kësaj kërkesë – të akuzës së formuluar, nëpërmjet saj - për të mbështetur (përbulluar) një gjykim të mirëfilltë të çështjes në themel, (mbi bazën e ekzaminimit të burimeve të provave - mbështetëse të akuzës së kontestuar të pandehurit, në prezencë të kontradiktoritetit të palëve), kontroll i realizuar, sikurse përcaktohet në gërmën “a” të paragrafit të parë të nenit 332/dh të KPP, mbi bazën e standartit provues të mjaftueshmërisë – suficencës – së këtyre elementëve provues (burimeve të provave të grumbulluara nga Prokurori përgjatë fazës së hetimeve paraprake) në mbështetje të akuzës.

[...] Gjyqtari i seancës paraprakë pranë Gjykatës [...], në zbatim të gabuar të ligjit procedural, gjatë shqyrtimit të çështjes janë pozicionuar në cilësinë e gjyqtarit të themelit, duke përdorur, në funksion të gjykimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim, të “filtrimit” të saj, standartin provues të gabuar, të aplikueshëm për këtë fazë konkluzive të procedimit – të gjykimit të çështjes – akuzës – në themel.

Gjyqtari i seancës paraprake, [...] në kundërshtim me përcaktimet e gërmës “a” të nenit 332/dh/1 në lidhje me nenin 328/1/a të KPP, [...] ka vendosur pushimin e çështjes penale të regjistruar në ngarkim të të pandehurve të akuzuar, respektivisht, për veprat penale të parashikuara nga nenet 143/1 dhe 186/1 të KP, megjithë prezencën, minimalisht dhe mjaftueshmërisht të të dhënave – të elementëve provues – të justifikimit – përshtatshmërisë së tyre për të mbështetur akuzën (akuzat) e kontestuar nga Prokurori këtyre të fundit.

Përfundimisht, Kolegji Penal konsideron vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, [...] në kushtet e paligjshmërisë – të zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal - përsa kohë në kundërshtim me kriteret – standartet - provuese të parashikuara në nenet 328/1/a - për pushimin e çështjes dhe 332/dh/a – për dërgimin e çështjes në gjykim - të KPP.

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se, rekursi i paraqitur kundër vendimit nr. [...], të Gjykatës së Apelit, Shkodër, përmban shkaqe të parashikuara në nenin 432 të KPP dhe si i tillë duhet të pranohet.



**20. Vendim nr. 763,
datë 05.07.2022 (kompetencë lëndore/
funktionale: çështje të veçuara të të
njëtit procedim penal)**

Maksima: Çështjet e veçuara të të njëtit procedim penal nga gjyqtari i seancës paraprake duhet të gjykohen prej tij dhe për rrjedhojë çështja të vijojë gjykimin tek po ky gjyqtar.

Fjalë kyçe: kompetencë lëndore/funkionale gjyqtar i seancës paraprake, veçimi i çështjes

Decision no. 763, dated 05.07.2022 (subject matter/functional competence: separate cases of the same criminal proceeding)

Legal principle(s): Severed proceedings arising from the same criminal case ordered by the judge of the preliminary hearing must continue to be heard by the same judge. .

Keywords: subject matter/functional jurisdiction of the judge, preliminary hearing judge, severance of proceedings

Rrethanat e çështjes:

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës (gjyqtari i seancës paraprake) është paraqitur për gjykim kërkesa e prokurorisë për dërgimin në gjyq të procedimit penal [...], në ngarkim të pandehurve të mitur në konflikt me ligjin [...]akuzuar për kryerjen e veprave penale të përshkruara në pjesën hyrëse të vendimit dhe të pandehurve [...]akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278, paragrafi 2 i KP dhe [...]akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 83 i KP.

Gjyqtari i seancës paraprake, [...]vendosi veçimin e gjykimit të të miturve në konflikt me ligjin [...]nga të pandehurit e rritur [...]. Gjyqtari i seancës paraprake (gjyqtar F.D.) ka vazhduar gjykimin e çështjes në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, ndërsa procedimi penal në ngarkim të të pandehurve të rritur është hedhur në short dhe i ka kaluar për gjykim, si gjyqtar i seancës paraprake, gjyqtar M.K.

Në përfundim të seancës paraprake, [...]vendosi kthimin e çështjes prokurorisë për të proceduar me zbatimin e masës së shmangies ndaj të miturve në konflikt me ligjin [...] sepse kushtet dhe kriteret për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale të pandehurve të mitur në konflikt me ligjin [...]përmbushen plotësisht.

Gjykata e seancës paraprake që i kaloi për shqyrtim procedimi penal në ngarkim të të pandehurve të rritur (gjyqtare M.K.), [...]ka konstatuar se ka pengesë ligjore për gjykimin e kësaj çështje. Gjykata ka relatuar se, sipas nenit 332 KPP, çështjet e ndara nga i njëjti procedim shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar i seancës paraprake dhe në këto kushte kjo çështje i përket gjyqtarit të seancës paraprake që ka bërë ndarjen e çështjes. Gjykata ka relatuar se kjo çështje t’i kalojë kancelarit të gjykatës për t’iu nënshtruar procedurave të shortit.

Gjyqtari që ka marrë vendim për veçimin e çështjes (gjyqtar F.D.) ka zhvilluar disa seanca në lidhje me çështjen, ndërsa, me vendimin [...]ka vendosur: *“Parashtrimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes së kompetencës përpara Gjykatës së Lartë.”* [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...]konstaton se [...] në çështjen në shqyrtim, Kolegji vlerëson se ka mosmarrëveshje për kompetencën funksionale/lëndore të shqyrtimit të çështjes penale midis trupit gjykues që i ka kaluar çështjen gjyqtarit të mëparshëm të seancës paraprake dhe gjyqtarit të seancës paraprake që ka marrë vendim për veçimin e çështjeve dhe që ka investuar me konflikt

kompetence Gjykatën e Lartë. Të dy këto trupa gjykues nuk pranojnë të marrin në shqyrtim çështjen penale me objekt dërgimin në gjyq të procedimit penal ndaj të pandehurve [..].

Kolegji konstaton se gjyqtari i seancës paraprake që nuk ka pranuar të gjykojë çështjen penale me objekt dërgimin në gjyq të procedimit penal (gjyqtare M.K.) nuk ka marrë një vendim, qoftë edhe të ndërmjetëm, për të mbajtur një qëndrim në lidhje me çështjen penale të seancës paraprake që i ishte caktuar për shqyrtim. Kjo gjyqtare duhet të ishte shprehur me një vendim moskompetence, duke parashtruar se në thelb kompetenca lëndore për gjykimin e kësaj çështje i përket gjyqtarit të seancës paraprake që ka marrë vendim për veçimin e çështjeve, në kuptim të nenit 332/1/1 të KPP. Kolegji vë në dukje se kalimi i një çështjeje gjyqësore nga një gjyqtar tek një tjetër do të duhet bërë me një vendimmarrje nga ana e gjykatës që i është caktuar çështja për gjykim, në rastin konkret vendimmarrje jo përfundimtare. Gjykata nuk mund të shmangë gjykimin e një çështjeje të caktuar me short sipas ligjit me anë të një veprimi apo procedure administrative si kalimi i dosjes për short tek kancelari i gjykatës.

Megjithatë, pavarësisht kësaj mungese veprimi nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake, Kolegji vlerëson se në thelb qëndrimi i saj (për të cilin Kolegji gjen arsyetim vetëm në procesverbalin e seancës gjyqësore) është i drejtë. Rezulton se objekt gjykimi në seancë paraprake ka qenë procedimi penal ndaj të pandehurve si më sipër, të cilët janë një pjesë të mitur në konflikt me ligjin dhe një pjesë të pandehur të rritur. Gjyqtari i seancës paraprake (gjyqtari që ka investuar me konflikt kompetence Kolegjin Penal) ka vendosur veçimin e çështjes, në respektim të nenit 93 të KPP. Pavarësisht kësaj, gjyqtari ka vazhduar me gjykimin e çështjes në seancë paraprake vetëm për të miturit në konflikt me ligjin, ndërsa për të pandehurit e rritur çështja është hedhur me short dhe i ka kaluar një gjyqtari tjetër të asaj gjykate. Kolegji e vlerëson një praktikë të tillë në kundërshtim me nenin 332/1 të KPP [..]

Ligji procedural penal e parashikon shprehimisht se çështjet e ndara të të njëjtit procedim penal në seancë paraprake shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar. Në këto kushte, gjyqtari i seancës paraprake që ka kryer veçimin ka pasur detyrimin për t'i shqyrtuar të dyja këto çështje. Kalimi i procedimit të ndarë tek një gjyqtar tjetër, i cili më vonë i'a kaluar përsëri çështjen gjyqtarit të mëparshëm, ka krijuar vonesë në gjykimin e kësaj çështjeje në seancë paraprake, për të cilin ligji procedural penal parashikon afat gjykimi 30 ditë nga data e depozitimit të kërkesës.

Në lidhje me pretendimin e ngritur në parashtrimin e konfliktit të kompetencës se gjyqtarja duhet të jepte dorëheqjen nga gjykimi i çështjes,

Kolegji e gjen të pabazuar këtë pretendim. Kolegji thekson dallimin midis rasteve të papajtueshmërisë së gjyqtarit për gjykimin e një çështje, pasi ai ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë së parashikuar nga nenet 15, 16, 17 të KPP dhe rasteve kur ai nuk mund të gjykojë një çështje, pasi kompetencën lëndore/funksionale ligji i'a jep në mënyrë të shprehur një gjyqtari tjetër, siç ka ndodhur në rastin konkret. Kolegji vlerëson se gjyqtarja e seancës paraprake M.K. nuk ndodhej në ndonjë shkak papajtueshmërie për gjykimin e çështjes në mënyrë që të jepte dorëheqjen, por ajo nuk mund ta gjykonte çështjen, për shkak se neni 332/1 i KPP parashikon si gjyqtar kompetent për gjykimin e saj gjyqtarin e seancës paraprake që ka veçuar çështjet.

Për sa më lart arsyetohet, Kolegji [...]vlerëson se në rastin konkret kompetenca për gjykimin e çështjes me objekt dërgimin në gjyq të procedimit penal ndaj të pandehurve [...]përket gjyqtarit të seancës paraprake që ka investuar me konflikt kompetence Gjykatën e Lartë, prandaj aktet duhet t'i kthehen këtij gjyqtari me qëllim vazhdimin e gjykimit të çështjes.



**21. Vendim nr. 94 (23),
datë 19.01.2023 (Pushim akuze:
ndalim vlerësimi i provave/elementeve
të figurës së veprës)**

Maksima: Gjyqtari i seancës paraprake mund të pushojë akuzën kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara nga neni 328 i KPP, vendim ky që merret nga e tij në zbatim të nenit 332/dh, pika 1, shkronja “ç” e këtij Kodi, por, gjyqtari i seancës paraprake nuk mund t'i hyjë vlerësimit të provave, të çmojë vlerën e tyre provuese në raport me faktin apo fajësinë e të pandehurit apo në raport me prova të tjera, sikundër rezulton se ka ndodhur në rastin konkret.

Fjalë kyçe: kompetencë funksionale, gjyqtar seancë paraprake, pushim akuze, vlerësim prove

Decision no. 94 (23), dated 19.01.2023 (Dismissal of charges: prohibition of assesment of evidence/elements of the crime)

Legal principle(s): The preliminary hearing judge may dismiss the charge when the circumstances provided for in Article 328 of the CPC exist, this decision is taken by the judge in application of Article 332/dh, point 1, letter “ç” of this Code, but the preliminary hearing judge may not enter into the evaluation of the evidence, assess its

probative value in relation to the fact or guilt of the defendant or in relation to other evidence, as it turns out to have happened in the specific case.

Keywords: *functional jurisdiction, preliminary hearing judge, dismissal of charges, assesment of evidence*

Rrethanat e çështjes:

Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat e faktit, ka rezultuar se, shtetasit A.A., Gj.Gj., U.P, A.L, dhe H.A. kanë shkuar më datë 15.12.2018, [...] në lokalin e quajtur “Maria Bonita”, [...] në pronësi të shtetasit A.F.. Fillimisht, para se të hynin në ambientet e këtij lokali, ata janë kontrolluar nga shtetasit Y.L. dhe F.M, që janë të punësuar si punonjës të shoqërisë [...]. Ka rezultuar se ata nuk kanë pasur asgjë të kundërligjshme apo të rrezikshme me vete. Pasi personat janë futur në lokal, kanë filluar të konsumojnë pije alkoolike si dhe të komunikojnë me zë të lartë. Pronari i lokalit A.F. dhe dy persona të besuar prej tij, shtetasit F.G. dhe G.T, që ai i përdor si truproja të tij, kanë vënë re situatën dhe kanë njoftuar dy punonjësit e SHRSF të sipërcituar.

Ata janë afruar në ambientet e brendshme të lokalit, ndërkohë që truprojat e pronarit të lokalit, shtetasit F.G dhe G.T, kanë dalë në ambientet e jashtme të lokalit. Duke parë që situata po bëhej problematike në lokal, ka ndërhyrë punonjësi i SHFRSF Y.L, i cili ka vajtur tek tavolina ku ndodheshin 5 persona dhe i ka kërkuar njërit prej personave që dukej me i qetë, që të dilnin dhe të diskutonin pak në lidhje me problematikën, pasi aty nuk mund të diskutohej se muzika ishte e lartë. [...] Në momentin që Y.L., po i kërkonte që të mos shqetësonin klientët e tjerë, aty janë afruar dhe katër personat e tjerë. Gjatë kohës që këta po diskutonin katër personat e tjerë, kanë filluar të fyejnë dhe të shajnë shtetasin F.M.. Fillimisht, konflikti ka qenë verbal, me pas kanë tentuar disa herë ta godisnin shtetasin Y.L. dhe më pas ky i fundit, ka goditur shtetasin A.A.. Në këtë moment, ka nisur konflikti fizik midis tyre, që ka përfunduar me sulmin me send te forte dhe konkretisht, me një elektrike dore të gjatë, nga ana e të pandehurit G.T.. Pas goditjes me këtë send të fortë, personat e goditur ndër të cilët janë dhe shtetasit A.L, H.A. dhe Gj.Gj, kanë ndaluar së vrapuari, duke u rrëzuar në tokë.

Fakti i ndodhur si më sipër, sipas provave të ndodhura në dosjen e hetimit paraprak të paraqitura për shqyrtim nga prokurori, provohet me deklaratimet e personave të pranishëm në vendngjarje, pamjet filmike të marra nga regjistrimet e kamerave, të cilat kanë si fushëpamje vendin ku ka ndodhur konflikti fizik, si dhe aktet e tjera të administruara në këtë procedim penal.

Me të marrë dijeni në lidhje me shpjegimet e shtetasve të sipërcituar, grupi hetimor ka shkuar përsëri në ambientet e brendshme të lokalit [..] me qëllim për të marrë pamjet filmike nga kamerat e sigurisë që monitorojnë lokalin, për të shikuar dinamikën e ngjarjes dhe mënyrën se si ka ndodhur konflikti ndërmjet palëve, si dhe për të përcaktuar shkallën e fajësisë në kuadrin e të dyshimit për secilën palë të përfshirë në konflikt. [..]. Në prezencë të avokatit mbrojtës, këtij shtetasi iu bë e qartë arsyeja se pse kishin vajtur dhe oficeri i policisë gjyqësore me pëlqimin e pronarit të lokalit, është futur në ambientet e brendshme të lokalit dhe kanë shkuar tek DVR. Aty shtetasi A.F., u ka thënë që kamerat nuk punojnë. Ky shtetas pretendonte që në fillim që DVR nuk punonte.

Në këto kushte, është kryer sekuestrimi DVR, e markës HCVR 5216 A-S/2, me ngjyrë të zezë dhe në momentin e sekuestrimit kapaku i sipërm, i saj ishte i lëvizshëm pa vidat që e fiksojnë me trupin e saj. Ky fakt është shënuar edhe në procesverbalin e sekuestrimit të provës materiale, të mbajtur më datë 15.12.2018 në orën 11:12 min.

Nga akti i ekspertimit kompjuterik nr. 12933 ka rezultuar se, pajisja DVR objekt ekspertimi e markës HCVR, [..], në momentin e ardhjes për ekspertim nuk kishte *hard disk* të instaluar në të. DVR-të i ruajnë pamjet filmike në *hard disk* që montohen në brendësi dhe duke qenë se DVR objekt ekspertimi, në momentin e ardhjes për ekspertim nuk kishte *hard disk* të montuar në të, ekzaminimi i saj për pamje filmike nuk mund të kryhet. [..]

Në vijim të hetimeve, personat e dëmtuar i janë nënshtruar ekzaminimit mjekësor. Sipas akteve të ekspertimit mjeko-ligjor, ka rezultuar se dëmtimet në trupin e shtetasit [..] hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të rënda dhe kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të tyre nëse nuk do i jepej ndihma e kualifikuar mjekësore; dëmtimet në trupin e shtetasve [..] nuk kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të tyre, hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat kanë shkaktuar humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë. [..]

Në datën 20.03.2019, shtetasi U.P. referuar aktit “procesverbal mbi heqjen dorë nga ankimi”, ka deklaruar se nuk do ta ndjekë në rrugë ligjore këtë problem dhe heq dorë nga ankimi. Në datën 20.3.2019, shtetasi A.A. referuar aktit “procesverbal mbi heqjen dorë nga ankimi”, ka deklaruar se nuk do ta ndjekë në rrugë ligjore këtë problem dhe heq dorë nga ankimi. Po ashtu, rezulton se është ripyetur shtetasi H.A., i cili ka deklaruar se nuk dëshiron ta ndjekë në rrugë ligjore këtë ngjarje, pavarësisht dëmtimeve që ka pësuar ditën e ngjarjes. Gjithashtu, është ripyetur edhe shtetasi A.L., i cili ka deklaruar se nuk dëshiron ta ndjekë në rrugë ligjore këtë ngjarje,

pavarësisht dëmtimeve që ka pësuar ditën e ngjarjes.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit. Dërgimin e çështjes për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale për të pandehurin G.T[...] Pushimin e çështjes penale ndaj personit nën hetim A.F., për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, të parashikuar nga neni 301 i K.Penal. Pushimin e çështjes penale ndaj personit nën hetim F.G., për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje”, të parashikuar nga neni 88 e 25, të K.Penal.

[..]

Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur lënien në fuqi të vendimit [...], sa i përket personit nën hetim A.F... [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] sjell në vëmendje se, me ligjin nr. 35/2017 [...] është parashikuar faza e seancës paraprake, si një fazë e rëndësishme dhe e pamangshme e procedimit penal, që synon të garantojë të drejtat e mbrojtjes, duke verifikuar dhe kontrolluar plotësinë e hetimeve të kryera, veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit gjatë fazës së hetimit paraprak. Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë të verifikojë provat e mbledhura në ngarkim të të pandehurit gjatë fazës së hetimeve paraprake, si dhe bazueshmërinë/qëndrueshmërinë e akuzës në gjykimin e themelit. Me fjalë të tjera, detyra kryesore e gjyqtarit të seancës paraprake është të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq është e bazuar, si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë dhe vlefshmërisë së akteve, por nuk ka si qëllim të arrijë në konkluzione mbi fajësinë e të pandehurit.

Kontrolli i ushtruar nga gjyqtari i seancës paraprake mbi hetimet e kryera, përfshi këtu edhe saktësimin apo korrigjimin e akuzës, nuk do të thotë se ai merr funksionet e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale. Detyra e gjyqtarit të seancës paraprake është që në prani të burimit të provave që i paraqiten, të verifikojë nëse në situatën në të cilën ndodhen aktet, mund të kalohet çështja në gjyq, pa bërë vlerësime thelbësore që i takojnë fazës së gjyimit. Vlerësimi i gjyqtarit të seancës paraprake në këtë rast, bazohet në faktin penal dhe në provat e depozituara nga organi i akuzës, por kjo nuk do të thotë që ai të bëjë një analizë të thelluar duke argumentuar nëse niveli i të provuarit shkon përtej dyshimit të arsyeshëm.

[..]

Kolegji, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi llojin e çështjes penale në gjykim, vendimet e gjykatave dhe shkaqet e rekursit, vlerëson se vendimet e gjykatave të shkallëve më të

ulëta, objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor në Gjykatën e Lartë, janë marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit penal procedural. Ky konkluzion i Kolegjit lidhet me atë pjesë të vendimmarrjes, me të cilën është disponuar pushimi i çështjes penale ndaj personit nën hetim A.F., për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, të parashikuar nga neni 301 i KP, objekt rekursi në Gjykatën e Lartë.

Kolegji vlerëson se përfundimi i arritur që në rastin konkret nuk ka vepër penale, është një përfundim i cili nuk mund të arrihet *prima facie* dhe kërkon një analizë më të thelluar nga ana e gjykatës. Këtë vlerësim të thelluar apo çmuarje të provave, si dhe elementeve të veprës penale, nuk mund ta bëjë gjyqtari i seancës paraprake, pasi provat duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor dhe kontradiktoritetit, si dhe analizës së elementeve të veprës penale, që janë karakteristikë e gjykimit në themel të çështjes. Gjyqtari i seancës paraprake mund të pushojë akuzën kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara nga neni 328 i KPP, vendim ky që merret nga e tij në zbatim të nenit 332/dh, pika 1, shkronja “ç” e këtij Kodi, por, gjyqtari i seancës paraprake nuk mund t'i hyjë vlerësimit të provave, të çmojë vlerën e tyre provuese në raport me faktin apo fajësinë e të pandehurit apo në raport me prova të tjera, sikundër rezulton se ka ndodhur në rastin konkret.

Përsa më lart, lidhur me pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur, Kolegji vlerëson se ka shkaqe për cenimin e vendimmarrjes së gjykatave të shkallëve më të ulëta (gjyqtari i seancës paraprake). Në bazë të parashikimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 441, të KPP [...] Kolegji çmon se vendimi i gjykatës së apelit duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në këtë gjykatë (me atributet e Gjyqtarit të Seancës Paraprake), me tjetër trup gjykues. Në rishqyrtim, gjykata e apelit duhet të rimarrë në shqyrtim ankimin e organit të akuzës ndaj asaj pjese të vendimmarrjes, me të cilën është disponuar pushimi i çështjes penale ndaj personit nën hetim A.F., për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, të parashikuar nga neni 301 i K.Penal, duke iu përmbajtur këtij arsyetimi të Kolegjit (referuar rolit dhe kompetencës funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake).



**22.Vendim nr. 00-2024-1995 (298),
datë 04.12.2024 (legjitimim për ankim
ndaj vendimit të gjyqtarit tëseancës
paraprake: viktimë e veprës penale -
person juridik)**

Maksima: Kur kërkuesi, në cilësinë e personit juridik, nuk identifikohet me cilësinë e viktimës së veprave penale objekt akuze dhe nuk ka cilësinë e palës në këtë proces, ai nuk legjitimohet të ushtrojë ankim ndaj vendimmarrjes së gjyqtarit të seancës paraprake.

Fjalë kyçe: Person juridik, viktimë e veprës penale, seancë paraprake, e drejtë ankimi

Decision no. 00-2024-1995 (298), dated 04.12.2024 (legitimacy to appeal against the decision of the judge of the preliminary hearing: victim of a criminal offense - legal entity)

Legal principle(s): Where the applicant, acting in the capacity of a legal person, does not qualify as the victim of the criminal offence forming the subject matter of the indictment and does not have the status of a party to the criminal proceedings, it lacks standing to lodge an appeal against the decision of the judge of the preliminary hearing.

Keywords: Legal entity, victim of a criminal offense, preliminary hearing, right to appeal

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria e Posaçme [...] ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme [...] kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq në ngarkim të të pandehurve [...], të akuzuar për kryerjen e veprave penale të cituara në hyrje të këtij vendimi.

Në datën [...], në Gjykatën e Posaçme [...] është regjistruar kërkesa e [...] SHPK, me objekt pranimin e kësaj shoqërie si [...] palë e interesuar në cilësinë e viktimës së veprës penale, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të saj të pronësisë lidhur me pasurinë e llojit pyll [...].

Gjykata e Posaçme [...], me vendimin nr [...], ka vendosur mospranimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria [...] SHPK, me arsyetimin se, [...] se kërkesa e paraqitur nuk plotëson elementet formal, duke qenë se nuk është paraqitur asnjë akt që të tregojë që avokati E.T ka tagër dhe legjitimohet për të paraqitur këtë kërkesë në emër të shoqërisë tregtare. [...] Përsa i përket kërkesës së datës 24.05.2024, Gjykata [...] ka vendosur

mospranimin e kërkesës së paraqitur, duke iu referuar nenit 332/a/1 të KPP [...] shoqëria tregtare, palë kërkuese, nuk konsiderohet viktimë e veprës penale në kuptim të nenit 58 e vijues të KPP.

Gjykata e Posaçme [...], me vendimin nr. [...] ka vendosur: “Mospranimin për shqyrtim të ankimit të veçantë të [...] SHPK ndaj urdhrit datë 28/06/2024 të gjykatësit të seancës paraprake në Gjykatën (...)”. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se nuk janë parashtruar shkaqe që e cenojnë vendim-marrjen e Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe kësisoj kjo vendim-marrje duhet të lihet në fuqi.

Fillimisht, Kolegji referuar edhe shkaqeve të ngritura në rekurs se pala që cenohet në pasurinë e tij ka të drejtën ligjore të mbrohet para një gjykate pavarësisht cilësisë si “viktimë e veprës penale”, “person i interesuar” apo “person i tretë”, vlerëson të sjellë në vëmendje se subjektet e procedurës penale janë ata persona (fizik dhe juridik) të cilët kryejnë veprime procedurale penale, sipas ligjit, kanë të drejta dhe detyrime të caktuara dhe hyjnë në marrëdhënie procedurale penale. [...] Ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, Kolegji vlerëson se Kodi është i përpiktë (ezaurues) në dhënien e cilësisë së “subjektit” personave të caktuar dhe vetëm kur identifikohen si të tillë ata mund të jenë pjesëmarrës në procedimin penal. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë faktin se kërkuesi, shoqëria [...] SHPK pretendon se eventualisht mund të cenohet në të drejtat e saj të pronësisë dhe për këtë shkak kërkon të hyjë (thirret) në procesin penal që zhvillohet para Gjykatës [...], në seancë paraprake, duke qenë se e drejta për akses në gjykatë konsiderohet si një e drejtë themelore dhe si element i procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës, çmon të marrë në shqyrtim nëse gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejtë ligjin procedural penal në vendim-marrjet e tyre.

[...] Neni 58 i KPP, megjithëse në pikën 1 të tij tregon të drejtat e viktimës së veprës penale, nuk jep një përkufizim të këtij termi. Në fakt, një përkufizim i tillë nuk jepet as nga ndonjë dispozitë tjetër e Kodit. Në interpretim të këtij termi, Kolegji edhe më parë ka sjellë në vëmendje përkufizimin e termit “viktimë e veprës penale” sipas Direktivës 2012/29/BE [...] [...] Pra siç shihet, ligjvënësi evropian shprehimisht me termin “viktimë” nga vepra penale i referohet vetëm personave fizikë, duke mos përmendur edhe personat juridik. [...]

Pavarësisht sa më sipër, Kolegji vlerëson se edhe pse direktiva evropiane e mësipërme parashikon shprehimisht se viktimë nga veprat penale janë vetëm personat fizik, për sa kohë ligjvënësi shqiptar nuk ka parashikuar

në ndonjë dispozitë të KPP kuptimin e “viktimës” nga vepra penale, duke nënkuptuar si të tillë vetëm individët, nuk ka asnjë arsye që të pengojë personat juridik, të dëmtuar nga një vepër penale që të kërkojnë të marrin pjesë në procesin penal, duke ushtruar të drejtat e parashikuara nga ligji me cilësinë e viktimës së veprës penale. Nga ana tjetër, në një rast të tillë, të drejtat e saj (viktimës) do të jenë të kufizuara për aq sa është e mundur të ushtrohen nga personi juridik. Në këtë kontekst Kolegji, në praktikën e tij, ka pranuar në konceptin e “viktimës” së veprës penale “personin juridik”, duke e legjitimuar kështu për të ushtruar ankim, e më tej rekurs në Gjykatën e Lartë, për rastet kur ligji e parashikon një të drejtë të tillë.

Gjithashtu, Kolegji sjell në vëmendje se viktimës së veprës penale, Kodi i njeh të drejtat e parashikuara në nenin 58 të tij. Qëllimi i kësaj dispozite (nenit 58 të KPP) është të përcaktojë pozitën e viktimës në procesin penal, si dhe të drejtat e saj procedurale nga momenti i njoftimit të veprës penale e deri në përfundim të procesit. Neni 58 i KPP, rendit të drejtat e viktimës së veprës penale, të cilat mund të kategorizohen në të drejta eventuale (potenciale), të cilat viktimat mund të zgjedhë t'i ushtrojë ose jo dhe të drejta të detyrueshme, ushtrimi i të cilave passjell detyrimin e organit procedues për t'i plotësuar. Në konsideratë të rastit konkret dhe përsa lidhen me të, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje se gjykata ka detyrimin të njoftojë viktimën e veprës penale për të marrë pjesë, si në seancën paraprake (neni 332/a, pika 1), ashtu edhe në gjykimin e themelit (neni 333, pika 2), si dhe t'i komunikojë asaj vendimin përfundimtar në rastet kur nuk është e pranishme në gjykim. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson të theksojë se viktimat nuk është palë në proces, pavarësisht se merr pjesë në të, me përjashtim të rastit kur merr pjesë me cilësinë e paditësit civil në procesin penal (nenet 61-68 të KPP) ose kur ka rolin e viktimës akuzuese sipas nenit 59 të KPP. Megjithatë KPP parashikon viktimën si subjekt të procesit penal, palët në proces janë vetëm prokurori që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit dhe i pandehuri i mbrojtur vetë ose nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur apo të caktuar kryesisht, si personi ndaj të cilit zhvillohet procesi penal. Në këtë kontekst, pjesëmarrja e viktimës në procesin penal, duke pasur mundësinë të ushtrojë të drejtat e parashikuara në ligj, nuk i jep asaj cilësinë e “palës” në proces. Përjashtimisht, viktimat merr cilësinë e palës në proces kur ajo ndërhyr në proces me cilësinë e paditësit civil, duke kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar apo rastin kur është në cilësinë e viktimës akuzuese, duke ndjekur akuzën private.

Duke iu rikthyer rastit konkret, [...] referuar edhe pretendimeve të ngritura në rekurs, shoqëria tregtare, në rastin konkret, nuk është person

i dëmtuar pasi nuk është “titullar” i objektit të mbrojtur nga norma penale për të cilën akuzohen të pandehurit në këtë proces. Viktimë e veprës penale është vetëm personi (fizik/juridik) që ka pësuar një dëm (fizik, mendor, emocional, apo ekonomik), i cili është shkaktuar drejtpërdrejtë nga vepra penale. Në këto rrethana, duke mos patur cilësinë e viktimës së veprës penale, pretendimi i këtij personi juridik se pavarësisht cilësisë duhet të marrë pjesë në seancë paraprake për të mbrojtur të drejtën e tij të pronësisë, është një pretendim që vlerësohet i pabazuar. Kjo për arsye se në procesin penal subjektet janë ato që parashikohen shprehimisht në KPP dhe kjo shoqëri, në rastin konkret, referuar fazës në të cilin ndodhet procesi penal, nuk identifikohet në ndonjë prej këtyre subjekteve dhe as paraqitet me cilësinë e “palës” së procesit penal (për shembull si paditës civil).

Përpos sa më sipër, Kolegji vlerëson të drejtë konkluzionin e Gjykatës së Posaçme [...] edhe, në referim të natyrës që ka kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim dhe vendimmarrjen e gjyqtarit të seancës paraprake, në përfundim të procesit gjyqësor, në bazë të nenit 332/dh të KPP. Arsyeja ligjore (*Ratio legis*) e nenit 332/dh të KPP është garantimi i hetimeve të plota. Legjislatori, me anë të kësaj dispozite i ka dhënë gjyqtarit të seancës paraprake, jo vetëm ushtrimin e “kontrollit” dhe “filtrit” të hetimeve paraprake, por njëkohësisht, ai bën verifikimin nëse kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq ka elemente të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjykim. Detyra e gjyqtarit të seancës paraprake është që, në prani të burimit të provave që i paraqiten, të limitohet të verifikojë nëse në situatën në të cilën ndodhen aktet, mund të kalohet çështja në gjyq, pa bërë vlerësime thelbësore që i takojnë fazës së gjykimit. Procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel. [...] Gjyqtari i themelit nuk ka të drejtë të shpallë të pavlefshëm vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, por ka të drejtën dhe detyrimin të korrigjojë shkeljet procedurale që konstaton se janë kryer në seancë paraprake. Kësisoj, edhe nën të tillë profil nuk konstatohet shkelje e ligjit procedural penal dhe as mohim i të drejtës së aksesit në gjykatë të personit që pretendon të futet në proces si viktimë (person i dëmtuar) nga vepra penale, pasi procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as e paragjykon vendimin përfundimtar të saj, i cili, nga ana tjetër, mund të jetë objekt kontrolli (edhe për shkaqe të pavlefshmërive absolute – neni 128/a të KPP) nëpërmjet mjetit të ankimit të parashikuar në ligj dhe të ushtruar vetëm prej atij që ligji ia njeh shprehimisht.

[...] Në këto formulime evidentohet se e drejta e ankimit udhëhiqet nga parimi i taksitivitetit, nga i cili rrjedh se jo kushdo mund të paraqesë ankim,

por vetëm “palët”, të cilat janë vetëm ato shprehimisht të përmendura në ligj. E drejta e ankimit nën profilin subjektiv, përbëhet në dy aspekte: legjitimimi për tu ankuar (d.m.th., titullariteti abstrakt për të ankimuar në rastet e referuara nga ligji) dhe interesi për tu ankuar (“eliminimi” i një vendimi të dëmshëm ndaj ankuesit dhe zëvendësimi e tij me një tjetër nga i cili rrjedh një rezultat më i favorshëm për palën). Mungesa e njërit prej këtyre dy aspekteve është shkak për mospranimin e ankimit (neni 420 i KPP). Kolegji vlerëson se, përsa kohë kërkuasi nuk identifikohet me cilësinë e viktimës së veprave penale objekt akuze dhe as ka cilësinë e palës në këtë proces, ai nuk legjitimohet që të ushtrojë ankim ndaj vendimmarrjes së gjyqtarit të seancës paraprake. Përsa më lart, Kolegji vlerëson se vendimi nr. [...], i Gjykatës së Posaçme të Apelit është në zbatim të drejtë të nenit 420/1 të KPP dhe parimin e taksativitetit të ankimit dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi, sipas arsyetimit të parashtruar më lart.



23. Vendim nr. 00-2025-1140 (180), datë 10.07.2025 (vlerësim i gjendjes së akteve/kërkesë gjykim i shkurtuar: pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar seancë paraprake/gjykim themel)

Maksima: Gjyqtari i seancës paraprake që ka disponuar dërgimin e çështjes për gjykim, nuk mund të marrë pjesë në gjykimin në themel të çështjes. Në këtë rast, kemi të bëjmë me pavlefshmërinë absolute të aktit/vendimit të disponuar nga gjykata.

Fjalë kyçe: gjyqtari i seancës paraprake, verifikim gjendja e akteve, gjykim i shkurtuar, pavlefshmëri absolute e vendimit

Decision no. 00-2025-1140 (180), dated 10.07.2025 (assessment of the status of the acts/request for abbreviated judgment: participation of the same judge in the preliminary hearing/trial on the merits)

Legal principle(s): The preliminary hearing judge who ordered the referral of the case for trial cannot participate in the trial on the merits of the case. Any judgment rendered in breach of this rule is affected by absolute nullity.

Keywords: preliminary hearing judge, verification of the status of the acts, abbreviated judgment, absolute invalidity of the decision

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës [...]ka regjistruar procedimin penal ndaj të pandehurit A.Sh. si i dyshuar për veprat penale të “Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/b dhe 22 i KP; “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i KP dhe të “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i KP.

[...]Gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim sipas kërkesës së prokurorisë. I gjykuari ka paraqitur kërkesë për të proceduar me gjykim të shkurtuar, por ky kërkim është refuzuar pasi sipas nenit 403 të KPP duke qenë se vepra penale e parashikuar nga neni 79/b të KP parashikon dënimin me burgim të përjetshëm, nuk është proceduar me gjykimin e shkurtuar. [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr[...]ka vendosur: *“Bazuar në nenin 375/1 të KPP, ti japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokuroria, në lidhje me veprën penale të parashikuar nga nenet 79/b dhe 22 të KP.*

1) *Deklarimin fajtor të të pandehurit [...], për kryerjen e veprës penale të “Goditja për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 237/3 i KP [...]*

2) *Deklarimin fajtor të të pandehurit [...], për kryerjen e veprës penale të “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i KP [...]*

3) *Deklarimin fajtor të të pandehurit [...], për kryerjen e veprës penale të “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, [...] Në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të KP, dënimin e të pandehurit [...] në një dënim të vetëm prej 6 (gjashtë) vjet burgim. [...]”.* [...]

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. [...], ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. [...]me ndryshimin si më poshtë: Deklarimin fajtor të të pandehurit [...]për veprën penale “Vrasja e punonjësit të policisë së shtetit”, e mbetur në tentativë, veprën penale e parashikuar nga neni 79/b dhe 22 i KP, dhe bazuar në nenin 23, 47 dhe 79/b të KP dënimin e tij me 15 vjet burgim. [...]”.* [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vë në dukje se neni 332/dh i KPP, parashikon mënyrën e disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake [...]që pasi ka dëgjuar diskutimet e palëve vendos: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës; b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimin të fajësisë dhe caktimin

e dënimit; c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t'u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë. Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një veprë penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit; ç) ... [..]

Në rastin konkret, Kolegji konstaton se gjykimi i çështjes në themel në ngarkim të pandehurit, ka vijuar me një trup gjykues në përbërje të cilit ka qenë edhe gjyqtari i seancës paraprake T.T. Kolegji vlerëson se në këto rrethana procedurale, gjyqtari T.T., në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake nuk mund të vijonte edhe gjykimin në themel të kësaj çështje penale, pavarësisht depozitimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri, kërkesë që është refuzuar për shkak të ligjit (në referim të pikës 2 të nenit 403 të KPP). Gjyqtari i seancës paraprake nuk ka disponuar ndonjë saktësim akuze apo plotësim të hetimeve, e për më tepër nuk rezulton as të ketë verifikuar pavlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave, si dhe qëndrueshmërinë e akuzës, por me paraqitjen e kërkesës për gjykim të shkurtuar ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq (referuar procesverbalit të seancës gjyqësore). Kolegji rithekson se qëllimi për të cilin ligjvënësi ka parashikuar si fazë procedurale seancën paraprake, ka qenë verifikimi i veprimeve të organit procedues dhe mjaftueshmërisë së provave në mbështetje të akuzës, për dërgimin e çështjes për gjykim. Një ndër disponimet e gjyqtarit të seancës paraprake është edhe në lidhje me kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, por vetëm pasi të jenë verifikuar aktet në përputhje me kërkesat e nenit 332/c të KPP. Disponimi i gjyqtarit të seancës paraprake në këtë rast (për refuzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar), nuk mund të vlerësohet i lidhur me të drejtën dhe detyrimin që ligji procedural penal i ka njohur atij për të verifikuar plotësinë e hetimeve apo saktësinë e akuzës, për të cilat mund të disponojë sipas parashikimeve të nenit 332/ç dhe 332/d të KPP. Në rastin konkret, gjyqtari i seancës paraprake duhet të kishte disponuar në lidhje me kërkimin e të gjykuarit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, duke argumentuar edhe arsyet përse ka disponuar në këtë mënyrë, por vetëm pasi të kishte verifikuar “gjendjen e akteve”, plotësinë e hetimeve dhe saktësinë e akuzës (cilësimin juridik të faktit penal të atribuar të pandehurit nga prokurori). Në vijim të këtij disponimi, gjyqtari i seancës paraprake vendos në lidhje me çështjen, dërgimin në gjyq apo jo, sipas parashikimeve konkrete që lidhen me këtë disponim.

Ky konkluzion mbështetet në dispozitat e KPP që rregullojnë mënyrën e zhvillimit të seancës paraprake dhe mënyrën e disponimit në përfundim të saj. Kolegji rithekson se në marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar, gjyqtari i seancës paraprake zbaton kërkesat e nenit 405 të KPP.

Në lidhje me këto konstatime, Kolegji rithekson edhe qëndrimin njësuës të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 00-2021-1134 vendimi (62), datë 01.11.2021 [...]Kolegji në këtë rast vlerëson të mos ndalet në elementet që kanë ndikuar në arritjen e këtij konkluzioni, por çmon se duhet theksuar se kur shqyrton kërkimin e të pandehurit për gjykimet e posaçme, gjyqtari i seancës paraprake, përveç dispozitave tipike që lidhen me rolin dhe funksionin e kësaj faze të procedimit penal, duhet të zbatojë edhe parashikimet konkrete të ligjit procedural penal për secilin nga gjykimet e posaçme, përfshi këtu edhe gjykimin e shkurtuar. Ligjvënësi ka parashikuar të drejtën e gjykatës për të çmuar nëse çështja mund të zgjidhet në gjendjen e akteve të fashikullit. Në këtë aspekt, Kolegji vlerëson se gjykata që shqyrton këtë kërkesë, duhet të mbajë në konsideratë pikën 7 të nenit 405 të KPP, që rregullon rastet apo parashikon arsyet përse kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk mund të pranohet. Ky parashikim ka lidhje të drejtpërdrejtë me aktet dhe provat e grumbulluara gjatë hetimit paraprak, ndaj Kolegji vlerëson të drejtë interpretimin e gjyqtarit të themelit se “gjendja e akteve” që referohet në pikën 6 të kësaj dispozite, duhet vlerësuar e lidhur me sa parashikon pika 7 e saj (pra edhe Kolegji çmon se pikat 6 e 7 të nenit 405 të KPP duhen interpretuar e zbatuar në unison me njëra – tjetrën).

Por, në rastin konkret, Kolegji konstaton se refuzimi i kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar bazohet në pikën 2 të nenit 403, pra nuk ka një vlerësim të gjendjes së akteve, pavlefshmërisë apo papërdorshmërisë së tyre, nuk ka një verifikim të plotësisë së hetimeve apo saktësisë/qëndrueshmërisë së akuzës nga gjyqtari i seancës paraprake. Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson se gjyqtari i seancës paraprake nuk ka zbatuar drejt dispozitat procedurale penale që lidhen me kompetencën e tij funksionale sipas ligjit. Në rastin konkret, nuk rezulton që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij të kenë parashtruar pretendime në lidhje me provat dhe as gjykata/gjyqtari i seancës paraprake nuk ka konstatuar akte të pavlefshme apo prova të papërdorshme. Kolegji konstaton që refuzimi i kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar është disponuar nga trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e çështjes në themel, pjesë e të cilit ka qenë edhe gjyqtari i seancës paraprake. Ky shkak refuzimi i referuar nga gjykata,

nuk lidhet me pavlefshmërinë e ndonjë akti të hetimit paraprak apo me papërdorshmërinë e provave, por është për shkak të parashikimit ligjor në pikën 2 të nenit 403 të KPP, pasi akuza e atribuuar të gjykuarit parashikonte një dënim me burgim të përjetshëm.

[..]Kolegji referuar dispozitave procedurale që rregullojnë gjykimin e shkurtuar, konstaton se në rastin konkret kërkesa e të pandehurit është paraqitur në përputhje me ligjin – në seancë paraprake, siç parashikohet nga pika 1 e nenit 403 të KPP. Kolegji vlerëson se qëllimi i ligjvënësit në lidhje me ndryshimet që ka pësuar neni 332/dh, pika 1, shkronja “c” e KPP nuk është shmangia e kompetencës funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake, që fillimisht duhet të ketë kryer verifikimet mbi gjendjen e akteve dhe pasi të ketë respektuar kërkesat e nenit 332/c të këtij Kodi, mund të disponojë edhe mbi kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar (edhe kur verifikohet shkaku ligjor i mospranimi të këtij lloji gjykimi të posaçëm sipas pikës 2 të neni 403 të KPP).

Duke ju rikthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata e shkallës së parë ka disponuar me ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal të atribuuar të pandehurit. Gjykimi i çështjes ka vijuar me procedurën e gjykimin të zakonshëm, ku në cilësinë e kryesuesit ka qenë gjyqtari i caktuar për zhvillimin e seancës paraprake. Diskutimi që lind në këtë rast është nëse ky gjyqtar është në kushtet e papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit që shqyrton çështjen në themel, kur fillimisht ai ka disponuar për dërgimin e çështjes në gjyq si gjyqtar i seancës paraprake. [..]Rasti përjashtimor në vlerësim të Kolegjit, është kur disponohet pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar nga gjyqtari i seancës paraprake që ka vlerësuar paraprakisht se çështja mund të zgjidhet në gjendjen e akteve të fashikullit të prokurorit. Ndërkohë, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për dërgimin e çështjes në gjyq, ai ka papajtueshmëri dhe nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në themel. Ky parashikim ligjor lidhet me faktin se në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake ai ka vlerësuar plotësinë e hetimeve, qëndrueshmërinë e akuzës, vlefshmërinë e akteve dhe përdorshmërinë e provave të përfshira në fashikullin e prokurorit, pra ka formuar një bindje paraprake mbi akuzën dhe faktin penal të atribuuar të pandehurit. Në rrethanat procedurale të parashtriuara, kur refuzimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar është bërë për shkak të ligjit përmbajtja e të cilit ishte e qartë, Kolegji vlerëson se gjyqtari i seancës paraprake T.T. nuk plotëson kushtet për të qenë gjyqtar dhe për të marrë pjesë edhe në gjykimin e çështjes në themel, me pasojë pavlefshmërinë absolute aktit/vendimit të disponuar

nga gjykata e shkallës e parë, element që nuk është verifikuar e konstatuar as nga gjykata e apelit. [..]

Kolegji vlerëson se, në kushtet kur në çështjen konkrete verifikohet një nga rastet e pavlefshmërisë absolute të vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë, nuk mund të vijojë me shqyrtimin e pretendimeve të tjera të parashtruara në rekurs nga i gjykuari. Në këto kushte, Kolegji mbështetur në nenin 441, pika 1, shkronja “ç” të KPP çmon se duhet disponuar për prishjen e vendimit nr. [..]të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimit nr. [..]të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, me tjetër trup gjykses. Në rigjykimin e çështjes në themel, gjykata e shkallës së parë duhet të verifikojë më kujdes faktin e atribuuar të gjykuarit në raport me provat dhe ligjin e zbatueshëm, për të konkluduar saktë për cilësimin juridik të këtij fakti, duke pasur në vëmendje edhe konkluzionet e Kolegjit Penal në vendimin njësuës nr. 00-2024-2161 (167), datë 04.07.2024. Kjo detyrë për gjykatën e themelit në rigjykim, është si rrjedhojë akuzës së atribuuar të gjykuarit nga prokurori i çështjes në shkallë të parë, në raport me qëndrimet e parashtruara nga prokurori i seancës në apel dhe prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme pranë Gjykatës së Lartë. [..]



**24.Vendim nr. 00-2025-1887,
datë 02.12.2025 (kompetencë
funktionale: shqyrtimi i të gjitha
kërkesave që burojnë nga i njëjti
procedim penal)**

Maksima: Seanca paraprake konstituohet vetëm me paraqitjen e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq. Nga ky moment, gjyqtari i seancës paraprake është kompetent të shqyrtojë bashkërisht kërkesën për gjykim dhe kërkesat apo ankimet për pushim që burojnë nga i njëjti procedim penal.

Fjalë kyçe: kompetencë funksionale, konstituimi i seancës paraprake, kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq, ankim ndaj vendimit të pushimit

Decision no. 00-2025-1887, dated 02.12.2025 (functional jurisdiction: examination of all requests arising from the same criminal proceedings)

Legal principle(s): *The preliminary hearing is constituted only upon the filing of the prosecutor's request for the case to be referred to court. From this moment on, the preliminary hearing judge has functional jurisdiction to examine jointly the request for trial and the requests or appeals for dismissal arising from the same criminal proceedings.*

Keywords: *functional jurisdiction, constitution of the preliminary hearing, prosecutor's request for the case to be referred to court, appeal against the dismissal decision*

Rrethanat e çështjes:

Mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga shtetasi M.A Prokuroria [...] ka regjistruar procedimin penal [...], për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i KP. [...]për veprën penale “Pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i KP, [...]për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i KP dhe [...]për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 të KP.

Duke qenë se, procedimet penale [...]kanë lidhje me njëri-tjetrin, Prokuroria [...]ka marrë vendim për bashkimin e tyre në një procedim të vetëm, [...]. Më datë 04.08.2025, Prokuroria [...], bazuar në nenin 328/1/a të KPP ka vendosur pushimin e hetimeve për veprën penale “Pushtim i tokës”[...]

[...]kallëzuesi M.A [...], ka paraqitur ankim në Gjykatën e [...]

Me vendimin nr. [...] (gjyqtari referues), ka shqyrtuar në dhomë këshillimi ankimin ndaj vendimit të pushimit të organit të prokurorisë duke vendosur: “Konstatimin e mos kompetencës së këtij trupi gjykues për gjykimin e kërkesës penale [...]dhe dërgimin e akteve për gjykim Gjyqtarit të Seancës Paraprake (gjyqtarit [...]) me arsyetimin se, nga verifikimi suo moto që trupi gjykues ka kryer në sistemin e gjykatës rezulton se, më datë 22.09.2025, është regjistruar në ngarkim të gjyqtarit E.S, kërkesa penale me objekt dërgimin në gjyq të procedimit penal nr.51/2020, duke u konstituuar Gjyqtari i Seancës Paraprake konform nenit 329/1 të KPP, [...]

Bazuar sa më sipër gjyqtari E.S i Gjykatës së [...] me vendimin [...] ka vendosur ; “Parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore/funksionale, të gjykatës me trup gjykues [...] pranë Gjykatës së Lartë [...]”. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..]në praktikën e tij, ka pranuar ekzistencën e konfliktit për kompetencë edhe ndërmjet gjyqtarëve të së njëjtës gjykatë, si në rastin objekt gjykimi, kur në të njëjtën kohë marrin ose nuk ata pranojnë të marrin për shqyrtim një çështje të caktuar, duke kërkuar nga Gjykata e Lartë të zgjidhë mosmarrëveshjen e kompetencës mes tyre. [..]

Pra, në rastin konkret kemi vetëm një procedim i cili është ai nr.51/2020 dhe për të cilin prokuroria ka disponuar për të gjitha veprat penale që janë bashkuar, ose me pushim ose me dërgimin për gjykim. [..]

Në këto kushte gjyqtari M.H. i të njëjtës Gjykatë [..]në disponim të të cilit mbi bazë shorti ka rezultuar gjykimi i vendimit të pushimit të prokurorit për veprën penale të “Pushtimit të tokës”, të parashikuar nga neni 200 i KP, të atribuar të hetuarës (ankimi i tij nga kallzuesi) – ka konstatuar moskompetencën funksionale të tij për të gjykuar vendimin e pushimit të prokurorit/të ankimuar për ketë vepër penale – në kushtet e instaurimit/kostituimit të seancës paraprake pranë Gjykatës [..]me rastin e paraqitjes së kërkesës së Prokurorit për gjykimin e akuzës ndaj të pandehurës për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP (pra në thelb për ushtrimin e ndjekjes penale ndaj të hetuarës Lame) – seancë paraprake – e cila përthith për pasojë edhe gjykimin e kërkesës alternative të prokurorit për pushimin e çështjes lidhur me fakte/vepra penale të hetuara në kuadrin e të njëjtit procedim penal – për të cilat nuk kanë rezultuar kushtet për ushtrimin e ndjekjes penale - [..] të cilën prokurori ja ka bashkëngjitur kërkesës për gjykimin e çështjes/akuzës, në konformitet me përcaktimet e nenit 329/1 të KPP [..]

Kolegji paraprakisht - në funksion të zgjidhjes së konfliktit të kompetencës funksionale të invokuar prej gjyqtarit ad quo të Gjykatës [..] (E.S.) – lidhur me përcaktimin e gjykatës kompetente/gjyqtarit të seancës paraprake për të gjykuar kërkesat e prokurorit pranë kësaj gjykate - [..] çmon të prononcohet lidhur momentin e kostituimit të seancës paraprake që eventualisht përbën edhe thelbin e zgjidhjes së këtij konflikti.

Sipas konsideratës së këtij Kolegji - sistemimi i dispozitës që parashikon [..] “seancën paraprake” [..]qartazi evokon kostituimin/themelimin e saj vetëm në kushtet e aktivimit të prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq/që përfaqëson momentin indikativ të komunikimit të akuzës të hetuarit (i cili-prej këtij momenti - konsiderohet nën “statusin” e të pandehurit) dhe - në të njëjtën kohë - progredimin/avancimin e procedimit të regjistruar prej prokurorit në një fazë më të lartë atë paragjykimore, të identifikuar pikërisht me seancën paraprake, dhe jo

stopimin e tij nëpërmjet vendimit të pushimit të çështjes apo paraqitjes së kërkesës për pushimin e saj. [..]

Në terma të tjera - përtej kompletimit/plotësimit të kompetencave të gjyqtarit të hetimeve paraprake lidhur me kontrollin juridiksional në drejtim të mosushtimit të ndjekjes penale prej prokurorit/të inercisë së organit të procedimit për ushtrimin e saj/rastet e pushimit të çështjes sipas përcaktimit të nenit 328 të KPP – shtrirjes dhe zgjerimit të tij edhe në drejtim të stimulimit të drejtpërdrejtë të këtij organi për ushtrimin e ndjekjes penale [..]– legjislatori parashikoi për herë të parë edhe vendosjen e kontrollit juridiksional mbi ushtrimin e ndjekjes penale prej organit të procedimit pra, [..]– “instaloi” seancën paraprake si një moment/seli e ndërhyrjes/materializimit të kontrollit juridiksional paraprak, në një fazë më të avancuar të procedimit/para gjykimit të çështjes në themel/ - mbi ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori/akuzën e kontestuar të pandehurit nëpërmjet kërkesës për gjykim – në funksion të qëllimit të “filtrimit të akuzave të pabaza/të pambështetura” dhe në instancë të fundit - të evitimit të gjykimeve të tepërta.

Vetëm në kushtet konstituimit të kësaj seance nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për gjykim nga prokurori – sipas konsideratës së këtij Kolegji – merr sens edhe parashikimi i paragrafit të parë, të nenit 329 të KPP që toleron gjykimin prej gjyqtarit të seancës paraprake – [..]– edhe të vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes/mbi ankimin e palëve apo të kërkesës së tij për pushimin e saj, lidhur me vepra penale të tjera të atribuara subjektit për të cilin është paraqitur kërkesa për gjykim.

Mbi këtë bazë interpretimi që evidenton konstituimin e seancës paraprake vetëm në kushtet e ushtrimit të ndjekjes penale/nëpërmjet dërgimit të kërkesës për gjykim/akuzës, prej prokurorit, qartazi, edhe zgjidhja e konfliktit të kompetencës funksionale midis dy gjyqtarëve të të njëjtës gjykatë – do të anojë në favor të atribuimit të kompetencës për gjykimin e kërkesave të prokurorit - për dërgimin e çështjes në gjyq ndaj të pandehurës Lame [..], për pushimin e çështjes ndaj kësaj të fundit [..]dhe të ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes ndaj të hetuarës [..]– gjyqtarit të seancës paraprake – ad quo - të identifikuar me gjyqtarin E.S. në disponim të të cilit rezultoi gjykimi i kërkesave alternative të prokurorit - për gjykimin e akuzës, sipas nenit 248 të KP, ndaj të pandehurës Lame dhe për pushimin të çështjes, ndaj kësaj të fundit, në këtë rast, nën statusin e të hetuarës, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i KP - në konformitet me përcaktimet e paragrafit të parë, të nenit 329 të KPP – që toleron koncentrimin e gjykimit/përfshirë edhe të kërkesave të prokurorit për pushimin e çështjes/tek gjyqtari i seancës paraprake vetëm në kushtet

e konstituimit të kësaj seance me paraqitjen e kërkesës për gjykimin e çështjes/akuzës prej këtij të fundit/prokurorit. Kolegji vendosi zgjidhjen e konfliktit të kompetencës funksionale mes gjyqtarëve të [..], për gjykimin e çështjes objekt i kësaj mosmarrëveshje [...] në favor të gjyqtarit të seancës paraprake të identifikuar në gjyqtarin E.S. si gjyqtari/gjykata kompetente për gjykimin e çështjes.



**25.Vendim nr. 00-2025-1867 (293),
datë 04.12.2025 (vendim për pushimin e
çështjes: kompetencë e kufizuar/analiza
e thelluar tejkalim kompetence)**

Maksima: Detyra e gjyqtarit të seancës paraprake është që, në prani të burimit të provave që i paraqiten, të limitohet në verifikimin e situatës në të cilën ndodhen aktet, me qëllim vlerësimin e mundësisë së çështjes për të kaluar për gjyq, pa bërë vlerësime thelbësore që i takojnë fazës së gjykimit. Vendosja e pushimit të çështjes nga gjyqtari i seancës paraprake, mbi bazën e një analize të thelluar të elementeve të veprës penale, duke përfshirë vlerësimin e anës objektive dhe subjektive të saj, si dhe të lidhjes shkakësore ndërmjet veprimeve të të pandehurit dhe pasojës së ardhur, përbën një tejkalim të kompetencave të kësaj faze procedurale. Ky lloj vlerësimi i përket ekskluzivisht fazës së gjykimit në themel, ku provat administrohen dhe debatohen në prani të kontradiktoritetit të plotë të palëve.

Fjalë kyçe: gjyqtari i seancës paraprake, pushimi i çështjes, tejkalim kompetence

Decision no. 00-2025-1867 (293), dated 04.12.2025 (decision to dismiss the case: limited jurisdiction/in-depth analysis exceeding competence)

Legal principle(s): The role of the judge of the preliminary hearing is limited to verifying, on the basis of the sources of evidence submitted, the state of the case file in order to determine whether the case is fit to proceed to trial, without undertaking substantive assessments that fall within the province of the trial court. The dismissal of the case by the Judge of the Preliminary Hearing on the basis of a detailed analysis of the constituent elements of the criminal offence, including an assessment of its objective and subjective elements and the causal link between the defendant's conduct and

the alleged consequence, constitutes an excess of the judge's functional jurisdiction at this procedural stage. Such an assessment falls exclusively within the competence of the trial on the merits, where the evidence is examined and challenged in fully adversarial proceedings.

Keywords: *preliminary hearing judge, dismissal of the case, excess of jurisdiction*

Rrethanat e çështjes:

[..] Prokuroria[..] ka regjistruar procedimin nr. 2116, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i KP [..] në lidhje me një incident që ka ndodhur me dërgesën e dokumenteve biometrike të shtetasve shqiptarë, në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë. Autoritetet doganore të pikës së Kalimit Kufitar në Kakavijë kishin bllokuar në kufi dërgesën e pasaportave të shtetasve shqiptarë, pasi ishte konsideruar prej autoriteteve doganore greke se posta diplomatike ishte përcjellë jo konform rregullave të parashikuara nga Konventa e Vjenës “Për Marrëdhëniet Diplomatike”, [..] MEPJ ka udhëzuar Konsullin e Përgjithshëm në Janinë, [..], të merrte në dorëzim dokumentet biometrike të shtetasve shqiptarë dhe t’i dorëzonte këto pranë Ambasadës [..] në Athinë. [..] Më datë 15.02.2019, MEPJ vihet në dijeni nga ambasada në Athinë se, ishte vjedhur mjeti i P.Gj, gjatë rrugës nga Janina në Athinë dhe së bashku me sendet personale edhe 100 pasaporta të shtetasve shqiptarë. [..] Në raport pretendohet nga ana e MEPJ për fakte që referojnë veprën penale të shpërdorimit të detyrës, duke sjellë për vlerësim dhe dokumentet e hetimit administrativ. [..] ka rezultuar i provuar fakti se Ambasada e RSH transportin e dokumenteve biometrike e ka bazuar në një kontratë që kjo ambasadë kishte lidhur me shoqërinë e autobusëve [..] sh.p.k, më date [..] Në këtë kuptim edhe transporti i tyre është i domosdoshëm që në respekt edhe të parashikimit të nenit 27 të Konventës së Vjenës, të realizohet përmes shoqërimit të tyre nga personel diplomatik të pajisur me pasaportë të këtij niveli. Për këtë arsye, transportimi i këtyre materialeve përmes linjës së autobusëve dhe pa shoqërinë e personelit përkatës, konsiderohet si e parregullt administrativisht dhe me të drejtë është kërkuar nga Ministria përgjegjëse (MEPJ), rishikimi i menjëhershëm i procedurës së transportit. [..]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. [..], ka vendosur: “1. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë [..] për dërgimin në gjyq të çështjes penale [..] për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.P, ndaj të pandehurve P.Gj dhe A.H. [..].” [..]

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. [..], ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit [..]”. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [..] vlerëson se shkaqet e ngritura prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë të bazuara dhe cenojnë vendimmarrjen si të Gjykatës së Apelit Tiranë ashtu dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kolegji konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, ka disponuar me rrëzimin e kërkesës së prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq dhe pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurve [..] ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi këtë vendim duke zgjeruar dhe më tej arsyetimin ligjor të tij. Të dyja gjykatat kanë arritur në përfundimin se mungojnë elementet e veprës penale në fjalë, duke analizuar në mënyrë të detajuar anën objektive dhe subjektive të kësaj figure penale, si dhe duke u shprehur mbi lidhjen shkakësore ndërmjet veprimeve të të pandehurve dhe pasojës së ardhur.

Sa i përket mundësisë së gjyqtarit të seancës paraprake për të disponuar me pushimin e çështjes në rrethanat konkrete faktike dhe juridike, si Gjykata e Apelit ashtu dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor kanë arsyetuar se nuk ka asnjë kuptim procedural për të tërhequr pa baza një të pandehur në një proces themeli, ashtu edhe për ekonomi gjyqësore kur gjyqtari i seancës paraprake, i cili në të njëjtën kohë mund të shndërrohet në gjyqtar themeli me paraqitjen e kërkesës për gjykim të shkurtuar sipas nenit 403 të KPP kur ai vlerëson se ky fakt nuk ekziston ose nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. [..]

Kolegji vlerëson se qasja e ndjekur nga të dyja gjykatat përbën një zbatim të gabuar të ligjit procedural penal me rëndësi për zhvillimin e praktikës gjyqësore dhe vjen në kundërshtim me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë lidhur me rolin dhe kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake. Në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë është përcaktuar qartësisht se në seancën paraprake nuk zbatohet standardi provues “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”, standard ky që i përket fazës së gjykimit të çështjes në themel dhe formësohet mbi bazën e provave të marra në gjykim në prezencë të kontradiktoritetit të palëve para një gjykate natyrale dhe neutrale.

Kolegji thekson se gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të bëjë një vlerësim më të thellë se ai që kërkohet për seancën paraprake, si dhe nuk mund të hyjë në çështje të të vlerësuarit të provave e çmuarjes së tyre në kuptim të të provuarit, vlerësim që bëhet në kontradiktoritet e debat

gjyqësor që është karakteristikë e gjykimit në themel të çështjes.

Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji konstaton se të dyja gjykatat e faktit, duke bërë një vlerësim të thelluar të faktit, si dhe duke analizuar nëse veprimet/mosveprimet e të pandehurit P.Gj formësojnë elementet e veprës penale për të cilën ai është akuzuar (neni 248 i KP), kanë tejkaluar kufijtë e kompetencës së gjyqtarit të seancës paraprake dhe kryer një analizë që i përket ekskluzivisht fazës së gjykimit në themel. [...]

Kolegji sjell në vëmendje se, referuar nenit 328, pika 1, shkronja “dh” të KPP, gjyqtari i seancës paraprake mund të vendosë pushimin e çështjes vetëm kur *prima facie* del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet që e ka kryer ai. Kjo dispozitë duhet interpretuar në harmoni me natyrën e fazës së seancës paraprake dhe nuk mund të shërbejë si bazë për një vlerësim të thelluar të provave që kërkon debat gjyqësor dhe kontradiktoritet. Gjyqtari i seancës paraprake mund të pushojë akuzën kur del qartë që fakti nuk ekziston ose kur nga pikëpamja e kontrollit të hetimeve nga ana e tij rezulton se prokurori që kërkon dërgimin e çështjes në gjykim, nuk ka sjellë prova që lidhen me të pandehurin, duke bërë një numërtim përkatës të provave ose provat që ka sjellë nuk janë të tilla që në raport me këtë të pandehur në gjykim më tej të japin ndonjë të dhënë për fakte objekt akuze lidhur me këtë person. Megjithatë detyra e gjyqtarit të seancës paraprake është që, në prani të burimit të provave që i paraqiten, të limitohet në verifikimin e situatës në të cilën ndodhen aktet, me qëllim vlerësimin e mundësisë së çështjes për të kaluar për gjyq, pa bërë vlerësime thelbësore që i takojnë fazës së gjykimit.

Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji konstaton se nuk evidentohet prezenca si dhe nuk janë argumentuar asnjë prej rrethanave të sipërcituara për pushimin e çështjes në seancë paraprake. Vendosja e pushimit të çështjes nga gjyqtari i seancës paraprake, mbi bazën e një analize të thelluar të elementeve të veprës penale, duke përfshirë vlerësimin e anës objektive dhe subjektive të saj, si dhe të lidhjes shkakësore ndërmjet veprimeve të të pandehurit dhe pasojës së ardhur, përbën një tejkalim të kompetencave të kësaj faze procedurale. Ky lloj vlerësimi i përket ekskluzivisht fazës së gjykimit në themel, ku provat administrohen dhe debatohen në prani të kontradiktoritetit të plotë të palëve.

Kolegji vëren se arsyetimi i Gjykatës së Apelit, sipas të cilit nuk ka asnjë kuptim procedural për të tërhequr pa baza një të pandehur në një proces themeli dhe se gjyqtari i seancës paraprake mund të shndërrohet në gjyqtar themeli me paraqitjen e kërkesës për gjykim të shkurtuar sipas nenit 403 të KPP, nuk përbën bazë të mjaftueshme ligjore për të përligjur vlerësimin e thelluar të kryer nga gjyqtari i seancës paraprake. Ky arsyetim bazohet

në prezumimin që do të paraqitej kërkesë për gjykim të shkurtuar dhe se kjo kërkesë do të pranohej nga gjykata, prezumime këto që nuk mund të bëhen nga gjykata përpara se të verifikohen kushtet konkrete procedurale. Për më tepër, edhe në eventualitetin e paraqitjes së një kërkesë të tillë, nuk paraqitet asnjë bazë logjike dhe ligjore që gjyqtari i seancës paraprake të marrë atributet e gjyqtarit të themelit vetëm se ekziston mundësia hipotetike që ky gjyqtar të shndërrohet në gjyqtar themeli.

Konstatohet se, vendimmarrja e të dyja gjykatave të faktit ka sjellë si rezultat shndërrimin e seancës paraprake në një fazë gjykimi të themelit, duke anashkaluar garancitë procedurale që lidhen me debatin gjyqësor dhe kontradiktoritetin e palëve. Nëse çështja do t'i nënshtrohej gjykimit në themel, analiza e gjyqtarit të themelit nuk do të mund të ishte më e thelluar nga ajo që është kryer nga gjyqtari i seancës paraprake dhe nga Gjykata e Apelit në këtë rast. Kjo qasje ka privuar palët nga e drejta për të paraqitur dhe debatuar provat në një fazë gjykimi të karakterizuar nga një kontradiktoritet i plotë, duke sjellë si pasojë cenimin e parimit të procesit të rregullt ligjor.

Kolegji vëren se jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës së Lartë e ka përcaktuar tashmë qartë se roli i gjyqtarit të seancës paraprake duhet të fokusohet në një kontroll të plotësisë së hetimeve dhe ekzistencës së provave të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjykim dhe jo në vlerësimin e thelluar të provave apo në formulimin e konkluzioneve kategorike mbi elementet e veprës penale. [..]

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se si vendimi nr. [...], i Gjykatës [...], jashtë dhe vendimi nr. [...], i Gjykatës së Apelit Tiranë, janë marrë në kundërshtim me dispozitat e KPP që normojnë rolin dhe kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, si dhe në kundërshtim me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal. [...] Kolegji vlerëson se duhet të disponohet me prishjen e të dyja vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës [...], me tjetër trup gjykues, tek gjyqtari i seancës paraprake, i cili do të duhet të vlerësojë kërkesën e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq brenda kufijve të kompetencës që i njeh ligji procedural penal.

III. Gjykimi i shkurtuar



**26.Vendim nr. 00-2021-739,
datë 04.11.2021 (revokim vendimi
gjykim i shkurtuar- ndryshim cilësimi
juridik)**

Maksima: Kur gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, konstaton se duhet të ndryshojë cilësimin juridik, ajo duhet të revokojë vendimin për zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, duke i bërë me dije të pandehurit dhe mbrojtjes mundësinë e ndryshimit të cilësimit juridik dhe duke i garantuar të drejtën e mbrojtjes. Vetëm pas një procedure të tillë, gjykata mund të shpallë moskompetencën lëndore dhe t'ia dërgojë aktet gjykatës kompetente.

Fjalë kyçe: gjykata kompetente, revokim i kërkesës për gjykim të shkurtuar, ndryshim cilësimi juridik, proces i rregullt

Decision no. 00-2021-739, dated 04.11.2021 (revocation of summary trial decision - change of legal qualification)

Legal principle(s): Where, upon completion of the trial, the court concludes that the legal classification of the offence must be changed, it is required to revoke its order granting summary trial, inform the defendant and defence counsel of the proposed reclassification, and afford them an effective opportunity to exercise the rights of the defence. Only after complying with these procedural guarantees may the court declare its lack of subject-matter jurisdiction and refer the case to the competent court.

Keywords: competent court, revocation of the order for summary trial, change of legal qualification, due process

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës [...] është drejtuar Gjykatës [...] me kërkesë me objekt dërgimin në gjyq të procedimit penal [...] ndaj të pandehurve [...], akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i KP, si dhe të pandehurve [...] akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 paragrafi i tretë i KP. [...]

KLSH ka konkluduar se procedurat e tenderave[...] (gjithsej shtatë tendera), janë zbatuar në shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore. Për pasojë, KLSH ka kallëzuar veprën penale në Prokurorinë [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. [...], ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 4 të vitit 2018, në ngarkim të të pandehurve [...], të cilët akuzohen për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, [...] si dhe të pandehurve [...], të cilat akuzohen për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, [...]

Gjatë gjykimit të çështjes në themel, i pandehuri A.P është shprehur se i qëndron kërkesës për aplikimin ndaj tij të gjykimit të posaçëm, atij të shkurtuar, paraqitur në seancë paraprake, ndërsa të pandehurit e tjerë kërkuar shqyrtimin e çështjes me gjykim të zakonshëm, kërkesë që është pranuar nga gjykata.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin e datës [...] ka vendosur: *“Ndarjen e çështjes në ngarkim të të pandehurit A.P, [...] dhe vazhdimin e gjykimit nga i njëjti trup gjykues. Veçimin e çështjes në ngarkim të të pandehurve [...] akuzuar nga Prokurori për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, [...] si dhe të pandehurve [...], akuzuar nga Prokurori për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve [...] dhe gjykimin e çështjes nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës Gjykatë...”*

Në përfundim të gjykimit në lidhje me të pandehurin A.P, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës**, me vendimin nr. [...], ka vendosur: *“Shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes. Dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.” [...]*

Gjykata e Posaçme [...] me vendimin nr. [...] ka vendosur: *“Ngritjen e mosmarrveshjes për kompetencë ndërmjet Gjykatës së Posaçme [...] dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, për gjykimin e çështjes penale [...], në lidhje me gjykimin e procedimit penal [...] me të pandehur A.P [...] Dërgimin e akteve të çështjes penale [...] për zgjidhje të mosmarrveshjes në Gjykatën e Lartë.” [...]*

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] duke i'u kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vlerëson se, parashtrimi i Gjykatës së Posaçme [...] lidhur me mosmarrëveshjen për kompetencën e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur për gjykim, është i drejtë, prandaj çështja duhet t'i kthehet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës e cila duhet të vazhdojë gjykimin e saj. [...]

Kolegji konstaton se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës nuk janë zbatuar dispozitat procedurale në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, që rregullohet nga neni 375 i KPP[...]

Në vendimin nr. 4/2012 Gjykata Kushtetuese është shprehur në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në ritin e gjykimit të posaçëm, atij të shkurtuar, duke pasur si qëllim të ofrojë garanci ndaj të pandehurit që atij t'i garantohet e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe të gjitha të drejtat e tjera në procesin penal. [...]

Në rastin konkret, rezulton se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës nuk janë zbatuar as parashikimet e nenit 375 të KPP dhe as vendimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese. Gjykata ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar, pasi ka konstatuar se gjykimi mund të zhvillohej në gjendjen që janë aktet. Megjithatë, në fund të gjykimit gjykata ka konstatuar se fakti penal kishte një cilësim të ndryshëm juridik nga ai i paraqitur nga organi i akuzës. [...] Gjykata ka pasur detyrimin që në rast se konstatonte një fakt të tillë, të revokonte kërkesën për gjykim të shkurtuar, t'ia bënte me dije të pandehurit dhe mbrojtësit së tij dhe t'i jepte atyre kohën e nevojshme për të realizuar mbrojtjen. Sipas nenit 375/2 në këtë rast palët kanë të drejtë edhe të paraqesin prova të reja. Kjo dëshmon pikërisht që zhvillimi i gjykimit me ritin e gjykimit të posaçëm, atij të shkurtuar, e përjashton mundësinë që ndryshimi i cilësimit juridik të kryhet në një gjykim të tillë. Ndryshimi i cilësimit juridik sipas nenit 375 të KPP mund të bëhet vetëm kur gjykata procedon me ritin e gjykimit të zakonshëm. E kundërta do t'i mohonte të pandehurit të drejtën e mbrojtjes dhe rrjedhimisht do të cenonte procesin e rregullt ligjor.

[...] Në ritin e gjykimit të shkurtuar, i pandehuri e ushtron të drejtën e mbrojtjes duke i'u referuar akuzës së ngritur nga prokuroria si dhe provave të cilat i ka njohur dhe i ka pranuar në gjendjen që janë. Me kërkesën për gjykim të shkurtuar i pandehuri pranon të gjykohej me gjykimin e posaçëm në raport me akuzat e formuluar nga prokurori, e vetëm ndaj tyre ai shpreh vlerësimin e dobisë së këtij gjykimi, kështu që nuk do të ishte kushtetutshmërisht e pranueshme që ai të gjendej i detyruar nga zgjedhja e tij edhe ndaj veprave penale të reja ose një vepre më të rëndë që mund t'i ngarkohej. [...]

Kolegji vlerëson se Gjykata e Rrethit [...]duke vepruar në këtë mënyrë i ka cenuar të pandehurit A.P të drejtën e mbrojtjes në lidhje me veprën penale për të cilën, gjykata ka ndryshuar cilësimin juridik.

Kolegji thekson se, në fazën ku ndodhet gjykimi dhe referuar çështjes së konfliktit të kompetencës, për të cilën ai është investuar, ky Kolegj nuk ka kompetencë të vlerësojë në pikëpamje të faktit se cila është vepra penale në të cilën duhet të kualifikohen veprimet e të pandehurit. Megjithatë, Kolegji konstaton se nga Gjykata e Rrethit [...]ka pasur mosrespektim të dispozitës procedurale, nenit 375 të KPP dhe të vendimit nr. 4/2012 të Gjykatës Kushtetuese, kur ka shpallur moskompetencën duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale në një më të rëndë se ajo për të cilën ishte paraqitur akuza.

Në rastin konkret, gjykata nëse në përfundim të shqyrtimit gjyqësor do të konstatonte se duhet të ndryshonte cilësimin juridik, ajo duhet të revokonte vendimin për zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, duke i bërë me dije të pandehurit dhe mbrojtjes mundësinë e ndryshimit të cilësimit juridik dhe duke i garantuar të drejtën e mbrojtjes. Vetëm pas një procedure të tillë, gjykata mund të shpallte moskompetencën lëndore dhe t'ia dërgonte aktet gjykatës kompetente.

Sa më sipër, Kolegji çmon se kompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkeje e ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, të cilës duhet t'i dërgohen aktet lidhur me këtë çështje.



**27.Vendim nr. 00-2022-29 (34),
datë 27.01.2022 (refuzim i aplikimit të
gjykimit të shkurtuar: ndryshim i cilësimit
juridik-rrethanë rënduese)**

Maksima: Kur ekziston mundësia reale që, në përfundim të gjykimit, faktit penal t'i jepet një cilësim juridik më i rëndë se ai i ngritur nga organi i akuzës, veçanërisht për shkak të rrethanës cilësuese të bashkëpunimit, gjykata është e detyruar të refuzojë aplikimin e gjykimit të shkurtuar, pasi ndryshimi i cilësimit juridik në këtë rit procedural bie ndesh me të drejtën e mbrojtjes dhe me standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

Fjalë kyçe: ndryshim cilësimi juridik, rëndim i pozitës së të pandehurit, gjykim i shkurtuar

Decision no. 00-2022-29 (34), dated 27.01.2022 (rejection of application of summary trial: change of legal qualification-aggravating circumstance)

Legal principle(s): *When there is a real possibility that, at the end of the trial, the criminal fact will be given a more serious legal qualification than that raised by the prosecution, especially due to the qualifying circumstance of cooperation, the court is obliged to refuse the application of a summary trial, since the change of legal qualification in this procedural rite conflicts with the right to defense and with the constitutional standards of due process.*

Keywords: *change of legal qualification, aggravation of the defendant's position, summary trial*

Rrethanat e çështjes:

[..] Prokuroria [..] ka regjistruar procedimin penal për kryerjen e veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi 1 dhe 22 i KP, në ngarkim të personit nën hetim E.Ll. [..] Gjatë kontrollit të ushtruar në vijën e dytë të kontrollit të ndodhur në pikën e kalimit kufitar, në mjetin e drejtuar nga i pandehuri është konstatuar se, pas heqjes së dy gomave të pasme të automjetit, në të dyja anët e tij janë fshehur dhe montuar në brendësi të telajos anësore dy tuba plastik [..] në brendësi [..] janë gjetur të futura 10 (dhjetë) paketime në secilin tub [..] me lëndë narkotike e llojit Cannabis Sativa me një peshë prej 10 (dhjetë) kg e 99.4 (nëntëdhjetë e nëntë pikë katër) gram si dhe 1 (një) pako në trajtë pluhuri e e llojit kokainë me një peshë prej 449.6 (katërqind e dyzet e nëntë pikë gjashtë) gramë. [..]

është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasit E.Ll. Arrestimi [..]me vendimin nr. [..], është vleftësuar i ligjshëm duke u caktuar ndaj tij masa e sigurimit “arrest në burg”.

I pandehuri ka paraqitur kërkesën për t’u proceduar me gjykim të shkurtuar, kërkesë që nuk është pranuar nga gjykata, pasi ka konstatuar se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen që janë akte.

Gjykata [..], me vendimin nr. [..], ka vendosur, ndërmjet të tjerash: “Deklarimin fajtor të të pandehurit E.Ll, për kryerje të veprës penale “Trafikim i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe [..] dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim [..]”. [..]

Gjykata e Apelit [..], me vendimin [..], ka vendosur: “Mospranimin e Apelit (ankimit) të paraqitur nga Prokuroria [..] Lënien në fuqi të vendimit [..] Ndryshimin e këtij vendimit si më poshtë: Në aplikim

të nenit 406/1 të KPP dënimin përfundimtar të të pandehurit [...]me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.Lënien në fuqi të këtij vendimi edhe për pjesët e tjera të tij.” [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se pretendimet e ngritura në rekurs nga prokuroria janë në përputhje me shkaqet e rekursit të parashikuara nga neni 432 i KPP, prandaj ka shkak për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Kolegji vlerëson se, [...] nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda është anashkuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 4/2012, vendim i detyrueshëm për t’u zbatuar nga të gjitha gjykatat më të ulëta. [...]

Kolegji vlerëson se në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka vendosur të mos pranojë kërkesën për gjykim të shkurtuar, pasi ka çmuar se kjo çështje penale nuk mund të zgjidhej në gjendjen e akteve. Në përfundim të gjykimit të kësaj çështje penale, rezulton se Gjykata për Krime të Rënda ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, duke i dhënë faktit penal një cilësim të ndryshëm nga ai që ka bërë organi i akuzës, konkretisht, gjykata e shkallës së parë ka krijuar bindjen e bazuar në prova se vepra penale “Trafikimi i narkotikëve” është kryer në bashkëpunim, nga i pandehuri.

Për këtë shkak, Kolegji vlerëson se disponimi i gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e gjykimit të shkurtuar është i drejtë, pasi është i mbështetur në konkluzionet *erga omnes*, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të reflektuara në vendimin nr. 4/2012 të saj.

[...]

Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson se nuk kanë ekzistuar kushtet ligjore që Gjykata e Apelit të riparonte pasojat e parashikuara në nenin 406/3 të KPP për të pandehurin E.Ll, për arsye se kjo është një çështje që pikërisht në kuadër të ofrimit të garancive ndaj të pandehurit, nuk mund të gjykohej me procedurën e gjykimit të shkurtuar. [...]

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nga Prokuroria kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar kundër vendimit nr. [...], të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda përmban shkaqe ligjore prandaj duhet pranuar. Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës [...]është e drejtë, prandaj duhet të vendos prishjen e vendimit nr. [...], të Gjykatës së Apelit [...]dhe lënien në fuqi të vendimit nr. [...], të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.



**28.Vendim nr. 00-2023-1078 (191),
datë 30.06.2023 (mosrëndimi i pozitës
së të pandehurit nga gjykata rishikuese)**

Maksima: *Gjykata penale e juridikisonit rishikues nuk mund të deklarojë fajtor për të pandehurin për të cilin gjykata gjykata penale e juridikisonit fillestar (me gjykim të shkurtuar të kërkuar nga i pandehuri) kishte pushuar çështjen, mbi bazën e të njëjtave fakte dhe prova, duke garantuar në këtë rast respektimin e parimit të mosrëndimit të pozitës të të pandehurit.*

Fjalë kyçe: *reformation in pejus, gjykimi i shkurtuar, pushim çështje penale*

**Decision no. 00-2023-1078 (191), dated 30.06.2023
(non-aggravation of the defendant's position by the re-viewing court)**

Legal principle(s): *An appellate criminal court may not convict a defendant where the court of first instance, following summary trial requested by the defendant, had dismissed the criminal proceedings, on the basis of the same facts and evidence guaranteeing in this case the respect of the principle of non-aggravation of the defendant's position.*

Keywords: *reformation in peius, summary trial, dismissal of criminal case*

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të procedimit penal nr. 3683, viti 2016, ka paraqitur për gjykim, [...] të pandehurin S.V., nën akuzën “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” të parashikuar nga neni 291 i K.Penal.

Gjykatat e faktit, në gjykimin e çështjes me procedurën e gjykimit të shkurtuar, kanë pranuar këto rrethana të çështjes: Në datën 30.04.2016 rreth orës 04:45, Shërbimet e Policisë Rrugore Tiranë kanë ndaluar në rrugën [...], mjetin tip [...], me drejtues mjeti të pandehurin S.V.

[...] Sipas procesverbalit të datës 30.04.2016 “Mbi verifikimin me drager alkooli”, shtetasi S.V., si drejtues i automjetit tip [...], i është nënshtruar testit të matjes së alkoolit me aparatën drager dhe ka rezultuar se, nga testi i

parë se kishte përdorur alkool në masën 0.58 mg/l dhe në testin e dytë 0.57 mg/l.

Referuar procesverbalit të datës 30.04.2016, punonjësit e policisë kanë dokumentuar kapjen në flagrancë të shtetasit S.V., i cili drejtonte automjetin, nën efektin e pijeve alkalike. [...] I pyetur në fazën e hetimeve paraprake, personi nën hetim S.V. ka dhënë shpjegime lidhur me rrethanat e ngjarjes, duke sqaruar se ditën e ngjarjes nuk kishte konsumuar pije alkalike dhe se ishte duke shkuar për në shtëpinë e tij; I pandehuri ka deklaruar se e ka kundërshtuar edhe rezultatin e testit të alkoolit që i ishte kryer.

Mbi kërkesën e mbrojtësit të personit nën hetim, në datë 30.4.2016, ora 04.51, pasi ka dalë nga dhomat e paraburgimit, është kryer analiza mjekësore që tregon përmbajtjen e alkoolit në gjak, në laboratorin Inter-medika;

[...] Prokuroria [...], në datë 28.7.2016 ka bërë njoftimin e akuzës duke e marrë të pandehur shtetasin S.V., për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal; procedimi është zhvilluar me masën e sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, bazuar nënenin 234 të KPP.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, [...] ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit, i akuzuar për kryerjen e veprës penale [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, [...] ka vendosur ndryshimin e vendimit gjyqësor [...] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të «Drejtimi automjeteve në mënyrë të parregullt», parashikuar nga neni 1/291 i K.Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. Në zbatim të nenit 1/406 të KPP i ulet 3/1 e dënimin duke e dënuar përfundimisht të pandehurin me 1(një) muaj burgim.

[...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] vlerëson se pretendimet e ngritura në rekurs i referohen shkaqeve të rekursit të parashikuara nga 432 i KPP. Pavarësisht se Kolegji Penal nuk i hyn vlerësimit të provave në çështjen objekt gjykimi, nga shqyrtimi i çështjes referuar shkaqeve të rekursit të paraqitur nga kërkuesit S.V., rezulton që të ketë shkaqe për cënimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Për sa i përket rekursit të paraqitur nga i gjykuari S.V., i cili në themel të pretendimeve të tij, parashtron se Gjykata e Apelit Tiranë ka deklaruar fajtor kërkuesin, mbi të njëjtat fakte dhe prova, në bazë të së cilave ai është deklaruar i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë, duke keqinterpretuar

nenin 427/4 dhe 403- 404 të KPP. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit ka shkelur ligjin procedural penal, pasi ka bërë një vlerësim të kundërt të fakteve dhe provave nga gjykata e shkallës së parë, në kushet e gjykimit të shkurtuar, pa bërë shqyrtim gjyqësor duke e deklaruar atë fajtor.

Kolegji konstaton se, gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, pra është zhvilluar gjykim mbi bazën e akteve të ndodhura në fashikullin e prokurorit. Në lidhje me ritin e gjykimit, kërkesa është paraqitur nga i pandehuri në gjykim dhe është pranuar nga gjykata, pasi ajo ka çmuar që çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet; referuar vendimit nr. 2 datë 29. 01. 2003 të Kolegjeve të Bashkuara [...]

Në lidhje me këtë shkak të rekursit, Kolegji konstaton se përpara Gjykatës së Apelit, Prokurori, i cili ka ushtruar ankim në apel nuk ka paraqitur kërkesë për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor, sipas nenit 427 pika “4” e KPP; gjykata me vendim të ndërmjetëm ka vendosur të zbatojë nenin 427/4 të KPP, që parashikon përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe të administrojë me cilësinë e provës aktet e fashikullit hetimor nr. 3683, në ngarkim të të pandehurit. Gjykata e Apelit kreu përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor duke administruar vetëm aktet që gjenden në fashikull e duke vijuar po me gjykimin në kushtet e gjykimit të shkurtuar pa ndryshuar ritin e gjykimit të shkurtuar, me qëllimin e moscënimit të së drejtës së të pandehurit për këtë lloj gjykimi. Gjykata e Apelit në shqyrtim të çështjes, investuar edhe nga ankimi i prokurorit, pasi ka zhvilluar gjykimin, ka marrë vendim duke ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke deklaruar fajtor të pandehurin S.V..

Zbatimi në këtë mënyrë i nenit 427/4 i KPP është në interpretim të gabuar të ligjit procedural përse i përket ripërsëritjes së shqyrtimit gjyqësor sipas këtij neni, në lidhje me nenet 403 e vijues të KPP, jurisprudencën e Gjykatës sonë Kushtetuese dhe atë GJEDNJ në lidhje me zbatimin e parimit *reformation in pejus*. Për të arritur në një konkluzion të tillë Kolegji vlerëson të analizojë ndryshimet e nenit 427/4 të KPP dhe të interpretojë mënyrën e duhur të zbatimit të tij në lidhje me gjykimin e shkurtuar nën frymën e jurisprudencës së GJEDNJ mbi zbatimin e parimit *reformation in pejus*, lidhur me të drejtën e përfitimit nga gjykimi shkurtuar. **Në interpretimin e kësaj dispozite që ka të bëjë me dy insitute të rëndësishme procedurale penale, do të niset nga kritere logjike-juridike mbi interpretimin e normave procedurale penale, siç janë: interpretimi tekstual, apo literal i dispozitës ligjore, më tej nëse ky kriter nuk do të mjaftojë për kuptimin e domethënies së normës penale, Gjykata do të vijoje me interpretimin logjik, që nënkupton analizën e dispozitës mbi bazën e qëllimit praktik**

të saj (*ratio legis*); pra, në analizën që bazohet në kuptimin e normës, duke gjetur qëllimin që ajo ka ose duhet të ketë, në bazë të një krahasimi të dispozitës në raport me dispozitat e tjera në mënyrë sistematike, duke identifikuar nga sistemi juridik qëllimin e vërtetë të normës dhe rolin që ajo në rendin juridik (*interpretim teleologjik*) gjithnjë në interpretim pajtues me normën ndërkombëtare e frymen e jurispruencës së GJEDNJ.

Sipas nenit 404 të KPP, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr.35/2017, datë 30.3.2017, por edhe pas këtyre ndryshimeve, sipas nenit 405 pika “6”, gjykimi i shkurtuar mund të zhvillohet vetëm mbi kërkesën e të pandehurit dhe vetëm atëherë kur gjykata çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Tashmë jurisprudenca e konsoliduar gjyqësore është e qartë se ky rit i posaçëm gjykimi është parashikuar në ligj dhe aplikohet në ato raste kur marrja, dëgjimi dhe administrimi i provave sipas ritit normal të gjykimit, është formal, pasi palët nuk kanë kontestime mbi mënyren e marrjes së tyre, mbi vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e akteve procedurale dhe provave dhe për efekt të ekonomisë gjyqësore, shmanget procedura normale e hetimit gjyqësor. Këtij gjykimi, në dallim nga gjykimi i zakonshem, i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. Si benefic të kësaj ekonomie gjyqësore, ligji ka parashikuar uljen e dënimit për të pandehurin me 1/3 në rast se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ai deklarohet fajtor.

Në nenin 403 të KPP nën titullin “Kërkesa për gjykimin e shkurtuar” parashikohet shprehimisht [...] ndërsa në nenin 405 pika 5, 6, 7 dhe 8 të KPP nën titullin “Seanca e gjykimit të shkurtuar” parashikohet shprehimisht se: [...]

[...]

Kështu, në vendimin Nr. 4, datë 10.02.2012 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera shprehet se: [...]

Sipas nenit 427 të KPP, të ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.3.2017, pika “4” [...] Sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr.35/2017, datë 30.3.2017, pika 3 dhe 7, [...] Bazuar në analizën e këtyre dispozitave, por edhe në parimin tashmë të konsoliduar të jurispruencës gjyqësore, normat e reja procedurale gjejnë zbatim në çastin e hyrjes në fuqi të tyre, duke u zbatuar në atë gjendje të procedimit penal, pavarësisht nisjes së këtij të fundit përpara ndryshimeve.

Sipas dispozitave procedurale, roli i gjykates se apelit është ai kontrollues në raport me vendimmarrjen e gjykatave të shkallës së parë dhe ky kontroll lidhet si me zbatimin e drejtë të normave procedurale në lidhje me respektimin e garancive procedurale, me hetimin gjyqësor, me mënyren e administrimit dhe vlerësimit të provave, ashtu edhe me

zbatimin e drejtë të ligjit material, në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të procedimit penal, fajësinë e të pandehurit si dhe cilësimin juridik të veprës penale, apo pafajësinë e tij, gjithnjë bazuar në analizen e provave të marra dhe administruara në gjykim. Ky shqyrtim duhet të bazohet brenda kufijve të përcaktuar në nenin 425 të KPP. Ndodhur përpara një vendimi gjyqësor të marrë prej gjykatës së shkallës së parë, në përfundim të gjykit sipas rritit të gjykit të shkurtuar, në kuptim të nenit 406 të KPP dhe natyrës së këtij gjykimi, gjykata më e lartë duhet ta bazojë kontrollin e vendimit të ankimit, së pari në kontrollin e cilësisë së akteve të procedimit penal, pra në ligjëshmërinë e vendimit që ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe me tej, nëse ky vendim ka qenë i drejtë, në analizën që gjykata më e ulët i ka bërë provave dhe fakteve të provuara prej tyre në funksion të akuzës së ngritur ndaj të pandehurit, provueshmërisë së elementeve për përgjegjësi penale dhe cilësimit juridik të veprës.

Në kushtet kur nga kontrolli i cilësisë së akteve të procedimit penal, gjykata më e lartë arrin në përfundimin se me të drejtë është proceduar nga gjykata e shkallës së parë me ritin procedural të gjykit të shkurtuar, analiza e mëtejshme duhet të lidhet me analizën që gjykata më e ulët i ka bërë provave dhe fakteve të provuara prej tyre në funksion të akuzës së ngritur ndaj të pandehurit, provueshmërisë së elementeve për përgjegjësi penale dhe cilësimit juridik të veprës.

Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ është gjykimi i çështjes nga një gjykatë e paanshme. [...] Duke kuptuar inicimin e këtij ndryshimi, frymëzuar më së shumti nga jurisprudenca e GJEDNJ, gjykata e apelit çmon se një situatë e tillë, *“reformatio in pejus”* (reformimi për keq i vendimit të pafajësisë) duhet t’u referohej rasteve kur kërkesa e prokurorit kundër një vendimi pafajësie bazohet në motive që lidhen me vlerësimin e provave deklarative, [...]

Pra, një situatë e tillë, *“reformatio in pejus”* nga gjykata më e lartë, lidhet detyrimisht me egzistencën e dy rrethanave: së pari, me kërkesën e prokurorit për vlerësim të gabuar të provave dhe së dyti, ky vlerësim i gabuar t’i referohej jo çdo lloj prove (siç mund të jenë edhe provat materiale apo dokumentat), por provave deklarative (dëshmivë, deklarimeve të të pandehurit, ballafaqimeve) dhe jo të të gjitha këtyre provave me këtë natyrë por të atyre që konsiderohen vendimtare ose thelbësore. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ, vlerësimi ose çmuarja mbi besueshmërinë e një dëshmitari, është një detyrë komplekse që përgjithësisht nuk mund të kryhet nëpërmjet një leximi të thjeshtë të fjalëve të shkruara [...]

[..]

Rimarrja e provave materiale apo dokumentave, tashmë sipas një procedure normale mund tu japë atyre një vlerë tjetër në kushtet e kontradiktoritetit dhe debatit gjyqësor e kjo në veçanti nëse ka prova me dëshmitarë e në rast se diskutohet vlera e deklarimeve e dëshmitareve të pyetur në fazën e hetimeve paraprake, të fiksuara në procesverbalet e pyetjes se tyre, nëse rimarrja e dëshmisë do të jetë e pamundur për shkak të vdekjes së dëshmitarit apo mosgjatësisë së tij.

Në këtë mënyrë gjykimi në apel nënkupton një përsëritje të shqyrtimit gjyqësor pa u kushtëzuar nga riti i gjykimit të shkurtuar. Sipas vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr. 2 datë 29.1.2003, këtij gjykimi në dallim nga gjykimi i zakonshëm i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmerinë e tyre. Sipas Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, të sipercituar: [..]

Detyrimi i përcaktuar në nenin 427 pika 4 ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.3.2017, për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor, edhe kur procedimi me gjykim të shkurtuar ka qenë i drejtë, nuk nënkupton cenimin e qëllimit të këtij riti të posacëm gjykimi, por përmbushjen e detyrimit për gjykim të drejtë që në rast të rëndimit të pozitës së personit shkon drejt drejt rritit normal që konsiston në marrjen dhe dëgjimin e drejtperdrejtë të provave nga gjykata e apelit. Bazuar në unifikimin e mësipërm, krijohet idea se gjykata e apelit do të ndodhet përpara dy alternativave, ose të konsiderojë të ligjshëm gjykimin e shkurtuar dhe për rrjedhojë të ketë pamundësi të procedojë me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, ose të prishë vendimin e asaj gjykate për gjykimin e shkurtuar, për t'i hapur rrugë mundësisë për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Për rrjedhojë, në cenimin e garancisë së fituar nga i pandehuri për të përfitur uljen e denimit, megjithëse kërkesa e tij ka qenë e bazuar dhe me të drejtë është çmuar zhvillimi i gjykimit të shkurtuar.

Detyrimi i përcaktuar në nenin 427 pika “4” ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.3.2017, për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor në rastet kur çështja në shkallë të parë është shqyrtuar sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, do të zbatohet drejt nëse do të përsëritej ky shqyrtim për marrjen e provave të reja, qoftë mbi kërkesën e prokurorit si subjekti ankues, qoftë edhe kryesisht nga gjykata e apelit, por gjithnjë pa cenuar rregullshmërinë e procesit të zhvilluar nga gjykata e shkallës së parë dhe për rrjedhojë, të beneficiti të përfitur prej të pandehurit.

Në këtë rast rregullimi i ri në nenin 427 të KPP, lë pa efekt pjesën e vendimit unifikues në rast se Gjykata e Apelit, kryesisht apo mbi bazë të kërkesës së palëve, përsërit shqyrtimin e gjyqësor të çështjes. Interpretimi në këtë mënyrë dhe zbatimi në këtë mënyrë interpretimi i nenit 427 pika “4”

ndryshuar me ligjin nr.35/2017 datë 30.3.2017, do ishte në përputhje me parimin kushtetues të barazisë së shtetasve përpara ligjit edhe për faktin se, pikërisht për shkak të vendimmarrjes së gabuar të gjykatës së shkallës së parë në vlerësimin e provave dhe zbatimin e ligjit për pafajësinë e të pandehurit, ky i fundit ekspozohet nga rreziku i zhvillimit të gjykimit në shkallë të dytë sipas rritit normal të gjykimit, duke shkelur pritshmëritë e tij për një kohezgjatje të arsyeshme të procesit dhe kosto financiare shtesë për të, në raport me po atë kategori subjektesh që janë proceduar me gjykim të shkurtuar dhe dënuar si rrjedhojë e një vendimmarrje të drejtë të gjykatës së shkallës së parë të cilët përfitojnë këto garanci – kohëzgjatje të arsyeshme dhe kosto të ulët financiare.

Ligji procedural i ka njohur të drejtën të pandehurit dhe ekskluzivisht vetëm atij, të drejtën për të vendosur të gjykohet sipas këtij riti të posaçëm, pikërisht bazuar në keto pritshmëri, ai i gjykimit brenda një kohezgjatje sa më të shkurter të procesit dhe me kosto financiare sa më të ulët. Të transformosh në “normale” atë që të pandehurit i është njohur si e drejtë, duke vendosur të përcaktohet në të “shkurtuar”, aq më tepër në fazën e apelit, është në kundërshtim me vetë qëllimin e këtij gjykimi të posaçëm dhe të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit. Kjo situatë riskon të ndodhe edhe në rastet e gjykimit me marrevëshje, ku gjykata e shkallës së parë mund të deklarojë të pafajshëm të pandehurin, për shkak të interpretimit të ndryshëm të ligjit penal dhe gjykata e apelit do të jetë e detyruar të përsërisë shqyrtimin gjyqësor, pavarësisht vullnetit të qartë të të pandehurit për të pranuar fajësinë dhe dënimin e caktuar me marrevëshje. Formulimi i nenit 427 pika “4” ndryshuar me ligjin nr.35/2017, datë 30.3.2017, duhet interpretuar nën frymen e jurisprudencës së GJEDNJ në lidhje me kriteret që duhet të zbatohen në rastin e “*reformatio in pejus*” të vendimit të pafajësisë nga gjykata më e lartë, si një garanci në favor të të pandehurit dhe respektimin e parimit për një proces të drejtë dhe të rregullt.

[..]

Jurisprudenca e GJEDNJ ka vënë theksin tek zbatimi i parimit të gjykimit të drejtë në rastet e rëndimit të pozitës së të pandehurit. Në çështjen *Lorefice v. Italia* GJEDNJ shprehet se: [..] Në çështjen *Dan kundër Republikës së Moldavisë* GJEDNJ thekson se [..]

[..]

Në gjithë jurisprudencën e GJEDNJ theksohet parimi i marrjes e dëgjimit të provave në rast se Gjykata e Apelit konfirmon akuzën pas një vendimi pafajësie. Marrja e provave në mënyrë të drejtpërdrejtë nënkupton shqyrtimin e tyre në procedurë gjyqësore në debat, kontradiktoritet e mundësinë të kundërshtive e jo vetëm duke i administruar ato, një mënyrë

procedurale kjo që nuk parashikohet në KPP.

[..] Prandaj, në rastin e interpretimit të nenit 427 të KPP, kolegji çmon t'i referohet drejtpërdrejtë standardeve të vendosura në **çështjet Lorefice v. Italia çështjen Dan kundër Republikës së Moldavisë**, çështjen di Martino dhe Molinari kundër Italisë që ka të bëjë me të drejtën e dëgjimit e marrjes së drejtpërdrejtë të provës në rastet e rëndimit të pozitës së të pandehurit "*reformatio in pejus*".

Në vijim të këtij interpretimi, Kolegji Penal vlerëson se standarti i vendosur nga GJEDNJ-ja, në lidhje me zbatimin e parimit të *restitutio in integrum* është i detyrueshëm të mbahet parasysh nga gjykatat e sistemit të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë. Në analizë të argumenteve në raport me jurisprudencën e GJEDNJ, gjykata e Apelit në rast të ndryshimit të vendimit të pafajësisë duhet të përsërisë shqyrtimin gjyqsor duke marrë provat në mënyrë të drejtpërdrejtë një nga një, duke marrë prova të reja e duke dëgjuar dhe dëshmitarë e se nuk mund të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke realizuar një vlerësim formal e të ndryshëm të provave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë dhe vetëm me shkakun e vendosjes së përsëritjes së shqyrtimit gjyqsor pa rivlerësuar një provë duke e rimarë atë apo me mungesën e pranimit të një prove të re.

Duke iu kthyer rastit konkret në shqyrtim, Kolegji konstaton se, Gjykata e Apelit Tiranë, ka interpretuar vendimmarrjen e saj për këtë fakt, ku ndërkohë ka arsyetuar se me riçeljen e shqyrtimit gjyqësor, ajo nuk ka cënur të drejtën e të pandehurit për ritin e gjykimit të shkurtuar. Por nga ana tjetër, vendimarrja e Gjykatës së Apelit, në rastin konkret ka të bëjë me vlerësimin të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë, pasi nëse ajo nuk ishte e bindur në vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, duhet të kishte riçelur shqyrtimin gjyqësor dhe të kishte marrë prova që do t'i vlerësonte të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, duke ju dhënë mundësinë palëve që të debatonin në lidhje me to pasi pozita e të pandehurit është rënduar.

Në zbatim të këtyre parimeve në çështjen nëngarkim të të pandehurit S.V., Kolegji vlerëson se, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit Tiranë vlerësohet prej saj rast pas rasti, në ushtrim të pushtetit të saj si gjykatë ligji dhe fakti. Gjykata e Apelit ka të drejtë të përsërisë shqyrtimin gjyqësor, kur çmon se kjo është e nevojshme për të krijuar bindjen mbi faktet dhe provat, por ndërkohë kjo gjykatë ka administruar pikërisht provat që janë marrë për shqyrtim në shqyrtim në shkallë të parë. Gjykata i ka zbritur 1/3 të pandehurit ndërkohë që i ka rënduar pozitën duke mohuar të drejtën e dëgjimit, debatit e kundërshtimit të provave, element ky i procesit të rregullt ligjor.

Në vendimin nr.4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë theksohet se [...]Kjo procedurë gjithsesi është e shoqëruar me një lehtësim të garancive procedurale të ofruara nga e drejta e brendshme, në veçanti për sa i përket publicitetit të diskutimit si dhe mundësisë që të kërkohet paraqitja e provave dhe thirrja e dëshmitarëve (çështja Këiatkoëska kundër Italisë). Këto garanci përbëjnë aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar nga neni 6 i KEDNJ-së. Gjithsesi as teksti dhe as fryma e kësaj dispozite nuk ndalojnë që një person të heqë dorë në mënyrë spontane dhe të shprehur nga kjo e drejtë. Por, që të merret në konsideratë nën këndvështrimin e Konventës, kjo heqje dorë duhet të jetë e shprehur në mënyrë eksplicite dhe duhet të jetë e shoqëruar me një minimum garancish”.

Në vijim GJEDNJ-ja ka çmuar se, duke kërkuar procedimin me gjykim të shkurtuar, aplikanti ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga të drejtat e tij për një seancë publike, të thërrasë dëshmitarët e tij në gjykim, të paraqesë prova, në këmbim të një sërë avantazheve që atij i garantohen nga legjislacioni i brendshëm (çështja Scoppola kundër Italisë). [...]

Është kundër parimeve të sigurisë juridike dhe të mbrojtjes të besimit legjitim të personave që janë në gjykim që Shteti mund, në mënyrë të njëanshme, të ulë avantazhet që rrjedhin nga heqja dorë e disa të drejtave që kanë të bëjnë me nocionin e procesit të rregullt. Nëse kjo heqje dorë bëhet në këmbim të avantazheve të lartpërmendura, nuk mund të konsiderohet e drejtë që, pasi autoritetet e brendshme kanë pranuar të procedojnë me gjykim të thjeshtuar, një element themelor i marrëveshjes ndërmjet Shtetit dhe të pandehurit mund të modifikohet në disavantazh të këtij të fundit, pa konsensusin e tij.

Procesi i çmuarjes së vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave marra gjatë gjykimi penal duhet respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, që përbën një nga parimet bazë të sistemit akuzator. [...]

Mënyra e vlerësimit provave sipas këtij standarti dhe rëndësia që paraqet respektimi i parimit të prezumimit pafajësisë gjatë gjykimit penal, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, është theksuar në vijimësi edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së), konkretisht në vendimin nr.47, datë 07.11.2011 Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar se[...]

Parimi i prezumimit të pafajësisë, në shkallën e dytë të gjykimit, nuk mund të zbatohet i veçuar nga parimi i mosrëndimit të pozitës të të pandehurit gjatë shqyrtimit të çështjes mbi ankimin e palëve të gjykimit penal. Nevoja për harmonizimin e këtyre dy parimeve në shkallën e dytë të gjykimit duhet të jetë mbajtur parasysht nga ligjvënësi në ndryshimet

e fundit të KPP në vitin 2017, kur ka parashikuar si risi në procedurën e gjykimit në shkallë të dytë, nëpërmjet një dispozite ndaluese, pamundësinë e gjykatës së apelit për të bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë, për rastin kur objekt ankimi është një vendim pafajësie.

Më konkretisht në këtë drejtim rezulton që në paragrafin 4 të nenit 427 të KPP, shtuar me ligjin nr.35/2017, të jetë përcaktuar shprehimisht [...] Përkeqësimi i pozitës të të pandehurit, si rrjedhojë e një vlerësimi të ndryshëm të njëjtave fakte dhe prova nga gjykata e rigjykimit, është trajtuar edhe në vendimin unifikues nr.2, datë 06.02.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin ndër të tjera, është theksuar se: [...] Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 425/1 të KPP, duhet të shqyrtojë çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim dhe për rrjedhojë, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në këtë shkallë gjykimi, në parim është i lejueshëm vetëm kur kërkohet në përmbajtje të ankimit të paraqitur.

Në përputhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes penale në shkallën e dytë të gjykimit, në nenin 427/1 të KPP, është përcaktuar më konkretisht se [...] Si rregull Prokurori duhet të ankimojë vendimin e ndërmjetëm për gjykimin e shkurtuar së bashku me vendimin përfundimtar pasi në shqyrtimin e ankimit Gjykatat e Apelit duhet tu përmbahen atyre të paraqitura në ankimin e prokurorit, duke iu përmbajtur në mënyrë rigorozë kufizimeve ligjore të parashikuara për procedurën e shqyrtimit gjyqësor në shkallën e dytë të gjykimit. Mbi bazën e interpretimit sistematik të paragrafit të parë dhe të katërt të nenit 427 të KPP, si dhe nenit 426/a paragrafi i gjashtë i KPP, rezulton se në rastin e ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj një vendim pafajësie, nuk mund të kërkohet fajësia e të pandehurit, vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të provave të marra gjatë gjykimit në shkallë të parë, dhe se për të provuar fajësinë duhet të kërkohet nga pala ankimuese, jo në seancë gjyqësore, por në kërkesën ankimore apo plotësimin e saj, sipas nenit 415/2 të KPP, marrja e provave të reja apo rimarrja e provave të shqyrtuara në shkallën e parë të gjykimit.

Në mënyrë përjashtimore ligjvënësi në paragrafin e tretë të nenit 427 të KPP, ka lejuar mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, edhe kryesisht nga Gjykata e Apelit, pa kërkesë të palëve. Paragrafi 3 i nenit 427 të KPP, që parashikon përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, me kërkesë të palëve, nuk mund të interpretohet i veçuar nga paragrafi i parë i kësaj dispozite që parashikon rregullin e përgjithshëm, si dhe në kundërshtim me rregullat proceduale të zbatueshme për gjykimin e shkurtuar.

Sipas rregullit të përgjithshëm të parashikuar nga paragrafi i parë i nenit

427/1 të KPP, rezulton se përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, qoftë në formën e rrimarrjes së provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë, qoftë në formën e marrjes së provave të reja, lejohet në qoftë se vlerësohet se nuk mund të merret vendim përfundimtar në gjendjen që janë aktet. Gjykimi i shkurtuar, sipas përcaktimeve të nenit 405/6 të KPP është konceptuar si një gjykim në gjendjen që janë aktet, që për më tepër sipas vendimit unifikues nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në thelb të tij si gjykim i posaçëm, ka pranimin e akteve të grumbulluara gjate fazës së hetimit paraprak, duke evituar marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to.

Por ky këndëvshtrim i natyrës së gjykimit të shkurtuar lidhet me të pandehurin dhe sjelljen e tij ndaj procesit pranimit të akteve e heqjes dorë nga të drejta për debat mbi provat duke i pranuar ato në gjendjen që janë. Interesi i drejtësisë në rast të rëndimit të prozitetës së të pandehurit në gjykimin në shkallë të dytë, nënkupton një balancim në mes të së drejtës për dëgjim të provave, debatit e kontradiktoritetit mbi to, të drejtës për të debatuar provat e reja të pakërkuara dhe së drejtës së përfitimit të gjykimit të shkurtuar me atë dhënies së një vendimi objektiv fajësie të mbështetur në prova.

Rimarrja e provave të njëjta apo marrja e provave të reja, me kërkesë të prokurorit ose edhe kryesisht, mbi bazën e interpretimit të mësipërm, mund të bëhet në rastin e shfuqizimit të vendimit të ndërmjetëm që ka pranuar kërkesën për gjykimin e shkurtuar, kur ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim së bashku me vendimin përfundimtar Në vendimin nr.14, datë 26.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese [...] Gjykata e Lartë në vendimin Unifikues nr. 2/2003 është shprehur se [...]

Në rast se nuk është bërë ankim ndaj vendimit të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës të të pandehurit për gjykim të shkurtuar, gjykata e Apelit kur vlerëson së vendimi i pafajësisë nuk është i drejtë mund të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë prova, duke i debatuar ato e dhënë mundësi të pandehurit të diskutojë mbi ro, duke marrë prova të reja e në vecanti ato me dëshmitarë. Nëse nga ana e të pandehurit nuk paraqiten prova të reja dhe shqyrtimi gjyqësor i rëpërsëritur mbyllet po me ato prova për të cilat ai ka kërkuar e është procedura me gjykim të shkurtuar, të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së 1/3 së dënimit në rat të vendimit të fajësisë nga Gjykata e Apelit. Sipas GJEDNJ-së, në çështjen *Scoppola kundër Italisë* [...]

Në të tilla kushte, në të kundërt të pretendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se nuk mund të deklarohet në shkallën e dytë të gjykimit, fajësia e të pandehurit S.V., për të cilin është pushuar

akuza nga gjykata e shkallës së parë, vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të të njëjtave prova të marra, sipas gjykimit të shkurtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të një përsëritje shqyrtimi formal nëpërmjet një procedure të ashtuquajtur “*të administrimit të provave shkresore*” që është një rudiment procedural që nuk njihet në frymën e legjislacionit tonë të ri procedural.

Sa më sipër, Kolegji Penal arrin në përfundimin se rekursi gjendet i mbështetur në bazë të nenit 432 paragrafi 1 shkronja a) dhe në bazë të nenit 441 paragrafi 1 shkronja c), vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet prishur, për zbatim të gabuar të ligjit procedural penal, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë si një vendim i dhënë në interpretim të drejtë të tij.

Mendim pakice: Mbi motivet e kundërshtimit të vendimit

[..] unë gjyqtar Sokol Binaj, [...] paraqes motivet e kundërshtimit të vendimit të këtij Kolegji - shumicës – në justifikim të votës time kundër. [...]

Duke mbështetur qëndrimin e shumicës lidhur me problematiken e sipërcituar – verifikimin e ometimit të gjykatës së shkallës së dytë për të realizuar detyrimin e përcaktuar në paragrafin e katërt të nenit 427 të KPP – për të marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë provat verifikuese të fajësisë së të pandehurit – kam mendimin – ndryshe nga qëndrimi i mbajtur prej saj (shumicës) – së verifikimi i këtij vesi të vendimit të asaj Gjykate kompromenton vlefshmërinë e tij dhe bën të pamundur procedimin e mëtejshëm të Kolegjit në funksion të një vendimmarrje definitive të tij përse kohë që qartazi ka konstatuar pavlefshmërinë e këtij disponimi.

Në terma të tjerë – Kolegji – është në kushtet e pamundësisë për t’u prononcuar lidhur me ligjshmërinë e vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit, dhe për pasojë edhe për ligjshmërinë e disponimit të gjykatës së shkallës së parë – me verifikimin e “pengesës” – pavlefshmërisë së disponimit të Gjykatës së Apelit – dhe të detyrimit, në të njëjtën kohë, për të “përcjellë” çështjen pranë Gjykatës së Apelit, për të bërë të mundur “formësimin” e vendimmarrjes së asaj Gjykate në kushtet e përcaktuara prej paragrafit të katërt të nenit 427 të KPP.

Marrja e provave në mënyrë të drejtpërdrejtë – prej asaj Gjykate – të Apelit – në funksion të plotësimit të detyrimit të kërkuar nga dispozita – megjithëse implikon “shqyrtim gjyqësor” të papranueshëm për konceptin e gjykimit të çështjes me rregullin e gjykimit - në “gjendjen e akteve” – që karakterizon aplikimin e ritit procedural të “gjykimit të shkurtuar” të parashikuar në nenet 403 – 406 të K.Pr.Penale (me të cilin është proceduar

për gjykimin e çështjes) - nuk paragjykon aplikimin në favor të të pandehurit – në përfundim të gjykimit (të këtij gjykimi të konkluduar me ritin normal të gjykimit) të bonusit – të zbritjes së një të tretës së dënimit (për efekt të aplikimit të “gjykimit të shkurtuar” sipas përcaktimit të neneve 403 – 406 të KPP) përsa kohë që nuk ndryshon thelbin e kërkesës se të pandehurit – gjykimin e çështjes në gjendjen e akteve – të sjella nga prokurori pa asnjë lloj kontributi të karakterit provues të sjelle prej tij dhe për sa kohë që “situata” e re procedurale e krijuar është “provokuar” prej iniciativës së pavarur (kryesisht) të gjykatës për të ndërhyrë – pavarësisht vullnetit të tij – në kushtet kur – kjo e fundit – ka konsideruar pamundësinë e zgjidhjes së çështjes në gjendjen e akteve.



**29.Vendim njësues nr. 00-2024-2161
(167), 04.07.2024 (vepra penale/dënim
me burgim të përjetshëm - mbetja në
tentativë/cilësim tjetër juridik)**

Sentenca njësuese: 1. Ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2 i KPP, zbatohet edhe për subjektet ndaj të cilëve ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm. 2. Kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë, nuk zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar. 3. Nëse gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshtëm, i japin faktit një cilësim tjetër juridik për një vepër penale që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm, duhet të zbatojnë nenin 406/1 të KPP në lidhje me masën e dënimit edhe nëse akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e ka dërguar në gjyq për këtë akuzë. Ky përfundim zbatohet, me kusht që të plotësohen elementet e mëposhtme: a. Të jetë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri në përputhje me parashikimet e paragrafit të parë të nenit 403 të KPP, e shoqëruar me kërkimin e tij për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit, për një vepër penale që nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm. b. Të çmohet që çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 7 të nenit 405 të KPP.”

Fjalë kyçe: burgim i përjetshëm, i mitur, vepër e mbetur në tentativë, gjykim i shkurtuar

Unifying Decision no. 00-2024-2161 (167), 04.07.2024 (criminal offense punishable by life imprisonment - remaining in attempt/other legal classification)

Unifying sentence: 1. The prohibition provided for by Article 403, point 2 of the CPC, also applies to subjects against whom the criminal law prohibits the imposition of a life imprisonment sentence. 2. When the charge is for a criminal offense punishable by life imprisonment, but has been classified as remaining in attempt, the summary trial procedure shall not apply. 3. If the courts, at the end of the ordinary trial, give the fact a different legal qualification for a criminal offense that does not provide for a life imprisonment sentence, they must apply Article 406/1 of the CPC in relation to the measure of punishment even if the charge was filed for a criminal offense that provides for a life imprisonment sentence and the judge of the preliminary hearing has sent him to court for this charge. This conclusion applies, provided that the following elements are met: a. A request for a summary trial has been filed by the defendant in accordance with the provisions of the first paragraph of Article 403 of the CPC, accompanied by his request for a change in the legal qualification of the fact, for a criminal offense that does not provide for a life imprisonment sentence. b. It is assessed that the case could be resolved in the current state of the acts, taking into account also point 7 of Article 405 of the CPC.”

Keywords: life imprisonment, juvenile, attempted crime, summary trial

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria [...]ka paraqitur kërkesën për dërgimin e kësaj çështje në gjyq, duke akuzuar të miturin në konflikt me ligjin R.M për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje” parashikuar nga neni 76 i KP. Më datë 06.03.2018, prokuroria ka marrë vendim për ndryshimin e akuzës për veprën penale “Vrasja me dashje” parashikuar nga neni 76 i KP për të miturin në konflikt me ligjin, duke i komunikuar akuzën për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 79/a i KP (për shkak se ka rezultuar që viktimja është i mitur).

Në seancë paraprake [...]mbrojtësi i zgjedhur dhe i mituri në konflikt me ligjin (i pranishëm), kanë parashtruar kërkimin për të vijuar gjykimin sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, pasi sipas tyre gjykata mund të japë një vendim të drejtë me këto prova. [...]Gjykata [...]ka vendosur dërgimin e

çështjes në gjyq për të miturin në konflikt me ligjin, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” parashikuar nga neni 79/a i KP.

[..]Gjykata [..] (gjykata e shqyrtimit të çështjes në themel) bazuar në parashikimet e nenit 403 pika 2 i KPP [..]ka vendosur të rrëzojë kërkesën e të miturit R.M në konflikt me ligjin, për gjykim të shkurtuar, duke vijuar gjykimin e kësaj çështje penale me gjykim të zakonshtëm. [..]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. [..], ka vendosur: “*Deklarimin fajtor të pandehurit, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79, shkronja “a” e KP dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vite burgim. [..]*”.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. [..], ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit [..]*”. [..]

Arsyetimi i Kolegjit:

[..]Kolegji vlerësoi se në rekursin e paraqitur nga i gjykuari, ngrihen çështje ligjore me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, në vështrim të kërkesave të nenit 432, pika 1, shkronja “a” të KPP. [..]në drejtim të zbatimit të nenit 403/2 të KPP, për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm kur të akuzuar janë persona ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë. [..]Në praktikën e Kolegjit Penal ku është marrë në analizë dhe interpretuar neni 403/2 i KPP, pas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017 është mbajtur qëndrimi se ky ndalim gjen zbatim edhe kur të akuzuar për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm është një i mitur në konflikt me ligjin (*shih vendimin nr. 00-2022-1595, datë 06.12.2022 të Kolegjit Penal*). [..] Ndërsa në një rast tjetër, Kolegji ka mbajtur qëndrim të ndryshëm, duke konkluduar se ndalimi i parashikuar në nenin 403/2 të KPP nuk gjen zbatim kur i akuzuar për këto kategori veprash penale është një i mitur në konflikt me ligjin (*shih vendimin nr. 00-2023-928 (169), datë 01.06.2023 të Kolegjit Penal*). [..]

Krahas vendimeve të sipërcituara, pas ndryshimit të nenit 403/2 të KPP me ligjin nr. 35/2017, nga hulumtimi janë evidentuar edhe vendimmarrje të gjykatave të faktit, të cilat reflektojnë qëndrime të ndryshme në drejtim të zbatimit apo jo të këtij ndalimi, jo vetëm kur të akuzuar për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm janë “të miturit në konflikt me ligjin”, por edhe kur subjekt i kësaj kategorie veprash penale është një grua. Në thelb të qëndrimeve lejuese të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar për subjektet “të mitur në konflikt me ligjin” dhe “grua” që akuzohen për një vepër penale që parashikon dënimin me burgim

të përjetshëm është pamundësia *de jure* dhe *de facto* i caktimit të këtij dënimi ndaj këtyre subjekteve. Ndërsa, në thelb të qëndrimit të ndryshëm të praktikës gjyqësore është se ligjvënësi pengesën për mospranimin e gjykimit të shkurtuar nuk e lidh me masën e dënimit të dhënë por e lidh me veprën penale. [...]

Sa më sipër, në referim të nenit 438 të KPP, Kolegji ka disponuar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore (me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë), me qëllim njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet:

1. A zbatohet neni 403, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale për personat e akuzuar për një krim që KP parashikon dënim me burgim të përjetshëm, por ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë?

1.1 A zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë?

1.2 Si do të veprohet në rastin kur akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e dërgon në gjyq për këtë akuzë, por gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm i japin faktit një cilësim tjetër juridik, që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm?

Kolegji, vëren se [...]nga përmbajtja e neneve 403-406 të KPP rezulton se ky lloj i posaçëm gjykimi ndryshon nga gjykimi i zakonshëm, për shkak se aplikohet vetëm mbi kërkesën e të pandehurit, kërkesë e cila duhet të paraqitet në afatin procedural ligjor me pasojë mospranimi.

Aktualisht një nga arsytet që parashikon ligji procedural penal (në fuqi) për mospranimin e gjykimit të shkurtuar është kur i pandehuri akuzohet për një vepër penale për të cilën parashikohet dënim me burgim të përjetshëm (neni 403/2 i KPP). *Në Kodin Penal janë parashikuar në mënyrë ezauruese veprat penale për të cilat ligji parashikon dënim me burgim të përjetshëm (23 vepra penale).* [...]

Referuar parashikimit ligjor të pikës 2 të nenit 403 të KPP, në të gjitha rastet kur akuza përfshin qoftë njërën nga veprat penale të sipërpërmendura, gjykata vendos mospranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar dhe vazhdon procedurën e gjykimit të zakonshëm. [...] Kolegji gjen me vend të vërë në dukje se në dispozitat kalimtare të ligjit nr. 35/2017, nuk gjen rregullim ligjor të posaçëm rasti kur vepra penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm është kryer para hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve të KPP në raport me kërkesën për gjykim të shkurtuar, kur kjo kërkesë është paraqitur në seancë paraprake pas hyrjes

në fuqi të ndryshimeve ligjore. Edhe ky ometim ka krijuar paqartësi, duke passjellë praktika të ndryshme gjyqësore të gjykatave më të ulëta në lidhje me faktin nëse për këto raste do të zbatohet ligji procedural penal që ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës prej të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, sipas parimit latin *“tempus regit actum”* apo ligji procedural penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale sipas parimit të zbatimit të *“ligjit penal favorizues”*. [...]

Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se mospranimi i kërkesës së të pandehurit për gjykim të shkurtuar duhet të jetë i arsyetuar dhe i mbështetur në ligj. Ligji procedural shqiptar i parashikon në mënyrë taksative rastet kur kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk duhet të pranohet. Një nga arsyet që parashikon ligji për mospranimin e gjykimit të shkurtuar është kur i pandehuri akuzohet për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm, parashikim që ndonëse i qartë në përmbajtjen e dispozitës është reflektuar në interpretime të ndryshme në praktikën gjyqësore, duke passjell nevojën që të shtrohen për njësim pyetjet që do të trajtohen në vijim.

a. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim: *“A zbatohet neni 403, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale për personat e akuzuar për një krim që Kodi Penal parashikon dënim me burgim të përjetshëm, por ndaj të cilëve ligji ndalon dhënien e një dënimi të tillë?”*

[...]Kolegji çmon të sjellë në vëmendje se ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre (neni 1, paragrafi 1 i KP). Me këtë formulim KP i referohet ligjit penal për përcaktimin e veprës penale dhe kësisoj vë në plan të parë si element të saj kundërligjshmërinë e veprimit ose mosveprimit. Praktika gjyqësore dhe doktrina pranon se baza juridike për përcaktimin e veprës penale është kundërligjshmëria e saj. Kundërligjshmëria e veprimit ose mosveprimit është shprehje e rrezikshmërisë shoqërore të veprës. Një vepër e kundërligjshme mund të quhet penale kur parashikohet si e tillë në ligjin penal. Ndërsa rrezikshmëria shoqërore është tipari social dhe elementi thelbësor material i veprës penale. Ajo është kategori objektive që do të thotë se përcaktimi i saj bëhet në bazë të kushteve objektive të shoqërisë, se cilat vepra janë shoqërisht të rrezikshme. Rrezikshmëria është vlerësimi negativ që i bëhet një vepre (veprim ose mosveprim) në një shoqëri të caktuar dhe në një periudhë kohe të caktuar, nga ligjvënësi. Kriteri që ka patur parasysh ligjvënësi në vlerësimin e një vepre, është sjellja e njeriut që paraqet rrezik për shoqërinë dhe individin. Ky vlerësim apo çmim që i bëhet rrezikshmërisë shoqërore ka karakter objektiv dhe jo subjektiv. Në këtë

rast merret për bazë objekti që është dëmtuar ose kundër të cilit drejtohet vepra penale. Sa më i rëndësishëm të jetë ky objekt, pra marrëdhëniet juridike të vendosura e të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, aq më e rrezikshme është vepra dhe sa më pak i rëndësishëm të jetë objekti, aq më pak e rrezikshme për shoqërinë është vepra. Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale është e shkallëzuar; disa vepra penale janë më të rënda, d.m.th., paraqesin rrezikshmëri shoqërore më të madhe. Pra, konkludohet se shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale përcaktohet në radhë të parë nga rëndësia e objektit të prekur ose të vënë në rrezik. Në përshtatje me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale në KP janë parashikuar edhe sanksionet penale. Për ato vepra penale që janë të rënda edhe dënimet penale janë të ashpra; ndërsa për ato që janë më pak të rënda edhe dënimet parashikohen më të lehta. Në vijim të kësaj që u tha kuptohet se veprat penale për të cilat parashikohet dënimi maksimal me burgim të përjetshëm, janë veprat penale më të rënda në rendin shoqëror, të cilat paraqesin shkallën më të lartë të rrezikshmërisë shoqërore për shkak të rëndësisë së objektit që cenojnë, në përshtatje të të cilës ligjvënësi ka parashikuar edhe sanksionin penal. Kjo është e qartë edhe nga parashikimi i nenit 31/1 të KP, [..].

[..]Arrihet në këtë përfundim pasi rrezikshmëria shoqërore ka karakter objektiv dhe jo subjektiv dhe për rrjedhojë, merret për bazë objekti që është dëmtuar ose kundër të cilit drejtohet vepra penale. Ndalimi i përgjithshëm i materializuar në pikën 2 të nenit 403 të KPP, objekt diskutimi në çështjen për njësim ka një arsye të fortë: ligjvënësi e kushtëzon zgjedhjen e zbatimit ose moszbatimit të një instituti të caktuar, në rastin konkret, gjykimin e shkurtuar, me parashikimin abstrakt të veprave penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm (veprat penale më të rënda), duke shprehur në këtë mënyrë vlerësimin e tij “negativ” dukshëm më të lartë ndaj kësaj kategorie veprash penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore në raport me veprat e tjera për të cilat nuk parashikohet një dënim i tillë, si dhe duke ia nënshtuar gjykimin e tyre një trajtimi më “rigoroz”. [..]

Në këtë vështrim nuk mundet kurrësi që këto garanci të mos garantohen në mënyrë të barabartë për të gjithë personat e akuzuar për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm. Nuk ka asnjë kuptim që të pandehurve “burra madhorë” të akuzuar për këto vepra penale t’u garantohet standard më i lartë i procesit ligjor se sa “të miturve në konflikt me ligjin” dhe “grave” të akuzuar po për të njëjtat krime. Këtu duhet theksuar se, debati gjyqësor efektiv dhe oral mbi çdo provë dhe shqyrtimi i provave sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm ku provat

merren, formësohen, debatohen dhe shqyrtohen drejtpërdrejt para gjykatës, rrit garancitë për dhënien e drejtësisë efektive përmes procesit të rregullt ligjor, garanci që duhen ofruar në mënyrë të barabartë për të gjithë të akuzuarit për këto krime të rënda. [..]

Përsa më sipër, nisur nga një interpretim literal dhe logjik, Kolegji vlerëson se parashikimi ndalues i bërë në nenin 403/2 të KPP, i referohet objektit të veprës penale që mbron norma e posaçme e KP, pra rëndësisë së marrëdhënies juridike që kjo normë mbron dhe jo elementeve të tjerë të figurës së veprës penale. Nëpërmjet këtij parashikimi ligjor, ligjvënësi mbi bazën e një politike penale ka synuar të identifikojë një kategori veprash penale që duhet t'i nënshtrohen një trajtimi më "rigoroz", për shkak të "alarmit social" (ndjeshmërisë së publikut) të gjeneruar nga këto lloj krimesh, i cili jo domosdoshmërisht është i lidhur me masën e dënimit përfundimtar. Nëse ligjvënësi do të dëshironte të kundërtën ai mund t'i referohej dënimit përfundimtar dhe një teknikë e tillë ligjore është prezente në legjislacionin material penal sikurse shfaqet me rastin e institutit të pezullimit të dënimit⁵, parashkrimin e ekzekutimit të dënimit⁶, rehabilitimin⁷, caktimin e masave të sigurimit personal⁸, apo duke e lidhur me subjektin e proceduar, sikurse parashikohet në ligjin procedural penal në rastin e caktimit të masës së sigurimit arrest në burg.⁹ Vlen të evidentohet se ligjvënësi, për arsye të politikës penale, edhe në raste të tjera, aplikimin apo jo të një instituti procedural e lidh me rëndësinë e veprës dhe jo (ose vetëm) me masën e dënimit përfundimtar sikurse në gjykimin e posaçëm me marrëveshje, përgjimet, caktimin e masës së sigurimit personal arrest në burg ndaj një kategorie të privilegjuar subjektësh. [..]

Ky Kolegj i kësaj gjykate vlerëson se edhe përballë një situatë në të cilën i pandehuri kërkon gjykim mbi aktet (madje pohon fajësinë e tij), nuk është e paarsyeshme zgjedhja e ligjvënësit në parashikimin e zhvillimit të një gjykimi oral dhe kontradiktor, në të cilin gjen shprehje në mënyrën më të mirë garancia e "të drejtës për tu mbrojtur duke provuar" për vërtetimin e fakteve dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, në interes të të gjithë shoqërisë dhe viktimave të veprës penale. [..]

Referuar kuadrit të mësipërm ligjor, Kolegji nuk ka se si të mos ndajë të njëjtin qëndrim ligjor se në rastet kur i mituri është autor i veprës penale, nga gjykata është i pamundur caktimi i dënimit me burgim të përjetshëm

5 Nenet 59, 63 të Kodit Penal.

6 Neni 68 i Kodit Penal.

7 Neni 69 i Kodit Penal.

8 Neni 229/2 i KPP.

9 Neni 230/2 i KPP.

(apo më i lartë se 12 vjet), pikërisht për shkak se këtë e ndalon vetë ligji. KDPM parashikon të drejta të posaçme për të miturin në konflikt me ligjin, duke garantuar mbrojtjen e të miturit dhe interesin e tij më të lartë, në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, duke vënë theksin në forcimin e sistemit të drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të të drejtave procedurale të fëmijëve. [...]Mirëpo, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje se gjykimi i shkurtuar është një rit procedural që normohet në KPP, ndërsa dispozitat e KDPM nuk kanë ndonjë parashikim ligjor lidhur me gjykimet e posaçme, e atë më tepër ndonjë parashikim të ndryshëm dhe më të favorshëm që do të kishte përparësi për tu zbatuar gjatë gjykimit për të miturit në konflikt me ligjin. Për këtë arsye, nuk mund të pranohet zbatimi i parimit të specialitetit si argument për përjashtimin e të miturit në konflikt me ligjin nga ndalimi ligjor i parashikuar në nenin 403/2 të KPP, pasi ky parim gjen zbatim vetëm kur dy norma ligjore rregullojnë të njëjtën lëndë, me pasojën që zbatohet norma e posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme (*lex specialis derogat legi generali*). Raporti i specialitetit ekziston kur elementet përbërëse të një norme penale (të përgjithshme) janë të gjithë të pranishëm edhe në një normë tjetër (e posaçme), e cila përveç tyre, përmban edhe disa elemente më specifike që e cilësojnë normën e dytë, të posaçme në raport me normën e parë (*vendimi njësuës nr. 3, datë 02.11.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*). Gjithashtu, Kolegji çmon se as parimi i subsidiaritetit nuk gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes të shtruar për njësim, pasi ky parim ndërhyr për të mbuluar një hapësirë të lënë nga normë tjetër, apo kur dy a më shumë norma mbrojnë në shkallë të ndryshme marrëdhënien juridike. Sipas këtij parimi, zbatimi i njëres normë në të njëjtën kohë për të njëjtin fakt, përjashton zbatimin e normës penale tjetër, në rastin e mbrojtjes së marrëdhënieve juridike që mbrohen në mënyrë progresive dhe të përshkallëzuar nga një nivel më i ulët drejt një niveli më të lartë. [...]

Pavarësisht parimit të mbrojtjes më të lartë të të miturit, Kolegji vlerëson se ky parim nuk do të thotë moszbatueshmërinë e instituteve të KPP apo Kodit Penal, sikurse i ka parashikuar ligjvënësi. Në mungesë të rregullimeve të posaçme ligjore në KDPM lidhur me një institut të parashikuar në KP apo KPP, nuk mund të konkludohet në përjashtimin e zbatimit të institutit në fjalë për të miturin në konflikt me ligjin, pasi kjo mënyrë do të çonte në krijimin e një norme të re të së drejtës penale të posaçme, duke hyrë kështu në juridiksionin ligjibërës. [...]

Përsa më lart mund të sintetizohet se trajtimi sanksionues i privilegjuar, i toleruar prej legjislatorit për “të miturit në konflikt me ligjin” dhe “gratë”, që presupozon pamundësinë e aplikimit ndaj tyre të llojit të dënimit me

“burgim të përjetshëm”, si dhe të një dënimi më të lartë se 12 vjet burgim (për të miturit në konflikt me ligjin), nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të evitimit të ndalimit të përgjithshëm, të përcaktuar në nenin 403/2 të KPP, përjashtues apriori, i të drejtës për të pasur akses në ritin procedural të “gjyqimit të shkurtuar”, të subjekteve të gjykuara për veprat penale të atribuara prej akuzës, që parashikojnë si titull sanksionues, llojin e dënimit me “burgim të përjetshëm”.

Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me çështjen e shtruar për njësim, Kolegji mban këtë qëndrim njëses: **“Ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2 i KPP, zbatohet edhe për subjektet ndaj të cilëve ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm.”**

ii. Në lidhje me nënçështjen e parë të shtruar për njësim:
“A zbatohet procedura e gjyqimit të shkurtuar kur akuza është për një veprë penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë?” [..]

Kodi Penal shqiptar (në fuqi), tentativën e ka rregulluar në dy nene që janë nenet 22 dhe 23 të tij. Sipas nenit 22 vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij. Nisur nga kuptimi që ligji penal i jep tentativës, si dhe doktrinës së të drejtës penale, ky institut përbëhet nga disa elemente. *Elementi i parë* i rëndësishëm i tentativës është ndërmarrja nga personi i veprimeve të drejtpërdrejta në kryerjen e veprës penale. Kjo do të thotë që vepra penale ka filluar të kryhet dhe personi me veprimet e tij ka cenuar ose ka rrezikuar të mirat juridike që mbrohen nga legjislacioni penal. Për të përcaktuar nëse personi ka ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës penale një rëndësi të madhe, përveç anës objektive ose tërësisë së veprimeve të jashtme që kryen ai për realizimin e veprës penale, paraqet edhe ana subjektive e personit ose qëndrimi psikik që ai mban ndaj veprimeve të kryera dhe pasojave që vijnë prej tyre. Për të arritur në një përfundim të drejtë në këtë rast, nuk ekziston një rregull i përgjithshëm që mund të zbatohet gjithmonë në raste të ngjashme, por kjo zgjidhet rast pas rasti, nga gjykatat, duke u bazuar në të gjitha rrethanat, si dhe aktet dhe provat e çdo çështje konkrete. *Element tjetër* i tentativës është se veprimet për realizimin e veprës penale kryhen nga personi me dashje. Veprimi i personit me dashje për realizimin e veprës penale në rastet e tentativës do të thotë që, ai parashikon karakterin e kundërligjshëm të veprimeve të tij, si dhe parashikon pasojat e mundshme

të veprës penale dhe realizon veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale, por vepra ndërpritet dhe nuk përfundohet për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij. *Element tjetër* i tentativës është që veprimi i synuar nga personi të ndërpritet, të mos përfundohet. Vepra penale do të konsiderohet se është ndërprerë dhe nuk është përfunduar kur personi ka filluar kryerjen e saj, ai ka ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e veprës, por nuk ka arritur që të realizojë qëllimin e tij kriminal. *Elementi i fundit* i tentativës është që vepra penale të jetë ndërprerë dhe të mos jetë përfunduar, për shkaqe që nuk varen nga vullneti i personit. Në qoftë se vepra penale është ndërprerë për shkaqe që lidhen me vullnetin e lirë të personit, vepra nuk do të konsiderohet si e mbetur në tentativë edhe pse personi ka ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta për realizimin e saj. Në këto raste do të ndodhemi para heqjes dorë, me vullnetin e lirë të personit nga kryerja e veprës penale, e cila nëse është përfundimtare, e përjashton atë nga përgjegjësia penale për veprën që ka tentuar të kryejë.

1. Vepra penale do të konsiderohet që është ndërprerë dhe nuk është përfunduar për shkaqe që nuk varen nga vullneti i personit, kur ndërprerja e saj ka ndodhur për rrethana objektive, për shkaqe të jashtme që nuk mund të parashikohen dhe as të ndikohen nga personi. KP përmban një dispozitë të përgjithshme që parashikon se personi që tenton të kryejë një krim mban përgjegjësi penale. Kështu, ky Kod në nenin 23 parashikon se “*Personi që tenton të kryejë një krim përgjigjet për të.*” Që personi të përgjigjet për tentativën e kryerjes së një krimi gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor duhet të analizojë mbi të gjitha rrethanat e provat elementet e sipërpërmendur për të arritur në përfundimin që këto elemente përmbushen kumulativisht dhe personi që ka tentuar kryerjen e krimit do të përgjigjet për të. Në këtë rast, personi që ka tentuar të kryejë një krim do të mbajë përgjegjësi penale njëlloj sikurse personi që e ka konsumuar plotësisht veprën penale. Kësisoj, parashikimi nga legjislatori në nenin 23 të KP për personat që tentojnë të kryejnë një krim, mundësinë e zbutjes së dënimit, uljes apo caktimit të një dënimi më të butë nga ai i parashikuar në ligj, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të evitimit të ndalimit të përgjithshëm, të përcaktuar në nenin 403/2 të KPP, përjashtues apriori i të drejtës për të pasur akses në ritin procedural të “gjykimit të shkurtuar”, të personave të gjykuar për veprat penale të atribuuara prej akuzës, që parashikojnë si titull sanksionues, llojin e dënimit me “burgim të përjetshëm”.

[..]Praktika gjyqësore në Shqipëri, por dhe teoria, nuk e ka interpretuar asnjëherë si domosdoshmëri/detyrim zbutjen e masës së dënimit në rastet kur vepra ka mbetur në tentativë. Gjithashtu, përcaktimi i rrethanave apo

shkaqeve për të cilat vepra penale ka mbetur në tentativë dhe sa kjo ndikon në masën e uljes së dënimit, kërkon një analizë të thelluar në raport me rrethanat e faktit penal, shkallën e fajit si dhe verifikimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese. Kësisoj, edhe në këtë këndvështrim përsa kohë nuk ka ndonjë parashikim ligjor që përcakton masë konkrete dënimi për veprën penale të mbetur në tentativë apo përjashtimin e saj nga një lloj i caktuar dënimi, Kolegji konkludon se është i paevitueshëm, zbatimi i ndalimit të përgjithshëm të parashikuar në nenin 403/2 të KPP.

Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me nënçështjen e parë të shtruar për njësim/zhvillim, Kolegji mban këtë qëndrim njëses: **“Kur akuza është për një vepër penale që përmban dënimin me burgim të përjetshëm, por është cilësuar e mbetur në tentativë, nuk zbatohet procedura e gjykimit të shkurtuar.”**

iii. Në lidhje me nënçështjen e dytë të shtruar për njësim:
“Si do të veprohet në rastin kur akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e dërgon në gjyq për këtë akuzë, por gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm i japin faktit një cilësim tjetër juridik, që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm?”

[..] Kolegji çmon se neni 34 i KPP, titulluar “marrja e cilësisë se të pandehurit”, është një dispozitë e përgjithshme që tregon rëndësinë që ka njohja e të pandehurit me akuzën, të dhënat ku ajo bazohet, burimet e provave si dhe çdo të dhënë, fakt apo rrethanë që është e nevojshme për realizimin e një mbrojtje efektive. Kjo dispozitë nuk parashikon asnjë pasojë në lidhje me aktin e njoftimit të akuzës, ndaj duhet vlerësuar ngushtësisht me të drejtën e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale dhe “thirrjen e të pandehurit në gjykim”/ *vocatio in ius*. KPP në tërësinë e dispozitave të tij, garanton edhe të drejtat procedurale të pandehurit, i cili duhet të njoftohet në mënyrë efektive për akuzën ndaj tij, aktet/provat (burimet e provave) ku ajo bazohet dhe çdo element tjetër thelbësor që ndikon në mbrojtjen e tij. [...]

Kolegji thekson se ligji procedural penal i jep mundësi prokurorit si gjatë hetimit paraprak, ashtu edhe në gjykim, të ndryshojë akuzën e atribuuar të pandehurit. Çdo ndryshim i akuzës apo i rrethanave cilësuese/rënduese duhet ti njoftohet të pandehurit, pikërisht për të garantuar të drejtat e tij të mbrojtjes. Gjatë hetimeve paraprake sipas afateve të parashikuar në ligj prokurori ka të gjithë hapësirën e nevojshme për të realizuar një hetim të plotë, duke respektuar normat procedurale dhe parimet që udhëheqin procesin penal. Ligji procedural penal parashikon se cilësia e të pandehurit ruhet më pas në çdo gjendje

dhe shkallë të procesit derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit. Në përfundim të hetimeve paraprake, nëse prokurori vlerëson se provat e grumbulluara gjatë hetimeve janë të mjaftueshme për të provuar se fakti penal ka ndodhur dhe se ai është kryer nga i pandehuri, paraqet para gjykatës kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq (*nenet 327/6, shkronja b dhe 331 të KPP*). Ky moment konkretizon ushtrimin e ndjekjes penale dhe nënkupton detyrimin e prokurorit që në përfundim të hetimeve të procedojë me një nga mënyrat e parashikuara në ligj, në zbatim të nenit 327 pika 6 të KPP. Ky akt përmban të dhënat e kërkuara nga neni 34, si dhe pika 3 e nenit 331 të KPP: a) gjeneralitetet e të pandehurit dhe të viktimës, kur është e mundur, si dhe çdo element tjetër që shërben për identifikimin e tyre; b) parashtrimin e faktit penal dhe cilësimin juridik të veprës penale; c) burimet e provës dhe faktet që ato u referohen; ç) kërkimin që gjyqtari i seancës paraprake të vendosë dërgimin e çështjes në gjyq; d) datën dhe nënshkrimin e prokurorit. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se pika 2 e nenit 331 parashikon pavlefshmërinë e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, kur nuk është respektuar ndër të tjera edhe parashikimi i pikës 3 të nenit 327 të KPP, që përmban: përshtkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin i pandehuri është proceduar, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik të këtij fakti penal, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për tu njohur me akte dhe për të marrë kopje të tyre. [...]

Përfshirja e seancës paraprake si një nga fazat e procedimit penal, paraqet rëndësi në funksion të forcimit të institutit të mbrojtjes, nëpërmjet kontrollit (filtrimit) të akuzave të nxituara dhe të pambështetura, të paraqitura prej prokurorit, fryt i një veprimtarie hetimore të pakompletuar/ të paplotë, përfshirë sidomos rastet kur prokurori anashkalon apo nuk tregon vëmendjen e duhur në lidhje me integrimin e kontributit të mbrojtjes në funksion të kompletueshmërisë. [...]

Në këtë pikë, Kolegji sjell në vëmendje se një ndër disponimet e gjyqtarit të seancës paraprake është edhe në lidhje me kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të shkurtuar. [...]

Duke u rikthyer në çështjen e shtruar për njësim, Kolegji thekson se verifikimi i akuzës së atribtuar të gjykuarit ka rëndësi në raport me shqyrtimin e pretendimeve të pandehurit për bazueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e kësaj akuze, si dhe vlefshmërinë apo përdorshmërinë e provave ku ajo mbështetet. Sikurse është thënë në këtë vendim, një nga arsytet kur nuk pranohet kërkesa për gjykim të shkurtuar është situata ligjore kur i pandehuri akuzohet për një veprë penale për të cilën ligji

penal parashikon dënim me burgim të përjetshëm. Verifikimi i kësaj situatë, vendos detyrim për gjyqtarin e seancës paraprahe që të analizojë pretendimet e të pandehurit për ndryshimin e cilësimit juridik të fakti penal që i është atribuar në raport me gjendjen e akteve të fashikullit të hetimeve. Të drejtën për të kundërshtuar akuzën për të gjitha elementet përbërës të saj, i pandehuri mund ta ushtrojë jo vetëm në seancë paraprahe por edhe gjatë gjyqimit në themel të çështjes së tij penale në ngarkim të tij. Edhe në gjykim, në funksion të garantimit të një mbrojtje efektive i pandehuri mund të kundërshtojë akuzën e ngritur ndaj tij si përsa i përket shkakut ashtu dhe në lidhje me natyrën (cilësimin juridik) e akuzës. Detyra e gjyqtarit që gjykon çështjen në themel është ta zgjidh drejt çështjen dhe të zbatojë ligjin. Në këtë vështrim me qëllim që të garantohet dhënia e drejtësisë dhe zbatimi i ligjit, si dhe të garantohet e drejta e të pandehurit për mbrojtje dhe kontradiktoritet, KPP në nenin 375, ka parashikuar mundësinë e gjykatës që shqyrton çështjen në themel të saktësojë edhe cilësimin juridik të faktit penal që akuza i konteston të pandehurit. Sipas Gjykatës Kushtetuese, kuptimi në këtë mënyrë i përmbajtjes së nenit 375 të KPP i shërben dhënies së drejtësisë, sepse në të kundërtën ajo do të vepronte në kundërshtim me provat dhe me ligjin. Në rast se gjykata nuk do të bënte një cilësim të drejtë të veprës penale, vendimi i saj do të prishej nga gjykata më e lartë për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Pra, edhe në këtë aspekt, gjykata është e detyruar të bëjë vetë ndryshimin e cilësimit të veprës kur ky është i ndryshëm nga ai i prokurorit (*shih vendimin nr. 50, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kolegji rithekson qëndrimin se në këtë rast, gjykata mund të rikualifikojë të njëjtin fakt që është përshkruar në akuzë apo në kërkesën për gjykim dhe jo një fakt të ri, i cili përmban elemente apo rrethana të reja që nuk i janë njoftuar të pandehurit apo për të cilat prokuroria nuk ka ushtruar ndjekjen penale. Kolegji vë në dukje se, me “fakt që rezulton ndryshe” duhet të kuptojmë një fakt që paraqitet ndryshe në mënyrë tërësore, nga ai i parashtruar në kërkesën për gjykim. E thënë ndryshe, gjykata në emër të dhënies së drejtësisë, nuk legjitimohet të vlerësojë ato veprime apo mosveprime të të pandehurit, të cilat ndonëse rezultojnë gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk i janë atribuar të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës apo në kërkesën për gjykim. Nëse do të ndodhte kjo gjë, cenohet e drejta e të pandehurit për proces të rregullt ligjor, si: e drejta e tij për t’u mbrojtur, e drejta për t’u dëgjuar, e drejta për akses në gjykatë, etj. Gjykata ushtron të drejtën e saj për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, vetëm në lidhje me faktin e përshkruar në kërkesën për gjykim, që i është njoftuar/komunikuar të pandehurit dhe për të cilin prokuroria

ka ushtruar ndjekjen penale, duke i atribuuar një akuzë konkrete. Pra, në zbatimin e nenit 375 të KPP, fakti nuk ndryshon por cilësimi juridik i tij (natyra e akuzës) rivlerësohet nga gjykata në përputhje me parimin *jura novit curia* (gjykata e njeh ligjin). Fakti i njëjtë do të thotë “i njëjti fakt objektiv” i cili karakterizohet nga te njëjtat veprime, subjekte dhe objekt material. Pra, “fakti i njëjtë” do të thotë që fakti jo vetëm në tërësinë e tij të jetë i njëjtë, por edhe se asnjë element i tij përbërës nuk duhet të rezultojë të jetë i ndryshëm nga ajo që është përcaktuar në akuzën e paraqitur nga prokurori (*shih vendimin nr. 00-2024-1166 (150), datë 27.06.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). [...]

Në vijim të analizës së mësipërme, për pyetjen e shtruar për njësim, Kolegji, duke u bazuar në vlerësimet e lartpërmendura, çmon se në rastin kur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nuk rezulton i provuar fakti ashtu sikurse është kontestuar nga prokurori, por gjykata që gjykon çështjen e ndryshon cilësimin juridik të veprës penale në një vepër penale për të cilën nuk parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, duhet të riparojë pasojat e një vendimi të marrë në kundërshtim me ligjin, duke aplikuar nenin 406/1 të KPP, pavarësisht se kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk është pranuar (nga gjyqtari i seancës paraprake). Ky parim vlen jo vetëm për gjykatën e shkallës së parë, por edhe për gjykatën e cila kontrollon vendimin përfundimtar (gjykatën e apelit), sigurisht brenda kufijve të shkaqeve të ankimit. Kjo për arsye se, gjykimi në apel ka si qëllim, nga njëra anë t’i respektohet e drejta e ankimit personit të dënuar, në mënyrë që ai të ketë mundësinë të dëgjohet nga një trup tjetër gjyqësor. Nga ana tjetër, gjykimi në apel ka si qëllim që të korrigjojë edhe ato gabime që mund të jenë bërë gjatë gjykimit në shkallën e parë në lidhje me zbatimin e ligjit, vlerësimin e provave, moskryerjen e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të çështjes, si dhe në lidhje me ligjshmërinë e refuzimit të gjykimit të shkurtuar. Kontrolli i ushtruar nga gjykata e apelit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është kontroll konstatues, por me synim që të plotësohen mangësitë e të korrigjohen gabimet.

80. Nga ana tjetër, Kolegji thekson se në këtë rast, riparimi i pasojave të mospranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, duhet të jetë i kushtëzuar me verifikimin e përmbushjes edhe të kushteve të tjera të përmendura më lart. Konkretisht: (i) kërkesa për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri duhet të jetë paraqitur në përputhje me parashikimet e paragrafit të parë të nenit 403 të KPP; (ii) ky kërkim duhet të jetë shoqëruar edhe me analizën apo pretendimin e tij për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit penal (për një vepër penale që nuk parashikon dënim me burgim

të përjetshëm); (iii) verifikimi nga gjykata nëse çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 7 të nenit 405 të KPP. Lidhur me verifikimin e faktit nëse çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, Kolegji vlerëson se ky verifikim tashmë do të kryhet jo mbi bazën e një vlerësimi paraprak të akteve të hetimit, por duke u bazuar edhe tek ecuria e procesit gjyqësor në raport me provat e marra e të verifikuara në gjykim, e lidhur kjo me faktin nëse ka qenë e nevojshme marrja e provave të tjera për të dhënë një vendim të drejtë. Në rast se gjatë gjykimit janë marrë prova të reja (si pasojë e pavlefshmërive absolute/papërdorshmërisë) dhe shqyrtimi i tyre ka qenë i rëndësishëm/vendimtar për cilësimin ligjor të fakteve dhe zgjidhjen e çështjes, gjykata ka të drejtën e refuzimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Ndërsa, në rast se shqyrtimi i provave nuk i ka sjellë ndonjë të re procesit por vetëm humbjen e së drejtës për të përfituar uljen e 1/3 të dënimit në rast se do të ishte pranuar kërkesa për gjykim të shkurtuar, gjykatat duhet të aplikojnë nenin 406/1 të KPP, pavarësisht se kërkesa për gjykim të shkurtuar në seancë paraprake apo në shkallë të parë është refuzuar, duke ndrequr kështu pasojat e një vendimi të marrë në kundërshtim me ligjin. Në këtë rast çështja mund të zgjidhej “në gjendjen që janë aktet” dhe kështu do të bëhet ndreqja e pasojave, duke aplikuar uljen e dënimit me 1/3 sipas nenit 406/1 të KPP.

Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me nënçështjen e dytë të shtruar për njësim/zhvillim, Kolegji mban këtë qëndrim njësoj: ***Nëse gjykatat në përfundim të gjykimit të zakonshëm, i japin faktit një cilësim tjetër juridik për një vepër penale që nuk parashikon dënimin me burgim të përjetshëm, duhet të zbatojnë nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me masën e dënimit edhe nëse akuza është ngritur për një vepër penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm dhe gjyqtari i seancës paraprake e ka dërguar në gjyq për këtë akuzë. Ky përfundim zbatohet, me kusht që të plotësohen elementet e mëposhtme:***

a. Të jetë paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar nga i pandehuri në përputhje me parashikimet e paragrafit të parë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, e shoqëruar me kërkimin e tij për ndryshimin e cilësimit juridik të faktit, për një vepër penale që nuk parashikon dënim me burgim të përjetshëm.

b. Të çmohet që çështja mund të zgjidhej në gjendjen që janë aktet, duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 7 të nenit 405 të Kodit të Procedurës Penale.”

iv. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

[..]Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Shkodër nuk ka vend për tu cenuar dhe si e tillë duhet të lihet në fuqi. [..]

Në rastin konkret, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, Kolegji vlerëson se cilësimi juridik i veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79, shkronja “a” i KP është në interpretim të drejtë të ligjit material penal. Pretendimi i mbrojtjes së ankuesit në lidhje me ndryshimin e cilësimit të faktit penal nga vepra penale për të cilën është akuzuar në veprën penale “Vrasje e kryer në kapërcim të mbrojtjes së nevojshme” parashikuar nga neni 83 i KP është i pabazuar (në konsideratë të rrethanave të faktit të pranuar nga të dyja gjykatat) dhe ka marrë përgjigje të argumentuar nga të dyja gjykatat. Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatave është e arsyetuar në përputhje me nenin 152 dhe 383 të KPP, duke i dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të ankuesit, si dhe në respektim të standardit provues “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”. Nga mbrojtja nuk është paraqitur asnjë fakt, rrethanë apo provë që të krijojë dyshim për akuzën, e cila të çmohej në favor të të miturit në konflikt me ligjin.

[..] përr më sipër, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “e” të KPP, Kolegji vlerëson se vendimmarrja objekt rekursi duhet të lihet në fuqi.

Mendim pakice

[..]Me këtë vendim të shumicës së anëtarëve të Kolegjit, **ne gjyqtarët Ilir Panda dhe Albana Boksi, jemi pjesërisht kundër.** Gjyqtarët në pakicë kanë mbajtur qëndrimin se, “*Ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2 i KPP, nuk zbatohet për subjektet ndaj të cilëve ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm*” (ndaj të miturit në konflikt me ligjin dhe grave). Natyrisht, ky qëndrim gjen zbatim edhe në rastin kur akuza që i është atribuuar të miturit në konflikt me ligjin apo gruas, cilësohet si e mbetur në tentativë. Në lidhje me dy qëndrimet të tjera njësuere në raport me zbatimin e institutit të gjykimit të shkurtuar, jemi dakord me konkluzionet njësuere (duke saktësuar se për nënçështjen e dytë, cilësimi i veprës penale si e mbetur në tentativë, jemi dakord me konkluzionet e shumicës, kur i gjykuari nuk është një mitur në konflikt me ligjin apo grua). Në lidhje me këtë qëndrim argumentojmë sa me poshtë vijon: [..]

Gjyqtarët në pakicë theksojnë se KDPM është një kuadër ligjor i posaçëm (*lex specialis*) mbi drejtësinë penale për të miturit, i krijuar për të mbrojtur të miturit dhe interesin më të lartë të fëmijës. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të dhëna qoftë nga institucione

publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ofron mbrojtje të veçantë për të miturit dhe ka për qëllim të tregojë edhe një status, një kujdes më të madh për fëmijët, i cili duhet të reflektohet jo vetëm në legjislacion por edhe në të gjithë veprimtarinë e organeve shtetërore dhe subjekteve që trajtojnë të miturit. Lidhur me parimin e specialitetit të normave, me vendimin nr. 3, datë 02.11.2015, Kolegjet e Bashkuara [...]

Në referim të analizës dhe të përcaktimeve ligjore të sipërcituara, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se në kushtet e ekzistencës së mbrojtjes së posaçme ligjore të parashikuar për të miturin në konflikt me ligjin, zbatimi i rregullit të parashikuar në nenin 403/2 të KPP, është i kufizuar. Qëllimi i ligjvënësit nuk është dënimi i të miturit por rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose një vepër tjetër penale. Ndër parimet e drejtësisë penale për të mitur është edhe gjykimi i drejtë, i shpejtë dhe me përparësi i të miturit në konflikt me ligjin (nenet 17 dhe 88 të KDPM). Sa më sipër trajtuar, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se rregulli i përgjithshëm i parashikuar në nenin 403/2 i KPP, nuk gjen zbatim në rastin e të miturit në konflikt me ligjin, pasi KP (nenet 31 dhe 51) dhe KDPM, përmbajnë rregullime më të favorshme, jo vetëm duke e përjashtuar atë nga dënimi me burgim të përjetshëm, por duke përcaktuar se dënimi me burgim për të miturin nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikohet për veprën penale të kryer, por jo më shumë se 12 vjet, (neni 97/2 KDPM). Në këtë kuptim, vlerësohet se pika 2 e nenit 403 të KPP, në rastin kur të miturit janë autorë të veprës penale, nuk mund të interpretohet si dispozitë e vetme (e izoluar) në legjislacionin penal shqiptar, por, në bazë të interpretimit sistematik, duhet analizuar dhe interpretuar në raport harmonik me parashikimet e dispozitave të tjera materiale të KP dhe KDPM.

Gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se i njëjti qëndrim duhet mbajtur edhe në rastin kur akuza i atribuohet një gruaje, për të cilën ligjvënësi ka përjashtuar dhënien e një dënimi me burgim të përjetshëm. Ky qëndrim mund të parashtrojë diskutime në drejtim të diskriminimit për shkak të përkatësisë gjinore, në raport me zbatimin e ndalimit të parashikuar në pikën 2 të nenit 403 të KPP, kur i pandehuri është burrë. [...] Gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se edhe në rastin e grave ndalimi i parashikuar në nenin 403 pika 2 të KPP, nuk mund të zbatohet. [...]

Në ndryshim nga sa ka argumentuar shumica e anëtarëve të Kolegjit Penal, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se ligjvënësi në ndryshimet e

pikës 2 të nenit 403 të KPP, nuk ka individualizuar si kriter të vetëm llojin e veprës penale, përse kohë kriteri ndalues në zbatimin e gjykimit të shkurtuar lidhet me sanksionin e parashikuar në veprat penale përkatëse. Kjo do të thotë se nga analiza e zbatimit të këtij lloji gjykimi të posaçëm nuk mund të shmanget parashikimi i sanksionit që *de jure* dhe *de facto* mund të zbatohet si dënim në përfundimin e gjykimit. Në rastin e të miturit në konflikt me ligjin apo të gjykuarave gra që akuzohen për një vepër penale të rëndë, ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht se ndaj tyre nuk mund të aplikohet dënimi me burgim të përjetshëm (natyrisht në rastin kur ato gjenden fajtorë për faktin penal të atribuuar). Ky parashikim ligjor i posaçëm do të zbatohet dhe ka përparësi ndaj çdo rregulli tjetër të përgjithshëm. [..]

Në përfundim të kësaj analize, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se neni 403 pika 2 e KPP nuk gjen zbatim në rastin e të miturve në konflikt me ligjin apo të gjykuarave gra, për të cilët në asnjë rast (referuar veprave penale të pjesës së posaçme të KP apo të Kodit Penal Ushtarak) nuk mund të zbatohet (por as nuk parashikohet *de facto*) dënimi me burgim të përjetshëm. Gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se qëllimi i ligjvënësit në rastin konkret, duhet analizuar edhe në raport me parimet që udhëheqin procesin penal ndaj një të mituri në konflikt me ligjin apo në raport me standardet ndërkombëtare që janë miratuar në mbrojtje të grave. [..]

Në përfundim, ne gjyqtarët në pakicë Ilir Panda dhe Albana Boksi, në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete shprehim dakordësinë me konkluzionet e shumicës së anëtarëve të Kolegjit Penal në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe bazueshmërinë e akuzës së atribuuar të miturit në konflikt me ligjin në provat e marra dhe të verifikuara në këtë gjykim në përputhje me kërkesat e neneve 152 dhe 383 të KPP. Në këtë rast, referuar konkluzioneve dhe analizës së cituar më lart në lidhje me zbatimin e nenit 403 pika 2 për të miturit në konflikt me ligjin dhe gratë, shprehim votën tonë për ndryshimin e vendimit nr. 188, datë 09.05.2019 të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke riparuar pasojat e gjykimit të shkurtuar që në vlerësimin tonë është refuzuar pa të drejtë nga gjykatat e faktit. Në këtë kuptim, duke vlerësuar këtë qëndrim zbatim të ligjit procedura penal, që nuk dikton nevojën e vlerësimit të fakteve apo të provave, çmojmë që dënimi i caktuar nga gjykatat e faktit për të miturin në konflikt me ligjin, Roland Matranxhi, duhet të ishte ulur me 1/3 e tij.



**30.Vendim njësues nr. 00-2025-2162 (275),
datë 06.11.2024 (përsëritje shqyrtimi
gjyqësor apeli - kur i pandehuri është
deklaruar i pafajshëm përfitim ulje 1/3
e dënimit)**

Sentenca njësuese: Parashikimi i nenit 427, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale nuk e detyron gjykatën e apelit që në çdo rast kur apelohe vendimi i pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Kur gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, e vlerëson këtë disponim në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë. Vendimmarrja e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kushtëzohet nga kërkimi i prokurorit në apel për vlerësim të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë, por kur gjykata e apelit e çmon të domosdoshme, mund të marrë prova të tjera edhe kryesisht, me qëllim garantimin e kontrollit efektiv rishikues. Gjatë gjykimit në shkallë të dytë, në përputhje me nenin 427, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata ka detyrimin të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë provat deklarative që janë të nevojshme në drejtim të përcaktimit të fajësisë ose pafajësisë së të pandehurit.

Nëse çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, parashikimi i nenit 427, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale nuk e pengon gjykatën e apelit të përsërisë shqyrtimin gjyqësor edhe përmes marrjes së provave të reja. Të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së një të tretës së dënimit, në rast të dhënies së vendimit të fajësisë nga ana e gjykatës së apelit.

Fjalë kyçe: apelim i vendimit të pafajësisë, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor, marrja e provave të reja

**Unifying Decision no. 00-2025-2162 (275), dated 06.11.2024
(repeat of the appeal trial - when the defendant is declared
not guilty, benefit of a 1/3 reduction in the sentence)**

Unifying sentence: The provision of Article 427, point 4, of the Code of Criminal Procedure does not oblige the appellate court to repeat the trial in every case when the decision of acquittal is appealed. When the court decides to repeat the trial, it evaluates this disposition in relation to the need to verify the facts or evidence of the case under trial, if issues of erroneous assessment of evidence

by the court of first instance have been raised in the appeal. The decision of the appellate court to repeat the trial is conditioned by the prosecutor's request on appeal for an erroneous assessment of the evidence by the court of first instance, but when the appellate court deems it necessary, it may also receive other evidence ex officio, in order to guarantee effective review control.

During the trial in second instance, in accordance with Article 427, paragraph 4 of the Code of Criminal Procedure, the court is obliged to repeat the trial by receiving the declaratory evidence that is necessary in order to determine the guilt or innocence of the defendant. If the case was tried in first instance under the summary trial procedure, the provision of Article 427, paragraph 4 of the Code of Criminal Procedure does not prevent the appellate court from repeating the trial by receiving new evidence. The defendant is entitled to a one-third reduction in sentence in the event of a guilty verdict by the appellate court.

Keywords: *appeal of acquittal, retrial, admission of new evidence*

Rrethanat e çështjes:

[...] Me datë 17.06.2004 me anë të vendimit nr.31777 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë vendimi për regjistrimin si person juridik të shoqërisë tregtare pa ofertë publike “Emanuel Gas” SHA me aksioner [...] Prokuroria në kërkesën e paraqitur për gjykim ka pretenduar, se i pandehuri Gj.L. ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 164 i KP, për shkak se nuk ka paguar qiranë sipas kontratës së lidhur ndërmjet palëve; nuk ka mbajtur mbledhje të rregullt vjetore; ka ndryshuar termat e kontratës së kredisë së lidhur me BKT SHA në vitin 2005 pa miratimin e shoqërisë i ka dhënë hua shoqërive të treta etj, ku pa analizuar në mënyrë konkrete veprimet, por duke u bazuar kryesisht vetëm tek akti i ekspertimit ka vlerësuar se shtetasi Gj.L. në cilësinë e drejtorit të shoqërisë ka shpërdoruar kompetencat e njohura me statut e me ligj, duke dëmтуar interesat e shoqërisë për interesa të tij.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me anë të vendimit nr.134, datë 25.07.2013 ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin Gj.L. për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 164 i KP. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me anë të vendimit nr.68, datë 17.02.2014 ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues. Në këtë vendim Gjykata e Apelit Shkodër ndër të tjera ka arsyetuar se gjykata në asnjë vend nuk ka arsyetuar se cila ka

qenë mospërmbushja e rregullt e detyrës nga ana e të pandehurit dhe dëmi efektiv që i ka ardhur shoqërisë nga veprimtaria e paligjshme e të pandehurit.

Pasi çështja është kthyer për rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka caktuar një ekspert kontabël, dhe në përfundim të ekspertimit, pasi është njohur me konkluzionet e ekspertimit (siç rezultoi nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë), prokuroria në bazë të nenit 377 të KPP ka kërkuar kalimin e akteve pranë saj. Në bazë të kësaj kërkesë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me anë të vendimit nr.284, datë 30.06.2015 ka vendosur kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ky vendim ka marrë formë të prerë me datë 10.07.2015 pa u ankimuar nga palët.

Pasi ka tërhequr aktet, organi i akuzës ka kryer disa veprime hetimore dhe kryesisht është përqendruar në kryerjen e një ekspertimi kontabël, duke e mbështetur edhe akuzën në këtë ekspertim. [...]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 194, datë 19.06.2017 ka vendosur: *“Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Gj.L. për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i kompetencave” parashikuar nga neni 164 i KP. [...]”*.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 110, datë 30.07.2020 ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr.194, datë 19.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Deklarimin fajtor të të pandehurit Gj.L. për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim i kompetencave” parashikuar nga neni 164 i KP. Dënimin e të pandehurit me 300.000 (treqind mijë) lekë gjobë. [...]”*

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] pasi shqyrtoi dhe analizoi llojin e çështjes penale në gjykim, shkaqet e ngritura në rekurs, shqyrtoi vendimet e gjykatave, duke konstatuar se në rekurs [...] ngrihen shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, paraqiten pretendime për shkelje procedurale gjatë gjyimit të çështjes pranë gjykatës së apelit, në zbatimin e nenit 427 të KPP “përsëritja e shqyrtimit gjyqësor”, dhe në veçanti për zbatimin e pikës 4 të nenit 427 të KPP, në lidhje me detyrimin e gjykatës së apelit për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor, kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, e në pamundësinë që kjo gjykatë të vendosë për deklarimin fajtor vetëm mbi vlerësimin ndryshe të provave të marra në gjykimin e shkallës së parë. Gjithashtu konstatohet se vendimi i Gjykatës së Apelit ka trajtuar disa nga çështjet që lidhen me zbatimin e paragrafit 4 të nenit

427 të KPP, që lidhen me interpretimin e termit “Përsëritje e shqyrtimit gjyqësor”, masën e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, kuptimin e vlerësimit të gabuar të provës e mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në gjykimin në apel pa kërkesë të prokurorit.

Kolegji konstatoi, se për çështje të zbatimit të nenit 427/4 të KPP ka praktika të ndryshme nga ana e gjykatave të apeleve, si dhe kuptime të ndryshme në lidhje me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, konkretisht në lidhje me zbatimin e pikës 4 të nenit 427 të KPP, nëse përmbajtja e këtij rregullimi e detyron gjykatën e apelit, që në çdo rast kur apelohe vendimi i pafajësisë të përsërisë shqyrtimin gjyqësor tërësisht apo pjesërisht, nëse vendimi për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kushtëzohet nga shkaqet e paraqitura në apel nga prokurori, e se cilat prova mund të merren gjatë gjykimit në apel në rast të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP, si dhe në rast se çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, a duhet të zbatohet parashikimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP në lidhje me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja dhe a ruhet përfitimi nga gjykimi i shkurtuar.

[...] Kolegji vlerësoi të njësojë praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e nenit 427/4 të KPP, pas ndryshimeve ligjore që ka pësuar kjo dispozitë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr.35/2017, datë 30.03.2017, duke shtruar për njësim çështjet si vijon:

1. Zbatimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP, a e detyron gjykatën e apelit, që në çdo rast kur apelohe vendimi i pafajësisë të përsërisë shqyrtimin gjyqësor (tërësisht apo pjesërisht)?

1.1 Vendimi për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, a kushtëzohet nga shkaqet e paraqitura në apel nga prokurori ?

2. Cilat prova mund të merren gjatë gjykimit në apel në rast të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP?

3. Në rast se çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, a duhet të zbatohet parashikimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP në lidhje me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja dhe a ruhet përfitimi nga gjykimi i shkurtuar?

[...]

Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Kolegji thekson se mosrëndimi i pozitës së të pandehurit së bashku me parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, parimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtën e mbrojtjes, aksesin në gjykim e të drejtën për t'u dëgjuar e marrë provat e kërkuara, barazia e armëve në procesin gjyqësor penal, dhe e drejta e ankimit janë elementet thelbësorë të procesit të drejtë

gjyqësor në kuptim të nenit 30, 31, 42, 43 të Kushtetutës¹⁰ dhe nenit 6 të KEDNJ e duhet të trajtohen si kushte të domosdoshme e kumulative për garantimin e pozitës së të pandehurit në procesin gjyqësor penal. [...]

Në dispozitat tona procedurale që parashikojë ankimin në apel, janë sanksionuar këto parime që garantojnë paanësisë e gjykatës në rastin vetëm të ankimit të të pandehurit por me mundësinë që gjykata e apelit të shqyrtojë ankimin edhe mbi motive të tjera, të cilat ngrihen kryesisht nga gjykata ose nga palët por që mund të prekin edhe palët e tjera kur nuk lidhen me motive ngushtësisht personale. Në funksion të garantimit të pozitës së të pandehurit e së drejtës për t'u mbrojtur e paraqitur prova në gjykimin në shkallë të dytë, Kodi parashikon mundësinë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apel, nëpërmjet rimarrjes së provave të lejuara gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, ose marrjen e provave të reja nëpërmjet përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor me kërkesë të palëve apo edhe kryesisht nga gjykata e apelit. [...]

E drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor dhe e drejta për t'u dëgjuar në gjykimin në apel sanksionohet nga parimet e përgjithshme të së drejtës së ankimit. E drejta e ankimit i është njohur të pandehurit, prokurorit, viktimës akuzuese, paditësit civil dhe të paditurit civil. [...] Pikërisht me këtë fazë të shqyrtimit të ankimit në apel është i lidhur dhe zbatimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformation in peius*) në mënyrë të veçantë ofron garancinë juridike për pozitën e të pandehurit ndaj vendimit të pafajësisë. Shfajësimi i të akuzuarit nga akuzat gjatë një gjykimi objektiv, të plotë e të paanshëm është pasojë e zbatimit të parimit të prezumimit të pafajësisë. [...] Parimi i prezumimit të pafajësisë nuk mund të zbatohet i veçuar nga ai i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit gjatë gjykimit të çështjes penale mbi ankimin e palëve. Nevoja për harmonizimin e këtyre parimeve është marrë parasysh në ndryshimet e bëra në KPP në vitin 2017, duke synuar përmirësimin e pozitës së të pandehurit gjatë hetimit e gjykimit të procedimit penal. Vendimi i pafajësisë është një nga format e disponimit që gjykata e shkallës së parë mund të japë në përfundim të gjykimit sipas parashikimeve të nenit 388 të KPP. Vendimi i pafajësisë garanton zbatimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, si një nga parimet themelore të procedimit si dhe atë të paanshmërisë së gjykatës. Gjykimi me paanshmëri e një çështje gjyqësore penale kërkon që zgjidhja përfundimtare e çështjes në gjykim, të jetë rrjedhojë e analizës tërësore

10 Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

dhe përfundimtare të çështjes, bazuar në provat e shqyrtuara në ligj dhe në bindjen e brendshme që krijon gjyqtari pas kësaj analize.[...]

[...] Kolegji në nevojën e gjykimin njësoj ka konstatuar se nga ana e gjykatave të apelit ka patur interpretime të ndryshme në lidhje me natyrën e detyrimit procedural të kësaj gjykate në funksion të riçeljes së shqyrtimit gjyqësor, nëse ky detyrim është absolut, nëse riçelja i referohet shqyrtimit gjyqësor në tërësinë e tij apo provave që çmohen prej gjykatës, e në vijim mënyrës së zbatimit të kësaj dispozite. Kjo në mënyrë të veçantë në zbatimin e pikës 4 të nenit 427 të KPP, si në rastet kur gjykimi është zhvilluar në ritin procedural të gjykimit të zakonshëm ashtu edhe në rastet kur gjykimi në shkallë të parë është konceptuar sipas ritit të gjykimit të shkurtuar.

Kolegji Penal në praktikën e tij mbi çështje të zbatimit të nenit 427 të KPP, e ka vënë theksin tek arsyetja e normës së re të krijuar me ndryshimet procedurale të vitit 2017, në nevojën e respektimit të parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. [...]

Në vështrim, e interpretim krahasimor, Kolegji vlerëson se është e nevojshme të bazohet edhe në jurisprudencën dhe praktikën gjyqësore të vendit të legjislacionit procedural burimor tonin, atë procedural italian. Jurisprudenca dhe praktika gjyqësore italiane në lidhje me rishqyrtimin gjyqësor në gjykatën e apelit (*ndryshim vendim pafajësie të gjykatës së shkallës së parë*) ka reflektuar e ndjekur interpretimin jurisprudencial të GJEDNJ, në lidhje me respektimin e këtij parimi, kryesisht në rastet e përballjeve të legjislacionit italian me kontrollin e GJEDNJ.

[...]

Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim:

1. *Zbatimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP, a e detyron gjykatën e apelit, që në çdo rast kur apelohej vendimi i pafajësisë të përsërisë shqyrtimin gjyqësor (tërësisht apo pjesërisht)?*

[...]

Normimi procedural i paragrafit 4 të nenit 427 të KPP, në reflektim të frymës së jurisprudencës së GJEDNJ, u referohet parimeve të përgjithshme mbi të cilat funksionon gjykimi penal në të dy shkallët e gjykimit, në shkallë të parë dhe në apel, natyrën e gjykimit në fakt ku përfshihet dhe gjykimi në apel, dhe mundësinë që gjykata të ketë hapësirën e nevojshme për vlerësim objektiv e me paanësi, në bazë të bindjes së saj të brendshme të të gjitha pretendimeve e provave të nevojshme. *Ratio legis* e normës është ajo që procesi i ankimimit shihet nga ligjvënësi si një natyrë “kontrolluese”, duke kuptuar plotësimin e marrjes së provave gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe garanci për vendimin e pafajësisë së dhënë gjatë gjykimit në këtë shkallë.

Gjykimi në shkallë të dytë, në dallim nga gjykimi në shkallë të parë, kryesisht zhvillohet mbi ato akte që janë administruar dhe i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë. Ky gjykim ka për qëllim të vlerësojë bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, prandaj si rregull ai kontrollon mënyrën se si janë vlerësuar provat dhe se si është interpretuar e zbatuar ligji në shkallë të parë. Gjykimi në apel ka një funksion kontrollues mbi vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, duke shqyrtuar pretendimet e ankuesve mbi gabimet në fakt apo në ligj, në lidhje me vendimin e apeluar.

Rregullat procedurale që ndiqen në shkallë të parë, janë të zbatueshme në apel, për aq sa ato mund të përputhen me natyrën e gjykimit në apel, objekt shqyrtimi i të cilës është vendimi i apeluar. Në këtë vështirësi, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor në apel shfaqet si një përjashtim, i lidhur me rastet kur gjyqtari në apel vlerëson se hetimi gjyqësor në shkallë të parë ka të meta që lidhen me procesin e të provuarit. Gjatë gjykimit në apel, gjykata mund të marrë prova të reja ose t'ia nënshtrojë debatit gjyqësor provat e marra në gjykimin në shkallë të parë, duke përsëritur shqyrtimin gjyqësor, duke riçelur pjesërisht ose plotësisht shqyrtimin gjyqësor në shkallë të dytë. Vetë dispozita që parashikon këtë rregull titullohet “*Përsëritja e shqyrtimit gjyqësor*” dhe ka si qëllim të normojë mënyrën sesi mund të përsëritet shqyrtimi gjyqësor gjatë gjykimit në shkallë të dytë.

Dispozita përkatëse e cila parashikon përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në apel është neni 427 i KPP, ndërsa ajo që lidhet specifikisht me detyrimin për përsëritjen e këtij shqyrtimi në rast se i pandehuri është deklaruar i pafajshëm në gjykimin në shkallë të parë është pika 4 e tij, ndryshuar në vitin 2017.

Kolegji evidenton faktin se, neni 427 i KPP është dispozita analoge e nenit 603 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Italisë (në vijim KPPI). [...]

Nisur nga ky interpretim i bërë nga Gjykata Kushtetuese, Kolegji në praktikën e tij gjyqësore, lidhur me mënyrën e zbatimit të kësaj dispozite, në vendimin nr. 00-2021-898, datë 25.11.2021, ka vlerësuar se fjalja e fundit e pikës 4 të nenit 427 të KPP, *nuk detyron gjykatën e apelit që në çdo rast të apelimin nga ana e prokurorit të vendimit të pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në mënyrë që të shqyrtojë apelin dhe të disponojë me vendim mbi të. Riçelja e shqyrtimit gjyqësor në këto raste mbetet sërish kompetencë diskrecionale e gjykatës së apelit.*

Kolegji është mbështetur kryesisht në jurisprudencën e GJEDNJ dhe asaj Kushtetuese. Kolegji ka theksuar se rol ka edhe natyra e provave

të administruara në funksion të provueshmërisë së pafajësisë së të pandehurit. Kështu mund të ketë raste që procesi gjyqësor të jetë zhvilluar vetëm me material provues shkresor. Në këto raste nuk ka kuptim dhe asnjë dobi juridike për asnjë nga palët dhe për gjykatën që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP. Gjithashtu duhet të mbahet parasysh se mund të ketë raste në të cilat vendimi i pafajësisë është bazuar në prova me dëshmitarë dhe se dëshmitarët mund të kenë ndërruar jetë apo nuk gjenden në gjykimin në apel. Në këto raste kuptohet se është e pamundur objektivisht të përsëritet shqyrtimi gjyqësor për të shqyrtuar apelin e prokurorit, kundër vendimit të pafajësisë së gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu mund të ketë raste kur pyetja e një dëshmitari në gjykimin në apel mund të çojë në cenimin potencial të së drejtës së tij kushtetuese dhe konventore për t'u mos vetëinkriminuar. Në këto raste sërish përsëritja e shqyrtimit gjyqësor mund të rezultojë kushtetutshmërisht dhe ligjërisht e pamundur për t'u realizuar efektivisht në gjykimin në apel. [...]

Sipas dispozitave tona procedurale, roli i gjykatës së apelit është ai kontrollues në raport me vendimmarrjen e gjykatave të shkallës së parë dhe ky kontroll lidhet si me zbatimin e drejtë të normave procedurale, në lidhje me respektimin e garancive procedurale, me hetimin gjyqësor, me mënyrën e administrimit dhe vlerësimit të provave, ashtu edhe me zbatimin e drejtë të ligjit material, në lidhje me zgjidhjen perfundimtare të procedimit penal, fajësinë e të pandehurit si dhe cilësimin juridik të veprës penale, apo pafajësinë e tij, gjithnjë bazuar në analizën e provave të marra dhe administruara në gjykim. Ky shqyrtim duhet të bazohet brenda kufijve të përcaktuar në nenin 425 të KPP. Gjykimi në apel ruan tiparet e gjykimit në fakt e të shqyrtimit në themel të pretendimeve të palëve duke u mbështetur në materialin procedural e provues të marrë gjatë gjykimit në shkallë të parë.

[...]

Nga analiza e këtyre termave rezulton se ligjvënësi nuk bën fjalë për *“përsëritje tërësisht të shqyrtimit gjyqësor”* dhe aq më tepër për një detyrim të tillë ndaj gjykatës. Vetë parashikimi i rimarrjes së provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë, marrja e provave të reja, do të thotë se shqyrtimi gjyqësor mund të përsëritet pjesërisht ose në mënyrë të plotë. Përsëritja e hetimit gjyqësor në mënyrë të plotë do të thotë hetim gjyqësor nga e para. Kjo dispozitë nuk e përjashton dhe as nuk e ndalon përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor. Përkundrazi vetë parashikimi i rishqyrtimit të provave të marra në shqyrtimin gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, marrja e provave të reja, apo atyre që kanë dalë

pas shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë, në thelb në vetvete është formë e përsëritjes së pjesshme të shqyrtimit gjyqësor.

Në nenin 427/1 të KPP bëhet fjalë për rastin kur njëra palë kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë. Pra nuk bëhet fjalë për rimarrjen e të gjitha provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor në shkallë të parë e nuk ndodhemi përpara një detyrimi për të rimarrë të gjitha provat që janë lejuar të merren në gjykatën e shkallës së parë. Rimarrja e disa provave që janë lejuar të merren në gjykatën e shkallës së parë nuk e cenon hetimin gjyqësor, dhe as nuk është veprim në kundërshtim me këtë dispozitë për aq kohë që kjo dispozitë nuk shprehet në mënyrë taksative për të gjitha provat e marra në gjykimin në shkallë të parë. Nga analiza e kësaj dispozite rezulton se, nëse ankuesi kundër vendimit të një gjykate më të ulët në një gjykatë më të lartë, kërkon rimarrjen e provave të lejuara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata mund të vendosë sipas diskrecionit të vet nëqoftëse çmon se në gjendjen që janë provat çështja nuk mund të zgjidhet.

Ndryshe është rasti i shkronjës “ç” të nenit 425 të KPP, parashikim ligjor ky i cili detyron gjykatën e apelit, që në rast kualifikimi ndryshe dhe më të rëndë të veprës penale, të riçelë shqyrtimin gjyqësor dhe të zbatojë procedurën e posaçme të parashikuar në nenin 375 të KPP. Përmbajtja e dispozitës rezulton se është në diskrecion të gjykatës së apelit të vendosë, rast pas rasti, nëse ka vend për pranimin ose jo të kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Jo vetëm kaq, por edhe në rast se gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kjo nuk çon apriori në ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe deklarinin fajtor të të pandehurit, pasi gjykata e apelit, në përfundim të gjykimit, ka detyrimin të zbatojë një nga rastet e nenit 428 të KPP, në lidhje me llojin e vendimmarjes.

Nga mënyra se si është formuluar neni 427 i KPP, gjykata nuk detyrohet që të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo rast dhe kjo është një çështje që ngelet në diskrecionin e saj, si dhe ajo nuk detyrohet të vendosë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo deklarinin fajtor të të pandehurit edhe në rast se vendos pranimin e kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Deklarimi i fajësisë së të pandehurit apo individualizimi i veprave dhe dënimeve penale janë në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, gjatë shqyrtimit të çështjes cakton llojin dhe masën e dënimit.

[...]

Kolegji vlerëson se në kontekst të interpretimit të paragrafit 4 të nenit

427 të KPP, duhet të përdorim të njëjtën logjikë, se qëllimi i fjalisë së fundit të pikës 4 të nenit 427 të KPP, nuk ka qenë që ta detyrojë gjykatën e apelit që në çdo rast të apelimt nga ana e prokurorit të vendimit të pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në mënyrë që të shqyrtojë apelin dhe të disponojë me vendim mbi të. Edhe duke mbajtur parasysh mundësinë e vendimmarrjes së gjykatës së apelit në gjykimin e zakonshëm, në atë që parashikon neni 428 i KPP, konkludohet se vendimmarrjet e gjykatës së apelit në procesin penal, janë të tilla që përjashtojnë apriori përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor në çdo rast. Në këtë kuptim vlerësohet dhe arrihet në konkluzionin se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në këto raste mbetet sërish kompetencë diskrecionale e gjykatës së apelit, edhe sipas rregullimit të ri, pas ndryshimit të nenit 427 të KPP, në vitin 2017.

Kolegji vlerëson se, pika 4 e nenit 427 të KPP, nuk mund të kuptohet dhe nuk mund të zbatohet në atë mënyrë që të konkludohet se në çdo rast të ndryshimit të vendimit të pafajësisë në gjykimin në apel do të duhet të realizohet detyrimisht një përsëritje e plotë e shqyrtimit gjyqësor. Masa e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor rast pas rasti do të duhet të vlerësohet nga ana e gjykatës rishikuese të faktit që është gjykata e apelit. Mund të ketë raste kur ndryshimi i vendimit të pafajësisë vjen jo si pasojë e faktit apo të provave në fashikullin e gjykimit të formësuar në shkallë të parë, por për shkaqe ekskluzivisht ligjore dhe çështje të interpretimit ligjor të instituteve të ndryshme penale, materiale dhe procedurale. Në këto raste nuk është e nevojshme që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor për të përcaktuar ekzistencën apo jo të faktit penal. Mund të ketë raste që procesi gjyqësor të jetë zhvilluar vetëm me material provues shkresor, apo thënë ndryshe të vetmet materiale provuese të përdorura në gjykim për të provuar ekzistencën e faktit dhe fajësinë e autorit të jenë provat e ngrira dhe dokumentare. Në këto raste nuk ka nevojë për asnjë nga palët dhe për gjykatën që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP.

Kolegji sjell në vëmendje se nuk do të ketë nevojë që të zbatohet pika 4 e nenit 427 të KPP atëherë kur dëshmitari që prokuroria kërkon të dëgjohet dhe të administrohet si provë nuk vlerësohet nga gjykata se ka rëndësi në përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit. Kjo do të thotë se nëse dëshmitari ka dhënë dëshmi indirekte, ka dhënë në dëshmi vlerësimet subjektive të tij, opinione apo edhe kur të dhënat nga dëshmia rrëzohen nga provat e tjera të administruara në fashikullin e gjykimit apo të hetimit, atëherë nuk ka arsye që gjykata e apelit të zbatojë detyrimisht pikën 4 të nenit 427 të KPP. Marrja e kësaj prove në gjykimin në apel në këto raste nuk do të kishte rëndësi mbi faktet e çështjes dhe mbi rrethanat

tashmë të provuara në gjykim. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se, pika 4 e nenit 427 të KPP nuk do të zbatohet në rastet kur dëshmia apo prova e re nuk ka rëndësi provuese në faktet dhe rrethanat e çështjes dhe kur vlerësohet nga gjykata se nuk është e rëndësishme në raport me provat e tjera të administruara.

Kur gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, e vlerëson këtë disponim në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë. Në çdo rast gjykata është e detyruar që ta përsërisë shqyrtimin gjyqësor, nëse nga ana e prokurorit është argumentuar në ankim se vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë është i gabuar, duke specifikuar provën konkrete që kërkohet të merret nga gjykata e apelit dhe të verifikohet në debat gjyqësor.

Kriteri i marrjes së vendimit duhet të interpretohet në kuptimin që prova e kërkuar për tu marrë ose që duhet të merret të jetë vendimtare, e do të konsiderohet e tillë kur ka të bëjë me një element i cili, në bazë të vendimit të shkallës së parë, ka përcaktuar ose madje ka kontribuar vetëm në përcaktimin e një rezultati i cili, nëse hiqet nga tërësia e materialit provues, mund të dalë potencialisht i aftë për të ndikuar në rezultatin e vendimit të ankimuar. Provat vendimtare verbale përbëjnë gjithashtu prova që megjithëse gjykohen nga gjyqtari i shkallës së parë me pak ose aspak vlerë, të jenë të rëndësishme për ankuesin, vetëm ose bashkë me prova të tjera, që ndikojnë në vendimarrje.

Gjykata e apelit në marrjen e vendimit të ndërmjetëm për përsëritjen e shqyrtimit vlerëson këtë kërkim si pjesë e apelit dhe argumenton nëse plotësohen kushtet për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor duke u nisur nga shqyrtimi i pretendimit për vlerësim të gabuar të provës/provave dhe nëse kjo është e rëndësishme e vendimtare për disponimin përfundimtar të kësaj gjykate. Ndryshimi i vendimit të pafajësisë bëhet vetëm mbi bazën e një arsytimi të qartë, të plotë që shpjegon në mënyrë specifike paqëndrueshmërinë në nivel logjik dhe ligjor të argumenteve më të rëndësishme të vendimit të gjyqtarit të shkallës së parë. Kjo kalon përmes një verifikimi të thellë analizes e kritik në kohë dhe që rezulton në një arsytim të ndryshëm, të plotë dhe më bindës, i cili, duke u mbivendosur në përgjithësi me arsyet e vendimit të shkallës së parë, bazohet në rezultatet e ndryshme të arritura dhe vlerën më të madhe ose të ndryshme që i jepet secilit element prove që është pjesë e procesit të të provuarit.

Detyrimi i gjyqtarit të apelit për të proceduar qoftë edhe kryesisht, me rimarrjen e provave bëhet kur është e nevojshme një vlerësim i ndryshëm i besueshmërisë së një prove që konsiderohet e rëndësishme dhe përcaktuese

për qëllimin e vendimit të ndryshëm nga ai i pafajësisë. Fizionomia e provës vendimtare i referohet idesë se vendimi i gjyqtarit të apelit të bazohet në një vlerësim të ndryshëm të provës që ka nevojë të dëgjohet, në mënyrë verbale e të drejtpërdrejtë në gjykim, merret drejtpërdrejt, të diskutohet, të kundërshtohet, kjo edhe në mundësinë që kjo provë e marrë në këtë mënyrë të konfirmojë dhe pafajësinë. [...] **Në përmbajtje të nenit 427 të KPP, nuk përmendet lloji i provave, e ligji ynë nuk bën diferencë mes natyrës së provave. Në këtë kontekst interpretimi, duhet bërë dallimi me natyrën e ndryshme të një kategorie provash që emërtohen si prova të gjalla apo deklarative, natyrë që lidhet me fizionominë e drejtpërdrejtë të provës si e tillë ose me karakterin deklarativ të saj që vjen nga një burim tjetër i provës. Këtu mund të citojmë dallimin që praktika gjyqësore italiane ka bërë në çështjen “Dasgupta”,¹¹ në konceptin e provës deklarative në mes të dëshmitarit dhe ekspertit apo konsulentit teknik. Natyra e deklaratave të ekspertëve dhe konsulentëve teknik do ti bënte ato të ngjashme me burimin e dëshmisë dhe rrjedhimisht me konceptin e provës deklarative.**

Në gjykimin e çështjes prej gjykatës së apelit, kjo e fundit që mban përgjegjësinë për të vendosur mbi fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarve, duhet që të jetë në gjendje të dëgjojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshmitarët në funksion të vlerësimit të besueshmërisë së tyre, përsa kohë që ky vlerësim përbën një detyrim kompleks, i cili normalisht nuk mund të konsiderohet i realizuar me një lexim të thjeshtë të deklarimeve të tyre.

Sa i përket masës së përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, nga sa më lart u arsyetua, arrihet në konkluzionin se në parim riçelja e shqyrtimit gjyqësor, sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP, është një përsëritje e pjesshme në raport me provën që duhet marrë. Është e pjesshme normalisht sepse nevoja për përsëritje dhe rimarrje të provave lidhet ekskluzivisht vetëm me ato prova të cilat janë vendimtare për ndryshimin e vlerësimit dhe që janë formësuar në gjykim si të tilla, natyra e të cilave do të trajtohet më poshtë në pikat e tjera të këtij vendimi. Por gjykata e Apelit nuk ka pengesë ligjore që të bëjë një përsëritje tërësore të shqyrtimit gjyqësor nëse e vlerëson të nevojshme se për arritjen e një vendimi ndryshe nga shkalla e parë, shqyrtimi gjyqësor duhet përsëritur në tërësi.

Në funksion të pyetjes së shtruar për njësim, referuar interpretimit sistematik dhe teleologjik të nenit 427/4 të KPP, e qëllimit të krijimit të kësaj

11 Vendimi nr. 27620 datë 28.04.2016 i Gjykatës së Kasacionit në Itali, vendim mbi çështjen Dasgupta.

norme, me standardet e vendosura nga GJEDNJ, si dhe jurisprudencës së Gjykatës së Kasacionit të Italisë dhe përmbajtjes homologe të dispozitës, neni 603 (3) të KPP italian në interpretim krahasues, Kolegji arrin në konkluzionin se ankimi ndaj vendimit të pafajësisë, sipas nenit 427/4 të KPP nuk ngarkon gjykatën e apelit me detyrimin absolut të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor sa herë paraqitet ankim nga prokuroria ndaj vendimit të pafajësisë ose në çdo rast kur kërkohet përsëritja në ankimin e prokurorit. Është në vlerësimin e gjykatës së apelit të vendosë, rast pas rasti, nëse ka vend për pranimin ose jo të kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Edhe në rast se gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, kjo nuk çon apriori në ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit, pasi gjykata e apelit, në përfundim të gjykimit, ka detyrimin të zbatojë një nga rastet e nenit 428 të KPP, në lidhje me llojin e vendimmarjes. Gjykata e apelit nuk detyrohet të vendosë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo deklarimin fajtor të të pandehurit edhe në rast se vendos pranimin e kërkesës për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor.

Nisur dhe nga interpretimi që jurisprudenca kushtetuese i ka bërë kufijve të pavarësisë së gjykatës në gjykimin në apel, riçelja e shqyrtimit gjyqësor në këto raste është kompetencë diskrecionare e gjykatës së apelit, e cila përsërit shqyrtimin gjyqësor në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave. Rrjedhimisht, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor është e pjesshme në raport me nevojën e marrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë të provave nga gjykata e apelit, dhe që duhet të verifikohen gjatë gjykimit në shkallë të dytë.

Si konkluzion logjik i arsyetimit të mësipërm, Kolegji arrin në përfundimin se parashikimi i nenit 427, pika 4, i KPP, nuk e detyron gjykatën e apelit që në çdo rast kur apelohej vendimi i pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Gjykata është e detyruar që ta përsërisë shqyrtimin gjyqësor, vetëm nëse nga ana e prokurorit është argumentuar në ankim se vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë është i gabuar, duke u specifikuar prova konkrete e kërkuar, marrja e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e apelit, verifikimi i saj në debat gjyqësor e kontradiktoritet, e nëse argumenton se kjo provë është vendimtare në vlerësimin në raport me provat e tjera.

Në vijim të arsyetimit të mësipërm, **në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:**

Parashikimi i nenit 427, pika 4, të Kodit të Procedurës Penale nuk e detyron gjykatën e apelit që në çdo rast kur apelohej

vendimi i pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Kur gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, e vlerëson këtë disponim në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë.

Në lidhje me nënçështjen e pyetjes së parë të shtruar për njësim:

Vendimi për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, a kushtëzohet nga shkaqet e paraqitura në apel nga prokurori ?

[...] Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, karakterizohen nga zbatimi i parimit *'tantum devolutum quantum appellatum'*, duke u kuptuar se në rishikim disponohet për aq sa kërkohet. Kjo do të thotë se brenda funksionit natyral të saj, gjykata e apelit si gjykatë ligji dhe fakti, shqyrton apelin e paraqitur në respektim të shkaqeve të ngritura në ankim. Apeluesi duhet të ketë evidentuar qartë në apelin e tij shkaqet për të cilat po kundërshtohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë. Ky parim nuk vepron në ato raste kur ligji ka garantuar rolin aktiv të gjykatës së apelit, në drejtim të sigurimit të procesit të rregullt ligjor, kur ajo duhet të aktivizohet kryesisht si një gjykatë ligji rishikuese e nivelit të dytë.

[...] Qëndrimi i Kolegjit Penal për këtë çështje të së drejtës ka qenë konstant. [...]

Në funksion të pyetjes së shtruar për njësim, në vijim edhe të qëndrimeve të mëparshme, Kolegji vlerëson se paragrafi 3 i nenit 427 të KPP, që parashikon përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Apelit, me kërkesë të palëve, nuk mund të interpretohet i veçuar nga paragrafi i parë i kësaj dispozite që parashikon rregullin e përgjithshëm. Në ndryshim nga paragrafët e mësipërm, Kolegji vlerëson se paragrafi 4 i nenit 427 nuk mund të interpretohet i lidhur me paragrafin 3 të nenit 427, pasi paragrafi 4 ndryshe nga paragrafët 1 dhe 3, parashikon rastin kur apelohe vendimi i pafajësisë. Në këtë rast, Kolegji vlerëson se, vendimmarrja e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor do të kushtëzohet nga kërkimi i prokurorit në apel/ ankim për vlerësim të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë, por nëse gjykata e apelit e çmon të domosdoshme, mund të marrë prova të tjera edhe kryesisht, përveç atyre të kërkuara nga ana e prokurorit në ankim, me qëllim garantimin e kontrollit efektiv rishikues. [...] Shqyrtimi i ankimit në apel kushtëzohet nga garancia e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, por me mundësinë që gjykata e apelit të shqyrtojë ankimin edhe mbi motive të tjera, të cilat ngrihen kryesisht nga gjykata ose nga

palët por që mund të prekin edhe palët e tjera kur nuk lidhen me motive ngushtësisht personale. Kjo në funksion të garantimit të pozitës së të pandehurit e së drejtës për t'u mbrojtur e paraqitur prova në gjykimin në shkallë të dytë.

Nisur nga procedura e gjykimit të çështjes në shkallë të parë, këtu duhen evidentuar dy situata procedurale: (i) Së pari, situata kur, gjykimi në shkallë të parë është bërë me procedurën e posaçme të gjykimit të shkurtuar, në përfundim të të cilit i pandehuri është deklaruar i pafajshëm. (ii) Së dyti, situata kur, gjykimi në shkallë të parë është bërë me procedurën e gjykimit të zakonshëm, në përfundim të të cilit i pandehuri është deklaruar i pafajshëm. Kolegji vlerëson se, në të dy rastet e cituara më sipër, është e nevojshme që, nga ana e prokurorit, në rastet kur është kërkuar prej tij përsëritja e shqyrtimit gjyqësor, ose edhe nga vetë gjykata e apelit, në rastet kur, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor bëhet me iniciativën e saj (*ex officio*), duhet të arsyetohet në mënyrë shteruese fakti se, përse është e nevojshme përsëritja e shqyrtimit gjyqësor, në kuptimin që, duhen marrë prova të reja që kanë dalë pas dhënies së vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duhen marrë në shqyrtim prova të cilat janë refuzuar nga gjykata e shkallës së parë, apo është e nevojshme zhvillimi i debatit gjyqësor të kryqëzuar midis palëve, sipas parimit të kontradiktoritetit, ku të përcaktohet fuqia provuese dhe vërtetësia e çdo prove, pa i dhënë asnjërës prej tyre vlerë të paracaktuar.

Gjykata është e detyruar që ta përsërisë shqyrtimin gjyqësor, vetëm nëse nga ana e prokurorit është argumentuar në ankim se vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë është i gabuar, duke u specifikuar prova konkrete e kërkuar, marrja e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e apelit, verifikimi i saj në debat gjyqësor e kontradiktoritet, e nëse argumenton se kjo provë është vendimtare në vlerësimin në raport me provat e tjera. Siç konkludoi Kolegji më sipër, me qëndrimin njësoj, parashikimi i nenit 427, pika 4, të KPP nuk e detyron gjykatën e apelit që në çdo rast kur apelohej vendimi i pafajësisë, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Kur gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, e vlerëson këtë disponim në raport me nevojën e verifikimit të fakteve ose provave të çështjes në gjykim, nëse në apel janë ngritur çështje të vlerësimit të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë.

Prandaj në ankim duhet të argumentohet pretendimi për vlerësim të gabuar të provës/provave në marrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë, dhe nevoja e marrjes së kësaj prove/provave gjatë gjykimit në shkallë të dytë. Gjithashtu, duhet të argumentohet pse kjo provë/prova është/janë vendimtare për të provuar faktet mbi të cilat bazohet akuza në gjykimin

në shkallë të dytë dhe përse është e nevojshme që të përsëritet shqyrtimi gjyqësor në nevojën e dëgjimit të provës në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e apelit.

Vlerësimi i gabuar i provave nënkupton vlerësimin e tyre në kundërshtim me parimet e vlerësimit të lirë të provave sipas nenit 152 të KPP dhe kriterëve të vlerësimit të tyre. [...] Ky është momenti i vlerësimit të provave një nga një, në mënyrë analitike, në raport me njëra-tjetrën. Çmuarja e vlerësimi, bëhet mbi bazën e asaj çka rezultojnë gjatë marrjes së shqyrtimit të tyre gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor. [...] Parimet bazë mbi të cilat zhvillohet ky proces janë se çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar, e gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Këto dy parime përbëjnë të ashtuquajturin vlerësim të lirë të provave që do të thotë se procesi i çmuarjes së provave i trajton provat në mënyrë të barabartë duke mos i dhënë asnjërës vlerë të paracaktuar. Gjithashtu ky proces i çmuarjes kryhet në bazë të bindjes së brendshme të gjyqtarit pasi ka shqyrtuar provat në tërësi.

[...] Kuptimi i normativizmit apo ligjësimi në vlerësimin e provës nënkupton një kriter metodik që në mënyrë të saktë e kryen vetëm debati gjyqësor e kontradiktoriteti në gjykim si dhe rregullat formale në marrjen e përdorimit të plotë të një të dhëne, e aftë të arsyetojë vendimin gjyqësor. Vlen të nënvizojmë këtu normat e përcaktuara nga neni 151, mbi ndalimin e përdorimit të provave të marra në mënyrë të paligjshme, parimet e vlerësimit të lirë të provave e mbi të cilat gjyqtarët duhet të bazojnë arsyetimin e vendimit sipas nenit 380 të KPP, pra veç ato që janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor. [...]

Prokurori duhet të kundërshtojë në ankim rrëzimin e akuzave duke pretenduar se nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë është bërë një vlerësim i gabuar i provave të cilat nëse do ishin vlerësuar në kontradiktoritet e debat gjyqësor do të sillnin një rezultat tjetër duke u konsideruar të tilla vetëm provat e gjalla ose deklarative, prova të cilat kanë nevojë për verifikim gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apel, në kontradiktoritet, në debat gjyqësor sipas *“kontrollit të kryqëzuar”* të provave siç janë pyetja e dëshmitarëve, ballafaqimi, pyetja e të pandehurit, dëshmia dhe pyetja e ekspertit etj.

Standardi i të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm sjell si nevojë përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor me disa nga llojet e provave për të cilat ka nevojë verifikimi për një vlerësim ndryshe që mund të sjellë konfirmimin e pafajësisë ose të akuzës e të fajësisë së rrëzuar në shkallë të parë. Kjo është në përputhje me parimin e marrjes së provës në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nga gjyqtari i apelit, duke patur gjithnjë referim në nenin 6 paragrafi

3, shkronja “d” e KEDNJ, dhe mënyrën e interpretimit nga GJEDNJ.

Gjyqtari i apelit vijon me marrjen e provave në mënyrë të drejtpërdrejtë përpara se të arrijë në konkluzionin se është siguruar vlera e provës që mbështet fajësinë e të pandehurit, mbi ato prova që janë konsideruar vendimtare në vendimin e pafajësisë në shkallë të parë. Kjo frymë interpretimi me qëllim respektimin e *reformation in pejus* është zhvilluar nga jurisprudenca e GJEDNJ duke fituar një rëndësi të veçantë në vendimin *Dan kundër Moldavisë* por edhe më herët, se konfirmimi i përgjegjësisë në gjykimin në apel, i të akuzuarit që ka marrë pafajësi gjatë gjykimit në shkallë të parë duhet të bëhet në një mënyrë që të ofrojë më shumë garanci për të akuzuarin.

Detyrimi për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor ekziston vetëm nëse gjyqtari synon të ndryshojë gjykimin mbi bindjen e brendshme mbi provën që është konsideruar vendimtare në vendimin e gjyqtarit në shkallë të parë. Pranimi i provave të reja të kërkuara në ankim, është i kushtëzuar nga dy momente me rëndësi : *së pari*, kërkimi i provave të reja duhet të argumentohet në raport me verifikimin e provave të marra gjatë ripërsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në apel, duke vënë në dukje rëndësinë e tyre në raport me vërtetësinë e provës së marrë dhe objektit të provuarit. *Së dyti*, prova e re që kërkohet duhet të jetë vendimtare dhe thelbësore për procesin e të provuarit, nuk duhet të jetë një provë e kërkuar më herët e për të cilën gjykata ka disponuar duke e përfshirë ose jo në fashikullin e gjykimit.

Për sa më sipër, Kolegji arrin në konkluzionin se, në rastin e apelimit të vendimit të pafajësisë, prokurori në aktin e apelit duhet të kërkojë marrjen e provave në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e apelit, kur pretendon se vlerësimi ndryshe i tyre gjatë gjykimit në shkallë të dytë, mund të çojë në një rezultat tjetër që mund të konfirmojë faktet e përgjegjësinë penale të pretenduar. Prokurori duhet t'i përmendë në mënyrë të shprehur këto prova në aktin e ankimit, duke i cituar shprehimisht ato.

Vendimmarrja e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kushtëzohet nga **kërkimi i prokurorit në apel për vlerësim të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë, pasi vendimmarrja për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor duhet të bëhet mbi këtë kërkim.** Megjithatë kjo nuk e pengon gjykatën e apelit, e cila kur e çmon të domosdoshme, me qëllim garantimin e kontrollit efektiv rishikues, mund të marrë prova të tjera përveç atyre të kërkuara nga ana e prokurorit.

Sa më sipër, **lidhur me nënçështjen e pyetjes së parë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:**

Vendimmarrja e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kushtëzohet nga kërkitimi i prokurorit në apel për vlerësim të gabuar të provave nga gjykata e shkallës së parë, por kur gjykata e apelit e çmon të domosdoshme, mund të marrë prova të tjera edhe kryesisht, me qëllim garantimin e kontrollit efektiv rishikues.

Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për njësim:

2. Cilat prova mund të merren gjatë gjykimit në apel në rast të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, sipas pikës 4 të nenit 427 të KPP?

Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor përcaktojnë dhe llojin e provave që mund të merren. [...] Në marrjen e provave gjykata, si rregull, udhëhiqet nga parimi i pandërmjetësisë. Sipas këtij parimi gjykata e merr dijeninë për faktet dhe rrethanat drejtpërdrejt nga burimi i tyre. Nëse ky parim është rregull për gjykimin në shkallë të parë, ai kthehet në përjashtim për sa i përket gjykimit në apel. Gjykimi në apel përgjithësisht bazohet në provat e formuara dhe të grumbulluara në gjykimin në shkallë të parë. Megjithatë, në raste të caktuara, kur gjykata e apelit duhet të ripërcaktojë vlefshmërinë dhe fuqinë e tyre provuese, ajo përsërit shqyrtimin gjyqësor, duke i rimarrë këto prova.

Provat verbale, në dallim nga ato shkresore, formësohen gjatë gjykimit. Për të parat vërtetësia dhe fuqia e tyre provuese testohet gjatë debatit gjyqësor, ndërsa të dytat i kanë të paracaktuara këto dy karakteristika. Për këtë shkak, vlerësimi i provave shkresore mund të bëhet në çdo fazë dhe shkallë të procedimit dhe kjo nuk varet nga nënshtrimi i tyre ndaj debatit gjyqësor. Të vetmet prova të cilat mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe që përcaktimi i vërtetësisë e fuqisë së tyre provuese varet nga faktorë të ndryshëm objektivë dhe subjektivë, janë provat e gjalla, ose provat verbale. [...] Qëllimi i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor është që t'i japë mundësinë të pandehurit që të mbrohet e të debatojë mbi provat të cilat në gjykimin në shkallë të dytë mund të marrin një vlerësim tjetër. [...]

Nga interpretimi literal i nenit 427/4 të KPP, rezulton se gjykata e apelit detyrohet të përsërisë shqyrtimin gjyqësor në çdo situatë, në të cilën i pandehuri deklarohejt fajtor për herë të parë nga gjykata e apelit, pa bërë dallim midis llojeve të provave. Neni 427/4 nuk parashikon në mënyrë të shprehur kufijtë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, lidhur me llojet e provave, për të cilat gjykata e apelit është e detyruar të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Në dallim nga parashikimi i legjislacionit italian, që sanksionon në mënyrë të shprehur përsëritjen e shqyrtimit për provat verbale, legjislatori ynë nuk ka specifikuar prova konkrete. Dispozita

ka parashikuar në mënyrë taksative përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, në çdo situatë, në të cilën mund të deklarohet për herë të parë fajtor i pandehuri, duke mos bërë një dallim midis llojeve të provave. Mungesa e këtij specifikimi mund të konsiderohet një *ometim* legjislativ. [...]

Vlerësimi i besueshmërisë së një dëshmitari është një veprimtari komplekse që, normalisht, nuk mund të kryhet thjesht duke lexuar përmbajtjen e deklaratave të këtij të fundit, siç raportohet në procesverbalin e seancave dëgjimore në shkallë të parë. Është karakteristikë e sistemit tonë procedural që ka zgjedhur modelin akuzator të gjykitit penal, bazuar në marrjen e provës në gjykim, e në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e konkretisht të pyetjes së dëshmitarit, pyetjes së bashkëtepandehurit, të pandehurit në një procedim të lidhur ose bashkëipandehuri në të njëjtin procedim. Kjo bazohet në vlerësimin e provave deklarative të konsideruara vendimtare në gjykimin në shkallë të parë. [...]

Aktet shkresore, procesverbalet ruajnë përmbajtjen dhe fuqinë provuese në gjykimin në fakt e vlerësimi ndryshe i tyre nuk kushtëzohet nga procedura e marrjes së tyre si provë që është e njëjtë si në gjykimin e shkurtuar ashtu dhe atë të zakonshëm. Ndërsa provat e tilla si, dëshmitë, deklaratimet e bashkëtepandehurve, ballafaqimet, pyetjet dhe ripyetjet e ekspertit, mund të ndryshojnë referuar procedurës së gjykitit apo mënyrës së marrjes së tyre. Ato për nga natyra mund të ndryshojnë jo vetëm me kalimin e kohës por edhe nga momenti procedural i procedimit e shkalla e gjykitit, prandaj konsiderohen si prova të gjalla nga momenti që janë fiksuar në procesverbalet e shkruara në momentin e parë. Fuqia provuese e tyre ndikohet nga faktorët objektivë dhe subjektivë. Prandaj dhe detyrimi për të përsëritur shqyrtimin gjyqësor në apel vlen vetëm për prova të tilla të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e fajësisë së të pandehurit.

[...] Në gjykimin e çështjes prej gjykatës së apelit, kjo e fundit që mban përgjegjësinë për të vendosur mbi fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarve duhet që të jetë në gjendje të dëgjojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshmitarët në funksion të vlerësimit të besueshmërisë së tyre, përse kohë që ky vlerësim përbën një detyrim kompleks, i cili normalisht nuk mund të konsiderohet i realizuar me një lexim të thjeshtë të deklarimeve të tyre. Në kuptim të aftësisë së provës për të ofruar të dhëna e besueshmëri mbi faktin e pretenduar, deklarimi në formë të shkruar e të lexuar nuk ofron të njëjtën saktësi si dëgjimi i provës në mënyrë të drejtpërdrejtë prandaj dhe vlerësimi mund të jetë i ndryshëm pikërisht për shkak të mënyrës së marrjes së provës.

[...] Për sa i përket të dhënave që përftohen nga "*prova e gjallë*"

dëshmia në seancë gjyqësore, dhe vlerësimin e saj si provë, legjislacioni ynë procedural sanksionin të njëjtin kuptim e vlerësim të provës “logjike”. [...]

Gjykata e Apelit kur vlerëson se vendimi i pafajësisë duhet ndryshuar ka detyrimin që të bëjë një arsyetim të fortë dhe të tregojë në mënyrë specifike paqëndrueshmërinë në nivel logjik dhe ligjor të argumenteve më të rëndësishëm të vendimit të gjyqtarit të shkallës së parë. Kjo kalon përmes një verifikimi të thellë analizues e kritik në kohë dhe që rezultojnë në një arsyetim të ndryshëm, të plotë dhe më bindës, i cili, duke u mbivendosur në përgjithësi me arsyet e vendimit të shkallës së parë, bazohet në rezultatet e ndryshme të arritura dhe vlerën më të madhe ose të ndryshme që i jepet secilit element prove që është pjesë e procesit të të provuarit.

Ndryshimi i vendimit të pafajësisë në apel, duhet të ketë forcë më të madhe bindëse, që të eliminojë çdo dyshim të arsyeshëm për përgjegjësinë e të akuzuarit e të konfirmojë standardin e provës tej dyshimit të arsyeshëm, në rast të prishjes së vendimit të gjyqtarit të shkallës së parë. Gjyqtari i apelit ka detyrimin të ripërsërisë provat e gjalla apo deklarative përpara se të ndryshojë vendimin e pafajësisë të shkallës së parë, kjo si në rastin e ankimit të paraqitur nga prokurori ashtu edhe nga pala private subjekt në gjykim.

Kriteri i marrjes së vendimit duhet të interpretohet në kuptimin që prova që do merret nga apeli (*prova e gjallë/deklarative*) është vendimtare kur ka të bëjë me një element i cili, në bazë të vendimit të shkallës së parë, është vlerësuar si moskonfirmues i fakteve mbi të cilat bazohet fajësia, e nëse vlerësohet në tërësinë e materialit provues, mund të marrë një vlerë provuese për të ndikuar në rezultatin e vendimit të ankimuar. Provat vendimtare verbale përbëjnë gjithashtu prova që megjithëse gjykohen nga gjyqtari i shkallës së parë me pak ose aspak vlerë, të jenë të rëndësishme për ankuesin vetëm ose bashkë me prova të tjera që ndikojnë në vendimarrje. Si e tillë është prova me dëshmitarë, ballafaqimi mes dëshmitarve, pyetje e të pandehurit, pyetje e bashkëtëpandehurit apo e të pandehurit në një procedim të lidhur, pyetja e ekspertit ose e palës private.

Gjykata e apelit duhet të argumentojë në mënyrë të përpiktë, sipas detyrimit të nenit 383 shkronja “ç”, me rregullat e përcaktuara në nenin 152 të KPP, paqëndrueshmërinë në nivel logjik dhe ligjor të argumentave më të rëndësishme mbi të cilat është dhënë vlerësimi i provës në gjykimin në shkallë të parë dhe përse gjatë marrjes së saj në gjykimin në apel kjo provë merr një vlerë tjetër. Gjykata e apelit duhet të argumentojë përse kjo provë është vendimtare për vlerën e përgjegjësisë në raport me provat e tjera.

Karakteristikë e sistemit procedural është zgjedhja e modelit akuzator të gjykimit penal, bazuar në marrjen e provës në gjykim e në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata. Kjo bazohet në vlerësimin e provave deklarative të konsideruara vendimtare në gjykimin në shkallë të parë. Në rastin e dëshmisë vlerësohet se kërkesa e prokurorit duhet të bazohet në mënyrë specifike në nevojën e verifikimit të besueshmërisë së dëshmitarit në kuadër të një vlerësimi të ndryshëm mbi bazën e të cilit është motivuar dhe ankimi sipas nenit 422 të KPP. Megjithatë, detyrimi nuk shtrihet në dëshmitë, përmbajtja e të cilave është e padiskutueshme, por në lidhje me të cilat thirret një vlerësim i ndryshëm i elementeve konfirmuese; në lidhje me dëshmi të tilla, rishqyrtimi lihet në gjykim të gjyqtarit, i cili mund ta ushtrojë atë në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 425 të KPP.

Kolegji vlerëson dhe konkludon se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel do të mbetet e nevojshme për t'u kryer vetëm në rastin e diktuar nga vlerësimi ndryshe i provave "deklarative". Kjo do të thotë se kjo mënyrë e të proceduarit në gjykimin rishikues në apel do të jetë e nevojshme që të realizohet vetëm kur fajësia/pafajësia e të pandehurit mbështetet kryesisht në provat me natyrë deklarative, të tilla si, dëshmia, deklarimet e bashkëtepandehurve, ballafaqimet, pyetjet apo ripyetjet e drejtpërdrejta të ekspertit.

Në vlerësimin si më lart, Kolegji mban parasysh arsyen juridike të krijimit të një rregulli të tillë në gjykimin penal rishikues. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson dhe konkludon se riçelja e shqyrtimit gjyqësor në apel do të mbetet e nevojshme për t'u kryer vetëm në rastin e diktuar nga vlerësimi ndryshe i provave të gjalla e deklarative. Për të konkluduar në këtë mënyrë Kolegji ka në vëmendje formulimin simotër të dispozitës analoge italiane, konkretisht nenin 603, pika 3-bis e KPPI. Kjo dispozitë formulon rregullin se, në rastin e apelit të prokurorit ndaj një vendimi pafajësie për shkaqe të vlerësimit të provave deklarative, gjykata e apelit vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor.

Në funksion të pyetjes së shtruar për njësim, Kolegji vlerëson se provat që mund të merren gjatë përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e apelit duhet të jenë prova vendimtare e thelbësore për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së të pandehurit dhe të afta për të ndryshuar bindjen e gjyqtarit në lidhje me përmbushjen e funksionit themelor të dhënies së drejtësisë. Në kuptim të nenit 427/4 të KPP, si dhe praktikës së sipërcituar, Kolegji vlerëson se detyrimi i përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, lind vetëm në rastin kur pafajësia ose fajësia e të pandehurit determinohet në procesin gjyqësor penal nga shqyrtimi i provave deklarative, si dëshmitë, deklarimet e

bashkëtëpandehurve, ballafaqimet, pyetjet dhe ripyetjet e ekspertit.

Sa më sipër, **lidhur me çështjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:**

Gjatë gjykimit në shkallë të dytë, në përputhje me nenin 427, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata ka detyrimin të përsërisë shqyrtimin gjyqësor duke marrë provat deklarative që janë të nevojshme në drejtim të përcaktimit të fajësisë ose pafajësisë së të pandehurit.

Në lidhje me çështjen e tretë të shtruar për njësim:

3. Në rast se çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, a duhet të zbatohet parashikimi i pikës 4 të nenit 427 të KPP në lidhje me përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja dhe a ruhet përfitimi nga gjykimi i shkurtuar ?

[...] Gjykimi i shkurtuar mund të zhvillohet vetëm mbi kërkesën e të pandehurit dhe vetëm atëherë kur gjykata çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Tashmë jurisprudenca e konsoliduar gjyqësore është e qartë se ky rit i posaçëm gjykimi është parashikuar në ligj dhe aplikohet në ato raste kur marrja, dëgjimi dhe administrimi i provave sipas rritit normal të gjykimit, është formal, pasi palët nuk kanë kontestime mbi mënyrën e marrjes së tyre, mbi vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e akteve procedurale dhe provave dhe për efekt të ekonomisë gjyqësore, shmanget procedura normale e shqyrtimit gjyqësor. Këtij gjykimi, në dallim nga gjykimi i zakonshëm, i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre. Si përfitim të kësaj ekonomie gjyqësore, ligji ka parashikuar uljen e dënimit për të pandehurin me 1/3, në rast se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ai deklarohet fajtor.

[...]

Në thelb të qëndrimit mbi ruajtjen e përfitimit të uljes së dënimit në gjykatën e apelit, pas përfitimit të pafajësisë me anë të gjykimit të shkurtuar në shkallë të parë, qëndron argumenti se përmes gjykimit të shkurtuar i pandehuri dakordëson “një marrëveshje” me autoritetin publik përmes së cilës ai pranon të heqë dorë nga disa të drejta procedurale në këmbim të uljes së dënimit përfundimtar në masën e 1/3 së tij (*eventualisht nëse do të ketë vendim dënim*).

[...]

Lidhur me të drejtën e riçeljes së shqyrtimit gjyqësor në apel, kur gjykata e shkallës së parë ka proceduar me gjykim të shkurtuar duke dhënë vendim pafajësie për të pandehurin, janë mbajtur qëndrime dhe nga

Kolegji, qëndrime të cilat konstatohet se janë në të njëjtën linjë parimore me jurisprudencën e sipërcituar. [...] Verifikimi i provës vendimtare është një kusht thelbësor i saktësisë dhe plotësimi të arsytimit për vlerësimin e provave, veçanërisht kur motivimi duhet të jetë i një standardi më të lartë të argumentimit për ndryshimin e një vendimi fajësie që është ai i tej dyshimit të arsyeshëm i lidhur drejtpërdrejt me parimin e prezumimit të pafajësisë. Nga këndvështrimi i të akuzuarit, mosmarrja e provës deklarative, shman një kontroll efektiv të argumenteve nga debati i drejtpërdrejtë mbi provën mbi të cilën është bazuar akuza, prandaj përsëritja e shqyrtimit gjyqësor është e nevojshme sipas paragrafit të 4 të nenit 427 të KPP, nëse ankimi i prokurorit bazohet në vlerësimin e gabuar të provës që mund të merret drejtpërdrejt në gjykim e në debat gjyqësor e kontradiktoritet. Referimi është në procedurën e gjykimit të zakonshëm për provat që merren në mënyrë të drejtpërdrejtë në debat gjyqësor gjatë seancës gjyqësore. Në rastin e gjykimit të shkurtuar gjyqtari i apelit duhet të zbatojë marrjen e provës deklarative në procesin e të provuarit, pasi ato janë vlerësuar vetëm në bazë të dokumenteve sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, neni 403 e vijues i KPP.

Në analizë të jurisprudencës së cituar më lart, në funksion të pyetjes së shtruar për njësim, Kolegji vlerëson se neni 427/4 i KPP, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor, aplikohet si në rastet kur gjykimi në shkallë të parë është bërë me gjykimin e zakonshëm ashtu edhe në rastin kur gjykimi ka vijuar me gjykimin e shkurtuar, pasi natyra e gjykimit në shkallë të parë nuk dikton vendimmarrjen e gjykatës së apelit për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, në rastet kur prej saj çmohet e nevojshme riçelja e shqyrtimit gjyqësor, qoftë edhe përmes marrjes së provave të reja.

Kolegji vlerëson se kjo dispozitë është njëlloj e zbatueshme edhe në rastin e shqyrtimit në apel të një çështje penale e cila është përmbyllur me vendim pafajësie përgjatë gjykimit të zakonshëm dhe përgjatë gjykimit të shkurtuar, duke konkuduar se zbatimi i kësaj dispozite në gjykimin në apel nuk lidhet dhe nuk mund të kushtëzohet nga riti procedural me të cilin është zhvilluar gjykimi në gjykatën me juridiksion fillestar.

Në këtë linjë arsytimi, Kolegji, në zbatim të interpretimit krahasues të legjislacionit të ngjashëm procedural penal me atë burimor, e nën lupën e verifikimit të standardit kushtetues, parimeve të procesit të rregullt ligjor e atij të sigurisë juridike, ka në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Italisë, të mbajtur në një rast të kontestimit përmes kontrollit incidental nga gjykata *a quo* mbi zbatimin e pikës 3-bis të nenit 603 të KPP në gjykimin e shkurtuar, konkretisht simotra italiane e rregullimit ligjor të pikës 4 të nenit 427 të KPP shqiptar. [...]

Kolegji vlerëson se në këto raste mundësia e ndryshimit të vendimit të pafajësisë dhe dhënia e një vendimi dënimi në gjykimin në apel nuk passjell humbjen e të drejtës së të pandehurit për uljen e dënimit për shkak të zbatimit të gjykimin të shkurtuar në gjykimin fillestar, pasi kjo e drejtë e tij lidhet me ligjshmërinë e dënimit sipas nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ¹². Ulja e dënimit për shkak të zhvillimit të gjykimin të shkurtuar është një e drejtë e të pandehurit që rrjedh prej ligjit procedural por që ka elementin material të përcaktimit të masës së dënimit dhe bën pjesë në konceptin e dënimit që duhet të formësohet dhe individualizohet në çdo rast sipas ligjit me të gjitha elementët e tij. Në këto raste gabimi i organeve shtetërore në ritin e gjykimin dhe në gjykim nuk mund të justifikojë dënimin pa ligj të të pandehurit dhe nuk mund të dëmtojë kurrësi pozitën juridike të tij (*in peius*).

Në këtë konkluzion ka arritur edhe Gjykata Kushtetuese, jurisprudence e cila ka theksuar se përcaktimi konkret i dënimit është i rivlerësueshëm nga gjykata e apelit, dhe nëse kjo gjykatë vlerëson se është i pajustificueshëm refuzimi i gjykimin të shkurtuar, duhet të aplikojë dënim të reduktuar, edhe pse procedura e ndjekur nuk ka qenë ajo e gjykimin të shkurtuar¹³. Jurisprudence kushtetuese në këtë rast duhet kuptuar në mënyrë të tillë që të detyron të konkludohet edhe në të kundërt po njëllë, që do të thotë se, edhe në rastet kur gjykata e shkallës së parë ka proceduar me gjykim të shkurtuar dhe ka konkluduar në pafajësinë e të pandehurit, gjykimi rishikues sipas ritit të zakonshëm në gjykatën e apelit mbi bazën e apelit të prokurorit nuk mund dhe nuk duhet të ndikojë në përcaktimin e dënimit penal të të pandehurit, duke mos i hequr dot atij në këtë mënyrë një të tretën e dënimit penal. [...]

Lidhur me aplikimin e uljes së dënimit, Kolegji vlerëson se duhet të mbahen në konsideratë standardet në jurispridencën e GJEDNJ në çështjen *Scoppola kundër Italisë* [...]

Në këtë mënyrë, duke mbajtur parasysh gjithçka u soll në vëmendje më lart, Kolegji vlerëson se në shqyrtimin e apelit të prokurorit kundër vendimit të pafajësisë, pavarësisht se gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar sipas ritit të posaçëm të gjykimin të shkurtuar, nevoja e shqyrtimit të apelit kundër vendimit të pafajësisë është e tillë që bën të domosdoshme marrjen e një/më shumë provave në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjykata e shkallës së dytë, duke përsëritur shqyrtimin gjyqësor, tashmë në këtë

12 GJEDNJ “*Scoppola v. Italy no.2*”, Ap. no. 10249/03, vendimi i Dhomës së Madhe të GJEDNJ datë 17.09.2009.

13 Vendimi nr. 21 datë 16.04.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

shkallë sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm. Shqyrtimi gjyqësor në këtë rast fokusohet vetëm në marrjen e një prove e cila duhet të merret në mënyrë të drejtpërdrejtë pasi është vendimtare për përfundimin e gjykimit në këtë shkallë.

Nevoja për marrjen e provave të reja në apel ose detyrimi i gjykatës së apelit për të ndrequr gabimet gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, brenda kompetencave të saj rishikuese si gjykatë ligji dhe fakti, të cilat kanë diktuar nevojën e zhvillimit të gjykimit në shkallë të dytë përmes riçeljes së shqyrtimit gjyqësor, nuk mund të cenojnë të drejtat procedurale të fituara nga i pandehuri për uljen e 1/3 së dënimit, dhe se një interpretim i ndryshëm i ligjit penal do të ishte jo proporcional për shkak të rëndimit *in pejus të pozitës së të pandehurit dhe cenimit të parimit të sigurisë juridike*.

Kolegji vlerëson se interpretimi në këtë mënyrë i nenit 427 paragrafi 4 i KPP, nuk cenon karakteristikat e gjykimit të shkurtuar gjatë të cilit nuk kemi shqyrtim gjyqësor, ndërkohë që në këtë nen parashikohet mundësia e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor. Në mënyrën sesi Kolegji arsyetoi më sipër, shqyrtimi gjyqësor është pikërisht ajo pjesë e gjykimit në apel që konsiston në nevojën për marrje në mënyrë të drejtpërdrejtë të një prove në procedurën e gjykimit të zakonshëm. Detyrimi për një gjykim të drejtë e një vendim të bazuar në prova tejkalon kufizimin procedural për shkak të natyrës së veçantë të gjykimit të shkurtuar dhe garanton një gjykim objektiv.

Si përfundim, Kolegji arrin në konkluzionin se, zbatimi i gjykimit të shkurtuar në shkallë të parë, nuk e pengon gjykatën e apelit të përsërisë shqyrtimin gjyqësor, qoftë edhe përmes marrjes së provave të reja, ku në rast se gjykata e apelit ndryshon vendimin e pafajësisë, të pandehurit i ruhet dhe i takon e drejta e përfitimit të uljes së një të tretës së dënimit.

Sa më sipër, **lidhur me çështjen e tretë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësuës se:**

Nëse çështja është gjykuar në shkallë të parë me procedurën e gjykimit të shkurtuar, parashikimi i nenit 427, pika 4 të KPP nuk e pengon gjykatën e apelit të përsërisë shqyrtimin gjyqësor edhe përmes marrjes së provave të reja. Të pandehurit i takon e drejta e përfitimit të uljes së një të tretës së dënimit, në rast të dhënies së vendimit të fajësisë nga ana e gjykatës së apelit.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

[...] Kolegji vlerëson se përsëritja e pjesshme e shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së apelit, nuk sjell zbatim të gabuar të nenit 427/4 të KPP. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit nuk e ka deklaruar fajtor

të gjykuar mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave.

Lidhur me pretendimin e të gjykuarit se prokurori nuk ka parashtruar shkaqe në ankimin e ushtruar pranë gjykatës së apelit, Kolegji konstaton se ky pretendim është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit, e cila ka argumentuar kërkimet e prokurorit në mjetin procedural ankim. [...]

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret objekt shqyrtimi, në përputhje me parashikimet e shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 441, të KPP, duhet të vendoset lënia në fuqi e vendimit nr. 110, datë 30.07.2020 të Gjykatës së Apelit Shkodër.



**31.Vendim nr. 00-2025-1032 (163),
datë 26.06.2025 (refuzim i aplikimit
të gjykimit të shkurtuar: mosnjohim
personal i të pandehurit në seancë
paraprake)**

Maksima: Refuzimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar për shkak të mosparaqitjes së të pandehurit në seancën paraprake nuk mund t'i atribuohet atij, kur ky i fundit nuk është njoftuar personalisht për zhvillimin e seancës dhe kur mbrojtësi i zgjedhur ka njoftuar gjykatën për pamundësinë e pjesëmarrjes. Në këto rrethana, mohimi i gjykimit të shkurtuar përbën zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Fjalë kyçe: refuzim i gjykimit të shkurtuar, gjykim në mungesë, mosnjohim i të pandehurit për seancën, proces i rregullt ligjor

Decision no. 00-2025-1032 (163), dated 26.06.2025 (rejection of summary trial: failure to notify defendant personally on the preliminary hearing)

Legal principle(s): The rejection of the request for a summary trial due to the defendant's failure to appear at the preliminary hearing cannot be attributed to him, when the latter was not personally notified of the hearing and when the chosen defense attorney has notified the court of the impossibility of participation. In these circumstances, the denial of the summary trial constitutes an erroneous application of criminal procedural law and violates the right to a due process.

Keywords: rejection of a summary trial, trial in absentia, failure to notify the defendant of the hearing, due process

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria [...]ka regjistruar procedimin penal nr. 140, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga nenet 278/3/4 dhe 283/1, të KP, në ngarkim të shtetasit Gj.D.

[...]është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit në fjalë, [...]dhe janë është gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri automatik, model 56, me një krehër metalik, me në brendësi municion, gjithsej 27 copë fishekë, municioni luftarak, model 56, kalibër 7.62 mm; Material bimor i ngjashëm me atë të bimës cannabis sativa, konkretisht, lëndës bimore me sasi prej 1.110 kg, me degë dhe gjethe të thata të krasitura, me gjatësi deri 50 cm, gjithsej 74 degë, si dhe e lëndës tjetër bimore sasisë prej 0.04 gramë, në formë boçe, në gjendje të thatë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. [...], ka vendosur:

“Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “Mbajtjes municioneve luftarake pa lejen e organeve kompetente shtetore[...] Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “Mbajtjes e armëve në banesë pa lejen e organeve kompetente shtetore” [...]Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitja e narkotikëve”, [...]Në bashkim të dënimeve, gjykata bazuar në nenin 55/3 të KP e dënon të pandehurin Gj.D me një dënim të vetëm me 5 (pesë) vite burgim”. [...]

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin [...], ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit [...]”. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...] konstaton se në thelb, shkak i rekursit është parashtrimi i kundërshtimit/mosdakordësisë ndaj disponimit të gjykatave më të ulëta për refuzimin e kërkesës së të gjykuarit për të vijuar gjykimin e çështjes me ritin e posaçëm të tij (gjykimin e shkurtuar). [...]

Kolegji vlerëson se këto të fundit (shkaqet e rekursit) përmbajnë/referojnë shkaqe ligjore nga ato të përcaktuara në nenin 432 të KPP, ndaj, si të tilla, sjellin cenimin e vendimit objekt rekursi të Gjykatës së Apelit Tiranë [...] që është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal dhe, si i tillë, duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues.

[...]rezulton se i pandehuri Gj.D nuk është paraqitur në gjykim në fazën e seancës paraprake. Nga aktet e dosjes rezulton se i pandehuri nuk ka marrë dijeni personalisht për seancën gjyqësore, pasi akti i njoftimit

është nënshkruar nga shtetasja L.D (nëna e të pandehurit). Gjithashtu, rezulton se avokati i të pandehurit, i caktuar me prokurë të posaçme nga bashkëshortja e tij, është njoftuar dhe ka marrë dijeni për datën që do të zhvillohej seanca gjyqësore (datë 17.12.2021) dhe ka njoftuar me email gjykatën për pamundësinë për të marrë pjesë në gjykim, duke parashtruar edhe arsyet përkatëse. Në seancën paraprahe të datës 17.12.2021, gjykata ka vlerësuar se i pandehuri ka dijeni për seancën nga familjarët, ndonëse nuk është paraqitur në gjykim. [..]

Së pari, Gjykata e Shkallës së Parë Mat, e cila ka refuzuar kërkesën për gjykim të shkurtuar, nuk e ka motivuar këtë vendimmarrje duke iu referuar pamundësisë së zgjidhjes së çështjes nga aktet - gjendje në dosje (fashikullin e prokurorit), pra nuk ka vlerësuar në drejtim të pamjaftueshmërisë së akteve në dosje, për zgjidhjen e drejtë të çështjes dhe nevojës për kryerjen apo marrjen e akteve apo provave të tjera. [..]. Në këto kushte dhe rrethana, Kolegji vlerëson se urgjenca e organit të akuzës për të dërguar çështjen në gjyq ose e gjykatës/gjyqtarit të seancës paraprahe për të kaluar çështjen në gjykim pa administruar të gjitha provat e nevojshme (neni 332/ë, pika 2, shkronja “e” i KPP) apo mosveprimi në kohë i institucioneve shtetërore (vonesa e përgjigjes së aktit të ekspertimit), nuk mund të faturohen/të interpretohen në dëm të interesave të të pandehurit, me pasojë cenimin e të drejtës ligjore të tij për kërkimin e gjykimit të shkurtuar. Pra, arsyetimi i gjykatës së apelit për pamundësinë e zgjidhjes së çështjes me aktet e dosjes, përveç se mbetet në kuadrin e një prezumimi (*pasi nuk analizohet pse kjo provë, “akti i ekspertimit nr. [...]”, ishte determinante në zgjidhjen e çështjes*), por nuk është as i bazuar në ligj (*pasi kjo provë është kërkuar nga akuza dhe jo nga i pandehuri, i cili në këtë drejtim ka përmbushur të gjitha detyrimet procesuale në ngarkim të tij*).

Së dyti, argumenti tjetër i përdorur nga gjykata e apelit në motivimin e mospranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, [..]nuk është bindës/i bazuar. [..]. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se, në një situatë të tillë procedurale, ku është refuzuar kërkesa për gjykim të shkurtuar, është mëse e pranueshme që mbrojtja, në ushtrim të funksionit të saj për mbrojtjen e interesave të të pandehurit, të ndryshojë strategjinë e mbrojtjes. Ndaj kërkesa e të gjykuarit për pavlefshmërinë e akteve të tjera apo marrjen e provave të reja me dëshmitar, e paraqitur pas refuzimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, nuk mund të interpretohen në motivimin e këtij disponimi (*për rrëzimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar*).

Së treti, fakti që në këtë dispozitë (neni 403 i KPP) janë parashikuar edhe rrethana të tjera procedurale që lidhen me gjykime të tjera të posaçme, rregulluar nga nenet 400 dhe 406/ç, pika 3 të KPP, nuk do të thotë se

qëllimi i ligjvënësit ka qenë të kufizojë të drejtën e gjyqtarit që është caktuar për të gjykuar çështjen në themel, të mos pranojë për shqyrtim këtë kërkim të pandehurit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjyqtari i caktuar për shqyrtimin e çështjes në themel, nuk ka asnjë pengesë ligjore për të vlerësuar këtë kërkim. Në mbështetje të këtij qëndrimi është edhe parashikimi ligjor i pikës 3 të nenit 332/dh të KPP, [..]

Kolegji, në praktikën e tij, ka theksuar se, në kushtet kur vetë ligji procedural penal nuk lejon ankim ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake që e dërgon çështjen në gjyq, edhe nëse gjyqtari i seancës gjyqësore konstaton parregullsi lidhur me njoftimin e të pandehurit në seancën paraprake, ligji procedural penal i ka dhënë hapësirë gjykatës që, gjatë shqyrtimit të çështjes në themel, t'i korrigjojë ato, duke kryer njoftimet e të pandehurit sipas rregullave të parashikuara në nenet 140-142, 352 të KPP, pa cenuar vendimin gjyqësor të dhënë nga gjyqtari i seancës paraprake, gjyqtar i po të njëjtës shkallë gjykimi.

Nga interpretimi logjik i dispozitave në lidhje me seancën paraprake, arrihet në përfundimin se ndaj vendimit të seancës paraprake nuk parashikohet e drejta e ankimit pikërisht sepse shkeljet procedurale që mund të konstatohen në seancën paraprake mund të rregullohen gjatë gjykimit të themelit. Në këtë linjë arsyetimi, gjyqtari i themelit nuk ka të drejtë të shpallë të pavlefshëm vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, por ka të drejtën dhe detyrimin të korrigjojë shkeljet procedurale që konstaton se janë kryer në seancën paraprake (*vendimin nr. 00-2020-485, datë 24.12.2020, të Kolegjit Penal.*).

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe më tej ajo e apelit (kur ka si shkak ankimi/ pretendim) shqyrtimin e kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar të paraqitur jo në afat (rasti konkret në seancën paraprake), duhet të verifikojë nëse janë kushtet që të rivendoset e drejta për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Për të arritur në këtë përfundim, gjykata e themelit duhet të verifikojë nëse konstatohen parregullësi lidhur me njoftimin e të pandehurit në seancën paraprake (*me pasojë pavlefshmërinë e njoftimit*), apo nëse plotësohen kushtet për të zbatuar ritin e posaçëm të gjykimit (*pra, verifikohet nëse ka akte të pavlefshme apo të papërdorshme, apo nëse nga palët ngrihen pretendime të tilla, ose për kryerjen e veprimeve të tjera, marrjen e provave etj.*). Në rastin kur seanca paraprake është zhvilluar në mungesë të të pandehurit, pa marrë ky i fundit personalisht dijeni për gjykimin, konform parashikimeve të ligjit procedural penal (për njoftimin e të pandehurit), ky i fundit mund të rivendoset në afat për të kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi një e drejtë e tillë, me ndikim në masën përfundimtare të dënimit, nuk mund

t'i mohohet për shkak të gabimeve të autoritetit shtetëror (gjykatës) në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor apo kur i pandehuri nuk ka dijeni se ndaj tij po zhvillohet një proces penal. Ndërsa në rastin kur vërtetohet se njoftimi i të pandehurit është kryer rregullisht dhe rezulton që ky i fundit i fshihet drejtësisë apo, megjithë dijeninë, refuzon të paraqitet në seancën paraprake, vlerësohet se nuk ka vend për rivendosjen në afat të së drejtës për të kërkuar gjykim të shkurtuar. Në këtë rast, konsiderohet se i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në procesin penal që zhvillohet në ngarkim të tij, duke iu fshehur drejtësisë apo duke refuzuar paraqitjen në gjykim, e kësisoj edhe nga e drejta për të kërkuar që të procedohet me gjykim të shkurtuar.

Duke u kthyer tek çështja në shqyrtim, Kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit (gjatë gjykimit të çështjes në themel) ndonëse kanë pasur pretendime/shkak ankimi nga i pandehuri, nuk kanë arsyetuar nëse gjatë seancës paraprake janë respektuar dispozitat për njoftimin rregullisht të tij. Kërkesa për gjykim të shkurtuar është refuzuar apriori, nga njëra anë duke arsyetuar se kërkesa nuk është paraqitur në seancën paraprake, dhe nga ana tjetër (*pavarësisht kontestimit të të pandehurit dhe akteve në dosjen gjyqësore*) duke cituar dhe pranuar arsyetimin e gjyqtarit të seancës paraprake mbi dijeninë e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij për gjykimin dhe mosparaqitjen e tyre pa shkaqe të arsyeshme. Ndonëse gjykatat më të ulëta (shkalla e parë dhe apeli), në vendimmarrjen e tyre kanë referuar në vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, ato nuk kanë arsyetuar dhe analizuar nëse vendimi për zhvillimin e gjykimit në mungesë, në seancën paraprake, është marrë konform ligjit procedural penal dhe nëse provohej se i pandehuri i fshihej drejtësisë, apo nëse përfaqësuesi/mbrojtësi i tij nuk ishte paraqitur në gjykim pa shkaqe të arsyeshme.

Kolegji vlerëson se gjykatat më të ulëta kanë interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitat procedurale penale. Sikurse më të drejtë parashtrohet në rekurs, thjesht fakti se i pandehuri nuk gjendet nuk mund të prezumojë faktin se ai ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u mbrojtur. [...]Kësisoj, vetëm nëpërmjet këtij kontrolli, gjykata e apelit, në vlerësimin e këtij Kolegji, mund të konkludonte nëse i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në procesin penal që zhvillohet në ngarkim të tij, duke iu fshehur drejtësisë, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e gjykimit të shkurtuar.

Gjykata e Apelit, si gjykatë rishikuese/kontrolluese e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duhet të kishte analizuar (*pavarësisht vendimmarrjes së gjyqtarit të seancës paraprake apo gjykatës së themelit të shkallës së*

parë) nëse i pandehuri ishte në dijeni për gjykimin që po zhvillohej në ngarkim të tij, apo se ndaj tij ishte caktuar masa e sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i KPP. Gjithashtu, ajo gjykatë duhet të kishte arsyetuar dhe vlerësuar edhe mbi faktin e mos shqyrtimit nga gjykata e shkallës së parë të kërkesës së përfaqësuesit/mbrojtësit të të gjykuarit për shtyrjen e seancës paraprake, dhe bazueshmërinë e kësaj kërkesë.

Kolegji thekson se, mosveprimi i organeve gjyqësore kompetente/personave përgjegjës, në rastin konkret, duke mos vënë në dispozicion të gjyqtarit të seancës paraprake kërkesën për shtyrje të paraqitur nga mbrojtja e të pandehurit, nuk duhet t’i faturohet të pandehurit. Kjo situatë/rrethanë nuk duhet të interpretohet në dëm të interesave procedurale të ligjshme të të pandehurit, dhe për pasojë të sjellë pamundësinë e tij për të ushtruar të drejtat dhe garancitë procedurale për paraqitjen e kërkesës për gjykim të shkurtuar. [...]Në kushtet kur administrata gjyqësore kompetente nuk ka vepruar, duke mosparaqitur përpara gjyqtarit të seancës paraprake kërkesën për shtyrje (*të paraqitur me email nga përfaqësuesi i të pandehurit*), dhe as gjykatat e themelit të çështjes (*gjykata e shkallës së parë Mat dhe Gjykata e Apelit Tiranë*), ndonëse të vënë në dijeni për këtë fakt, nga aktet në dosje dhe nga i pandehuri nëpërmjet ankimit apo gjatë gjyimit, nuk kanë korigjuar këtë të metë/shkelje, por kanë disponuar apriori për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, me argumentin se është paraqitur jashtë afatit, ato (gjykata) kanë interpretuar/zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat procedurale penale, çka ka sjellë cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, konkretisht mos garantimin e të drejtës procedurale të të pandehurit për të paraqitur kërkesë për gjykim të shkurtuar.

[...]Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Tiranë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal, neneve 140-142, 352, 332/b pika 4, 403 dhe 425 të KPP dhe për pasojë ka vend për cenimin e saj. [...] vendimi nr. [...]i Gjykatës së Apelit Tiranë, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe, si e tillë, duhet të priset dhe çështja të kthehet për rishqyrtim po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. [...] çështja duhet të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues. Në rigjykim, gjykata e apelit duhet të mbajë në konsideratë konkluzionet e parashtruara nga Kolegji në këtë vendim.

Mendim pakice

[...] Me këtë vendim të shumicës së anëtarëve të Kolegjit Penal, unë gjyqtare Albana Boksi, *jam pjesërisht kundër*, pasi çmoj se në rekursin e

paraqitur nga i pandehuri, ngrihet çështja ligjore që ka të bëjnë me zbatimin e gjykimit të posaçëm, (gjykimi të shkurtuar), për të cilën palët në proces janë dëgjuar dhe kanë mbajtur qëndrimin e tyre. Nga shqyrtimi gjyqësor nga gjykata e faktit nuk është çmuar e nevojshme marrja e provave të reja, si dhe nuk janë verifikuar akte të pavlefshme apo prova të papërdorshme. Në ndryshim nga sa ka vlerësuar Kolegji Penal (shumica), vota ime është për zgjidhjen përfundimtare të çështjes nga Gjykata e Lartë, pasi zbatimi i ligjit procedural penal në këtë rast e lidhur me zbatimin e procedurës së gjykimit të shkurtuar nuk diktohet nga marrja apo shqyrtimi i provave/fakteve.

Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit, me rëndësi vlerësoj disa momente: së pari, fakti i gjykuari është deklaruar në mungesë gjatë seancës paraprake me arsyetimin se i është shmangur drejtësisë, pasi nuk është gjetur; së dyti, fakti që mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët kishte depozituar një kërkesë për shtyrjen e seancës paraprake nëpërmjet postes elektronike të gjykatës. Gjykata e apelit analizon që kjo kërkesë është depozituar në orën 10:08, ndërkohë që seanca paraprake ishte caktuar në orën 10:30, por për mungesë të personelit kërkesa dhe shkaku i mosparaqitjes së mbrojtësit nuk i janë bërë prezent gjyqtarit të seancës paraprake. Së treti, në mbështetje të argumenteve për mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, gjykata e apelit ka theksuar edhe faktin se kjo çështje nuk mund të zgjidhej në gjendjen e akteve, me arsyetimin se, [...] Në vlerësimin e gjyqtarës në pakicë, këto argumente nuk janë ligjërisht të justifikuar, veçanërisht fakti i paraqitjes nga prokuroria të një akti ekspertimit, vonesë që nuk mund ti kundërdrejtohet të gjykuarit, duke e penalizuar pa të drejtë në kërkimin e tij. Në momentin që ka depozituar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, prokurori ka përfunduar hetimet dhe ka pasur detyrimin të njohë me akuzën dhe aktet/provat në mbështetje të saj të pandehurin dhe mbrojtësin. Fakti që një akt me rëndësi si ekspertimi bio-kimik i lëndës narkotike të sekuestruar nuk ka qenë pjesë e akteve, nuk mund të penalizojë të pandehurin në kërkimin e tij për të proceduar me gjykim të posaçëm. Ky fakt tregon se edhe gjyqtari i seancës paraprake nuk ka treguar kujdesin e duhur për të verifikuar plotësinë e hetimeve dhe akteve/provave ku bazohet akuza, në funksion të garantimit të se drejtës së mbrojtjes.

Në lidhje me momentin e depozitimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, e gjej me vend të sqaroj që, sipas ndryshimeve të bëra në nenin 403 të KPP, [...] kërkesa për gjykim të shkurtuar, bëhet nga i pandehuri gjatë seancës paraprake, ndërkohë që, rezulton që, ky i gjykuar gjatë zhvillimit të seancës paraprake, nuk ka qenë i pranishëm. Në vlerësimin tim, vetëm fakti që ai nuk është gjetur në vendet apo vendbanimin e zakonshëm nuk tregon se aji

ka dijeni efektive për procesin penal të iniciuar ndaj tij apo për zhvillimin e seancës paraprake. pa arritur që ai të njoftohet rregullisht, sipas ligjit, duke u zhvilluar kjo seancë në mungesë të tij, në bazë të vendimit të mosgjetes së marrë nga prokurori, gjatë fazës së hetimeve paraprake. Ky vlerësim bazohet në faktin se, nuk mund t'i mohohet e drejta e të pandehurit për të kërkuar gjykim të shkurtuar në gjykimin e themelit, në qoftë se, ai për shkaqe që nuk varen prej tij, nuk ka patur dijeni (nuk provohet) për zhvillimin e seancës paraprake, e cila është edhe seanca ku, i pandehuri, rregullisht duhet ta paraqesë një kërkesë të tillë. Njoftimi i të pandehurit është një detyrim i organeve proceduese (prokurori apo gjykatë)dhe si rrjedhojë mospasja dijeni efektive nga i pandehuri për zhvillimin e seancës paraprake, jo për faj të tij, si dhe zhvillimi i seancës paraprake, pa praninë e tij, bën që si përjashtim nga rregulli, si një rast i veçantë “siu generis”, i pandehuri të legjitimohet që, të kërkojë gjykim të shkurtuar, gjatë gjykimit të themelit. Një qëndrim i tillë gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e vazhdueshme të GJEDNJ e cila, në shumë raste ka theksuar që, është detyrim i organeve shtetërore që të provojnë, tej çdo dyshimi të arsyeshëm që, i pandehuri ka marrë dijeni për gjykimin që zhvillohet ndaj tij dhe, në mungesë të një provimi të tillë, të pandehurit nuk mund t'i shkelen të drejtat e tij, për shkak të paaftësisë së organeve shtetërore. Kështu, GJEDNJ Xheraj kundër Shqipërisë, në vendimin e saj, ka arsyetuar, ndër të tjera që, çdo parregullsi në funksionimin e veprimtarisë së organeve shtetërore, nuk mund të cenoje të drejtat e të pandehurit në një proces penal dhe shteti është i detyruar që, të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar të drejtat e të pandehurit në një proces penal, si pjesë e të drejtës së të pandehurit për një proces të rregullt gjyqësor, të garantuar nga neni 6 i KEDNJ.

Në rrethanat e parashtruara, duke qenë dakord edhe me konstatimet e shumicës së anëtarëve të Kolegjit Penal, vlerësoj se kjo çështje nuk duhet të ishte kthyer për rigjykim në apel, pasi pretendimi i vetëm i të gjykuarit si në apel, ashtu edhe në rekurs, ka qenë riparimi i pasojave të refuzimit pa të drejtë të kërkesës së tij për gjykim të shkurtuar. Në vlerësimin tim, ky shkak rekursi qëndron dhe nga gjykata e faktit nuk është zbatuar drejt ligji procedural penal, në lidhje me riparimin e pasojave të gjykimit të shkurtuar. Gjyqtarja në pakicë vlerëson se në rastin konkret, duhet të ishte disponuar për zgjidhjen përfundimisht të çështjes, pasi çmoj se zbatimi i ligjit penal procedural nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes, në përputhje me përcaktimet e nenit 441, pika 1, shkronja “dh” të KPP. Si nga palët, ashtu edhe Kolegji nuk vuri në dyshim faktet apo provat e analizuara drejt nga gjykatat e faktit,

në raport me faktin penal të atribuuar të gjykuarit apo dënimin e caktuar ndaj tij. Në vlerësimin tim, riparimi i pasojave të refuzimit pa të drejtë të kërkesës së gjykuarit për të proceduar me gjykim të shkurtuar, është një çështje e ligjit që nuk ka nevojë të diskutohet nga palët, përderisa ka qenë shkak ankimi, si në apel ashtu edhe në rekurs, pra palët kanë pasur mundësinë të parashtrojnë mendimet e tyre në lidhje me këtë çështje të ligjit (pra nuk është çështje e ligjit që të jetë vënë në diskutim kryesisht nga Kolegji, referuar pikës '3' të nenit 434). Në rrethanat e parashtruara, referuar neneve 436/a, 437 dhe 441 të KPP, unë gjyqtare Albana Boksi vlerësoj se Kolegji Penal duhet të zbatonte nenin 406 pika 1 të KPP, duke ulur dënimin e caktuar ndaj të gjykuarit me një të tretën e tij, pasi çmoj se kërkitimi i tij për të proceduar me gjykim të shkurtuar është refuzuar pa të drejtë nga gjykatat e faktit.



**32.Vendim nr. 00-2025-1402 (221),
data 23.09.2025 (dënim me burgim të
përjetshëm: ndalim procedural absolut që
lidhet vetëm me natyrën e veprës)**

Maksima: *Ndalimi i gjykimit të shkurtuar për veprat penale që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm është absolut dhe lidhet vetëm me natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës penale, jo me subjektin apo veçoritë personale të autorit. Ky ndalim nuk cenohet nga dispozitat që përjashtojnë gratë nga burgimi i përjetshëm.*

Fjalë kyçe: *gjykim i shkurtuar, vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, gratë*

Decision no. 00-2025-1402 (221), dated 23.09.2025 (life imprisonment sentence: absolute procedural prohibition related only to the nature of the offense)

Legal principle(s): *The prohibition on the application of the summary trial procedure to criminal offences punishable by life imprisonment is absolute and is determined solely by the nature and gravity of the offence, rather than by the identity or personal characteristics of the offender. Accordingly, this prohibition is not affected by statutory provisions excluding women from the imposition of a sentence of life imprisonment..*

Keywords: *summary trial, homicide due to family relations, women*

Rrethanat e çështjes:

[...]Nga të dhënat e marrë rezulton se shtetasja D.D rreth orës 02.00 - 03.00, ka qënë në banesën e saj dhe ka goditur me sende të forta bashkëshortin e saj Ll.D. [...]me një vegël pune sqepar e ka goditur disa herë në kokë duke i shkaktuar dëmtime e plagë të rënda për jetën dhe [...]më datë 21.11.2020 ai ka humbur jetën. [...] nga hetimi rezulton e provuar se e pandehura D.D, të ketë kryer veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, parashikuar nga neni 79/c i KP.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. [...], ka vendosur:

“Deklarimin fajtor të pandehurës ,për kryerjen e veprës penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, parashikuar nga neni 79/c të KP dhe dënimin e saj me 21 (njëzet e një) vjet burgim. Gjykata në zbatim të nenit 406 të KPP, për shkak të gjykitimit të shkurtuar ul 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht e pandehura me 14 (katërmëdhjetë) vjet burgim”. [...]

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. [...], ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit [...]”. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Kolegji [...]konstaton se në rekursin e paraqitur prej Prokurorisë [...]dhe të pandehures D.D referohen shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432/1 i KPP, përçuese të problematikës, të zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural penal prej Gjykatës së Apelit Tiranë, të parashikuar në shkronjën ‘a’, pika 1 të nenit 432 të KPP. [...]

Lidhur me shkaqet e rekursit të paraqitura nga organi i prokurorisë, Kolegji i konsideron ato shkaqet/motivet mbështetëse të rekursit, të identifikuar në zbatim të gabuar të ligjit penal nga Gjykata e Apelit Tiranë që ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, që ka aplikuar gjykimin e posaçëm - “të shkurtuar”, ndaj të pandehurës, e akuzuar dhe dënuar për një veprë penale që parashikon si dënimi burgimin e përjetshëm -(neni 79 gërma ‘c’ të KP), çfarë bie ndesh me përcaktimet e nenit 403 të KPP, që ndalon zbatimin/aplikimin e gjykitimit të shkurtuar për atë kategori veprash penale që parashikojnë si dënimi burgimin e përjetshëm.

Nga përmbajtja e paragrafit të dytë të nenit 403 të KPP, rezulton se ligjvënësi e ka kufizuar fushën e zbatimit të gjykitimit të shkurtuar për një kategori veprash penale, konkretisht për ato vepra penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm. Në këtë vështrim Kolegji çmon të sjellë në vëmendje se ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre (neni 1, paragrafi 1 i

KP). Me këtë formulim KP i referohet ligjit penal për përcaktimin e veprës penale dhe kësisoj vë në plan të parë si element të saj kundërligjshmërinë e veprimit ose mosveprimit. Kundërligjshmëria e veprimit ose mosveprimit është shprehje e rrezikshmërisë shoqërore të veprës. Ndërsa rrezikshmëria shoqërore është tipari social dhe elementi thelbësor material i veprës penale. Ajo është kategori objektive që do të thotë se përcaktimi i saj bëhet në bazë të kushteve objektive të shoqërisë, se cilat vepra janë shoqërisht të rrezikshme. Kriteri që ka patur parasysh ligjvënësi në vlerësimin e një veprë, është sjellja e njeriut që paraqet rrezik për shoqërinë dhe individin. Ky vlerësim apo çmim që i bëhet rrezikshmërisë shoqërore ka karakter objektiv dhe jo subjektiv. Në këtë rast merret për bazë objekti që është dëmtuar ose kundër të cilit drejtohet vepra penale. Sa më i rëndësishëm të jetë ky objekt, pra marrëdhëniet juridike të vendosura e të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, aq më e rrezikshme është vepra dhe sa më pak i rëndësishëm të jetë objekti, aq më pak e rrezikshme për shoqërinë është vepra. Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale është e shkallëzuar; disa vepra penale janë më të rënda, d.m.th., paraqesin rrezikshmëri shoqërore më të madhe. Pra, konkludohet se shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale përcaktohet në radhë të parë nga rëndësia e objektit të prekur ose të vënë në rrezik. Në përshtatje me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale në KP janë parashikuar edhe sanksionet penale. Për ato vepra penale që janë të rënda edhe dënimet penale janë të ashpra; ndërsa për ato që janë më pak të rënda edhe dënimet parashikohen më të lehta. Në vijim të këtij argumenti, kuptohet se veprat penale për të cilat parashikohet dënimi maksimal me burgim të përjetshëm –(ku përfshihet edhe vepra penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, parashikuar nga neni 79 gërma “c” të Kodit Penal, për të cilën është gjetur fajtorë e pandehura Deda) , janë veprat penale më të rënda në rendin shoqëror, të cilat paraqesin shkallën më të lartë të rrezikshmërisë shoqërore për shkak të rëndësisë së objektit që cenojnë, në përshtatje të të cilës ligjvënësi ka parashikuar edhe sanksionin penal. Kjo është e qartë edhe nga parashikimi i nenit 31/1 të KP[...]

Me këtë parashikim ligjor- (nenin 403/2 i KPP), ligjvënësi, duke përjashtuar nga ky lloj i posaçëm gjykimi vetëm një kategori të veprave penale, konkretisht veprat penale më të rënda -(të tilla konsiderohen ato për të cilat parashikohet dënimi maksimal) ka marrë për bazë objektin që është dëmtuar ose kundër të cilit drejtohet vepra penale, pasi rrezikshmëria shoqërore ka karakter objektiv dhe jo subjektiv dhe për rrjedhojë, merret për bazë objekti që është dëmtuar ose kundër të cilit drejtohet vepra penale. [...] Me këtë parashikim ligjor është synuar garantimi i realizimit

të drejtësisë penale në mënyrë efektive si për të pandehurin ashtu edhe për viktimën e veprës penale. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, ndalimi i gjykimit të shkurtuar ka një qëllim domethënës: për krime të kësaj rëndësie, ligjvënësi ka parapëlqyer (zgjedhur) debatin gjyqësor, si rruga më e sigurt për të shmangur gabimin gjyqësor, si dhe për të garantuar maksimalisht të drejtat e të pandehurit por edhe të viktimës së veprës penale nëpërmjet pjesëmarrjes në një gjyq oral-verbal dhe kontradiktor për sqarimin e të vërtetës. Në këtë vështrim nuk mundet kurrësi që këto garanci të mos garantohen në mënyrë të barabartë për të gjithë personat e akuzuar për një veprë penale që parashikon dënim me burgim të përjetshëm.

[...]

Nga interpretimi literal dhe logjik, Kolegji vlerëson se parashikimi ndalues i bërë në nenin 403/2 të KPP, i referohet objektit të veprës penale që mbron norma e posaçme e KP, pra rëndësisë së marrëdhënies juridike që kjo normë mbron dhe jo elementeve të tjerë të figurës së veprës penale. Qartazi, ky normin ligjor ndalon aplikimin e këtij riti procedural –(gjykimit të shkurtuar), me pasojë pamundësinë e aplikimit, për këtë shkak, të zbritjes, uljes së dënimit në masën e 1/3 të tij (përcaktimi i nenit 406/1 të KPP) kur gjykohen vepra penale për të cilat parashikohet (si sanksion) lloji i dënimit me “burgim të përjetshëm”, duke mos e lidhur këtë parashikim (ndalim) me statusin “gjininë” apo “moshën” e të pandehurit të gjykuar.

Duke u kthyer tek çështja në shqyrtim, [...]Kolegji vlerëson se mbrojtja e parashikuar në nenin 32/1 të KP, për këtë kategori subjektesh, “*gratë*” të veprës penale, nuk ndikon në zbatimin e parashikimit të ndalimeve për zbatimin e nenit 403 të KPP. Trajtimi sanksionues i privilegjuar, prej legjislatorit për “*gratë*”, që presupozon pamundësinë e aplikimit ndaj tyre të llojit të dënimit me “*burgim të përjetshëm*”, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të evitimit të ndalimit të përgjithshëm, të përcaktuar në nenin 403/2 të KPP, përjashtues apriori, i të drejtës për të pasur akses në ritin procedural të “*gjykimit të shkurtuar*”, të subjekteve të gjykuara për veprat penale të atribuara prej akuzës, që parashikojnë si titull sanksionues, llojin e dënimit me “*burgim të përjetshëm*”.

Normimi i përgjithshëm, bërë në paragrafin e dytë të nenit 403 të KPP, është pengesë e pakalueshme që pamundëson aplikimin e gjykimit të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm, pavarësisht cilësive që mund të bartin kategori të caktuara të subjekteve të veprës penale, për të cilët legjislatori ka parashikuar garanci e mbrojtë të posaçme, duke i përjashtuar ato nga masa ekstreme e dënimit

të përjetshëm- (*gratë apo të miturit*). Ky ndalim ligjor, lidhet vetëm me llojin e veprës penale të atribuar të pandehurit, sipas akuzës.

Kuptimi dhe interpretimi si më sipër i ndalesës ligjore të parashikuar në nenin 403 të KPP, ndonëse me një vendimi të më vonshëm se vendimi objekt i këtij rekursi, është konfirmuar edhe me sentencën njësuere të Kolegji, me të cilën është arritur në përfundimin se “*Ndalimi i parashikuar nga neni 403, pika 2 i KPP, zbatohet edhe për subjektet ndaj të cilëve ligji penal ndalon dhënien e dënimit me burgim të përjetshëm.*” (sentenca njësuere nr.00-2024-2161 i vendimit (167), datë 04.07.2024, Gjykata e Lartë, Kolegji Penal).

Për sa më sipër, Kolegji konsideron se vendimmarrja objekt rekursi e Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me aplikimin e gjykimit të posaçëm të gjykimit të shkurtuar, është marrë në zbatim të gabuar të legjislacionit penal, konkretisht nenit 403 të KPP dhe nenit 79 gërma “c” të KP.

Gjithashtu edhe sa i përket shkaqeve të rekursit të paraqitur nga e pandehura D.D, të cila në thelb janë përsëritje e shkaqeve të apelit, Kolegji vëren se gjykata e apelit në vendimin objekt rekursi, nuk u ka kthyer përgjigje shkaqeve të apelit, në atë vendimmarrje nuk arsyetohet/argumentohet mbi bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të paraqitura nga e pandehura në mbështetje të kundërshtimit të vendimmarrjes së shkallës së parë, sa i përket masë së dënimit të caktuar dhe kërimit të saj për zbatimin e nenit 53 të KP, për caktimin e një dënimi nën kufirin e parashikuar nga ligji. Në këtë drejtim vendimmarrja objekt rekursi megjithëse përsa i përket aspektit formal të paraqitjes, prezencës së një arsyetimi në mbështetje të vendimmarrjes së saj, i përmban elementët esencial të kërkuar nga neni 383 i KPP, sa i përket interpretimit të parimit të individualizimit sipas neneit 47 të KP, nuk është e arsyetuar dhe i mungon dhënia e përgjigjes në ankim për këtë pretendim.

Në përfundim, Kolegji, duke konsideruar të pranishme dhe të integruara përcaktimet e shkronjës “a” të nenit 432/1 të KPP, vlerëson se vendimi objekt rekursi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues, pasi për zgjidhjen e drejtë të saj është i pashmangshëm dëgjimi i palëve, vlerësimi i provave të fashikullit të gjykimit, apo pretendimeve të paraqitura prej tyre në ankim apo gjykim[...]



**33.Vendim nr. 00-2025-1613 (255),
datë 21.10.2025 (akses riti gjykimi:
person juridik)**

Maksima: 1. Personi juridik në cilësinë e të pandehurit nuk përjashtohet nga e drejta për të kërkuar gjykimin e shkurtuar. Pamundësia e aplikimit “matematik” të zbritjes së 1/3 të dënimit në rastin e sanksionit të “mbarimit të personit juridik” nuk përbën arsye ndalimi për aksesin në këtë rit gjykimi. 2. Disponimi i gjyqtarit të seancës paraprake për pranimin e gjykimit të shkurtuar, kur nuk ankimohet nga palët, merr formë të prerë dhe nuk mund të zhbëhet kryesisht nga gjykata e apelit në mungesë të një shkaku ankimi që konteston ligjshmërinë e tij.

Fjalë kyçe: gjykim i shkurtuar, përgjegjësi penale e personit juridik, mbarim i personit juridik, res judicata.

Decision No. 00-2025-1613 (255), dated 21.10.2025 (access to trial: legal entity)

Legal principle(s): 1. A legal entity in the capacity of a defendant is not excluded from the right to request a summary trial. The fact that the statutory one-third reduction of the sentence cannot be applied in a purely mathematical manner where the sanction imposed is the termination of the legal person does not constitute a ground for denying access to this form of trial.

2. The disposition of the judge of the preliminary hearing to accept the summary trial, when not appealed by the parties, becomes final and cannot be overturned ex officio by the court of appeal in the absence of a cause of appeal that challenges its legality.

Keywords: summary trial, criminal liability of a legal entity, termination of the legal entity, res judicata.

Rrethanat e çështjes:

Prokuroria e Posaçme [...]ka regjistruar procedimin penal nr. [...], për veprat penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 258 dhe 248 të KP. [...] lidhur me procedurën e kontraktimit, lidhjen dhe ekzekutimin e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe koncesionarit “Integrated Technology Ëaste Treatment Fier” për kontratën “Dhënia

me koncesion e Ndërtimit dhe Administrimit të Impiantit të Trajtitimit të Mbetjeve Urbane Fier”. [...]

Në vijim të hetimeve, më datë 18.03.2022, Prokuroria e Posaçme ka disponuar për kryerjen e ndryshimeve/perditesimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale, [...] duke regjistruar në këtë rregjister edhe veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuara nga nenet 248, 245 dhe 260 të KP, si dhe veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287, gërmat “a” dhe “b” të KP, e kryer në rrethanën cilësuese “të bashkëpunimit”, sipas nenit 287, paragrafi (2) i KP. Prokurori në këtë cilësi ka regjistruar emrat e shtetasve: [...], të shoqërive/ne cilesine e personit juridik - [...] sh.p.k., për veprat penale respektive.

Ndërsa nga gjykata/gjyqtari i seances paraprake është vendosur për pranimin e kërkesës së të pandehurve [...] Personi juridik [...] sh.p.k., për të proceduar për gjykimin e çështjes në themel me ritin procedural të “gjykimit të shkurtuar”, në konformitet me përcaktimet e neneve 403/406 të KPP – pra në gjendjen e akteve të paraqitura nga prokurori. [...]

Gjykata e Posaçme [...], me vendimin nr. [...], ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit [...] Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, **shoqëria tregtare [...] sh.p.k.**, [...] për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë” [...] në referim të nenit 388, pika 1, të KPP dhe ligjit nr.9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, shoqëria tregtare [...] për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 pg 2, i KP, [...] Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, shoqëria tregtare [...] akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, [...]”. [...]

Gjykata e Posaçme e Apelit [...], me vendimin nr. [...], ka vendosur:

“Prishjen e vendimit [...] dhe kthimin e akteve kësaj gjykate me tjetër trup gjykues”. [...]

Arsyetimi i Kolegjit:

Paraprakisht - Kolegji konstaton [...] për shkak të mosrespektimit të dispozitave procedurale që kanë të bëjnë me aplikimin/pranimin e ritit procedural të “gjykimit të shkurtuar”/pra në thelb - të zhvillimit në atë shkallë të procesit/gjykimit të çështjes duke aplikuar këtë lloj riti – “çka ka sjellë mohimin e të drejtës së mbrojtjes për një pjesë të të pandehurve”/

kryesisht të atyre në cilësinë e personave juridike/shoqërive “Itneg” sh.p.k. “Pupa services” sh.p.k., dhe “Froggy” sh.p.k., - të cilët janë deklaruar fajtores dhe dënuar, në përfundim të gjykimit me sanksionin kryesor të dispozitës - “Të mbarimit të personit juridik” – përsa kohë që aplikimi i këtij riti procedural konsiderohet i pamundur në favor të personave juridike pikërisht për shkak të pamundësisë së përfitimit prej tyre të bonusit/zbritjes së 1/3 të dënimit - të fundit me rastin e aplikimit të këtij sanksioni - Kolegji konsideron edhe vetëm për këtë shkak/motiv të referuar/ngritur në bazë të rekurseve - vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit në kushtet e zbatimit të gabuar të ligjit procedural. [...]

Duke ju referuar shkakut të parë të konstatimit të pavlefshmërisë të karakterit absolut të vendimit të gjykates së shkallës së parë prej Gjykatës së Apelit të Posaçëm [...] Kolegji konsideron përmbajtjen e tij në kushtet e papërshtatshmërisë/pabazueshmërisë për të impaktuar vlefshmërinë e vendimmarrjes së asaj gjykate/të shkallës së parë që ka proceduar/zhvilluar gjykimin sipas rritit procedural të “gjykimit të shkurtuar” në konformitet me përcaktimet e neneve 403/406 të KPP, në gjendjen e akteve të hetimeve paraprake të paraqitura nga prokurori përsa kohë që:

In primis – kjo vendimmarrje e gjykatës/gjyqtarit të seancës paraprake që mbi kërkesën e të pandehurve/të gjithëve pa përjashtim përfshirë edhe të pandehurit persona juridike ka pranuar aplikimin e rritit procedural të “gjykimit të shkurtuar”, [...] – në kushtet kur - prej asnjërit prej palëve pjesëmarrësve në procedim/prokuror/të pandehur - nuk është ankimuar/apeluar (bashkë me vendimin e gjykatës së shkallës së parë) – qartazi ka marrë statusin e “gjësë së gjykuar”/në kuadrin e formësimit progresiv të res iudicata - prekluduese, për pasojë, e çdo lloj ndërhyrje/iniciative edhe ex officio/kryesisht në funksion të zhbërjes së saj.

Argumentat e përdorura prej Gjykatës së Apelit në funksion të justifikimit të ndërhyrjes mbi këtë “status”/res iudicata dhe të cenimit të paprekshmërisë së tij – të identifikuara/justifikuara në/prej “hapësirën”/hapësirës e/të krijuar prej parashikimit të paragrafit të parë, të nenit 416 të KPP – të shtrirjes së ankimit të të pandehurit /zgjerimit të efektit të tij/kur nuk bazohet vetëm në motive personale – edhe për të pandehurit e tjerë të cilët nuk kanë paraqitur ankim – si dhe në parashikimin e paragrafit të parë, të nenit 425 të KPP [...] – Kolegji i konsideron në interpretim të gabuar të ligjit procedural penal përsa kohë që:

Efekti zgjerues i ankimit të bashkëtëpandehurit/bashkëteëpandehurve të tjerë/kur nuk bazohet në motive personale - do të shtrihet edhe për tre të pandehurit/persona juridike të cilët nga ana e tyre nuk kanë paraqitur ankim/apel ndaj vendimit të gjykatës shkallës së parë – vetëm në kushtet

kur “shkaqet e ankimit/apelit”/të këtyre të fundit, [...] - implikojnë trajtimin e kësaj lënde/problematike impaktuese edhe të interesave të tyre/të pandehurve persona juridike dhe gjithnjë vetëm me kushtin kur, sipas përcaktimit të paragrafit të parë, të kësaj dispozite/nenit 416 të këtij Kodi/ “vlen”/lehtëson/in bonam parte - pozitën e të pandehurve që nuk kanë paraqitur ankim.

Në rastin konkret, sikurse u theksua vendimi i pranimit të gjykimit të shkurtuar i gjithëkërkuar dhe gjithëpranuar ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar nga asnjëra prej palëve. Pra - në terma të tjera - argumenti i sipërcituar i Gjykatës së Apelit lidhur me shtrirjen e efekteve të ankimit të bashkëtëpandehurve edhe në favor të të pandehurve/persona juridike jo ankimues – i përdorur/prej kësaj të fundit/Gjykatës së Apelit për kapërcimin/shmangien e këtij statusi/të gjësë së gjykuar/formës së prerë - të disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake për të proceduar lidhur me gjykimin e çështjes me ritin procedural të “gjykimit të shkurtuar”, [...] dhe për të ndërhyrë, në instancë të fundit, në vlerësimin e pamundësisë së aplikimit të tij në favor të të pandehurve persona juridike – ndesh, në rastin konkret, në “pengesën” e pakapërcyeshme – “celesit” – të aktivimit të diskrecionit rishikues të gjykatës së gjykimit të ankimit edhe në drejtim të shmangies së efektit të res judicata të këtij disponimi/gjykimit të çështjes me ritin procedural të “gjykimit të shkurtuar” - të identifikuar në inekzistencën e “motivit/shkakut” specifik të parashtruar nga bashkëtëpandehurit apelues – kontestues i këtij disponimi/ligjshmërisë së aplikimit të tij.

Sakaq edhe përsa i përket diskrecionit të Gjykatës së Apelit për të “depërtuar”/zgjeruar kufijtë e shqyrtimit të çështjes përtej “shkaqeve të ngritura në ankim” prej të pandehurve apelues - edhe për pjesën që i takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë bërë apel – për “çështje të ligjit” që duhet të trajtohen kryesisht si dhe “mbi bazën e shkaqeve të ngritura në ankim/nga bashkëtëpandehurit apelues/që nuk bazohen në motive personale” – Kolegji konsideron se edhe ky lloj diskrecioni nuk ka “luksin” të aktivohet kryesisht nën egiden e “çështjeve të ligjit që duhet të trajtohen kryesisht” për shkak të efektiv prekluziv të formës së prerë të vendimit për këtë pjesë - të aplikimit të gjykimit të shkurtuar/statusit të gjësë së gjykuar të formësuar tashme – në konformitet me përcaktimet e gërmës “a”, të paragrafit të tretë, të nenit 462 të KPP – për shkak të mosankimimit të tij nga palët brenda afatit ligjor, ndërkohë që – sikurse e sipërcituam – përsa i përket “shtrirjes së shkaqeve të ankimit të të pandehurit apelues edhe në favor të atyre joapelues/kur nuk bazohen në motive personale” – kur vendimi nuk ka marrë formë të prerë - diskrecioni i gjykatës për të ndërhyrë edhe në pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë bërë

apel – kufizohet/kushtëzohet prej/brenda “motiveve/shkaqeve të ngritura në ankim” dhe gjithmonë vetëm në favor të lëhtësimit të pozitës së këtyre të fundit/in bonam parte.

Sakaq Kolegji - përtej evidentimit të pamundësisë procedurale/sikurse argumentohet sa sipër – të Gjykatës ad quem të Apelit të Posaçëm - për të ndërhyrë në drejtim të zhbërjes/nihilizimit të disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake për të gjykuar çështjen me ritin procedural të gjykimit të shkurtuar – nëpërmjet deklarimit kryesisht të pavlefshmërisë/së karakterit absolut/ të këtij disponimi dhe për pasojë edhe të gjykimit të çështjes/akuzës mbi bazën e këtij riti - konsideron - edhe në eventualitetin e kapërcimit të kësaj “pengese” - të formës së prerë/res judicata të disponimit të gjyqtarit të seances paraprake për aplikimin e ritit procedural të gjykimit të shkurtuar - ndërhyrjen e mirëfilltë/substanciale të asaj gjykate/ad quem – konstatuese të “kundërligjshmërisë” së disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake për aplikimin e këtij riti në favor të të pandehurve/subjekte juridike – të gjeneruar prej inefikasitetit/pamundësisë të aplikimit/shtrirjes të efektit premial/benefitit të njohur nga dispozita që parashikon këtë lloj riti/të zbritjes së 1/3 të dënimit/sanksionit - në eventualitetin e dënimit të tyre me llojin e dënimit (njerit prej tyre) të “Mbarimit të personit juridik” – në kushtet e interpretimit të gabuar të ligjit procedural penal.

Kolegji konsideron këtë mënyrë të interpretimit të ligjit/përmbajtjes së dispozitës që tout court mohon/eliminon mundësinë e aplikimit në favor të këtyre subjekteve të këtij riti/substancialisht të të drejtës për të përfituar zbritjen e 1/3 të dënimit edhe në eventualitetin e aplikimit ndaj tyre të alternativës tjetër të dënimit ndaj këtyre subjekteve/të gjobës - në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave të KPP dhe të ligjit nr.9754, datë 14.06.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, përsa kohë që në asnjërën prej tyre nuk evidentohet ndonjë dispozitë ndaluese që kufizon të drejtën e të pandehurit/person juridik për të patur akses ne procedurën/ritin procedural të “gjykimit të shkurtuar”, kur përmbushen kushtet dhe kriteret formale - substanciale të domosdoshme për aplikimin e këtij gjykimi të posaçëm.

[...]Kolegji konstaton se në rastin e dënimit të këtij subjekti me sanksionin me të rëndë të parashikuar në ligjin e sipërcituar të “Mbarimit të personit juridik” benefiti/bonusi i përfitimit prej aplikimit të gjykimit të shkurtuar paraqet një veçanësi të karakterit teknik, 1/3 e zbritjes zbatohet gjithnjë dhe ekskluzivisht vetëm mbi sanksionin e gjobës/si dënim kryesor në një kohë që në rastin e shkrirjes së entit prej gjykatës/të aplikimit të dënimit/kryesor të “Mbarimit të personit juridik” - këtu situata është me e komplikuar pasi zbritja e 1/3 nuk është e aplikueshme “matematikisht”

mbi sanksionin e “Mbarimit” të personit juridik. Pra në thelb qartazi nuk mund të aplikohet automatikisht asnjë lloj zbritje mbi këtë lloj sanksioni /kohëzgjatjes së perfundimit/të përhershëm së veprimtarisë së subjektit përsa kohë që ndryshe nga rasti i dënimit me burgim të personit fizik kur dënimi me burgim të përrjetshëm kthehej/zbritej/konvertohej për efekt të aplikimit të bonusit të 1/3 - [...]për entin nuk ekziston një konvertim automatik i “mbarimit” të veprimtarisë së tij në një sanksion me kohëzgjatje të përcaktuar vetëm për faktin e zgjedhjes prej subjektit të këtij riti - fakt i cili gjithësesi nuk mund të shërbejë për të justifikuar suprimimin e aksesit total të subjektit juridik në këtë rit edhe në eventualitetin e dënimit të tij me gjobë.

Benefiti i vërtetë në këtë rast/të dënimit të subjektit me “Mbarim”, konsiston në vlerësimin diskrecional/prej gjykatës të zgjedhjes prej subjektit të këtij riti/të gjykimit të shkurtuar – që shpesh lexohet si një sinjal bashkëpunimi procesual.

Kolegji konsideron se në rastin konkret, drejt ka arsyetuar Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, e cila pamundësinë objektivisht formale, për të aplikuar uljen e dënimit me 1/3 – sipas nenit 406/1 të KPP – ndaj një dënimi eventual të mundshëm për tu caktuar për të pandehurit – persona juridike – të llojit - “*mbarimi i personit juridik*”- nuk e ka ngritur në nivelin e pamundësisë substanciale – (ndalesës ligjore) – të mohimit tout court të së drejtës së këtyre subjekteve/te pandehurve për të kërkuar dhe për tu gjykuar me ritin e posaçëm të gjykimit/te shkurtuar. Pra fakti se ndaj personit juridik të pandehur mund të caktohet si masë dënimi “mbarimi i tij” dhe ndaj kësaj mase objektivisht nuk mund të zbatohet ulja me 1/3, nuk përbën shkak apriori për mohimin e të drejtës së këtyre të pandehurve për të kërkuar dhe për tu gjykuar me ritin e gjykimit të posaçëm – të shkurtuar.

[...]Përveç sa më sipër, Kolegji lidhur me shkaqet e tjera e përvijuar konsideron se vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit, persa i përket konkluzionit për pamundësinë e aplikimit/zbatimit të ritit procedural të gjykimit të shkurtuar ndaj të pandehurve – persona juridike – është në kundërshtim edhe me praktikën/jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë¹⁴, e cila qartësisht ka evidentuar në cilësinë e zbatimit korrekt të ligjit procedural penal aksesin pa dallim/diskriminim edhe për subjektet/persona juridike në aplikimin e ritit procedural të

14 Shiko vendimet nr. 00-2023-630, datë 13.04.2023; nr. 6, datë 11.01.2024; nr. 00-2025-446, datë 18.03.2025, të tjera të cituar nga rekursuesit, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

gjykimit të shkurtuar. Mundësia eventuale që në përfundim të gjykimit ndaj të pandehurve persona juridik të caktohet si masë dënimi “mbarimi i personit juridik” parashikuar në ligjit nr. 9754, datë 14.06.2007 – nuk përbëjnë shkak për mohimin e të drejtave të tyre ligjore, në këtë drejtim. [...]

Prokurori – sipas konsideratës së këtij Kolegji mund të procedojë me kontestimet e akuzave të reja gjatë gjykimit - në konformitet me përcaktimet se neneve 373 dhe 374 të KPP – vetëm në rastet e modifikimit/ndryshimit të bazës njohëse mbështetëse të akuzës origjinale të përcjellë në gjykim nëpërmjet kërkesës për gjykim – të realizuar mbi bazën e shqyrtimit gjyqësor të çështjes /në bazë të gjykimit me ritin procedural të zakonshem – në një kohë që në hipotezën e zhvillimit të gjykimit me ritin procedural të gjykimit të shkurtuar kur kjo fazë e marrjes së provave mungon – dhe në të njëjtën kohë evidentohen kushtet për të kontestuar një akuzë të re/ fjala vjen nga aktet e hetimeve paraprake evidentohet/del një vepër penale e lidhur – e vetmja mundësi e prokurorit për të dokumentuar këtë realitet të pashmangshëm – mundësi që nuk ja toleron konteksti i zhvillimit të gjykimit ad quo me ritin procedural të gjykimit të shkurtuar – mbetet rregjistrimi i një procedimi të ri penal.

Mbi këtë bazë konsiderohet se në gjykimin e shkurtuar gjyqtari/i seancës paraprake i “konvertuar” në cilësinë e gjyqtarit të gjykimit të çështjes në themel me pranimin e këtij riti – megjithë mundësinë për të modifikuar/ndryshuar kualifikimin juridik – duhet të ushtrojë fuqinë vendimmarrëse të tij/të prononcohet vetëm përse i përket veprave penale për të cilat prokurori ka ushtruar ndjekjen penale – mbi bazën e kuadrit provues të përvijuar prej situatës ekzistuese.

Përfundimisht, Kolegji, konsideron se ne rekursi/set e paraqitur nga rekursuesit – (të pandehurit dhe Prokuroria e Posaçme), përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP, pasi, sikurse u sipërcitua, prej Gjykatës së Posaçme të Apelit nuk është zbatuar drejt ligji procedural penal lidhur me, gjykimin e shkurtuar dhe kufijtë e gjykimit të çështjes në shkallë të dytë të gjykimit. Për këtë arsye, Kolegji Penal, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “c”, konsideron se vendimi nr. [...] të Gjykatës së Posaçme të Apelit [...], duhet të priset dhe çështja (aktet) të kthehet, për rishqyrtim, në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës



GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË